



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 6 DHE 7 TETOR 2011

T R A N S K R I P T

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
6. i 7 OKTOBRA 2011. GODINE

TETOR - OKTOBAR
2011

E enjte, 6 tetor 2011, ora 10:00

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuari zëvendëskryeministër, ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë prezentë 75 deputetë, që do të thotë mund të fillojmë me rendin e ditës.

Pika e parë e rendit të kitës është:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimi në emër të grupeve parlamentare zgjat deri në 5 minuta, në emër të deputetit 3 minuta dhe ju e dini që replika nuk ka.

Vazhdojmë. Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka kërkuar deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: I nderuari zoti kryetar,
I nderuar zoti zëvendëskryeministër,
Të nderuar deputetë,
Zonja dhe zotërinj,

Edhe një herë me dhembje të thellë dhe të madhe dënojmë ashpër vrasjen e drejtorit të Drejtorisë komunale për Arsim në Prishtinë, zotit Remzi Salihu.

Në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, të Grupit Parlamentar, falënderojmë të gjithë ata që morën pjesë në ndarjen e dhimbjes me rastin e vrasjes së drejtorit, të gjitha institucionet e Kosovës, pa përjashtim.

Po ashtu, me keqardhje jemi të shtrënguar të reagojmë fuqishëm ndaj një pjese të deklaratës së “Vetëvendosjes”, të lëshuar një ditë pas vrasjes, gjegjësisht më 4 tetor.

LDK Konsideron se ajo deklaratë, gjegjësisht ajo pjesë, një pjesë e saj është e papërgjegjshme, fyese dhe sikur i jep të drejtë dorasit.

Po ua citoj vetëm në një pjesë se çfarë thonë: “Arsimi në komunën e Prishtinës, si kudo në Kosovë, ka kohë që është futur në kolaps, pa strategji dalëse dhe me rrezik për rrëshqitje drejtë dështimit të mundshëm”. Thotë po ashtu edhe në një pjesë të deklaratës “që ai është viktimë e defekteve, e politizimit”.

Në një deklaratë ku dënohet vrasja dhe të thuhet edhe këto, është e turpshme, të thuhet dhe atë në çfarë momenti. Disa zotërinj të “Vetëvendosjes” as që kanë qenë të lindur, as

që kanë pasur mundësi të shkojnë në shkollë, kur zoti Salihu ka filluar t'i edukojë brezat e rinj, të punojë për arsimin dhe arsimimin tonë.

Është shumë e pakuptueshme, pse jo edhe politikisht tragjike, aspak etike e aspak politike, kur në raste të tilla të rënda sikur tentohet të përfitohet. Këtu, të nderuar, askush nuk mund të përfitojë, të gjithë kemi humbur.

Zoti Salihu ka qenë i LDK-së, por kur është zgjedhur drejtor, ka punuar dhe është sjellë ashtu siç i ka hije një drejtori të të gjithë qytetarëve. Ashtu është sjellë, ashtu është vlerësuar nga të gjithë dhe gjithmonë.

Si LDK dhe qytetarë të Prishtinës e më gjerë, jemi të irrituar dhe të fyer me konstatime të tilla të bëra nga ata ose pjesa e atyre që janë vërtet të vegjël të vlerësojnë punën e madhe të zotit Salihu dhe të arsimit në përgjithësi.

Veçmas e fyer ndihet familja e respektuar Salihu. Këtë nuk e kanë merituar. Le të mbetet në ndërgjegjen e atyre, nëse e kanë atë, atyre që e kanë shkruar thjeshtë këtë pamflet. Ata, lëre që e kanë bërë deklaratën me një ditë vonesë, por më mirë ka qenë fare të mos deklarohen, se sa të deklarojnë atë që e kanë deklaruar. Koha do t'i vlerësojë. Thënë sinqerisht, nuk kemi besuar se në këto momente të rënda ka të tillë që mund të flasin diçka në këtë mënyrë. Kjo është një lloj verbërie politike e pakufishme.

Edhe një herë, ngushëllime familjes Salihu, qytetarëve, nxënësve, arsimtarëve dhe punëtorëve tjerë të arsimit të Prishtinës dhe më gjerë për vdekjen e drejtorit, zotit Salihu! Edhe njëherë, na vjen shumë keq që na është dashur në këtë mënyrë të reagojmë, të shtrënguar dhe të obliguar, si obligim karshi familjes, karshi veprës së madhe të zotit Salihu. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputeti, Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: I nderuar kryetar i Kuvendit të Kosovës,
Të nderuar anëtarë të Qeverisë,
Zëvendëskryeministër, ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,
Unë po flas në emër të Komisionit të përkohshëm për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe dëshiroj të informoj Kuvendin se komisioni ka kaluar në fazën e tretë të përgatitjes së ndryshimeve kushtetuese.

Që nga 4 tetori, komisioni ka hapur debatin publik, i cili do të zgjatë deri më 4 nëntor. Gjatë kësaj periudhe ne do të kemi tubime publike në 11 qytete të Kosovës për të marrë opinionet e qytetarëve para se Komisioni të fillojë ta finalizojë tekstin e amendamenteve kushtetuese, në mënyrë që brenda mandatit legal dhe brenda afatit kohor t'i dorëzohet Kuvendit të Kosovës pakoja e amendamenteve kushtetuese, bashkë me Ligjin për zgjedhjen e Presidentit.

Po ashtu, dëshiroj të informoj se komisioni në mënyrë konsensuale dhe unanime ka miratuar pakon e amendamenteve kushtetuese, e cila përfshinë kryesisht reformën që ka të bëjë me zgjedhjen e drejtpërdrejtë të Presidentit.

Ne kemi përfshirë një reformë që ndryshon disa nene, nga neni 85 deri te neni 92 dhe kemi paraparë zgjidhje të cilat janë arritur me konsensus. Në disa raste ne kemi paraparë edhe zgjidhje me alternativa.

Pas debatit publik, në bazë të asaj se cilat zgjidhje i mbështesin qytetarët, do të fillojë debati me partitë politike parlamentare, në mënyrë që komisioni ta finalizojë tekstin dhe para se të vijë në një votim në Kuvend, të arrijmë konsensus sa është e mundur për Kushtetutën, si aktin më të lartë të vendit.

Gjithashtu, në punën e komisionit kem kyçur edhe institucionet relevante ndërkombëtare. Kemi vendosur raporte me Komisioni e Venedikut dhe dëshirojmë që projekti i amendamenteve dhe i ligjit të kenë edhe mbështetjen e këtij komisioni të specializuar në çështjet e kushtetutës.

Është duke u përfunduar edhe Ligji për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të presidentit. Është një ligj organik, një ligj që për herë të parë e ka Kosova dhe komisioni është duke punuar në mënyrë që ky ligj të ketë të gjitha elementet që do të hapin mundësinë që Kosova të mbajë zgjedhjet e drejtpërdrejta presidenciale.

Do të donim të ftojmë deputetët e zonave, të qyteteve që të vinë në debate publike, sepse ne jemi duke i ftuar përmes partnerëve tanë që po e mbështesin këtë debat publik, që edhe deputetët e zonave të marrin pjesë në këto tubime, që të kemi kontakte të drejtpërdrejta me qytetarë, që të dëgjojmë opinionet e qytetarëve për të qenë më sigurt me rastin e diskutimit që do të bëhet në parlament.

Gjithashtu, ftojmë Kuvendin, Kryesinë e Kuvendit, grupet parlamentare që të mbështesin punën e këtij komisioni, që është një punë shumë e rëndësishme, është iniciativa kryesore legjislative që po e ndërmerret parlamenti, është proces shumë i rëndësishëm për çdo legjislaturë ndërrimi i kushtetutës dhe ne kërkojmë që ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

Unë i kisha lutur deputetët dhe grupet parlamentare që disa çështje, se dy çështje që u ngritën këtu, është dashur të shkojnë përmes Kryesisë së Kuvendit. Fjalën e ka deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Deputetë të nderuar,

Ajo për të cilën do të flas sot, pra në këtë pikë, është një çështje e cila ka natyrisht rëndësi jetike për qytetarët e Kosovës dhe në këtë pikë jam tërësisht përbrenda kornizës së

Rregullores së Punës së Kuvendit që e parasheh këtë, pra deklarimet jashtë rendit të ditës, si pikë ku duhen ngritur çështje të tilla.

Mirëpo, njëkohësisht kjo është edhe një çështje e cila duhet të jetë së paku pikë e rendit të ditës, por më se e zakonshme do të kishte qenë që të jetë një seancë e tërë debati dhe për këtë e kemi pasur të pamundur ta thërrasim meqenëse nuk ka pasur gatishmëri nga ju, pra, deputetët e Kuvendit të Kosovës, si dhe nga grupet parlamentare për një gjë të tillë, gjë që më shtyrë ta ngrejë si çështje në këtë pikë të rendit të ditës. Këtu jam i vetëdijshëm se jam jashtë kornizës së Rregullores së Punës, por njëkohësisht jam brenda interesit të qytetarëve dhe brenda logjikës së ekzistimit të Kuvendit, si organ më i lartë legjislativ dhe politik i vendit.

Situata në veri të Kosovës nuk është as mirë e as duke u përmirësuar. Prej kohës së fundit, që e kemi diskutuar këtë çështje këtu në Kuvend, shumë gjëra për të keq kanë ndodhur atje. Janë sulmuar qytetarët e paktë shqiptarë që kanë mbetur atje, janë zbrapsur tërësisht institucionet e rendit që janë të Kosovës, janë shtuar dhe forcuar barrikadat nëpër rrugë. Dhe në tërë këtë situatë, Qeveria e Kosovës, e më së shumti kryeministri Thaçi, për çdo ditë dalin në televizor dhe tentojnë t'i bindin qytetarët se në veri po shënojmë vetëm suksese dhe se sovraniteti dhe integriteti territorial në atë pjesë të vendit na qenka i garantuar. Atje e kemi një situatë të nder të sigurisë, e këtij na thuhet që të mos brengosemi sepse për veriun jemi të sigurt. Kush është i sigurt dhe, më me rëndësi, për çka jemi të sigurt? Këto janë pyetje të cilat nuk shtrohen dhe për të cilat nuk jepen përgjigje.

Arsyetimi i mos thirrjes së një seance të tillë për veriun, që më është dhënë nga një pjesë e konsiderueshme e grupeve parlamentare, ka qenë ndjeshmëria e situatës atje dhe një lloj besimi në forcat e KFOR-it dhe EULEX-it për ta kryer punën. Pra, kemi një zbrapsje nga përgjegjësia në njërin anë, dhe një shpërthim të pakuptimtë të besimit në EULEX-in, besim ky i cili deri vonë, të paktën deklarativisht, kishte filluar të zbehet madje edhe të vetë qeveritarët e Kosovës. Deri dje EULEX-i kritikohet për neglizhencë dhe paaftësi në kryerjen e punës nga Qeveria e Kosovës, ndërkohë që sot na thuhet se të gjitha shpresat për veriun janë varur në të dhe në KFOR-in.

Ministri i rendit deklaroi se barrikadat në veri do të tolerohen deri sa t'i tolerojë ato EULEX-i. Kjo edhe një herë e konfirmon pikërisht atë që e kemi thënë ne, pra lëvizja “Vetëvendosje” që prej momentit kur është arritur marrëveshja për tërheqje nga veriu, se Qeveria e Kosovës po ia bartë përgjegjësitë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

Po duhet lajmëruar në fillim se e ke fjalën në emër të grupit!

Realisht, ti duhet të lajmërosh, se ne nuk po e dimë. Si të lajmërohesh, regjia vetë t'i jep 5 minuta. Regjia, ia vazhdoni 2 minuta!

VISAR YMERY: Mungesa e gatishmërisë për të debatuar për këtë çështje në Kuvend ka për qëllim ta shndërrojë edhe Kuvendin në një spektator të tillë, çfarë është shndërruar Qeveria, ndërkohë që debatin e kemi zhvendosur në media. Nuk ka natë që nëpër mediat televizive të mos kemi paraqitje të ndryshme të kryeministrit Thaçi, ku ai flet për veriu, përkundër ndjeshmërisë së situatës. Kjo nënkupton se nuk është problemi edhe aq te çështja, sa është te protagonistin e çështjes, në këtë rast Hashim Thaçi, për shkak se ky nuk është i gatshëm të ballafaqohet për këtë çështje me deputetët e padëgjueshëm, të cilët nuk i blejnë ato që ai i shet si të vërteta. Më shumë është i interesuar të diskutojë me gazetarë të dëgjueshëm, të cilët aktrojnë se i besojnë në çdo gjë. Pra, Thaçi nuk ka gatishmëri t'u përgjigjet pyetjeve të deputetëve të cilat e sfidojnë, por atyre të gazetarëve të përzgjedhur, të cilat vetëm se e lëmojnë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Vesna Nikiq.

VESNA NIKIĆ: Hvala, vam!

Gospodine predsjedniče,

Poštovani poslanici,

Dame i gospodo,

Koristim ovu priliku da iskažem ogromno nezadovoljstvo srpske zajednice rezultirano usled neprofesionalnog obavljanja dužnosti policijskih službi, odnosno policijskih patrola, pripadnika takozvane zelene linije u regionu Gnjilana.

Naime, prošlog meseca smo dobili nekoliko prijava gde su pripadnici te službe pribegli primeni sile, primenjujući psiko-fizičku torturu i pored toga što je na uvid data uredna dokumentacija uz šamaranje, omolovažavanje, obaranje na zemlju i šutiranje nogama.

Svi znamo da je život srpske zajednice i srpske omladine sveden na seosku sredinu punih 12. godina, pa je neverovatno da je i to zasmetalo nekim ekstremnim strujama unutar ove policijske službe, pa da i život srpske zajednice i srpske zajednice i srpske omladine svede na kućni pritvor.

Gospodo, ako je ovo neki novi vid demokratije koji potire definiciju da je demokratija poštovanje tuđeg identiteta i dostojanstva, onda vam ja u ime moje i u ime moje zajednice poručujem da Srbi više neće ćutati pod ovakvim nasiljem, da Srbi više neće saginjati glavu da ih tretirate kao građane drugog reda, da se Srbi više neće zadovoljavati onim što im na kašićicu dajete mimo onoga što im pripada i mimo onoga što je zakonom regulisano.

Izgleda da smo čekajući bolji status srpske zajednice integrisanjem u kosovske institucije dobili samo status glinenih golubova, gde nad nama može i najmlađi Albanac uvežbavati streljaštvo.

Ja se nadam da ćete i vi Srbi moji iz SLS-a, naročito mislim na Srbe koji su u lokalnoj samoupravi, u mesto što svakodnevno pokušavaju da blokiraju rad srpske decentralizovane opštine, poboljšaju, u stvari urade nešto na poboljšanju položaja srpske

zajednice i da ne gledaju više dali neko pripada SLS-u ili nekoj drugoj političkoj opciji i da se ne trude da iz izigravaju veće Albance od samih Albanaca, jer on koji ne poštuju svoju veru, ne može poštovati ni tuđu.

Gospodo, zbog sve veće eskalacije nasilja nad srpskom zajednicom, zbog flagrantnog kršenja ljudskih prava mislim da bi zaista Srbi sa severa Kosova mogli da izvuku pouku na našem primeru integracije koji se očigledno pokazao kao veoma loš, i ni na koji način ne prihvate ovakav model integrisanja, jer smatram s obzirom da na severu građanstvo je gotovo stopostotno srpske nacionalnosti, ima potpuno i legitimno pravo da samo odluči kome će se i kada prikloniti i da sami odlučuju o svojoj sudbini.

Ako se samo na trenutak vratimo u nazad, to im daje za pravo što Kosovo je dobilo tek 45. godine...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!
Arben Gashi e ka fjalën!

ARBEN GASHI: Faleminderit!
Të nderuar deputetë,
Unë do të flas për një çështje të rëndësishme siç është çështja e veriut të Kosovës.

Besoj që të gjithë jemi të njoftuar dhe të vetëdijshëm se LDK ka mbështetur veprimet e Bashkësisë Ndërkombëtare të Policisë së Kosovës për vendosjen e rendit në veri. LDK po ashtu mbështet çdo lëvizje që shënon përparim në shtrirjen e autoritetit dhe të sovranitetit shtetëror në këtë pjesë të Kosovës.

Mirëpo, lëvizjet e fundit, ndonëse në shikim të parë premtuese, po dalin jo efektive, të paplanifikuara dhe me rrezik për të ardhmen e veriut të vendit.

Përveç një euferie mediave, rezultatet e këtyre aksioneve ende janë të paqarta. Aksioni policor i 25 korrikut ishte i dështuar në aspektin operacional, policia u tërhoq dhe ishte vetëm KFOR-i ai që shpëtoi Kosovën nga një debakël i plotë. As rivendosja njëfarë kontrolli në pikat kufitare 1 dhe 31, më 16 shtator, kësaj radhe i planifikuar dhe i koordinuar me Bashkësinë Ndërkombëtare, nuk është se ndryshoi diçka thellësisht.

Veriu mbetet i bllokuar, pikat të bllokuara, trafiku i bllokuar, grupet kriminale të lira të bëjnë ligjin atje, ndërkohë që kryeministri vazhdon të krekoset thuaj se në Bërnjak dhe Jarinjë po valon i lirë flamuri shtetëror i Kosovës.

Ne e kuptojmë që vendosja e rendit shtetëror në veri nuk mund të bëhet brenda një jave ose një muaji, kanë kaluar 12 vjet që kjo situatë është krijuar atje. Këto struktura ilegale kriminale të ndërtuara me vite kërkojnë kohë për t'u çmontuar.

Por kërkojmë nga kryeministri t'i ndërpres këto adresime huazi-patriotike këtu në Kuvend dhe të mos krekoset për diçka që nuk i takon. Të mos përpiqet të përvetësojë

merita për diçka që nuk e ka bërë. Në qoftë se veriu do të kthehet në kontrollin e autoriteteve të Kosovës dhe kjo sot nuk mund të thuhet se është bërë, atëherë ne do t'ju aplaudojmë ju, zoti kryeministër për meritat që i keni, sepse ju jeni bërë edhe shëf i policisë dhe si i tillë do t'ju themi bravo! Por, aplaudimin e keni të garantuar për aq sa e meritoni, por sot nuk është koha për aplaudime dhe rrahagjokës. Sot është koha për veprime të vendosura, të koordinuara dhe të planifikuara.

Dhe, në këtë drejtim kam një pyetje për kryeministrin: Cili është plani i juaj afatshkurtër për veriun, çka do të bëni me barrikadat, si do të garantoni prezencën e vazhdueshme të zyrtarëve të Kosovës në vendkalimet kufitare?

Në fund fare, kryeministër, kryeministri duhet të tregojë se cili është plani afatgjatë strategjik për veriun. Dua që kryeministri të zotohet këtu para këtij Kuvendi që asnjë rirregullim territorial dhe administrativ nuk do të pranohet si zgjidhje për veriun. Ky Kuvend nuk do të pranojë një aranzhim të tillë, të jeni sigurt.

Nëse keni pasur për qëllim që përmes eskalimit të situatës në veri të krijohen kushte për të zgjidhur një problem përmes një marrëveshje të re që ofron një zgjidhje autonome jashtë kushtetutës, të jeni të sigurt që po shkoni drejt tradhtisë kombëtare.

Ne e kuptojmë që Kosova me kapacitetet policore që ka dhe ushtarake, ekonomike e politike e ka të vështirë të vendosë rendin dhe sovranitetin shtetëror në veri, por nëse e kemi vështirë sot, nuk do të thotë se e kemi të pamundur nesër...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

Vazhdojmë. Deputeti Xhavit Haliti e ka fjalën.

XHAVIT HALITI: Faleminderit!

Unë dola për një çështje tjetër, por nuk po mund të mos e them atë që ne e kemi autorizuar Qeverinë që të veprojë në veri, dhe mendoj që nuk është i deklaruar akoma i përfunduar aksioni në veri.

Unë dola për një çështje krejt të regjionit nga vij, krejt të arsyeshme mendoj për qytetarët atje. Ju e dini që ekosistemi i lumit Drini i Bardhë është shkatërruar po thuaj se nga Prizreni e deri ku e ka burimin përfaqësisht. Burimi i Drinit është qendra më e vizituar dhe qendra më turistike në Kosovë.

Realisht, atje po ndodhë një katastrofë ekologjike, së pari e bërë nga Kuvendi Komunal, i cili e ka mashtrua USAID-in për ta betonuar burimin e Drinit.

Tani, e dyta, është hidrocentrali, i cili në mënyrë të paligjshme ka dyfishuar kapacitetin e marrjes së ujit dhe ka lënë disa fshatra pa ujë.

Së treti, mendoj që shkelje e të drejtave të njeriut është kur në mënyrë të padrejtë tri fshatrave ju ndalohej uji i pijes për shkak se nuk është paguar energjia elektrike për pompat të cilat e përcjellin ujin e pijshëm për fshatrat Jabllanicë e Madhe, Jabllanicë e Vogël dhe një pjesë e Radavcit.

Po them, ndryshimi i rrjedhës së lumit, i cili ka qenë historikisht i planifikuar, tani me këtë që po ndodhë po lë jashtë sistemin ujitës, po e shkatërron për fshatrat Novosellë, Vitomiricë, Sigë, Brestovik dhe po e favorizon një hidrocentral, i cili fiton për interesa të tij. Kisha kërkuar që komisionet në fjalë dhe ministri në fjalë, i cili është i obliguar që të marrë parasysh, qoftë vendimet e KEK-ut për ta ndalë energjinë elektrike dhe për t'ua ndalë ujin qytetarëve, qoftë çështjen tjetër të prishjes së rrjedhjes së lumit për ta favorizuar një hidrocentral padrejtësisht, i cili ka punuar 6 muaj kur ka pasur ujë dhe 6 muaj s'ka punuar në kohën e verës, kur kanë pasur nevojë qytetarët për ujitje. Mendoj që duhet të shikohet edhe kontrata e cila është me hidrocentralin dhe me Hidrodrinin dhe kjo çështje duhet të trajtohet seriozisht dhe konsideroj që ndalja, ndërprerja e ujit për shkak të mos pagesës së pompave, të cilat janë obligim i marrëveshjes në mes dy ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

Çështje e ngritur tamam për këtë pikë të rendit të ditës.

Fjalën e ka deputeti Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Faleminderit!

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

S'ka shumë ditë që kur kryeministri Thaçi ka dhënë një deklaratë më shumë në neveritëse, se sa pompoze për lëvizjen "Vetëvendosje". Aksionin e rrotullimit të kamionëve me mallra të Serbisë, kryeministri e ka quajtur plaçkitje.

Neve na është dukur vërtet interesant se si njeriu i cili e ka shndërruar plaçkitjen e popullit në qeverisje profesionale, i akuzon të tjerët për hajni, sepse kryeministri ynë duhet të mbahet përgjegjës për ndërtimin e një sistemi të atillë qeverisës, në të cilin korrupsioni është bërë dukuri e institucionalizuar masive dhe sistematike.

Në vitin 2009, u pat krijuar Task-forca antikorrupsion, kurse një vit pas, pra në vitin 2010, rezultatet ishin të mjerueshme. Përderisa në vitin kur u krijua kjo task-forcë, Kosova sipas indeksit të korrupsionit në botë ndodhi në vendin e 90-të, një vit pasi u krijua kjo task-forcë antikorrupsion, Kosova për korrupsion ndodhi në vendin 119 dhe kjo tregon për luftën e qeverisë ndaj plaçkitjes.

Ky sistem qeverisës i plaçkit qytetarët në baza ditore, sepse për ta realizuar sot një shërbim të garantuar me ligj, shpeshherë detyrohesh të japësh ryshfet dhe këtë e kanë thënë edhe vetë qytetarët nëpër sondazhe të ndryshme dhe nëpër anketa që zakonisht bëhen në Kosovë.

Pastaj, paratë e qytetarëve të varfër të Kosovës janë shfrytëzuar për ta mbajtur financiarisht një rrjet të gjerë agjentësh informal që urdhërojnë, kushtëzojnë, shantazhojnë, punësojnë e shpunësojnë.

Kompanitë tona publike po ashtu janë plaçkitur si mos më keq, përpara se të falen. Edhe diaspora jonë e vyer po plaçkitet, sepse për çdo veturë të tyre që hynë në Kosovë, Qeveria ua merr nga 50 euro.

Kryeministri po merret me lëvizjen “Vetëvendosje”, në vend që të merret me mallrat e Serbisë. Kjo qeveri në njërin anë i lejon kamionët e Veselinoviqit dhe i quan plaçkitës ata që i sulmojnë kamionët me mallra të Serbisë. Plaçkitje është t’ua marrësh paratë qytetarëve dhe t’i harxhosh duke krijuar komuna të reja pa nevojë, në vend që t’i dedikosh këto para për zhvillim ekonomik, për arsim më të mirë dhe shëndetësi cilësor.

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Nazane Breca.

NAZANE BRECA: Faleminderit!

I nderuari kryetar, deputetë dhe ministra,

Në secilin shtet demokratik përpilimi dhe miratimi i ligjeve bëhet me të vetmin qëllim që ato të vënë rregull dhe të jenë të zbatueshëm. E njëjta gjë shpresojmë se duhet të ndodhë edhe në vendin tonë, shtet të ri dhe të brishtë.

Përpilimi dhe miratimi i shumë ligjeve tona bëhet me shumë rezistencë dhe vështirësi, me apo pa qëllim. Kur ligji miratohet nga parlamenti ynë, ai obligon që të zbatohet nga të gjithë pa përjashtime, kuptohet edhe nga vetë qeveritarët, zyrtarët e lartë të shtetit, përfshirë edhe kabinetin e ministrave.

Ligjet e miratuara nga deputetët e parlamentit fillimisht shkelen nga vetë ministrat, në anën tjetër kërkojmë korrektësi dhe respektim të ligjeve nga të tjerët.

Ligji i punës 03/2312, në nenin 46, mbrojtja e femrave të punësuar, pika 1, thotë: “Femrës shtatzënë dhe gjdhënëse i ndalohet të bëjë punë, e cila është e përcaktuar si e dëmshme për shëndetin e nënës apo të fëmijës”. Bazuar edhe në konventat ndërkombëtare më të avancuara, si për shembull ato të Organizatës Botërore të Shëndetësisë për Gjdhënie, nëna obligohet ta ushqej fëmijën e saj ekskluzivisht në gjë në periudhën 6 mujore, ndërsa gjdhënia mund të vazhdojë deri 2 vite, duke shtuar edhe ushqime plotësuese.

Po e cek edhe një herë se brenda kësaj periudhe 6 mujore, nëna duhet ta ushqej fëmijën e saj ekskluzivisht vetëm në gjë në kohë dhe në termine të caktuara.

Pyes ministren Mimoza Lila - Kusari, si është e mundur që ajo të dalë në punë vetëm disa ditë pas lindjes dhe të bëjë fillimisht shkelje të ligjit, por mbi të gjitha shkeljen e të drejtës së fëmijës së vet të porsalindur.

Marrja e foshnjës në vendin e punës tregon edhe një shkelje të radhës, marrë parasysh ambientin e punës me shumë frekuencë dhe mundësinë e rrezikimit të shëndetit të tij nga infeksionet e ndryshe, edhe përkundër asaj se nëna ia përcjell imunitetin fëmijës së vet përmes qumështit, pikërisht nëpërmes gjidhënies.

Ju lutem, zonja ministre, të paktën lexojeni dhe konsultojeni Ligjin nr. 02L/81, Ligji për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri.

Kuptojmë gjendjen kur nënat që posa kanë lindur, për shkaqe të ndryshme shëndetësore nuk kanë mundësi ta ushqejnë fëmijën me gjë, por gjithashtu kuptojmë nxitjen, stimulimin dhe edukimin shëndetësor të nënave të reja që të praktikojnë gjidhënien si formë më të mirë, më higjienike dhe më të lirë për rritjen e fëmijës së shëndoshë, pikërisht nga gratë intelektuale edhe pse jo - të pushtetit. Shembulli i tillë edhe të tjerë që janë bërë përditshmëri në shtetin tonë, tregojnë se sa shumë respektojnë të drejtat e fëmijëve dhe individit, si dhe sa shumë shkelen ligjet po nga zyrtarët të cilët kërkojnë zbatimin e tyre nga të tjerët.

Të nderuar,

Le të kuptohet kjo deklaratë jo si sulm personal nga ministres Kusari - Lila, por si sugjerim i im, si nënë dhe mjeke, se mbi shëndetin dhe të drejtat e fëmijës nuk mund të vihet asgjë, ngase edhe vetë perëndia na e ka dhënë këtë krijesë aq të çmuar dhe të çiltër që ne të kujdesemi dhe ta mbrojmë atë derisa ai të bëhet i zoti i vetes. Deri atëherë, duhet ta mbrojmë, rrisim dhe edukojmë, të di të respektojë edhe ligjet të cilat baballarët e tyre i thenin kur ata ishin fare të vegjël, qoftë edhe foshnje. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti i fundit për sot është Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë,

Sot këtu u diskutua për një çështje e cila vërtet është çështja më e ndjeshme, problemi më i prekshëm jo vetëm për ne, por për gjithë qytetarët e Kosovës në Kosovës e pas luftës, për veriun e vendit, për ruajtjen dhe garantimin e tërësisë territoriale të vendit.

Në Parlamentin e Kosovës, pikërisht ne këtu nga kjo foltore kemi debatuar gjer e gjatë për këtë çështje dhe kemi shprehur shqetësimet tona që të gjithë. Kemi kërkuar fuqishëm nga Qeveria e Kosovës që të kalojë në veprim dhe Qeveria e Kosovës ka kaluar në veprim, në bashkëkoordinim me të gjithë faktorët relevantë në Kosovë që të mbështesin Qeverinë dhe vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë një vendim më 25 korrik, që lirisht mund të themi se është vendim historik dhe se ka ndryshuar pozitivisht realitetin në Kosovë. Ka krijuar një realitet të ri në veriun e vendit, ka arritur suksesshëm në bashkëpunim me KFOR-in dhe faktorët e tjerë ndihmues, në bashkëkoordinim, që të sigurojë tërësinë territoriale të vendit.

Ju lutem, duhet një herë e përgjithmonë të mësohemi se me çështje kur janë në pyetje çështjet me interes nacional, nuk guxojmë që këto të lejojmë t'i shfrytëzojmë për interesat e ngushta grupe, individuale apo partiake.

Përsëritet vendimin, gjegjësisht rezolutën e nxjerrë nga ky Kuvend, ku i është dhënë mbështetje e fuqishme Qeverisë së Republikës së Kosovës për të vazhduar më tutje.

Tash, kur Qeveria e Republikës së Kosovës është në pjesën operative, pse dalin zëra dhe e kundërshtojnë një gjë të tillë. Këtu është vetëm një pyetje. Mos kanë nostalgji për të kaluarën, mos po ju vjen keq pse Qeveria e Kosovës po e futë në kontroll tërë tërësinë territoriale të vendit, apo në këtë formë po shprehet një keqardhje e cila i dëmton interesat e qytetarëve të vendit.

Nuk mund të ndërtohet shteti, nuk mund të zhvillohet vendi duke u dëmtuar prona private, duke dhënë shembuj negativ para krejt opinionit të vendit në regjion dhe në botë. Ne duhet të jemi shembull i mirë. Askujt prej nesh nuk i intereson që atje të derdhet gjak. Ka kaluar koha kur ishte e domosdoshme që të përdoret forca. Kemi kaluar në fazën, në luftën politike dhe ne e kemi mbështetur fuqishëm. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i jep edhe sot mbështetje Qeverisë së Republikës së Kosovës, mbështet aksionet e KFOR-it dhe dënon dhunën që është ushtruar kundër pjesëtarëve ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, edhe pse kjo pikë e rendit të ditës është për çështje pak më të ftohta!

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me nenin 45.1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetjet e deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta. Deputetët për një mbledhje mund të parashtrojnë më së shumti 2 pyetje parlamentare.

Deputeti Fadil Demaku, pyetje për ministrin Dardan Gashi. Deputet, e ke fjalën!

FADIL DEMAKU: I nderuari kryetar i Kuvendit,

I nderuari zoti kryeministër,

Kështu desha të bëjë një përshëndetje më të veçantë, se kolegët nga opozita kishin qenë shumë në formë për të kundërshtuar dhe s'përshëndeti kush.

Përshëndetje për zëvendëskryeministrat, ministrat,

Të nderuar deputetë,

Pyetje për ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, zotin Dardan Gashi.

I nderuar ministër,

Duke pasur parasysh problemin e ndotjes së mjedisit në Republikën e Kosovë, e sidomos në komunat Kastriot, Mitrovicë, Drenas, Hani i Elezit e të tjerë, ku operojnë industrinë e mëdha, do të ishte me interes që të dinim se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor cilët hapa konkret ka ndërmarrë deri tani dhe çfarë strategjie ka për të ardhmen?

Në një prononcim tuajin po thuaj se 3 muaj më përpara, keni deklaruar, aty kam qenë edhe vetë prezent, se Ministria e Mjedisit do të angazhojë një kompani ndërkombëtare për matjen e nivelit të ndotjes dhe do të dëshiroja të dija se a është ndërmarrë diçka deri më tani në këtë drejtim dhe përse ministria ka vendosur që të angazhojë një kompani ndërkombëtare?

Si arsyetim të kësaj, kemi shqetësime të mëdha për parametrat e ndotjes në vendin tonë, pastaj kemi shqetësimet e qytetarëve, të shoqërisë civile, të deputetëve e tjerë. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI DARDAN GASHI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari zoti kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Kolegë të Kabinetit qeveritar,

Sa i përket pyetjes, siç e kam lexuar edhe me shkrim, në pyetje nuk është vetëm Ferronikeli, por i kishit pyetjet për disa komuna që janë të afektuara, do të thotë komuna e Drenasit nga operatori Ferronikeli, komuna e Hanit të Elezit dhe disa komuna tjera.

Pra, siç besoj se jeni të informuar, në muajin shtator ministria ka lëshuar padi ndaj operatorit Ferronikeli në komunën e Drenasit për shkarkime të jashtëligjshme në ajrin e asaj komune, do të thotë për ndotjen në atë komunë. Po ashtu, në komunën e Hanit të Elezit, për operatorin Sharrcem.

Në diskutime të drejtpërdrejta me KEK-un, është arritur marrëveshja që për “Kosovën A” deri në muajin mars të vendosen filtra, të cilët do të ndalojnë dhe do të parandalojnë shkarkimet e deritashme të kësaj kompanie në ajër.

Jemi në dialog të përhershëm, pra, me gjithë operatorët që të përmirësohet gjendja. Sa i përket arsyes pse kemi kërkuar që të angazhohet edhe një kompani e tretë, është për shkak se ne nuk kemi qenë të bindur se matjet të cilat ka ndodhur deri tash, kanë qenë të kualitetit me të cilat ne kemi mund të shkojmë para gjyqeve, po ndërkohë i kemi përmirësuar edhe parametrat e matjeve të ministrisë sonë dhe njëkohësisht jemi në negociata që një kompani e huaj gjatë javëve, muajve të ardhshme të vijë në Kosovë.

Pra, ne jemi të përkushtuar që Ligji për mbrojtjen e mjedisit të zbatohet në tërësi dhe këto padi nuk janë të fundit, janë të parat dhe do të vazhdojmë me këtë ritëm. Ju faleminderit!

KRYETARI: Keni pyetje shtesë? Faleminderit!

Vazhdojmë. Deputeti Hashim Deshishku, pyetje për ministrin Bedri Hamza. Deputet, e ke fjalën!

HASHIM DESHISHKU: I nderuari kryetar i Parlamentit,
I nderuar kryeministër,
Të nderuar deputetë,
Më 17 dhjetor të vitit të kaluar, Gjykata Kushtetuese e Kosovës e shpall të pranueshëm kërkesën e punëtorëve të Fabrikës së tubave të Ferizajt.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, ka qenë i drejtë edhe juridikisht i pakontestueshëm vendimi i Gjykatës Komunale të Ferizajt, me numër 340/2011. Ajo ka miratuar kërkesën e 572 punëtorëve të kësaj ndërmarrje shoqërore për kompensimin e rrogave të papaguara në një shumë të përgjithshme prej 25.649.250 euro, plus 3% interesi nga viti 2002.

Kjo gjykatë konsideron se vendimi final dhe i detyrueshëm i Gjykatës Komunale të Ferizajt duhet të ekzekutohet nga autoritet kompetente, në veçanti nga Qeveria dhe nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit, pasues tashmë AKM-së.

Po ashtu, Qeveria dhe AKP-ja duhet të dorëzojnë në gjykatë në afat brenda 6 muajsh lidhur me masat e ndërmarra për ekzekutimin e këtij aktgjykimi.

Pyetja ime është për zotin ministër, Bedri Hamza. Me qenë se afati përfundimtar për dorëzimin e kësaj informate ka qenë mesi i qershorit, kurse tash jemi në mesin e tetorit, më intereson të di se a e keni shqyrtuar këtë aktgjykim dhe a e keni informuar Gjykatën Kushtetuese për masën që ka ndërmarrë. Nëse po, kur dhe çfarë masa keni ndërmarrë, po ashtu a keni analizuar cilat burime do të shfrytëzohen për kompensimin e këtyre pagave? Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!
I nderuari zoti kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,
Të nderuar deputetë,
Deputet Deshishku, faleminderit për pyetjen, po qysh në fillim më lejoni të theksoj dhe sqaroj se kjo nuk është përgjegjësi e Ministrisë së Financave dhe nuk ka të bëjë me Ministrinë e Financave.

Por, sidoqoftë, me këtë rast dëshiroj të sqaroj se rastin e ankesës së Sindikatës së Pavarur të Punonjësve të Fabrikës së Çelikut IMK Ferizaj e ka vendosur Gjykata Komunale në Ferizaj qysh në vitin 2002. Më vonë, Agjencia Kosovare e Privatizimit i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të Gjykatës Komunale të Ferizajt, numër 340/2001 të 11 janarit 2002.

Gjykata Kushtetuese, më 12 maj 2011, ka dhënë sqarim dhe ashtu siç shihet në pikën 10 të sqarimit të aktgjykimit në rastin numër K.I. 08/09, decidivisht thekson, citoj: “Sipas Ligjit për AKP, shihet që AKP-ja është autoriteti që administron ndërmarrjen shoqërore

dhe që AKP-ja do t'i përmbushë pretendimet e vlefshme të kreditorëve që kanë të bëjnë me ndërmarrje shoqërore nga mjetet e realizuara nga administrimi, shitja, transferimi ose likuidimi i ndërmarrjeve ose aseteve të tilla.

Pasi këto mjete të realizuara mbahen mirëbesim dhe në të mirë të kreditorëve përkatës nga AKP-ja, AKP-ja mund të jetë e vetmja dhe tërësisht përgjegjëse për zbatimin e vendimit të Gjykatës Komunale të Ferizajt, numër 340/2001, më 11 janar 2002. Varësisht nëse edhe në çfarë mënyre pasardhësja e asaj, AKP-ja veprimi gjatë këtyre 9 viteve të fundit lidhur me aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe respektimin e ligjit të zbatueshëm. Dhe nga kjo, Gjykata Kushtetuese ka qenë mjaftë e qartë, domethënë përgjegjësi është e AKP-së, i ka fondet në mirëbesim, pas procesit të likuidimit duhet t'i kompensojë kreditorët potencialë. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputet, ke pyetje shtesë? Faleminderit!

Deputetja Hikmete Bajrami, pyetje për ministrin Ferid Agani. Ju njoftoj se ministri Ferid Agani ka njoftuar se është në udhëtim zyrtar dhe nuk mund t'u përgjigjet pyetjeve të deputetëve për sot. Deputetja, a është këtu, po më duket nuk është as deputetja.

Vazhdojmë, Deputetja Blerta Deliu Kodra, pyetje për ministrin Dardan Gashi. Deputete, e ke fjalën!

BLERTA DELIU KODRA: Unë tash morra përgjigje nga ministri Gashi, deputeti Demaku kërkoi pothuaj se pyetjen e njëjtë. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Nazane Breca, pyetje për ministrin Ferid Agani. Deputete, dëshiron ta lexosh pyetjen? Mirë, faleminderit!

Po vazhdojmë me pyetjen e fundit. Deputetja Alma Lama, pyetje për kryeministrin zotin Hashim Thaçi, kryeministri doli jashtë. Alma, doni ta lexoni pyetjen? Regjia, fjalën deputetes Alma Lama!

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Qeveria e Kosovës, e cila ka marrë mandatin në mars të këtij viti, vazhdon të funksionojë pa zëdhënës, duke vështirësuar shumë punën e gazetarëve.

Mungesa e zëdhënësit të Qeverisë nga vetë gazetarët interpretohet si tentativë për t'i ikur qëllimisht dhënies së informacioneve të rëndësishme për publikun, të cilat kanë të bëjnë me performancën qeverisëse.

Transparenca ndaj publikut është një nga normat kryesore të funksionimit të demokracisë dhe çdo institucion është i detyruar edhe me Kushtetutën e Kosovës ta respektojë pra këtë rregull.

Prandaj, pyetja që i drejtoj kryeministrit të Kosovës është kjo: Përse i shmangeni kësaj norme të demokracisë, pra të transparencës, duke mos emëruar një zëdhënës i cili është

shumë i nevojshëm për punën e gazetarëve dhe të hapni dyer të institucionit për publikun, dyer të cilat tashmë janë të mbyllura. Duhet të keni parasysh se deklaratat që vinë prej jush apo kabinetit tuaj qeveritar, nuk janë informacion, por deklarata politike? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Pyetjet e deputetëve që nuk morën përgjigje në dy seanca plenare do të publikohen në revistën e Kuvendit, sipas nenit 45, paragrafi 11 të Rregullores së Kuvendit.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22 shtator 2011

Pyes, nëse ka vërejtje në këtë procesverbal?

Në seancë kemi 70 deputetë.

Nëse nuk ka vërejtje, konstatoj se Kuvendi miratoi Procesverbalin e mbledhjes plenare të mbajtur më 22 shtator 2011.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sistemin e adresave

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime, për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrin e Punëve të Brendshme... Urdhëro, fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti!

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Unë e kërkoja fjalën para se të fillojmë shqyrtimin e ligjeve, sepse i kemi një mori ligjesh në lexim të parë, por edhe në të dytin. Është qëndrim i yni i Grupit Parlamentar që të mos shqyrtohen në Kuvendin e Republikës së Kosovës projektligjet të cilat nuk i plotësojnë kushtet në bazë të Rregullores në fuqi të Kuvendit, që i bie: jo ligjet që nuk e kanë të definuar koston financiare, jo ligjet që nuk e kanë të përcaktuar qoftë me një nen kur fillon zbatimi i tyre, jo ligjet që nuk i kalojnë pozitivisht dy komisionet e përhershme themelore parlamentare, që është ai i ligjeve dhe i buxhetit. Pse them këtë? Sepse po na kalojnë ligjet nga dëshira që të kalojnë projektligjet të cilat faktikisht janë formal, sepse nuk hyjnë në përdorim. Ligjet kodifikojnë veprimtari të cilat janë të dobishme këtu dhe tash të kodifikohen. Nuk ka kurrfarë kuptimi që për të krijuar numra, të kalojmë ligje dhe projektligje që nuk hyjnë në zbatim. Ne deri tash kemi kaluar të tillë, sidomos në pjesë të tyre.

Apeli ynë është që kjo më të mos ndodhë, të mos japë Qeveria në Kuvend projektligje pa i pas parë nevojat e zbatimit të tyre menjëherë dhe të mos kalojnë në Kuvend projektligjet që nuk i plotësojnë kushtet në bazë të Rregullores së Kuvendit. Kjo vlen për të gjitha, prandaj desha para se të fillojmë. Faleminderit!

KRYETARI: faleminderit, deputet!

Ministër Rexhepi, në emër të Qeverisë e prezanton Projektligjin për sistemin e adresave.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: I nderuar kryetar i Parlamentit,

Zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejon të prezantoj para jush Projektligjin për sistemin e adresave, i sponzoruar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Projektligji për sistemin e adresave është hartuar duke u bazuar në Strategjinë legjislativë të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2011 dhe në pajtim të plotë me Rregulloren e Punës së Qeverisë, numër 1/2007.

Arsyeja për hartimin e këtij projektligji është sepse deri më tani nuk ka pasur ndonjë ligj i cili e ka rregulluar këtë çështje në Republikën e Kosovës.

Ky projektligj siguron krijimin e një sistemi të unifikuar të adresave zyrtare në Republikën e Kosovës.

Sistemi i unifikuar i adresave do të sigurojë që të gjitha institucionet publike, përfshirë Regjistrin civil, Kadastrën, Policinë, gjykatat, Administratën Tatimore dhe institucionet tjera, të mund të pranojnë dhe shfrytëzojnë adresat zyrtare.

Projektligji ka për qëllim rregullimin e të gjitha çështjeve të cilat kanë të bëjnë me sistemin e adresave në Republikën e Kosovës dhe ju adresohet të gjitha institucioneve përkatëse që kanë të bëjnë me këtë fushë.

Pra, projektligji rregullon çështjet që kanë të bëjnë me dispozitat, kriteret dhe rregullat në fushën e emërimit dhe numërimit të saktë të vendbanimeve të ndryshme, të shesheve, bulevardeve, rrugëve, rrugicave, objekteve, ndërtesave dhe parcelave të lira kadastrale.

Pastaj, rregullon standardet e vendosjes së tabelave, të adresave, dimensionet, ngjyrat e tabelave, si dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me ndalimin e emërimit me terminologji, e cila në njërin apo mënyrën tjetër mund ta ofendojë njërin apo komunitetin tjetër të cilët jetojnë në Republikën e Kosovës.

Po ashtu, definojnë dhe përgjegjësitë e institucioneve përkatëse dhe ndarja e kompetencave në mes të këtyre institucioneve.

Ky projektligj përmban VIII kapituj dhe gjithsej 28 nene, duke filluar nga dispozitat e përgjithshme, dispozitat shpjeguese, si dhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

Hartimi i projektligjit është bërë në pajtim me procedurat e parapara dhe për këtë projektligj janë pranuar edhe deklaratat respektive nga Ministria për Financa dhe

Ministria e Integrimit Evropian, me të cilat sigurohen pajtueshmëria buxhetore dhe pajtueshmëria me *acquis communautaire*. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Kryetari i komisionit funksional, a e do fjalën? Fjalën e ka deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, për të mos e marrë fjalën dy herë.

Ky ligj është jashtëzakonisht i rëndësishëm, sepse Kosova ndoshta është vendi i vetëm në Evropë që shumë rrugë dhe lokacione ose nuk kanë fare adresë ose kanë nga 2 e 3 më shumë emërtime të cilat janë bërë në etapa të ndryshme.

AAK e mbështet në parim këtë ligj, me gjithë vërejtjet që konsiderojmë që duhet të merren parasysh.

Ky ligj në masë të madhe shkakton shpeshherë konfuzion kur janë në pyetje kompetencat e komunave dhe të ministrive përkatëse dhe shpeshherë e ngarkon komunën me obligime që mund të ndikojnë në efikasitetin e komunave.

Së pari, neni ku komuna nuk lëshon leje ndërtimi, përveç nëse është caktuar adresa dhe është përfshirë në lejen e ndërtimit, ndikon në burokratizimin e mëtutjeshëm të procedurave për dhënien e lejeve për ndërtim dhe medoemos në rritjen e numrit të ndërtimeve pa leje.

Përveç kësaj, ku thuhet se të gjitha shpenzimet për vendosjen e tabelave të adresave në zonat e qarkullimit publik, në ndërtesa dhe brenda tyre, për herë të parë mbulohet nga buxheti komunal, shtrohet pyetja se sa është konsultuar niveli lokal në lidhje me këtë çështje dhe sa ka mundësi buxhetore që komuna të përballlet me këtë kosto, aq më parë kur nga komunat kërkohet veprim ekspeditiv. Konkretisht, brenda 6 muajve nga miratimi i akteve nënligjore të parapara me këtë ligj, komunat i identifikojnë të gjitha zonat e qarkullimit publik dhe vendosin emra për ato në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Me fjalë të tjera, diçka që nuk është arritur për një dekadë, synohet të arrihet brenda 6 muajve, që është afat shumë i shkurtër.

Prandaj, duke pasur parasysh se në amendamentimin e mëtutjeshëm do të punojmë edhe në komision, edhe si Aleancë për Ardhmërinë e Kosovës, do t'i kemi vërejtjet tona në mënyrë që të kemi një ligj i cili mund të zbatohet në terren. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Tani është radha e kryetarëve të grupeve ose e përfaqësuesve të tyre.

Në emër të Partisë Demokratike, fjalën e ka kërkuar deputeti Fatmir Xhelili.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryetar, përshëndetje!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar edhe e ka analizuar Ligjin për sistemin e adresave dhe ka vërejtur se është projektligj i cili përcakton rregullat dhe mënyrat e krijimit të sistemit të adresave dhe të administrimit të këtij sistemi, kështu që është me rëndësi edhe përcaktimi i kriterëve dhe kushteve për identifikimin e çdo objekti, pllaci apo të gjitha shesheve, lagjeve dhe rrugëve në Republikën e Kosovës dhe në parim do të përkrah këtë projektligj.

Gjithashtu, si grup parlamentar do të kontribuojmë në grupin e komisionit adekuat për t'u rritur kualiteti i relacioneve të përgjegjësisë dhe kompetencave në mes të komunës dhe Qeverisë, në mënyrë që ligji të jetë sa më kualitativ dhe në mënyrë që të administrohet më lehtë prej sistemit dhe të shfrytëzohet drejt prej qytetarëve dhe prej institucioneve, andaj propozojmë që ky ligj të aprovohet në parim.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Lidhjes Demokratike, deputetja Vjollca Krasniqi e ka fjalën.

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për sistemin e adresave.

Ky projektligj rregullon administrimin e sistemit të adresave, identifikimin e ndërtesave, objekteve, parcelave kadastrale, emërtimet, numërimet e rrugëve, shesheve e të tjerë.

Kemi vlerësuar si grup parlamentar se ky projektligj është shumë i rëndësishëm dhe shumë i nevojshëm. Mirëpo, bazuar në opinionin e Ministrisë së Financave, gjegjësisht Departamentit të Buxhetit, ky projektligj kërkon buxhet shtesë, rritje të numrit të punëtorëve. Pra, si i tillë kualifikohet pa mundësi financimi dhe mbështetje buxhetore, e sidomos rritjes së numrit të stafit të punëtorëve në Agjencinë Kadastrale të Kosovës dhe nëpër komuna. Ky projektligj është i sponsorizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe komunat, janë të ngarkuara ta jetësojnë apo ta implementojnë këtë ligj. Gjithnjë bazuar në opinionin e Ministrisë së Financave, ky projektligj vlerësohet se do të ketë vlerë të kalkuluar që arrin shifrën 7 milionë euro për Qeverinë e Kosovës, andaj po të ishte ministri i Financave këtu, do të doja ta pyesja. Në mbledhjet e Qeverisë suaj, kur ministrat paraqesin projektligje të ministrive të tyre, a e ngreh zërin t'ju thotë - ministra, nuk ka para për ta implementuar këtë projektligj, andaj mos të përballemi me këtë problematikë në mënyrë të vazhdueshme. Si projektligj, ne si Lidhje Demokratike e Kosovës e përkrahim, sepse është shumë i nevojshëm, mirëpo pamundësia e financiare atë e bën të pa implementueshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të "Vetëvendosjes", deputeti Rexhep Selimi e ka kërkuar fjalën.

REXHEP SELIMI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, duke e ditur problematikën e sistemit të adresave në Kosovë, ky ligj është jo vetëm i mirëseardhur, por shumë i nevojshëm dhe njëkohësisht, pavarësisht çmimit dhe kostos financiare që vërtet unë pajtohem me parafolësit, ky ligj duhet që sa më parë të jetë funksional dhe t'i hapë rrugët rregullimit të kësaj problematike, siç është sistemi i adresave në Kosovë.

Normalisht, ne i kemi vërejtjet tona të fokusuar në disa nga nenet e këtij ligji, vërejtje të cilat ne do t'i japim në bazë të kontributit tonë edhe në komisionin përkatës dhe si të tillë, lëvizja "Vetëvendosje" paraprkasht e përkrah këtë ligj në parim duke u fokusuar në disa vërejtje dhe unë do t'i marr dy shembuj krejt sipërfaqësor, siç është neni 21, pika 1, që flet për tabelat se kur vendosen ato dhe cila është forma e vendosjes, pra thotë: "Tabelat vendosen duke përdorur praktikat evropiane me të mira dhe më të përshtatshme". Mendoj se ky lloj fjalori nuk duhet t'i shkojë një ligji, sepse "më të mirë" dhe "më të përshtatshme" është relative.

Dhe, në anën tjetër, po ashtu në pikën 4 të këtij neni, ku flitet që në komunat ku gjuhët tjera kanë status të gjuhës zyrtare, tabelat janë në gjuhët zyrtare të komunës. Mendoj se ky ligj duhet të definohet që edhe të mos i rrezikojë të drejtat e komuniteteve ku janë, por gjithsesi ky ligj duhet të rregullohet dhe gjuha zyrtare duhet të dihet cila është gjuha zyrtare në gjithë nivelin e Kosovës, sepse si të tillë së paku ne mendojmë se është i pa definuar mirë, për mos të thënë i menduar keq. Sidoqoftë, ne si grup parlamentar dhe lëvizje "Vetëvendosje" do ta japim kontributin tonë në komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYETARI: AAK, Ekrem Ahmeti. Kosova e Re, nuk është lajmëruar, nga SLS-ja, deputeti Sasha Millosavljeviq e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: I Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke razmotrila je Nacrt zakona o sistemu adresa i mi čemo u načelu podržati ovaj Nacrt zakona. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar "6+", deputetja Dude Balja e ka fjalën.

DUDA BALJE: Zahvaljujem, predsedniče!

S obzirom da Zakon o adresnom sistemu ima za cilj da reguliše način kreiranja i upravljanja adresnog sistema, određivanja kriterijuma i pravila za identifikaciju svake zgrade, objekta i slobodnih katastarskih parcela na teritoriji Republike Kosova, a uzimajući u obzir i to da do sada nije bilo takvog jedinstvenog adresnog sistema, Parlamentarna grupa „6+“ podržava Zakon i daće naš doprinos u poboljšavanju kvaliteta ovog zakona radom u komisije. Želim da istaknem još jedno da poštujemo zakone o manjinama i svima u svim opštinama gde su jezici nevečinskih zajednica turski i bosanski, gde imena ulica i svi drugih obeležja budu i na ovim jezicima. Zahvaljujem!

KRYETARI: Ju faleminderit! Nga deputetët, për fjalë është lajmëruar deputeti Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Përshëndetje për ju dhe të gjithë të pranishmit!

Unë desha të vë një aksent që e ngritën edhe disa kolegë të tjerë rreth pambulushmërisë financiare të ligjit. Nuk kam asnjë vërejtje për ligjin dhe e shoh si diçka shumë të domosdoshëm, por mënyra se si ne po veprojmë, mendoj se po shkojmë në një rrugë që nuk e kemi të qartë ku na shpie.

Është hendikep pse Qeveria jonë ju sjell ligje pa mbulesë, pa një deklaram të Ministrisë të Financave për mbulesën, qoftë të atij viti apo të kornizës afatmesme. Mendoj se defekti është edhe këtu në Kuvend, zoti kryetar edhe për atë e mora fjalën.

Unë mendoj se Kryesia nuk duhet t'i radhitë ligjet për trajtim në asnjë seancë pa një mbulesë, pa një informatë nga Ministria e Financave se si e sheh trajtimin e mbulesës financiare të tillë. Ky është një shqetësim dhe mendoj se nuk i ikim përgjegjësisë edhe ne si deputetë, pavarësisht të gjitha arsyeve dhe urgjencave që i kërkon ky ligj, ligj i mirë e tjera, nevojat, por një përgjegjësi e tillë mendoj se është shumë e madhe për Kuvendin, të votojë për një ligj që e dimë se nuk do të zbatohet dhe mendoj se kjo ka filluar të bëhet një praktikë që është shumë e keqe. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Realisht, Kryesia nuk merret me çështjen përmbajtjesore të ligjeve. Kryesia e shikon anën formale dhe komisionet funksionale e shikojnë përmbajtjen e ligjeve dhe ata i rekomandojnë Kuvendit dhe Kuvendi merr vendim. Kjo është puna që ne duhet ta kryejmë si Kryesi, që e administrojmë kërkesat dhe dokumentet që vijnë në Kryesinë e Kuvendit. Pra, Kuvendi merr vendimin mbi bazën e rekomandimeve të komisionit funksional, kjo është rruga e procedimit të ligjeve.

Fjalën e ka deputeti Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Unë mendoj se mungesa e një dokumenti nga Ministria e Financave, që është përgjegjëse për këtë lami, ky ligj dhe ligjet e ngjashme nuk i plotësojnë edhe anën formale. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Unë e thashë me Rregullore, ne punojmë mbi bazën e Rregullores. Vazhdojmë, jemi në procedurën e votimit. Kërkoj deputetët që janë jashtë sallës, të vijnë në sallë dhe të votojmë projektligjin. Faleminderit!

Në sallë kemi 62 deputetë.

Shkojmë në procedurën e votimit, pra votojmë në parim Projektligjin për sistemin e adresave.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë, tash.

Konstatohet se me 57 vota “për”, 2 “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për sistemin e adresave.

Kërkohej nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t’i paraqesin raportin me rekomandime.

Ju faleminderit!

Vazhdojmë pikën e radhës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime, për shqyrtim në parim.

Ftoj zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Drejtësisë, zotin Hajredin Kuqi, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJRDIN KUÇI: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë, anëtarë të Qeverisë,

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që para jush të paraqes Projektligjin për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

Nevoja për Projektligjin për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës konsiston në atë që kjo fushë e pambuluar me ligj, në mënyrë adekuate deri më tani dhe nevojën për të plotësuar infrastrukturën ligjore, në pajtim me dispozitat e Kushtetutës dhe me kompetencat e Presidentit të Republikës për ndarjen e dekoratave.

Projektligji ka për qëllim rregullimin ligjor të dhënies, bartjes dhe revokimit të dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës për qytetarët e Republikës së Kosovës, për qytetarët e huaj dhe organizatat e ndryshme që shquhen për meritat e veçanta ndaj Republikës së Kosovës, qytetarëve të saj dhe interesave.

Projektligji përcakton llojet e dekoratave që mund nëndahen nga Presidenti i Republikës së Kosovës, subjektet që kanë të drejtë të propozojnë për dekoratë, subjektet që mund të propozohen për dekoratë, si dhe kushtet dhe kriteret që duhet përmbushur i dekoruari. Projektligji përcakton gjithashtu Komisionin vlerësues për dekorata dhe ceremoninë e dhënies së dekoratave, ceremoninë e dhënies së dekoratës pas vdekjes, mënyrën e bartjes së dekoratës, rastet e revokimit të dekoratës dhe njësinë për organizimin e dhënies së dekoratave.

Gjatë punës së këtij projektligji janë marrë në krahasim edhe traditat e tjera të vendeve të përafërta me sistem juridik dhe me kompetenca të përafërta të presidentëve të republikës dhe sot para jush është prezantuar një projektligj i tillë. Ju ftoj që me sugjerimet tuaja, me vërejtjet dhe propozimet ta plotësoni këtë ligj dhe ta miratojmë në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Pas prezantimit, po e hapim debatin për diskutim në parim.

Kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, deputeti Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Ju faleminderit!
Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe ka dhënë aprovimin që të shkojë si i tillë për seancë dhe përkrahet. Faleminderit!

KRYESUSI: Ju faleminderit!
Përfaqësuesit t grupeve parlamentare.
Në emër të Grupit Parlamentar të PKD-së, deputeti Behar Selimi.

BEHAR SELIMI: Faleminderit, zoti kryesues!
Të nderuar deputetë,
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar Projektligjin dhe do ta votojë. Sugjerojmë që edhe grupet tjera parlamentare ta votojnë.

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Arben Gashi, prapë.

ARBEN GASHI: Po, faleminderit!
Edhe në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike mund të them se ligji është një ligj i cili duhet të kalohet, mirëpo paraprakisht ne po hasim shumë probleme me ligjet që po vijnë nga Qeveria dhe me deklaratat përkrahëse ose deklaratat, format të cilat duhet të plotësohen.

Në qoftë se e shohim te deklaratat e pajtueshmërisë në legjislacionin e BE-së, flitet për Ligjin për dekoratat nga ana e Presidentit të Republikës së Kosovës. Kjo deklaratë është e nënshkruar, nuk po e njoh këtu Rexhep Bllaca, ushtrues detyre i drejtorit të Departamentit Ligjor, dhe kur shkon te pika 4, thotë, flitet gjatë gjithë kohës për Ligjin për dekoratat dhe tek pika 4 thotë: “legjislacioni i BE-së lidhur me sistemin e adresave” dhe pastaj pikat 4, 5, dhe 6, flitet për sistemin e adresave. Është një ngatërrim i paarsyeshëm dhe i panevojshëm dhe kjo thotë, dhe kjo në të njëjtën kohë thotë që

Qeveria është e papërgjegjshme në dokumentet që i çon në Parlament, sepse kjo është një gabim shumë i rëndë.

Të flitet për Ligjin për dekorata dhe pastaj të kalosh në sistemin e adresave, është diçka jo logjike. Sa i përket ligjit si i tillë, ne mendojmë se ligji duhet të kalojë parimisht, por pastaj do të shohim edhe vërejtjet që do të merren edhe nga anëtarët e tjerë të Kuvendit dhe në formën e amendamenteve t'i përfshijmë në Ligj dhe të japim edhe kontributin tonë edhe si parti, por edhe si komision.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Projektligji për dhënien e dekoratave nga presidenti është një projektligj mjaft i rëndësishëm për nderimin, çmuarjen dhe respektimin e personaliteteve të lëmenjve të ndryshëm, që shquhen për merita të veçanta për Republikën e Kosovës dhe çështjen kombëtare.

Në vazhdim, dëshiroj t'i theksoj disa nga çështjet që ne konsiderojmë që janë të domosdoshme për t'u marrë parasysh dhe për t'u inkorporuar në kuadër të këtij projektligji. Fillimisht, në nenin 5 të këtij projektligji, thuhet: “Presidenti i Republikës së Kosovës përcakton llojet e dekoratave me rregullore të veçantë”. Ky nen duhet të hiqet dhe të formulohet një nen tjetër, i cili parasheh llojet e dekoratave e jo t'i lihet presidentit që ta rregullojë me rregullore të veçantë.

Tek neni 6, pra te dhënia e dekoratave me iniciativë të presidentit, duhet të formulohet në atë mënyrë që edhe kur kemi propozim të presidentit për dekorim, kjo paraprakisht të kalojë në Komisionin vlerësues. Në nenin 7, pra aty ku flitet se kush mund të bëjë propozimin për dhënien e dekoratave, mendoj që duhet të plotësohet që t'u jepet e drejta edhe një numri të deputetëve që të bëjnë propozim për dekorata.

Në nenin 8, duhet të përcaktohet më detajisht meritat në bazë të cilave bëhet propozimi për dekoratë, si dhe kjo të rregullohet duke e respektuar strikt barazinë.

Tek neni 9, ku flitet për Komisionin vlerësues të dekoratave, ne mendojmë që ky nen duhet të plotësohet, pra të rregullohet në detaje se në përbërje të kujt bëhet komisioni, a vijnë ato personalitet nga Akademia apo prej nga vijnë, a ka mandat ky komision? Të gjitha kriteret në bazë të së cilave përcaktohen këto personalitete, kur dihet se deri më tani dhënia e dekoratave është përcjellë me kundërthënie dhe përveç që ka pasur tendenca të ndahen heronj nga heronjtë, ata madje edhe janë ndarë. Gjithashtu, duhet të jepen edhe detaje edhe për funksionimin bazë të Arkivit të të dekoruarve. Pra, këto janë disa nga vërejtjet tona dhe, krejt në fund, ne do të votojmë në parim, në favor të këtij projektligji, duke e ditur rëndësinë që ka. Faleminderit!

KRYESUSI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputetja Donika Kadaj- Bujupi.

DONIKA KADAJ- BUJUPI: Faleminderit!

Edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës në parim do ta përkrahë projektligjin në fjalë, sepse në aspektin përmbajtjesor ky projektligj plotëson kushtet, ndërkohë që të gjitha vërejtjet tona do t'i japim në komisionin funksional. Ju faleminderit!

KRYESUSI: Ju faleminderit!

Nga koalicioni Kosova e Re, deputetja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përshëndetje për zëvendëskryeministrin dhe ministrat e Kabinetit qeveritar dhe të gjithë të pranishmit!

Koalicioni për Kosovën e Re e ka shqyrtuar Projektligjin për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

Duke marrë parasysh pikë së pari sigurimin mjeteve financiare, del si konkluzion se këtu projektligji është në legjislacion të përballueshëm brenda buxhetit aktual dhe Ministria e Financave për këtë ligj e ka dhënë dekretin e vet që të shkojë në miratim.

Nën 2, procedurat dhe kriteret e dhënieve të dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës, në nenin 6, më duket se është një renditje jo edhe aq adekuate, ku dhënia e dekoratave me vetë iniciativë, e potencon pikë së pari kryetarin e Kuvendit, kryeministrin, kryetarin e Gjykatës Kushtetuese, kryetarin e Gjykatës Supreme, që konkludimi im do të ishte që komandanti i Forcave të Sigurisë së Republikës së Kosovës në të njëjtën kohë të dalë në radhitje më përpara.

Te neni 8, kriteret që duhet t'i plotësojë propozimi për dekorata, dërgon dy muaj para veprimtarisë së përvjetorit apo të ngjarjeve historike që i përket personit apo institucionit, si mund që të dekoratat t'i dërgohet dy muaj para veprimtarisë? Propozimin për dekorim duhet ta bëjë në radhë të parë presidenti, pastaj kryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme.

Te neni 13, bartja e dekoratave, pika 4, thotë: "Bartësi i dekoratave gjatë kohës sa është në mbajtje të dënimit, nuk ka të drejtë të bartë dekoratën, pra është në kundërshtim me nenin 14, pika 1, revokimi i dekoratave, ku thotë: "të dekoruarit mund t'i revokohet dekorata nëse vepron në kundërshtim me rendin publik, moralin dhe kryen veprën e tij që ka të bëjë me dhënien e dekoratave", pra Ligji duhet të përcaktojë dënimin sipas të cilit i hiqet dekorata prej figure. Në përgjithësi, me të gjitha këto sugjerime të Koalicionit për Kosovë të Re, Koalicioni për Kosovë të Re përkrah Projektligjin dhe të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet, do të dedikohen në komisionin parlamentar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! SLS, nuk ka të paraqitur.

Nga Grupi Parlamentar "6+", deputeti Albert Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar zoti nënkryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër, ministra, Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar Projektligjin për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhe pas konstatimit dhe vlerësimit se ky projektligj e ka bazën kushtetuese dhe i plotëson të gjitha kushtet dhe rregullat e caktuara me Rregulloren e Kuvendit, Grupi Parlamentar “6+”, në parim do ta miratojë këtë projektligj duke pasur parasysh edhe vet faktin se nuk i cenon dhe është në përputhje me parimet themelore dhe politike të Bashkimit Evropian, kurse kontributin tonë do ta japim përmes komisionit përkatës. Faleminderit!

KRYESUSI: Faleminderit!
Fjalën e ka zoti Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti Haliti!

Zotërinj ministra,
Deputetë,
Është interesant dhe më pëlqen që shumëçka që kam përgatitur të flas, e tha deputetja në një variant që unë e pëlqej, Albulena Haxhiu. Por, sido që të jetë, unë do të përcaktohem saktë çfarë shoh unë këtu. Është e domosdoshme që ky ligj të kalojë dhe duhet ta votojmë, nën një, dhe LDK-ja do ta votojë, do ta votojë edhe unë vetë.

Çështja është që problemi themelor që prek ky ligj, ky ka të bëjë me dekoratat, sepse edhe emrin e ka kështu dhe ai që është thelb i ligjit, është pjesa më e thatë, më pa objekt e ligjit dhe këtu është kontradikcioni i jashtëzakonshëm. Flitet shumë për procedurat çka ndodh e s’ ndodhë, ndërsa kapitulli i dytë - Dekoratat, i ka dy nene dhe të dy nenet janë shumë të papërcaktuara dhe unë insistoj që kjo boshësi, që është esencë, të mbushet, përndryshe s’ka kuptim ligji, kështu që propozoj që neni 4 të mbetet kështu qysh është - Dhënia e dekoratave, porse neni 5 të bëhet i plotë dhe të thuhet: “Presidenti i Republikës së Kosovës jep këto dekorata.” dhe të emërtohen. Nuk ka arsye dhe nuk ka logjikë që të ndërtojmë Ligj për dekoratat dhe ajo që është themelore, çfarë janë ato, t’i lihet një rregulloreje. Pse them unë kështu? Ne e kemi një empiri, tre presidentë të deritashëm që kanë dhënë dekorata të niveleve të ndryshme.

Ekzistojnë disa të evidentuara dhe të bëra dokumente. Ka shumë që nuk kanë dokumente, nuk ekziston një regjistër i vërtetë i emërtimeve, i përkufizimeve, i emrave. Kjo do të thotë që ne kemi një të kaluar të dekorimeve, nuk ekziston një evidencë, të gjitha ato janë marrë në bazë të një rregulloreje dhe unë po ju them që ajo ekziston edhe e botuar dhe ajo rregullore është më substanciale se ky ligj që e kemi tash, nëse nuk i shohin emërtimet.

Mua më duket që edhe ky propozim-ligj duhet të ketë qenë, po flas në këtë mënyrë, në një variant tjetër, sepse nuk ka logjikë që të mbetet esenca e tij e dy neneve kaq e thatë. Pse më shtyn të mendoj kjo? Më shtynë të mendoj sepse projektligjit i është ngjitur një memorandum, memorandumit sugjeron që këto probleme janë të rregulluara brenda. Disi më duhet sikur memorandumit i referohet ndonjë farë teksti, i cili është reduktuar dhe ka ardhur ndryshe. Po them, edhe te puna e çmimeve atje, është një farë

shifre që varet qysh lexohet. Unë nuk dija ta lexoja, a janë 40.000 a 400.000, se pikën ku e ka vë ai që i qetë shumë brenda vitit, qojnë lexime të dyfishta, po kjo është punë tjetër.

Pra, po rezymoj, duhet dhe është mirë që të votohet. Në nenin 5 të emërtohen saktësisht cilat dekorata i jep kryetari i Kosovës? Është punë tjetër, me rregullore kryetari mund të përcaktojë mbasandaj kufijtë e tyre, a paguhen a s' paguhen e tjera, ato janë punë me rregullore, por çdo ligj i tillë edhe në rajon, meqë po flitet, në ligj janë të emërtuara. Pse ndodh kjo? Sepse atëherë mund të ndodhë një punë e arbitraritetit, bre, një kryetar ka qejf të japë dekorata tjera, e tjetri do tjera. Është puna e arbitraritetit, nuk është mirë ajo. Rregullorja është rregullore, por është nën ligj, nuk është ligj. Edhe atje te neni 6 dhe neni 7, unë s' po specifikoj, se e kam ndërmend të bëj përmes grupit amendamente, ku renditen ata që i dekoron me vetiniciativë kryetari dhe ata që kanë të drejtë të propozojnë, patjetër duhet të jenë deputetët aty, patjetër duhet të jenë edhe nënkryetarët e Kuvendit. Nëse ministrat etj., kanë të drejtë të propozojnë, deputetët patjetër duhet të jenë. Faleminderit!

KRYESUSI: Ju faleminderit!

Unë mendoj që këtu duhet të kenë të drejtë edhe grupet e qytetarëve të propozojnë, po sidoqoftë amendamentimi do ta bëjë të vetën.

Zëvendëskryeministri e ka kërkuar fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Më lejoni që të jap vetëm dy sqarime lidhur me këtë projektligj. Po filloj prej asaj që është edhe më pozitive që është theksuar. Unë pajtohem plotësisht që të jenë deputetët një prej propozuesve, ngase e drejta pastaj mbetet te presidenti, apo presidentja që të vendosë dhe është edhe barazia e përfaqësimit qytetar dhe po ashtu pajtohem që të përcaktohet edhe një grup pi qytetarëve, një numër i theksuar ndoshta ekuivalent me mesataren e votave të deputetëve që ta propozojmë dike. Por, duhet ta theksoj një çështje që u hap për debat këtu, te emërtimi apo përcaktimi i llojeve të dekoratave. Unë mendoj që Kuvendi këtu duhet ta ketë parasysh a ka te drejtë ta bëjë një gjë të tillë apo jo? Pse e them këtë? E drejta për të ndarë dekorata i takon presidentit me Kushtetutë.

Dhe në momentin që dikujt ia përcaktoni, nënkupton një lloj kufizimi i asaj të drejte. Nëse Kuvendi mendon se duhet t'ia marrë të drejtën, në këtë rast për përcaktimin e llojeve të dekoratave, atëherë është krejt, plotësisht e ligjshme dhe është krejt të jetë e pranueshme. Por ligj, sponsorizues i ligjit, tash ka menduar dhe mendon e drejta është ekskluzive e presidentit të Republikës për ndarjen dekoratave dhe llojit të tyre. Emërtimi është kufizimi i asaj të drejte. Mund të shkojë në arbitraritet që e tha profesor Hamiti. Unë nuk dyshoj për këtë, por edhe në çështje duhet ta dimë që Presidenti i Republikës nuk i përgjigjet Kuvendit për punën e tij dhe në këtë rast do të ishte një lloj konflikti i kompetencave që mund të, por është shumë e vërtetë, por Kuvendi nuk ka të drejtë që t'ia kufizojë të drejtat. E ndërrojmë Kushtetutën, i ndërrojmë kompetencat, pse jo. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Hamiti, ka replikë.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zëvendëskryeministër dhe ministër i Drejtësisë, Ne kemi filluar t'i bëjmë tabu dhe klishe kush çka ka të drejtë dhe s' ka të drejtë. Presidenti i Republikës ka përgjegjësi, s' është me rëndësi në çfarë mënyre i përgjigjet Kuvendit, i përgjigjet çdo qytetari të Kosovës, se është përfaqësues i tyre dhe reflekton sensibilitete, dije për nacionin e vet ose qytetarët e vet, thoni qysh të doni. Nuk ia marrim ne të drejtën, s' po dua t'ia marrë të drejtën. Nëse këtë ligj e ka sponsorizuar në këtë rast Zyra e Kryeministrit, mirë ka bërë se e ka ndërtuar ligjin. Ne jemi në fazën e ndërtimit të ligjit dhe presidenti aktual ose ai që e përfaqëson, e ka të drejtën që t'i propozojë ai, qe ne s' po ia propozojmë, unë nuk po ia propozoj listën, por po them që në një ligj të tillë, duhet të jenë. Pse? Po ju garantoj që, nëse u lihet sensibiliteteve, jo që do të ndërrojnë lehtë ato tipe dekoratash, po ju e dini fortë mirë, nganjëherë kanë për t'u bërë masive dhe ju e dini që janë dhënë edhe nga 100.

Unë dua seriozitet me ligj, të përcaktohet çka po ndodhë sepse, më falni, po ma jepni një listë zyrtare kush është hero i Kosovës sot në Kosovë, prej 3 presidentëve, a e keni listën? Prandaj, unë jam për këtë ligj dhe ma jepni kush prej këtij vendi ka dekorata të mëdha jashtë shtetit? Kush s'e di. Është domosdo të jenë ato regjistra, se nuk mundesh një njeri që e ka ekstra dekoratë të një shteti tjetër, për t'ia dhënë dekoratën që është mirë se e dalluam... që thoshin këtyre here. Këto janë probleme serioze. Unë po them, në këtë kuptim ndërtohet rrjeti, emërimi, mbasandaj aktet nënligjore i bën ai që jep ato, po ne nuk po ia marrim të drejtën, ne po kërkojmë precizitet, kudo në ligje janë këto, nuk janë në rregullore, në ligje. Dekoratat e nivelit nacional në ligje, rregullorja është rregullore. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Zoti Kuqi, e keni fjalën!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Ju faleminderit, profesor Hamiti, vetëm dua t'i jap dy sqarime.

E para, mendoj se po ashtu është klishe të thuhet që presidenti i përgjigjet çdo qytetari, është popullsia, por presidenti përgjigjet vetëm në Kushtetutë, dhe i dimë vetëm rastet kur përgjigjet. 5 vjet, ai që zgjidhet president, ia pafte hairin dhe kjo e mirë kur shkojnë në tubim në ndonjë katund t'ju themi - presidenti ju përgjigjet juve. Presidenti, ne që jemi deputetë, që jemi juristë nga pak edhe më shumë shkollë, ne e dimë që presidenti veç me Kushtetutë përgjigjet, sikur edhe ne këtu vetëm me ligj dhe Kushtetutë. Ne duhet të jemi të përgjegjshëm ditën kur e zgjedhim presidentin. Kemi të bëjmë me personin e parë të vendit dhe atëherë kur të zgjedhim, duhet ta kemi parasysh se nuk mund ta kufizojmë çdo ditë.

KRYESUESI: Albulenë, nuk mund të kesh replikë në replikë, më fal! Nëse ke me Haradinin replikë, Okej. Po, a do Sabri prapë, a? Mirë. Po mendoj se e kemi shkelur edhe Rregulloren tash, por hajt.
Zoti Hamiti i ka edhe dy fjalë!

SABRI HAMITI: Zotin zëvendëskryeministër, unë e kam edhe kolegë, është pak më i ri, po koleg e kam. Ai e di që unë s'jam populist, bile jam skepticist më shumë se populist në këtë kuptim, harroje atë farë cilësimi, se s'jam dhe nuk dua të jem. Bile, më pëlqen të jem pakicë, që s'është politike, po mua më pëlqen ashtu.

E dyta, edhe një herë po e them, varet qysh do që të zgjedhet ai president, megjithatë është përfaqësuesi i çdo individi të këtij vendi. Është punë procedurale a e zgjedh Kuvendi, a e zgjedhin vet, është përfaqësues i të gjithëve, edhe kur s'është zgjedhin të gjithë. Kaq. I përgjigjet Kushtetutës të cilës tani ti po e din qysh interpretohet te ne Kushtetuta dhe unë e mbarova këtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputetja Haxhiu ka replikë edhe kjo me Kuçin.

ALBULENA HAXHIU: Sidoqoftë, zoti ministër, unë do ta bëj amendamentin në lidhje me këtë çështje në Komisionin për Legjislacion. Unë e di që ju e keni hallin diku tjetër, mirëpo ky është problem veç i yti, jo edhe i qytetarëve.

KRYESUESI: Zoti zëvendëskryeministër, e keni fjalën!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Unë, zonjusha deputete, parimisht i marr vesh gjërat që kuptova çka thatë. Ju të drejtën tuaj që të propozoni amendamente nuk ua mohon askush, se ua ka dhënë Kushtetuta, ua ka dhënë ligji. Unë vetëm e thashë një fenomen që unë besoj do ta kemi të qartë. Ne po i përcaktojmë të drejtat e dikujt tjetër që ia ka përcaktuar Kushtetuta. Ky është problemi. Vendos Kuvendi, unë i qoj dy duart dhe e respektoj tërë ditën. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Nuk ka diskutime tjera. Ju faleminderit që e diskutuat edhe pasi që u bë kuorumi i plotë. Në sallë janë 64 deputetë. Lus regjinë që të përgatiteni për votim. Votojmë, tani. Ju faleminderit!

Konstatohet se me 51 vota "për", 4 "kundër" dhe një abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

Kërkojmë nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë në Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Dua t'ju njoftoj, të nderuar deputetë që kartela janë 97 të shtypura dhe në sallë janë 62 deputetë.

Vazhdojmë me pikën e gjithë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbimet këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, zotin Blerand Stavileci, që në emër që Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit ta prezantoj dhe arsyetoj projektligjin. Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI BLERAND STAVILECI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

Para jush do ta prezantoj Projektligjin për shërbimet këshillimore për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Për ta ngritur nivelin e përgjithshëm të shërbimeve për fermat dhe ekonomitë bujqësore që i ushtrojnë aktivitetet e tyre bujqësore në zonat rurale, ne si Ministri e Bujqësisë na është paraqitur nevoja për një organizim më të mirë të zinxhirit këshillimor profesional, i cili është i rregulluar me ligj.

Ofrimi i shërbimeve këshillimore, përkatësisht trajnimi dhe transferimi i njohurive tek fermerët për të avancuar menaxhimin e fermës, nuk mund të bëhet pa krijimin e një kornize ligjore, të mbështetur në parimet e përgjithshme për organizimin dhe rregullimin e marrëdhënieve me interes të përbashkët. Prandaj, me qëllim që t'u krijojmë lehtësira dhe t'i ndihmojmë edhe më tej iniciativat e fermerëve, ne kemi hartuar këtë projektligj, fushëveprimi i të cilit është pikërisht krijimi i infrastrukturës së përshtatshme për çështjet që kanë të bëjnë me ofrimin e këshillave për ndërmarrjen e masave dhe veprimeve në baza profesionale, për rritjen e cilësisë të prodhimit bujqësor në funksion të shfrytëzimit racional edhe ekonomik, dhe shumë këshilla të tjera që do të jenë në përputhshmëri me praktikën e njohura ndërkombëtare.

Nevoja për vendosjen e standardeve që duhet të respektohen nga qendrat informative këshilluese, me ekspertë të specializuar bujqësor për zonat rurale dhe zonat e tjera bujqësore, pastaj nevoja për vendosjen e standardeve për certifikimin dhe kualifikimin e këshilltarit bujqësor, që është i nevojshëm për secilën komunë, i cili do t'ju ofrojë këshilla fermerëve për arritjen e rezultateve më të mira në bujqësi dhe për shfrytëzimin sa më racional të tokave bujqësore, janë vetëm disa prej nevojave që pa këtë projektligj, nuk do të mund t'i plotësojmë, prandaj miratimi i tij është i domosdoshëm për realizimin e kësaj mbështetjeje.

Deri me tani ka munguar legjislacioni i përshtatshëm i cili referohet procedurave dhe metodologjisë për ofrimin e shërbimeve këshillimore, për ndarjen e përgjegjësisë së institucioneve, si dhe për planifikimin, zbatimin dhe financimin e këtij procesi. Po ashtu, nga Departamenti i buxhetit është vlerësuar se projektligji nuk prodhon kosto shtesë

buxhetore për institucionet që do ta implementojnë, respektivisht për Ministrinë e Bujqësisë dhe për komunat, mirëpo buxheti aktual që kemi, sipas ligjit përfshin edhe buxhetin sipas kornizës afatmesme të shpenzimeve, vlerësohet i mjaftueshëm dhe implementimi i projektligjit, nuk do të krijojë implikime shtesë buxhetore.

Pra, siç po nënkuptohet nga ky përshkrim, projektligji është i një rëndësie të veçantë, sepse ka rol organizativ për zhvillimin e bujqësisë në baza profesionale dhe krijon stabilitet legjislativ në këtë fushë, prandaj miratimi i tij do të kontribuojë në zhvillimin e këtij sektori. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Sipas radhës, kryetari i Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Ju faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje, Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Komisioni ka mbajtur mbledhjen më 3.10 dhe ka shqyrtuar në parim Projektligjin për shërbimet këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, dhe ka vendosur që Kuvendit t'ia parqet rekomandimin që të miratohet në parim projektligji dhe ne do të jemi më tutje në bashkëpunim që të amendamentojmë nëse ka nevojë. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Sipas radhës, kryetarët e grupeve parlamentare ose përfaqësuesit e tyre.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputeti Niazi Idrizi.

NIAZI IDRIZI: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Njëra ndër sfidat e bujqësisë dhe zhvillimit rural është edhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i resurseve të vendit për prodhimin e produkteve dhe ofrimin e shërbimeve në sektorin e bujqësisë.

Projektligji për shërbimet këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural, do ta ketë një rol shumë pozitiv për tejkalimin e kësaj sfide. Për më mirë ky projektligj në fakt e plotëson dhe e pasuron edhe Ligjin mbi tokën bujqësore dhe ligjet tjera të cilat objektiv të vetin e kanë shfrytëzimin e qëndrueshëm të tokës në përgjithësi dhe tokës bujqësore në veçanti.

Me këtë projektligj krijohet baza ligjore për ofrimin e këshillave nga shërbimet këshilluese për zbatimin profesional të aktiviteteve të planifikuara për shtimin e sasisë dhe kualitetit të prodhimit të bujqësore, duke i aplikuar dije të reja shkencore të cilat kanë trendë të ndryshimeve për shkak të zbulimeve dhe aplikimit të tyre. Ky projektligj dhe kushtet e vendit tonë, merr peshë të veçantë sepse vendit tonë i mungon një legjislacion i cili duhet të bëhet referues për t'i obliguar aktorët që t'i afirmojnë përdorimin e teknologjive të reja dhe t'i zbatojnë metodat dhe teknikat bashkëkohore

gjatë ofrimit të këshillave profesionale, përmes të cilave do të zhvillohet dhe modernizohet bujqësia.

Projektligji për shërbimet këshilluese, i obligon përgjegjësit e institucioneve që të planifikojnë dhe zbatojnë standardet e specifikuar gjatë ofrimit të këshillave të cilat duhet t'i përshtaten kushteve agro-klimatike të vendit tonë. Kosova ka një deficit të madh të prodhimit të produkteve ushqimore dhe si e tillë është e obliguar që për çdo vit të humbë qindra milionë euro dhe të bëjë dhe të lejë jashtë vendeve të punës dhjetëra-mijëra njerëz të cilët do të mund të angazhohen në këtë sektor.

Për ofrimin e këshillave do të kemi institucionet të certifikuar të cilat në të dy nivelet edhe në nivelin qendror edhe në atë lokal, ku do të angazhohen ekspertë të kualifikuar të bujqësisë të cilët do të jenë pranë fermave dhe fermerëve të tyre me çka, me siguri do të ulin riskun e dështimit të tyre dhe do t'i rrisin fitimet e tyre, në të njëjtën kohë edhe do t'i motivojnë ndërmarrësit e rinj ë të kyçen në sektorin e bujqësisë, pa pasur frikë se do të dështojnë.

Me zbatimin këtij ligji do të bëhet e mundur ngritja e njohurive bazike dhe specifike të fermerëve, trajnimi i tyre për menaxhimin e fermave, organizimi i fermave, kujdesi për burimet natyre dhe mjedisore, rritja e sasisë së prodhimit dhe kualitetit, marketingun dhe tregtimin dhe shtimin e të ardhurave në fermë. Ky projektligj është i bazuar në legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe në standardet ndërkombëtare të cilat aktualisht janë duke u zbatuar në këto vende.

Grupi Parlamentar i PDK-së do ta mbështesë në parim këtë ligj dhe më tutje do ta jap kontributin e vet për pasurimin e këtij ligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Salih Morina.

SALIH MORINA: Ju faleminderit, kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe e ka par; si të arsyeshëm për nga përmbajtja dhe njëkohësisht për nga qëllim që ky ligj, do të thotë është i nevojshëm për miratim për fazën parë dhe njëkohësisht ka paraqitur disa vërejtje lidhur me këtë projektligj në leximin e parë, ku në nenin 17 duhet të qartësohet, nuk është dhënë kriteri se kush mund të certifikohet, përkatësisht cila është përgatitja paraprake që një këshilltar duhet të ketë të kryer që të mund të certifikohet dhe pa ashtu te neni 26 Ministria e Bujqësisë, ku thuhet: “Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në bashkëpunim me institucionet tjera relevante formon Komisionin për mbikëqyrje dhe koordinimin e punëve të shërbimeve këshillues për bujqësi dhe zhvillim rural.

Duhet të theksohet në këtë lëndë se cilat janë ato institucione relevante dhe jo të përkufizohet si e përgjithshme, a kemi të bëjmë me komunat apo edhe me institucionet

tjera që janë bartëse dhe hartuese të këtij ligji? Në kuadër të deklaratës financiare, do të thotë, nuk ka implikime buxhetore, është në kornizën afatmesme 2012- 2014 dhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, në parim do ta miratojë këtë ligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar Projektligjin për shërbime këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural. Konsiderojmë që ky ligj është i nevojshëm shumë, janë të nevojshme edhe shërbimet këshilluese pikërisht për zhvillimin e bujqësisë, sidomos krahasuar me gjendjen aktuale që e kemi dhe një ligj i tillë është pra i nevojshëm. Edhe Grupi Parlamentar i lëvizjes “Vetëvendosje” në parim e përkrah këtë ligj dhe do të votoj “për”.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Fillimisht dua t’ju them se edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, do ta votojë këtë ligj për shkak se anëtarë ynë në këtë komision, mendon se duhet të votohet dhe e ka lobuar grupin. Sidoqoftë, unë do të shfaqë edhe disa mendime tjera në lidhje me këtë ligj. Fillimisht dua të them se dy pikat e rendit të ditës, të cilat i kemi sot para vetes, e paraqesin njëfarë paradoksi. Paradoksi është ky, do të flas edhe për pikën tjetër, Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural e ka rekomanduar që të votohet ky ligj për këshillime në bujqësi, do të thotë për këshillim e kemi një ligj, ndërsa disa pika më vonë e kemi një pikë e cila thotë: për vendimin e Qeverisë, për caktimin e rregullave dhe procedurave për zbarkimin e trupave tona të sigurisë jashtë vendit, që do të thotë për këshillim kemi ligj e për zbarkim të trupave jashtë Kosovës, kemi vendim të Qeverisë, që është antikushtetuese, domethënë ka qenë dashur të jetë krejt kontra.

Çështja e parë që duhet të thuhet këtu është se ministri i Financave nuk e di cili ka qenë qëndrimi ti tij në Qeveri, mirëpo ka qenë dashur ndoshta që ta shohë raportin të cilin e ka dhënë Ministria e tij, i cili thotë se ky projektligj nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë në buxhetin e Kosovës, mirëpo ka rrezikshmëri jashtëzakonisht të lartë që të ketë ndikim më tutje, nëse do të ketë akte nënligjore ose vendime të Qeverisë të cilat do të mund ta ngarkojnë buxhetin edhe nëse dikush e sheh projektligjin, e sheh se aty ka mundësi jashtëzakonisht të mëdha që të punësohen njerëz, në administratë është fjala, nuk po flasim për punësim në bujqësi ose në industri ose në institucione prodhuese, private qofshin ose publike edhe kur themi kështu, gjithkujt në atë farë sensin prapë populist, prapë mund t’i shkojë mendja se është mirë për të krijuar vende pune. Unë po ju them, nuk është mirë për të krijuar vende pune në administratë se duhet ta bëjmë një kosto, ta llogarisim sa bujq duhen të punojnë edhe të paguajnë taksa, sa punëtorë në industri

duhet të punojnë dhe të paguajnë taksa për ta mbështetur një vend pune në administratë i cili është i panevojshëm, shembull ta marrim. Ky është ngarkim esencial i gjithë këtij sistemi.

Pyetja ime është pse jo vendim? Për shkak se askush nuk është kundër që të ketë institucione dhe sistem këshillëdhënës për bujqësi në Kosovë, dhe nuk jemi kundër, mirëpo Kuvendi i Kosovës nuk duhet të shtroj pyetje vetëm se a duhet ta bëjmë një punë, por edhe a duhet me ligj ta bëjmë një punë apo ka mundësi që e njëjta punë, pa kurrfarë ndryshimi të bëhet me një vendim të Qeverisë? Edhe gjithsesi, e unë si deputet i Kuvendit të Kosovës i kam shtuar vetit pyetje pse nuk është bërë me vendim të Qeverisë kjo punë? Po, është, është sjellë një ligj: Ligji në mënyrë implicite jep një përgjigje pse ka ndodhur kështu, pse është sjellë kërkesa për ligj edhe nuk ka marrë Qeveria vendim konform kompetencave që i ka ose që të amendojë atë listën e kompetencave që i ka Ministria e Bujqësisë, që me krejt respektin nuk mund të them se nuk po bënë kurrigjë deri me tani, mirëpo të sjellin ligj. Edhe tash për ta shpjeguar pse, të paktën mendoj unë, po provoj nja 1 minutë, 1 minutë e pak t' i lexoj dy ose tri nene të shkurta të këtij projektligji qysh ka ardhur kështu.

Neni 12, është neni i cili si në njëfarë forme gati, nën nen flet për metodat e këshill dhënës, domethënë ligji i shpjegon metodat e këshillëdhënies dhe thotë kështu: metodat e këshillimit individual, janë metoda këshilluese të punës intensive. Këto metoda mund të zbatohen në formën e vizitave në fermë, metoda praktike të demonstrimit si dhe për fermerët që drejtohen në zyrën e këshilltarit. Këshilltari mund të ofrojë këshilla për shfrytëzuesin dhe përmes telefonit, faksit, e-malit, situata kur problemi është i dedikuar.

Neni 13, thotë metoda në formë të grupeve dhe vazhdon thotë: metoda në formë të formë të grupeve siguron përfshirjen më të madhe të shfrytëzuesve të shërbimeve këshilluese. Nuk po e lexoj krejt.

Neni 14, metodat e këshillimit masiv thotë, këshillimi masiv mund të bëhet përmes mediave të shkruara dhe elektronike. Prapë nuk po vazhdoj.

Këto nene që i lexova, nuk janë nene të një projektligji, këto janë pjesë të një projekt-propozimi që e ka qua dikush, qoftë organizatë joqeveritare, qoftë pjesë e shoqërisë civile qoftë edhe një grup akademik për të përfituar grant, sepse në ligj duhet të shkruaj "duhet" ose "nuk duhet", në ligj nuk bën të shkruash metodat këshill dhënës janë edhe për t' i radhitur, nuk mund ligji me qenë ligjëratë se cilat janë metodat këshillëdhënës edhe çka duhet të bëjë ata që japin këshilla në formën e ligjëratës? Edhe, kur i lexon këto e kupton që me siguri Ministrinë dhe Qeverinë, edhe ministrin i ka vu në lajthitje një grup i njerëzve, të cilët e kanë parë që ë nuk mund t' i marrin të hollat që duan t' i marrin përmes vendimit të Qeverisë, për shkak se do të kishte probleme serioze buxhetore, po donë ta obligojnë vetveten me ligj që nesër të mos kenë mundësi kurrkush t' iu thotë se çka po bëni kështu?

Çështje tjetër për shembull është që e përmenda, me nenin 7 obligohet Kosova që të krijojë vende tjera të punës të cilat duhet t' i mbështesë bujqësia edhe industria jashtëzakonisht e vogël e Kosovës, vende të punës gati, gati në këtë sistem të panevojshme për shembull për shkak se me një udhëzim administrativ, në bazë ligjeve ekzistuese, ministri i Bujqësisë mund t' i obligojë komunat deri në njëfarë mase ose edhe në Ministrinë e vet që të ketë sistem këshillëdhënës nëpër të gjitha drejtoritë komunale që i kemi për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural. Nuk ka komunë që nuk e ka një drejtori për bujqësi.

Tani, për shembull, mund të thuhet një çështje tjetër që në këtë ligj, përmes këshillimit në bujqësi po kërkohet përmes nenit të caktuar që të ketë edhe mbështetje të rinisë për aktivitete kulturore në zonat rurale. Shikoni, kurrkush nuk po thotë që nuk është mirë për ta bërë këtë punë. Edhe unë personalisht jam i bindur që Qeveria e Kosovës edhe Ministria e Bujqësisë duhet ta kryejnë këtë punë, duhet ta mbështesin rininë nëpër zonat rurale, duhet mbështetur bujqësinë përmes sistemit këshillëdhënës, po unë po mendoj se kryerja e kësaj pune me projektligj është jashtëzakonisht e gabueshme për shkak se na ka sjellë neve në çështje të marrë me qindra orë pune gjithë Kuvendi i Kuvendi i Kosovës për të bërë diçka që këta kanë mund ta bëjnë për 2 orë edhe përfundimisht po e them, mendimi im personal është se ky projektligj ka ardhur në mënyrë që të obligohet Qeveria e Kosovës, tash në këtë rast paradoksalisht ta obliguar vetveten, për t' i paguar disa njerëz të cilët kanë vendosur që ndoshta duhet paguar ata se nuk po paguhen sa duhet.

Ky projektligj nuk është për Kosovën, nuk është për bujqit, ky projektligj është për një grup të vogël të njerëzve, për shkak se vet forma e projektligjit e determinon një gjë të tillë. Unë e thërras Ministrinë mos ta votojë këtë projektligj edhe Kuvendin po e thërras Ministrinë ta tërheqë këtë projektligj. Krejt çka ka shkruar në projektligj ta bëjë me vendim të Qeverisë për shkak se është jashtëzakonisht e lehtë dhe jashtëzakonisht e mundshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Nga Grupi Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputetja Lama.

SEVDIJE LAMA: Ju faleminderit!

I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re e përkrah Projektligjin për shërbime këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural, gjithmonë duke e parë rëndësinë dhe nevojën për një projektligj të tillë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

SLS-ja nuk është paraqitur.

Në emër të Grupit Parlamentar "6+", Rasim Demiri.

RASIM DEMIRI: Hvala, predsedavajući!

Nacrt zakona o savetodavnim službama za poljoprivredu i ruralni razvoj je od posebnog značaja. Parlamentarna grupa „6+“, nakon analiza u načelu Nacrta zakona o savetodavnim službama za poljoprivredu i ruralni razvoj, ocenila je da ovaj nacrt ispunjava sve uslove i mi ćemo ga podržati u načelu. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

E ka fjalën deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit shumë, zoti kryesues!

Kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

E thamë, e thanë edhe parafolësit se faktikisht iniciativat për ndihmë në bujqësi dhe në zhvillim rural, janë të domosdoshme, por përmes formave që janë efikase.

Ofrimi i këshillave dhe sjellja e një projektligji të tillë, nuk e plotëson atë nevojën imediate e cila është për përparimin në sferën e bujqësisë për dy arsye, sepse ky projektligj ka mund shumë thjeshtë me një udhëzim administrativ në harmoni me Ligjin për bujqësinë dhe zhvillimin rural, i cili përcakton rregullat e dhënies së këshillave. Kjo detyrimisht determinon, se këtu do të ketë shpenzime apo shtesë buxhetore në aplikimin e akteve nënligjore sepse, nëse i përmendim apo i përmenden edhe disa parafolës në mënyrë tërthorazi disa nene, nëse aplikohen, atëherë do të ketë shpenzime shtesë të cilat janë shumë të panevojshme.

E para, që të ofrojmë këshilla nga njerëzit profesionist dhe e dyta prapë flitet që edhe ata që ofrojnë këshilla duhet të trajnohen dhe të certifikohen nga Ministri përkatëse. Prandaj është mirë që të analizohet kjo çështje, mos të kemi shpenzime të panevojshme. Unë nuk po dua për të paragjykuar në stimulim të investimeve në Administratë Publike përmes këtyre formave, më shumë po e shoh si një çështje e cila është në aspektin pozitiv se sa në atë negativ dhe nuk duhet të jetë politikë qeveritare mbulimi i dikastereve të ndryshëm me njerëz, sidomos në aspektin e komunave, por të ofrimit të një ndihme me të vërtetë që e stimulon bujqësinë dhe bujqit dhe fermerët të cilët të cilët merren me këto çështje, sepse nëse lexohen, lexohen me vëmendje gati çdo i treti nen, detyrimisht thotë kjo plotësohet me një akt nënligjor dhe arsyetimi që është dhënë edhe nga Ministria për Ekonomi dhe Financa, tregon qartë se aplikimi i akteve nënligjore do të rritë koston buxhetore të këtij ligji, e cila është e pa aplikueshme për momentin. Prandaj, larg asaj që të mendojmë negativisht, sepse po mundohen, herën tjetër do të bisedojmë me shembuj që detyrimisht njerëzve po ju krijohet një mundësi punësimi përmes këtyre ligjeve apo përmes një politike, e cila e mbulon ose ndikon drejtpërdrejt në Administratën publike të vendit, e cila është shumë, shumë e panevojshme. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Zoti ministër, doni ta plotësoni fjalën tuaj? Urdhëroni!

Ministri Stavileci e ka fjalën!

BLERAND STAVILECI: Faleminderit, shumë kryesues, edhe njëherë!

Për hir të sqarimeve shtesë, edhe të natyrës profesionale, edhe të natyrës sektoriale, sidomos për deputetët që nuk janë pjesë e komisionit parlamentar dhe ndoshta do të ishte mirë që t'i ofronin këshilla kolegëve të tyre, deputetë në Komisionin parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Çështja e shërbimeve këshillimore, nëse e shihni si një sintagmë, dikush mund ta shohë që është diçka shumë sipërfaqësore dhënia e një këshille të thjeshtë. Për ta ditur dhe për ta kuptuar problematikën, besoj se nuk duhet pasur një qasje periferike, jo substanciale, por duhet ditur në thelb se sa, si, në ç'mënyrë do t'ju ndihmojnë këshillat fermerëve?

Dhe këto nuk janë vetëm të një natyre bujqësore, janë këshilla menaxheriale, këshilla të marketingut, këshilla sociale, juridike. Edhe një çështje që është shumë e rëndësishme, që nuk besoj se ju e shihni brenda kësaj sintagme, e që është aplikacioni për grande dhe subvencione, është segment i shërbimeve këshillimore. Këtu, pothuajse më së shumti çalojnë fermerët e vendit tonë.

Për ta përmirësuar këtë dhe shumë defekte të tjera, brenda sistemit është paraqitur nevoja e këtij ligji. Nëse e lexoni më mirë përmbajtjen dhe nëse e shihni se si funksionin sistemi, jo vetëm te ne, por edhe te vendet e tera, do ta shini se pa shërbime këshilluese të organizuara në këtë mënyrë, pothuajse është i pamundur përparimi. Madje, madje, ekzistenca e shërbimeve këshillimore dhe ekzistenca e njësisë organizative, të cilat do të bëhen me riorganizimin e ri të ministrisë, kanë qenë edhe disa nga kushtet e domosdoshme, të cilat edhe në projektet e aprovuara të Bankës Botërore, kredinë që për pak ditë besoj do ta keni edhe ju këtu, por edhe shumë projekte të tjera, të cilat do të vijjnë, janë paragrafë të veçantë, në të cilat citohet se ekzistenca e këtyre strukturave ka bërë që ata të marrin vendim pozitiv për të akorduar fonde dhe donacione në sektorin e bujqësisë.

Çështja e implikimeve financiare, edhe këtu përsëri, nëse e shini se si funksionon sistemi, sot për sot, ne e kemi një program kombëtar. Programi i bujqësisë është një program kombëtar, nuk mund të jetë i veçantë. Është i veçantë për zona të caktuara, komuna të caktuara ose për të ashtuquajturat zona më pak të favorshme. Sot për sot, edhe në nivelin qendror, edhe në nivelin lokal mungon një organizim i mirëfilltë. Nëse shkoni nëpër drejtoritë komunale të bujqësisë, të cilat janë partner i joni në implementimin e gjitha projekteve, do ta shini se format e organizimit janë shumë të ndryshme, që është shumë e natyrshme sepse ju përshtaten karakteristikave dhe specifikave të secilës komunë veç e veç, në bazë të specifikave bujqësore, agroklimatike dhe agroambientale. Mirëpo, njerëzit të cilët punojnë aty, nuk e kryejnë punën e tyre në bazë të karakteristikave që kanë dhe në mënyrën se si do të mund t'u ndihmonin d.m.th. në mënyrën më të mirë të mundshme fermerëve.

Për këtë arsye, të gjitha burimet njerëzore janë brenda sistemit. Duhet një organizim më i mirë, nuk ka kosto shtesë buxhetore. Të gjithë këta njerëz duhet të kenë certifikata, sepse sot për sot ofrimi i këshillave bëhet në mënyra të ndryshme dhe dikush mund t'i paraqitet bujkut si një këshilltar i mirë, por që në fakt mund t'ia mësojë një praktikë krejt të

kundërt, që pastaj nuk i sjell përfitimet, rendimentin, cilësinë e produkteve të cilat ai i pret.

Andaj, shërbimet këshilluese do të duhej të shiheshin shumë më shumë, se sa vetëm në mënyrën, i kuptoj do të thotë, vërejtjet dhe sugjerimet e juaja dhe po ashtu thashë se mund të jenë pjesë të cilën edhe mund t'ju transmetoni kolegëve të juaj. Mirëpo, duhet ta dini që shërbimet këshillimore dhe agjencia e pagesave që ekzekuton grande, jo vetëm në Kosovë, por edhe në të gjitha vendet e regjionit, edhe në shtetet anëtare, edhe në shtetet kandidate, janë parakushte edhe për funksionim të mirë të sektorit, por edhe për thithjen e fondeve në kuadër të instrumentit të shtyllës 5, të instrumentit të para anëtarësimit për zhvillimin rural. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ardian, a je habitur, a po ke farë replike? Mirë, për replikë Ardiani!

ARDIAN GJINI: Faleminderit zoti nënkryetar!

Ministër, po supozoj që për atë qëllim po na patronizon dhe po na kallëzon që s'dimë ne dhe ti di. Nuk është mirë t'i thoni Kuvendit kështu. Ne dimë fort mirë çka bëjmë dhe nuk ke nevojë të na kallëzosh se çka të bëjmë ne, kujt t'i flasim, kujt mos t'i flasim? Trego çka e ke mendjen të tregosh dhe na po të dëgjojmë, por jo të na mësosh. S'jemi nxënës!

Ti e the krejt çka thash unë. Është mirë të kemi sistem këshill dhënës, krejt në rregull, këshillimor në fakt, jo këshilldhënës. U pajtuam! Ti nuk na tregove neve, pse duhet ligj të jetë, dhe pyetja ime para Kuvendit ishte, pse duhet të jetë ligj, jo a është mirë të kemi sistem këshilldhënës. Të njëjtën gjë unë e thashë që kemi drejtori nëpër komuna, të cilat ju keni mundur të bini një ligj që t'i obliguar ato drejtori të komunave, për ta kryer këtë punë, por ju përpos drejtorive që nuk po punojnë, edhe ti vetë po thua që s'po punojnë, unë nuk thashë, përveç, atyre që nuk po punojnë, ti do të krijosh edhe diçka tjetër, edhe një sistem tjetër, se askund në ligj, zoti ministër, unë e kam lexuar ligjin goxha mirë, askund në ligj nuk thotë që në këto zyra duhet të jenë këto institucione ose zyra duhet të punojnë, por ju po doni t'i licenconi, domethënë, dikush tjetër që nuk është pjesë e zyrës, ju e licenconi, ju kushtimisht, ju ministria, ndoshta edhe ju, i licenconi ata njerëz, të cilët ju i njihni dhe ata kanë për të shkuar dhe të japim këshilla. Krejt në rregull, çfarëdo këshillash. Në ligj thoni, se nuk guxojnë të japin preferenca ose të bëjnë reklamë, thotë ligji kështu.

Mirëpo, ata me siguri kanë për t'iu treguar bujqve se cilin pleh ta blejnë, cilin fertilizator. Edhe ajo vetvetiu ka për të qenë konflikt interesi, qysh po mendoni ju, se p.sh. mundet të favorizohet një prodhues ose një kompani, në krahasim me kompaninë tjetër. Nuk do të thotë që bëhet, zoti ministër, por kur ia leni mundësinë, do të bëhet, ligji po e lë mundësinë për të ndodhur kështu. Edhe veç tregona, pse ligj e jo vendim tëndin? Kjo është pyetja, nuk është pyetja a është mirë, a s'është mirë? Ne po e dimë që është mirë, por pse s'e ke bërë ti me vendim, por na ke sjell neve ta bëjmë ligj këtë çështje? Kjo është pyetja. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër replikë, ministri!

BLERAND STAVILECI: E para, po besoj që këshilla nuk është pjesë e mësimit, për atë që ju po thoni dhe unë nuk kam nevojë juve këtu t'ju mësoj, se e di që të gjithë keni mësuar dhe jeni të dijshtëm.

Çështja e ligjit, ju e thatë që mund të bëhet me ndonjë vendim. Të gjitha ato, të cilat i përmban ligji, nuk do të mund të shkruheshin në një vendim. Si mendoni që mund të shkruhen në vendim të gjitha ato procedura që parashihen aty, të gjitha ato certifikime dhe të tjera. Dhe, një gjë të tillë, përsëri po e them, sepse shpeshherë i referoheni vendeve të tjera, praktikave të tjera, mund ta shini që në secilin prej këtyre shteteve, të gjitha këto praktika ekzistojnë dhe kanë treguar sukses, më e rëndësishmja është ajo që kanë treguar sukses.

Besoj se të gjitha çështjet që duhet dhe janë të rëndësishme, janë brenda ligjit, natyrisht që edhe ky ligj sikurse të gjitha ligjet tjera, për këtë arsye edhe ekzistojnë procedurat pastaj parlamentare, brenda komisioneve të ndryshme, ku deputetët, anëtarët e komisionit mund t'i shqyrtojnë, mund t'i japin sugjerimet e tyre, por nuk besoj që duhet të vihet në pikëpyetje ajo, të cilën ju po e vini në pikëpyetje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në mbledhje janë prezentë 74 deputetë. Po futemi, pra në procedurën e votimit. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Faleminderit! Konstatohet se me 54 vota "për", 7 vota "kundër" dhe 5 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për shërbimet këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural.

Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Faleminderit! Vazhdojmë me pikën e 7-të të rendit të ditës, që është:

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime, për shqyrtim në parim. Ftoj ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Rexhepi, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin. Zoti ministër, e keni fjalën!

BAJRAM REXHEPI: I nderuari kryesues i Kuvendit,
Ministra,

Të nderuar deputetë,

Arsyeja për hartimin e projektligjit të ri që e rregullon kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit është inkorporimi i çështjeve thelbësore që janë të domosdoshme për ushtrimin e

kontrollit kufitar dhe mbikëqyrjes së tij, si dhe rregullimi i bashkëpunimit të brendshëm dhe ndërkombëtar në fushën e kufirit dhe menaxhimit të aktiviteteve kufitare.

Aktualisht, ligji në fuqi për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror nuk e ka trajtuar në tërësi fushën e kufirit dhe mbikëqyrjen e tij, si dhe i njëjti nuk i ka paraparë dispozitat ndëshkuese që, sipas kësaj, gjykatat kompetente me vështirësi i kanë trajtuar çështjet që kanë të bëjnë me kundërvajtjet kufitare.

Po ashtu, tani në mënyrë më koncize është rregulluar edhe koordinimi dhe bashkëpunimi ndërmjet agjencive kufitare, si elemente kryesore për kufijtë e hapur, por të mbikëqyrur dhe të kontrolluar mirë. Në këtë projektligj, kapitull i veçantë i kushtohet edhe bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën kufitare, si dhe parashihet edhe shkëmbimi i oficerëve ndërlidhës, me qëllim të vendosjes së bashkëpunimit efektiv dhe efikas, normalisht, sipas marrëveshjes ndërkombëtare.

Është me rëndësi të potencohet se tani me projektligjin e ri avion-transportuesit do të obligohen që para nisjes së avionit në drejtim të aeroportit të vendit tonë, të dërgojnë listën e udhëtarëve me informatat relevante, në mënyrë që autoritetet tona kufitare ta ushtrojnë në mënyrë më të lehtë dhe më të shpejtë kontrollin kufitar.

Projektligji i ri është i sistematizuar mirë, si dhe njëkohësisht ka logjikë të veçantë juridike, me çka lehtësohet shumë edhe zbatimi i tij nga zyrtarët kufitarë kompetentë. Në punën rreth hartimit, kontribut të veçantë kanë dhënë organizatat ndërkombëtare, ICITAP, EULEX, UNDP.

Andaj, zonja dhe zotërinj deputetë,

Kërkoj nga ju ta aprovoni në parim Projektligjin për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, në mënyrë që i njëjti t'i nënshtrohet procedurës së mëtejme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, kryetari i Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë, deputeti Isufi, a do ta marrë fjalën? S'është këtu!

Në emër të komisionit, Anton Quni!

ANTON QUNI: Faleminderit zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës rekomandon që të miratohet në parim Projektligji për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror.

Komisioni, pas shqyrtimit në parim të Projektligjit për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim, në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani përfaqësues të grupeve parlamentare e kanë radhën. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputetja Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuara kolege dhe ju të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar Projektligjin për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror dhe në parim e përkrah këtë projektligj dhe fton të gjithë deputetët që ta votojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Quni.

ANTON QUNI: Edhe si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahim projektligjin, në parim, dhe të gjitha çështjet e diskutueshme do t'i trajtojmë brenda komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Në fakt, një ligj i tillë, siç është Ligji për menaxhimin dhe kontrollin e kufijve shtetëror të Kosovës është shumë i mirë se ardhur, shumë i mirë. Ne do ta japim kontributin tonë maksimal në këtë projektligj, në kuadër të komisionit dhe pjesëmarrjes tonë në këtë komision, sepse vërtet rregullon ky ligj shumëçka, por një gjë që s'po vazhdon ta rregullojë ligji edhe kur të dalë, është menaxhimi i tanishëm aktual i kufijve dhe, në fakt, këtu është ironia tanishme që ne vërtet po përgatisim infrastrukturë ligjore për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e kufijve dhe në anën tjetër situata aktuale e kufijve të Kosovës dihet se si është dhe kjo është në fakt është ironia e krejt kësaj që ne po e bëjmë sot.

Megjithatë, ne do ta japim kontributin tonë. Ligji është shumë i mirë, tash mbetet vetëm edhe kufiri dhe gjithçka do të jetë në rregull. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, si Grup Parlamentar e ka shqyrtuar projektligjin dhe i jep mbështetje me amendamentimet që do të bëhen në të ardhmen edhe në komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, deputeti Gëzim Kelmendi.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar ministra,
Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,
Pa dyshim që ky projektligj është i mirëseardhur dhe pjesa e parë, e cila ka të bëjë me kontrollin e kufirit kufitar, shihet qartë që është bërë me një qasje mjaftë profesionale dhe mangësitë janë më të vogla në krahasim me pjesën e mbikëqyrjes së kufirit shtetëror.

Nuk do isha ndalur shumë, përjashtimisht në këto tri nene, në të cilat vërehet një diversitet dhe një mospërputhje, ndoshta brendapërbrenda nenit. Te neni 35, ku ceket qëllimi i mbikëqyrjes së kufirit shtetëror, ka të bëjë me parandalimin e kalimit ilegal të kufirit shtetëror dhe parandalimin e krimit tejkuftar ndaj personave të cilët hyjnë në mënyrë të paligjshme në territorin e Kosovës, është harruar apo nuk e di me çfarë qëllimi nuk është përmendur në këtë nen, do të thotë, përveç personave të cilët hyjnë në mënyrë ilegale në territorin e Kosovës, kemi të bëjmë me një faktor shumë të rëndësishëm, kontrabandën me mallra dhe substanca të ndaluara apo të lejuara, të cilat nuk janë të regjistruara.

Ngase ne e dimë, kohët e fundit Kosova po përballet me një dukuri shumë të rëndë dhe të tillë, gjithashtu në kohët e fundit e kemi edhe raportin, i cili paraqet Kosovën si një vend destinacion i kontrabandës, përveç me qenie njerëzore, edhe me mallra. Ndaj në këtë rast, në këtë nen mungon elementi kryesor - ndalimi i kontrabandës së mallrave.

Nen tjetër, i cili do të thotë ka të bëjë gjithashtu me mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, janë masat e policisë në brendi të shtetit, te neni 46, ku zyrtarët policorë kufitarë, me qëllim të parandalimit të krimit brenda territorit të Kosovës marrin kompetenca që ta luftojnë këtë dukuri. Unë mendoj në këtë rast se këto kompetenca nuk duhet të kufizohen vetëm te zyrtarët policorë kufitarë, por edhe te zyrtarët policorë jo kufitarë, ngase ata e njohin më mirë territorin brenda vetë shtetit të Kosovës.

Dhe, neni tjetër, i cili gjithashtu ka të bëjë me dispozitat kundërvajtëse, është neni 59, ku me gjobë 500 deri 800 euro do të shqiptohet dënimi, këtu ceket, disa personave të cilët bëjnë shkelje brenda kalimit të kufirit, por këtu është paragrafi 1.3. i këtij neni, ku thotë se personi i cili nuk jep dokumentin, personi i cili refuzon të përgjigjet ndaj personave, zyrtarëve policorë kufitarë dhe i cili reziston, duhet të gjobitet me gjobë 500 deri 800 euro, çka unë mendoj dhe është e logjikshme që ai person, jo të gjobitet, por fare mos të lejohet të hyjë në territorin e Kosovës.

Ne, si grup parlamentar do ta mbështesim këtë projektligj, me shpresë që do të mbërrijnë amendamentimet e këtij ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! SLS nuk ka të paraqitur. Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, deputeti Rasim Demiri.

RASIM DEMIRI: Hvala, predsedavajući!

Nacrtom zakona za kontrolu i nadzor državne granice se uređuje granična kontrola, što je od velike važnosti. Smatramo da odredbe Nacrta zakona za kontrolu i nadzor državne

granice ne krše osnove principe Evropske Unije i nema budžetske implikacije, te Parlamentarna grupa „6+“ u načelu podržava ovaj nacrt zakona. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, deputetët e paraqitur. Deputeti Behar Selimi e ka fjalën.

BEHAR SELIMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Projektligji del se është punuar mirë dhe i ka përfshirë edhe ndryshimet pozitive edhe të karakterit politik, që ndërkohë kanë ndodhur në shtetin tonë, që i bie se tani janë përligjur kompetencat e policit të kufirit në mbrojtje të tërësisë territoriale.

Me gjithë punën e mirë që e kanë bërë Drejtoria e Zyrës Ligjore e ministrisë dhe dëshiroj t'i përgëzoj ata njerëz që kanë punuar në ministri, sepse meritat shkojnë te ata, sigurisht jo te ministri, dhe gjithë ata zyrtarë që kanë punuar në këtë projektligj dhe del se me të vërtetë e kanë punuar me një gjuhë juridike profesionale dhe si rrallë ndonjëherë, fillimisht është shkruar shqip, pastaj është përkthyer anglisht, ndërkohë që në shumicën e projektligjeve ndodh që fillimisht të shkruhen anglisht, pastaj të përkthehen në gjuhën shqipe.

Unë, meqë është shqyrtim në parim, dëshiroj t'i shpreh dy vërejtje parimore, pra jo nen për nen. E para, se me këtë projektligj duhet të rregullohet edhe më mirë misioni i Policisë së Kufirit, përkatësisht forcimi i mëvetësisë operacione të kësaj policie, në kuadër të Policisë së Republikës së Kosovës, për arsye se, siç dihet tanimë, kufirin do ta ruaj policia, vijën e gjelbër dhe mbikëqyrjen e pikave kufitare. Prandaj, duhet të forcohet sa më shumë që të mundet aspekti operativ, profesional, autonomia operacionale e Policisë Kufitare, në kuadër të Policisë së Kosovës. Pse ka ekzistuar një ndrojtje që do të krijohet një polici tjetër?

Pra, kjo çështje mund të rregullohet në dy mënyra, o me këtë ligj, ose me Ligjin e Policisë, të cilin do ta diskutojmë sot, po ashtu, pra duhet të definohet më qartë misioni dhe, e dyta, mendoj se normat juridike megjithatë nuk e kanë rregulluar mirë bashkëveprimin dhe bashkëpunimin në mes të agjencive. Pra, e kanë rregulluar mirë në raport me partnerët ndërkombëtarë, e kanë rregulluar mirë edhe në raport me bashkëpunimin brenda policisë, sepse kemi të bëjmë me menaxhim të integruar dhe menaxhimi i integruar nënkupton bashkëveprim, bashkëpunim të shumë faktorëve, të cilët ofrojnë shërbime në kufi. Prandaj, quhet i integruar dhe kemi detyrim edhe me kërkesat që na vijnë nga Bashkësia Evropiane dhe kjo nënkupton shfrytëzim të përbashkët edhe të burimeve njerëzore dhe materiale.

Natyrish që strategjia për menaxhim e integruar të kufirit i rregullon këto, mirëpo dihet gjithandej botës ku kemi të bëjmë me këtë çështje, ka telashe në koordinim mes agjencive, sepse ka konkurrencë mes agjencive, si asaj të doganës dhe asaj të policisë. Prandaj, kërkohet që bashkëveprimi dhe bashkërendimi të bëhet rregull juridike më shumë, se sa të lihet në baza të partneritetit apo të koordinimit të njësive të doganës, njësive të policisë apo edhe njësive tjera fito-sanitare, veterinare që ofrojnë shërbime atje.

Po e përsëris edhe njëherë, duhet të forcohet roli i Policisë Kufitare brenda Policisë së Kosovës. Pra, nuk po flas për një polici në vete, për arsye se policia kufitare edhe në të ardhmen do të jetë ajo e cila do ta ketë përsipër edhe mbrojtjen e sigurisë nacionale në vijën e kufirit.

Ndërkohë që vetëm në raste të jashtëzakonshme do të kemi nevojë për ndërhyrje të ushtrisë, ishalla s'kemi nevojë kurrë. Këto janë disa vërejtje parimore, përndryshe projektligjin do ta aprovojmë gjithsesi. Është projektligj që ka avancuar në kuptimin e forcimit të vetë shërbimit kufitar, duke përfshirë të gjitha agjencitë. Faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Bakalli e ka fjalën!

AURORA BAKALLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Me këtë projektligj kompletohen procedurat e kontrollit kufitar, kompetencat të cilat dalin për policinë në përgjithësi, që donë të thotë se është më i avancuar në disa aspekte, se sa Ligji për menaxhimin e integruar të kufirit dhe paraqet një hap më afër integritit evropian, sidomos në aspektin e integritit të informatave, si dhe në bashkëpunimin e institucioneve homologe të vendeve në regjion e më gjerë.

Megjithatë, ligji ka të meta. Më poshtë do t'i paraqes vërejtjet e grupit të ekspertëve të Lëvizjes për Bashkim lidhur me këtë projektligj.

Ligji, në aspektin gjuhësor, në disa dispozita është i pakuptimtë, ndërsa në disa vende lë hapësirë për keqinterpretime apo edhe për manipulime. Shembull, “koha e pritjes në pikën e kalimit kufitar zgjatet jashtë mase” thuhet, nëse zgjatet jashtë mase. Shtrohet pyetja, çka konsiderohet jashtë mase, 1 orë, 2 orë apo 10 orë? Do të thotë, se në vend të termit të përgjithshëm “jashtë mase” patjetër duhet të precizohet kohëzgjatja.

Subjekt i paqartësisë është edhe neni 24, lidhur me obligimin e avio-transportuesve për dorëzimin e të dhënave për udhëtarët, i cili kërkon përmirësim gjuhësor në mënyrë që të bëhet i kuptueshëm.

Neni 39, mundësimi i mbikëqyrjes së kufirit, konsiderojmë se nëse ndërrohet në lejin e mbikëqyrjes së kufirit, paraqet shumë qartë objektivin e tij. Gjithkund në tekst përmendet “ministria”, gjë që konsiderojmë që në përkufizime është dashur të ceket se fjala është për Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe se në ligj do t'i referohet vetëm si “ministria”.

Neni 49, në vend të “Qendra kombëtare për menaxhim kufitar”, duhet të zëvendësohet me “Qendra shtetërore për menaxhim kufitar”. Një ndër të metat tjera të ligjit është edhe numri i madh i neneve, të cilat ka pasur mundësi të integrohen, si shembull: neni 55, lidhur me aplikimin e mjeteve teknike, ka mundur të integrohet në nenin 37, “Metoda për kryerjen e mbikëqyrjes së kufirit”, nën ky i cili përmban vetëm një paragraf mjaftë sipërfaqësor për nga përmbajtja.

Vërejtje tjetër që e bën ligjin voluminoz është se disa detaje të panevojshme kanë mundur të rregullohen me udhëzime administrative dhe në këtë mënyrë të kontribojnë në praktikitetin e ligjit. Si shembull, është neni 57 lidhur me të dhënat personale, që përmban 15 dispozita të stërzgjatura. Presim që komisioni përkatës t'i marrë parasysh vërejtjet tona gjatë amendamentimit të këtij projektligjit. Ju faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar ministër, deputetë,

Padyshim që ky është një ndër ligjet më të rëndësishme që ka të bëjë me sigurinë në përgjithësi dhe që është në rangun e ligjeve që janë edhe kriter për procesin e liberalizimit të vizave, për procesin e integriteteve evropiane, etj.

Ministri theksoi disa prej çështjeve që kanë qenë të rëndësishme për t'u ndryshuar dhe mendoj që tashmë është koha, meqenëse kemi edhe një pjekuri më të madhe të institucioneve të cilat merren me menaxhimin e kufirit edhe janë pjekur kushtet që tashmë edhe ligji të ndryshohet në përputhje me ato të meta që janë evidencuar deri më tash dhe në përputhje me kërkesat e reja që dalin.

Pa dashur t'i përsëris disa prej çështjeve që u thanë, këtë që unë po e shtroj, e shtroi në njëfarë mënyre edhe Behari. Është çështja e bashkëpunimit të organeve, institucionet tjera që kanë përgjegjësi në menaxhimin e kufirit, përveç Ministrisë së Brendshme, që është institucioni themelor. Unë mendoj që edhe një prej arsyeve kryesore që ky ligj i është nënshtruar këtij trajtimi, është edhe kjo çështje, pavarësisht se a është shumë e rëndësishme gjopa për ata që nuk e respektojnë ose thyejnë ligjin, është me rëndësi të dedikohen ose të caktohen detyrat për institucionet përkatëse.

Thuhet këtu se bashkëpunimi është i nevojshëm dhe duhet të bëhet bashkëpunim në mes të institucioneve përkatëse dhe theksohet se kjo bëhet me strategji, por unë mendoj që pikërisht bashkëpunimi i këtyre institucioneve përkatëse duhet të theksohet, mendoj që komisioni përkatës dhe grupi punues do ta trajtojnë dhe mendoj që është e domosdoshme që të vihen në pah detyrat konkrete të institucioneve që kanë për detyrë të bashkëpunojnë në kuadër të kompetencave që i kanë për ta menaxhuar kufirin.

Nuk është kjo e domosdoshme, se vetëm me shprehjen "duhet" nuk mendoj që mund të precizohen detyrat as me strategjinë përkatëse nëse nuk i theksojmë në një nen të veçantë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka kuorum për votim!

Tani kemi kuorum, në sallë janë 70 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani. Faleminderit!

Kanë votuar 54 deputetë. “Për” kanë votuar 53, 1 abstenim. Konstatohet që Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror.

Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’i paraqesin raportet me rekomandime.

Po vazhdojmë me pikën e 8-të:

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për azilin

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime, për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrin e Punëve të Brendshme zoti Bajram Rexhepin, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës para deputetëve ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin. Zoti ministër, e keni fjalën!

BAJRAM REXHEPI: I nderuari kryesues i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të prezantoj para jush Projektligjin për azilin, të sponzoruar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Hartimi i Projektligjit për azilin ka filluar në fillim të vitit 2011. Në hartimin e këtij drafti kanë qenë të përfshirë edhe përfaqësues të misionëve ndërkombëtare në Kosovë, ku interesim të veçantë kanë shprehur përfaqësuesit e EULEX-it, ICITAP-it, UNHCR-it dhe OSBE-së.

Duke u mbështetur në rëndësinë dhe peshën që ka ky ligj për Kosovën dhe institucionet e saj, shihet qartë se bëhet fjalë për projektligj me prioritet të lartë për Qeverinë dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës, për faktin se ky projektligj bën pjesë në Raportin e Progresit për Kosovën, një ndër kriteret që kërkohet për të arritur progres në procesin e liberalizimit të vizave nga Bashkimi Evropian.

Nevoja për këtë projektligj është e madhe, për faktin se deri më tani kjo fushë ka qenë e mbuluar me Ligjin për azilin, i cili ka pasur mangësi sa i përket trajtimit të azilkërkuësve dhe procedurave. Mirëpo, projektligji i tanishëm i adreson fushat thelbësore për dhënien e azilit dhe statusit të refugjatit, dhënien e statusit të mbrojtjes plotësuese apo të përkohshëm personave që kanë nevojë, si dhe kthimin në vendin e origjinës apo prejardhjes ose në ndonjë vend të tretë, sipas praktikave më të mira ndërkombëtare.

Ky projektligj rregullon procedurën e kërkesës së azilit dhe hyrjen në Kosovë, si dhe rrethanat për ndërmarrjen e procedurës së azilit dhe përfundimin e azilit.

Çështje tjetër me rëndësi që rregullohen me këtë ligj janë, ndihmat sociale dhe ndihma urgjente, si dhe trajtimi i të dhënave personale dhe të dhënave në kuadrin e marrëveshjes së Dublinit. Projektligji rregullon edhe procedurën e ankimit, dokumentet personale, si dhe çështjet e bashkëpunimit ndërkombëtar. Projektligji ka gjithsej 11 kapituj, me gjithsej 107 nene.

Projektligji për azilin pritet të ketë implikime buxhetore, që vlerësohen të jenë të përballueshme nga Ministria e Punëve të Brendshme. Vlerësohet se me buxhetin aktual që ka aprovuar për vitin 2011, por edhe me buxhetin e vlerësuar për vitet 2012-2014, sipas Kornizës afatmesme të shpenzimeve, do të jetë në gjendje të absorbojë ndikimin buxhetor për zbatimin e këtij projektligji dhe s'ka nevojë për mjete shtesë buxhetore.

Projektligji ka deklaratën e pajtueshmërisë nga Ministria për Integritet Evropian, që nënkupton se është në pajtim me legjislacionin e BE-së, pra të *acquis communautaire*. Së bashku me materialin lidhur me këtë projektligj e keni marrë edhe memorandum shpjegues përfundimtar, ku përshkruhet përmbajtja e projektligjit. Nuk e shoh të nevojshme të zgjerohem më tepër, për përmbajtjen e projektligjit.

Projektligji krijon stabilitet legjislativ për fushëveprimtarinë të cilën e rregullon. Nga arsyet e theksuara më lartë, propozoj që Kuvendi i Republikës së Kosovës ta miratojë Projektligjin për azilin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pas prezantimit të projektligjit, e hapim debatin. Fjalën e ka, në emër të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë, deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar të pranishëm,

Aktualisht në Republikën e Kosovës ekziston Ligji për azilin me numër 03/L-066, mirëpo inplementuesit gjatë zbatimit kanë hasur në zbrazëtira juridike, të cilat kanë shkaktuar vështirësi për implementim.

Me këtë ligj përcaktohen rregullat ligjore për organizimin e mbrojtës dhe trajtimin e azilkërkuesve dhe masat për mbrojtjen e tyre. Projektligji për azilin është në ndërvarrësi me Ligjin për të huaj, Ligjin për procedurën administrative dhe Ligjin për gjendjen civile. Me miratimin e këtij ligji rregullohet dhe avancohet çështja e azilkërkuesve në Republikën e Kosovës, si dhe kemi një ligj i cili është në harmoni të plotë me legjislacionin e BE-së dhe konventat ndërkombëtare.

Duke pas parasysh rëndësinë e këtij ligji për forcimin e shtetit të Kosovës, në emër të komisionit ftoj të gjithë deputetët që ta votojnë në parim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, deputeti Xhelili e ka fjalën.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe ka konstatuar se është një prej projektligjeve më së miri të konceptuara dhe rregullon çështjen e dhënies së azilit, çështjen e njohjes së statusit të refugjatit dhe çështjet e zgjedhjes së statusit të mbrojtjes së përkohshme të qytetarëve apo të personave që kërkojnë strehim në Kosovë, deri sa të rregullohet kthimi i tyre në vendet e prejardhjes së tyre apo në vendin e tretë, që është e rregulluar edhe me konventa evropiane. Andaj, ky ligj, bashkë me Ligjin për të huaj, besoj që do të rregullojë mirë çështjen dhe dimensionin e politikave të migrimit dhe propozojmë që të miratohet në parim, kurse kontributin tonë në ngritjen e cilësisë të këtij ligji do të japim në komisionin adekuat.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputetja Vjollca Krasniqi.

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues i seancës!

Projektligjin për azil e kemi shqyrtuar si Grup Parlamentar i LDK-së. Edhe ky projektligj është i nevojshëm, gjë që do ta miratojmë në lexim të parë, por paraqesim vërejtjet tona, të cilat gjithashtu kanë të bëjnë me implikime buxhetore. Ministri tha, se nuk ka nevojë për kosto shtesë, mirëpo Departamenti i Buxhetit thotë se ka nevojë për kosto shtesë buxhetore, bile, bile na rekomandon që mos ta miratojmë, por meqenëse është ndryshim plotësim i ligjit aktual, do japim vizën për ta proceduar më tutje.

Gjithashtu, kemi vërejtjen në përpilimin gjuhësor të neneve të caktuara ose përkthime jo adekuate. Do t'ju përmend 2 nene:

Neni 10 thotë: “ Shtetet e origjinës, prejardhjes të treta sigurt”. Sinqerisht ju them që gjuhësisht nuk ka kurrfarë kuptimi ky përpilim. Kemi nenin 46, “padenjshmëria”. Në brendinë e nenit 46, asnjëherë nuk përmendet fjala “ i denjë” apo “i pa denjë”, por thuhet, se kur i refuzohet azili një personi, do të thotë, ai qenka “i pa denjë” për t'ju pranuar azili. Kështu që mendoj që kontributin tonë në nenet e caktuara apo gjatë amendamentimit do ta japim në grupin punues, gjegjësisht në Komisionin për Punë të Brendshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, s’ka të paraqitur! Atëherë, vazhdojmë. Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Në parim, Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah Propozim ligjin dhe në procedurat tjera do të vazhdojmë të punojmë në amendamentimin e këtij ligji, duke pas parasysh se edhe e kryesojmë këtë komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputetja Novobërdaliu.

SUZANA NOVOBËRDALIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar Projektligjin për azilin. Të njëjtën e përkrahim në parim dhe kontributin do ta japim në komisione përkatëse.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, deputeti Rasim Demiri.

RASIM DEMIRI: Hvala, predsedavajući!

Parlamentarna grupa „6+“ razmotrila je Nacrt zakona o azilu i glasaćemo za nacrt ovog zakona. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani, deputetët sipas radhës së paraqitur. Deputetja Aurora Bakalli e ka fjalën!

AURORA BAKALLI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Konstatimi i përgjithshëm i ekspertëve të Lëvizjes për Bashkim lidhur me Projektligjin për azilin, të cilët janë konsultuar edhe me organizata e shoqërisë civile që drejtpërdrejt merren me çështjen e azilit dhe azilkërkuesve, është se me këtë projektligj të drejtat e azil kërkuesve mbrohen më dobët se sa me ligjin aktual.

Kjo për ne është e papranueshme, sepse godet standardet themelore të të drejtave të njeriut që ne si shoqëri duhet të synojmë t’i arrijmë. Ndërsa, vërejtjet dhe komentet e veçanta për ligjin, janë si në vijim:

Te neni 2, te përkufizimet, paragrafi 1.6. lidhur me anëtarët e familjes së azilantit duhet qartësuar. Termet “apatrid” dhe “leje qëndrimi” duhet të futur te përkufizimet.

Te neni 6, mbrojtja plotësuese, paragrafi i 1, nënparagrafi 3, të zëvendësohet “dhunë e verbër” me “dhunë verbale” dhe e njëjta vlen edhe për nenin 66, paragrafi 3. Neni 7 lidhur me parimin e moskthimit. Duke qenë një nen shumë i rëndësishëm që prek drejtpërdrejtë të drejtat e njeriut, duhet të jetë shumë më i qartë, se sa që është aktualisht. Ne propozojmë që të përshtatet neni 7 i ligjit aktual, i cili në mënyrë specifike shpjegon rastet kur nuk mund të kthehet një azilkërkues apo azilant.

Në këtë mënyrë, ligji do të ishte në përputhje të plotë me kriteret e moskthimit, të parapara me Konventën e Gjenevës, të vitit 1951. Pra, propozimi ynë do të ishte, si vijon: “Nuk lejohet dëbimi i detyruar apo deportimi i azilkërkuesit, azilantit, në çfarëdo mënyre në territorin ku jeta apo liria e tij/saj do të rrezikoheshin për shkak të racës, fesë, kombësisë, anëtarësisë në një grup të veçantë shoqëror ose të mendimit politik”.

Gjithashtu, si edhe kolegja e LDK-së, mendojmë se neni 10, gjegjësisht titulli “shtetet e origjinës, prejardhjes të treta të sigurt” është krejtësisht i pakuptimtë dhe propozimi jonë për këtë titull do të ishte: “shtetet e origjinës ose vendet e treta të prejardhjes që janë të sigurta”.

Te neni 12, Detyrimet për të bashkëpunuar, në paragrafin 2 të këtij neni thuhet: “përrjashtimisht do të kërkohet nga azilkërkuesi që të përkthejë në një gjuhë zyrtare dokumentet e paraqitura prej tij, por që janë të hartuara në një gjuhë tjetër”. Ky paragraf nuk i plotëson standardet e të drejtave të njeriut, sipas të cilit organet kompetente në të tilla raste duhet të sigurojnë përkthimin për personat që gjenden në situatë të tillë.

Për më tepër, ky është një regres nga ligji aktual, por është edhe në kundërshtim me nenin 25.2. të këtij projektligji, ku përkthimi është obligim i autoriteteve publike. Ne propozojmë që neni 18 i ligjit aktual, i përshtatur për këtë projektligj të merret si bazë.

Ndër të tjera, neni 18 aktual thotë se “azilkërkuesi ka të drejtë për të kuptuar dhe marrë pjesë në procedurë në gjuhën, të cilën ai ose ajo e kupton”. Nëse azil kërkuesi nuk e kupton gjuhën zyrtare të procedurës, atij apo asaj do t’i sigurohet përkthyesi gjatë tërë procedurës. Dhe, neni vazhdon edhe me 3 paragrafë tjerë.

Në nenin 13 të këtij projektligji, lidhur me kontrollin, duhet të përcaktohet se cili është organi kompetent që mund të kontrollojë azilkërkuesin... në banesë private apo atë kolektive.

Neni 16, Marrëdhënia me procedurën që vjen nga Ligji për të huajt, të shpjegohet se çka nënkuptohet me “integrim të avancuar” në paragrafin 2, nën paragrafi 3 i këtij neni.

Neni 17, Gjuha e procedurës, edhe në këtë nen duhet të përcaktohet se azilkërkuesi do të ndihmohet nga një përkthyes i angazhuar nga shteti për të hartuar kërkesat zyrtare, në emër të azilkërkuesit në një nga gjuhët zyrtare të Kosovës.

Neni 18, Dispozita plotësuese, paragrafi 3 i këtij neni është i paqartë. Te neni 19, Kërkesa e azilit, ky nen të ndryshohet dhe të merret për bazë neni 16 i ligjit aktual. Në këtë projektligj, neni 19, thotë: “konsiderohet si kërkesë azili çdo shfaqje e vullnetit nëpërmjet, të cilit një person i kërkon Republikës së Kosovës që të mbrohet nga persekutimet”. Ne propozojmë që neni 16 i ligjit aktual, i cili më në detaje e përshkruan këtë, të merret parasysh.

Neni 16 i ligjit aktual i ka 8 paragrafë dhe propozojmë që të merret për bazë edhe në këtë projektligj.

Nënkreu 3, Procedurat në shkallën e parë, titulli i këtij nën kreu nuk korrespondon me nenet që e përmbajnë atë.

Neni 25, Seanca dëgjimore lidhur me motivet e azilit, paragrafi 2 është: DSHAM-ja u bën thirrje shërbimeve të një përkthyesi, përderisa do të duhej të ishte, se DSHAM-ja angazhon përkthyesin. Gjithashtu, këtu thuhet “seanca dëgjimore mbahet në një proces verbal” do të duhej të ishte se “gjatë seancës dëgjimore mbahet procesverbali”.

Gabime të ngjashme ka edhe p.sh. te neni 26, Organizatat për ndihmë të refugjatëve të autorizuar” që do të duhej të ishte “organizatat e autorizuar për ndihmë refugjatëve”.

Neni 33, jo vetëm t'u referohet neneve të tjera të ligjit, por për shkak të rëndësisë të përcaktojë në mënyrë taksative procedurat që i paraprijnë ndërprerjes së procedurës.

Te neni 45, Azili i dhënë familjeve, duhet të përcaktohet se cilat janë shkaqet dhe arsyet e veçanta.

Te neni 46, sikurse edhe kolegia e LDK-së, mendojmë se termi “padenjshmëria” është jo adekuat.

Te neni 48, Parimi, ky nen në mënyrë shumë të përciptë flet për të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga dhënia e statusit të refugjatit. Propozojmë të merren nenet 36 dhe 39 nga ligji aktual, që në mënyrë taksative të përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e refugjatit.

Te neni 49, Pasojat, duhet të ndërrohet emri i tij, sepse nuk korrespondon me përmbajtjen e nenit.

Te neni 51, duhet të ceket se aktivitetet fitimprurëse mund të ushtrohen pas 6 muajve, në mënyrë që të bëhet harmonizimi me nenin 40.

Te neni 52, Revokimi, në paragrafin 1.1, fjala “i huaj” duhet të zëvendësohet me “azilkërkues”, ndërsa në paragrafin 1.2, në mënyrë taksative duhet të përcaktohen kushtet e revokimit, e jo vetëm të bëhet një referim në Konventën e 28 korrikut të vitit 1951.

Te neni 56, Situatat e veçanta, përjashtuese, propozojmë të ndërrohet me “rrethana të jashtëzakonshme”.

Te neni 58, Grupet e personave për t'u mbrojtur, duhet të ndërrohet në “grupet e personave që kanë nevojë për mbrojtje” dhe kjo të ndërrohet edhe në nenet tjera.

Fjalja në nenin 64 ka ngelur e pa përfunduar. Tek kreu 6 duhet bërë unifikimi i termit “urgjent” ose “emergjentë”, sepse herë përdoret në njërën mënyrë, e herë në tjetrën.

Te neni 93, Komisioni kombëtar për refugjatë, në këtë nen mungon përcaktimi i rolit të këtij komisioni.

Te neni 96, ku shpjegohen procedurat e shkallës së parë, derisa si kaptinë është: Procedurat e shkallës së dytë, pretendohen, do të thotë, të elaborohen në këtë nen.

Kemi edhe një varg vërejtjesh tjera gjuhësore, të cilat e ndërrojnë kuptimin e dispozitave, por që do t'i dorëzojmë me shkrim. Shpresojmë t'i merrni parasysh gjatë amendamentimit të projektligjit në komisionin përkatës vërejtjet që ju kemi dhënë. Ju faleminderit për vëmendjen tuaj!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rexhepi, zoti ministër dëshironi ta merrni fjalën se s'ka të tjerë të paraqitur? Nuk dëshiron!

Atëherë, futemi në procedurën e votimit, për miratimin në parim të Projektligjit për azilin. Në mbledhje janë prezentë 72 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatitën për votim, votojmë tani!

Faleminderit! Konstatoj, se me 69 vota “për”, asnjë votë “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për azilin.

Kërkohej nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime. Faleminderit! Pauzë deri në ora 3:00.

Vazhdimi i seancës pas pauzës

KRYETARI: Të nderuar deputetë!

Në sallë kemi 64 deputetë. Vazhdojmë me punë.

Në rend të ditës kemi pikën 9:

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin të Ligjit nr. 2003/24, për sportin

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqit raportin me rekomandime, për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, zotin Memli Krasniqi, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantojë dhe arsyetojë projektligjin. Ministër, e ke fjalën!

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit!

I nderuari zoti kryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë që sot para jush të paraqes për shqyrtim dhe miratim njërin nga projektligjet më të rëndësishme për komunitetin e sportit në Kosovë, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të sportit nr. 2003/24.

Duke pasur parasysh përmbajtjen dhe çështjet që i rregullon, miratimi i këtij projektligji është i një rëndësie të veçantë për sportin në vendin tonë. Qëllimi i këtij projektligji është që të bëjë avancimin e kornizës ligjore për rregullimin e kësaj fushe dhe është në përputhje të plotë me përkushtimin institucional që sporti të rregullohet edhe më tej me ligje dhe akte nënligjore të standardeve të kërkuara evropiane.

Projektligji për ndryshim-plotësimin e Ligjit për sport rregullon: organizimin, kushtet dhe mënyrat e zhvillimit të veprimtarive sportive, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e

bartësve të tyre, garat sportive, financimin, mbikëqyrjen, si dhe çështjet e tjera me rëndësi për këto veprimtari, veçanërisht themelimin, regjistrimin dhe menaxhimin e organizatave sportive.

Këto ndryshim - plotësime të Ligjit për sport kanë rëndësi të madhe për komunitetin e sportit, i cili ka qenë i përfshirë në të gjitha fazat e hartimit të këtyre plotësimeve - ndryshimeve të domosdoshme. Plotësim - ndryshimet e Ligjit për sport, të cilat spikasin, janë: fuqizimi i Komitetit Olimpik të Kosovës, formimi i Agjencisë anti - doping, fuqizimi i Komitetit para olimpik, si dhe i Federatës së të Shurdhërve, fuqizimi dhe definimi i Këshillit të arbitrazhës sportive dhe i Gjykatës së arbitrazhës sportive, përmirësimi esencial i statusit të sportistit dhe aktorëve të tjerë në sport, dhënia e bursave olimpike për shpresat olimpike, mbështetja e përhershme financiare për sportistët e kategorizuar si sportistë të dalluar të nivelit vendor dhe veçanërisht për ata me të arritura ndërkombëtare, si dhe ashpërsimi i dënimeve për akterët me sjellje huligane, të cilit kundërligjshëm pengojnë aktivitetet sportive.

Projektligji është në përputhje të plotë me legjislacionin e Bashkimit Evropian, si dhe implikimet financiare shtesë janë të parapara edhe në Kornizën afatmesme të shpenzimeve. Andaj, i nderuari zoti kryetar, të nderuar deputetë, duke pasur parasysh nevojën për rregullimin e infrastrukturës ligjore sportive në Kosovë, të bazuar në kërkesat shumëvjeçare të komunitetit të sportit, ju ftoj që t'i jepni mbështetje këtyre kërkesave përmes miratimit në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sport. Ju faleminderit, për vëmendjen!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Kryetari i komisionit, e do fjalën?
Fjalën e ka deputeti Idriz Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Komisioni funksional, në bazë të nenit 56, të paragrafit 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më datën 27.9.2011, ka shqyrtuar në parim Projektligjin nr. 04/L75 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 për sport dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë rekomandim.

- Të miratohet në parim Projektligji 04/L75 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 për sport. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Ramë Vataj e ka fjalën.

RAMË VATAJ: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Grupi ynë parlamentar e ka shqyrtuar me vëmendje Projektligjin për ndryshimin edhe plotësimin e Ligjit për sport dhe jemi për aprovimin në parim të këtij ligji. Ne do të

punojmë ngushtë me komisionin përkatës për amendamentimin eventual të këtij ligji. Po ashtu, do të bashkëpunojmë ngushtë edhe me anëtarët e grupeve tjera parlamentare, ta plotësojmë këtë ligj që të jetë sa më funksional dhe sa më i mirë i mundshëm. Ju faleminderit, për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka deputetja Lirije Kajtazi.

LIRIJE KAJTAZI: I nderuar kryetar,
Të nderuar ministra, deputetë,
Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka mirëpritur ardhjen e Projektligjit me ndryshim dhe plotësimet që i ofron, duke vlerësuar se ndihmon ngritjen e cilësisë së sportit dhe plotëson disa kërkesa emergjente të sportistëve dhe të sportit në përgjithësi.

Përpiqet të precizojë strukturimin e organizatave sportive, duke u munduar që të saktësojë qëllimin dhe funksionet e tyre. Mbështetet në përvojat e mira që synon integrimin e sportit kosovar dhe kjo dëshmon edhe me deklaratën e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së, të cilën e prezantojë edhe ministri i Kulturës.

Por, nuk është kështu edhe me vlerësimin e Departamentit të Buxhetit. Këtu është një opinion tjetër, ku thuhet: “projektligji ka ndikime buxhetore që nuk mbështeten me mundësitë buxhetore të shtetit”. Veç kësaj, kemi edhe rritje stafi, e dimë që kemi kufizime në këtë drejtim, rreth 20 vetave. Siç shihet, këto elemente do të nxjerrin punë dhe mbetet të shihen alternativa për të rregulluar edhe gjendjen në këtë fushë, në pjesën e financimit.

Për këtë, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës mendon se kontribut në financim do të jepte edhe përshpejtimi i miratimit të Ligjit për sponzorime dhe donacione, ngase dihet se kjo fushë mbulohet me të madhe edhe nga fusha e mbështetjeve të sponzorizuesve të ndryshëm.

Në parim, e përkrahim, duke vazhduar ta japim kontributin tonë në komision apo edhe në format tjera të organizimit të debateve që mund t’i bëj edhe komisioni. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “ Vetëvendosje”, Afrim Kasolli.

AFRIM KASOLLI : Faleminderit, kryetar!
Të nderuar deputetë,
Edhe lëvizja “Vetëvendosje” e ka analizuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2003/24 për sport. Edhe kjo lëvizje në parim do ta përkrah këtë projektligj. Ne kemi disa vërejtje në përkufizim në këtë projektligj. Ato konsiderojmë se do t’i japim gjatë amendamentimit të ligjit, bie fjala sidomos te neni 8, ku merret parasysh veprimtaria e Komitetit Olimpik të Kosovës. Ne konsiderojmë që duhet të jetë një klauzolë e veçantë, ku bashkëpunimi ndërmjet Komitetit Olimpik të Kosovës duhet të

kemi një bashkëpunim të veçantë me Komitetin Olimpik të Shqipërisë, sepse vetëm në këtë sens, në sajë të këtij bashkëpunimi të veçantë ndërmjet këtyre komuniteteve olimpike, ne do të jemi më konkurrues në aspektin e sportit në të gjitha organizimet e tij. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të AAK-së, deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah në parim këtë projektligj, megjithëse ka edhe disa vërejtje dhe sugjerime, të cilat do të mundohem shkurt disa t'i përmend, kurse të tjerat do t'i inkorporojmë, shpresoj, në punën në komisione.

Duke pasur parasysh rolin dhe rëndësinë e sportit në përgjithësi, mendoj se krahas edhe shumë ligjeve tjera, ka qenë vërtet kohë e fundit që të kemi në dorë një projektligj të tillë, që besoj se do të jetë në funksion të ngritjes së nivelit të aktiviteteve sportive, gjithnjë në funksion të organizimit dhe të funksionalizimit të një shoqërie demokratike në Kosovë.

Në nenin 11, pika 26.1, ku është shkruar “Federata e sporteve, te personat me aftësi të kufizuara, bashkohen në Komitetin para olimpik të Kosovës, respektivisht në Federatën sportive të shurdhëve” duhet të jetë “Federata sportive” e jo “federatat”, sepse në këtë rast bëhet fjalë për një federatë e jo shumë federata të shurdhërve.

Pastaj, në nenin 7, pika 23.6. është shkruar: “angazhohet për përhapjen e parimeve olimpike dhe normave etike morale në sport”, duhet të precizohet: “Komitetit olimpik duhet të angazhohet për përhapjen e lojërave olimpike dhe normave etike e morale në sport”.

Gjithashtu, në nenin 23, pika 70.2. është shkruar: “Kurdisjet e qëllimshme të rezultateve nga ana e klubeve, federatave dhe aktorëve tjerë sportiv, me qëllim të përfitimit nga rezultati i kurdisur, dizajnohen në bazë të dispozitave të legjislacionit në fuqi”. Në këtë rast, duhet të shkruhet: “Marrëveshjet e qëllimshme të rezultateve nga ana e klubeve sportive, federatave dhe aktorëve tjerë sportiv, me qëllim të përfitimit nga rezultati i kurdisur” ndëshkohen në bazë të dispozitave të legjislacionit në fuqi.

Në nenet 25, 26, 27 dhe 28, ku është shkruar fjala: “ dënim me gjobë” duhet të ndryshohet me “ dëshmi me gjobë”. Në nenin 28 pika 79.1. është shkruar: “me dënimin me gjobë prej 2500 deri në 3000 euro, dënohet organizatori i garave sportive dhe shfaqjeve sportive, i cili nuk siguron personelin mjekësor dhe ndihmën e parë gjatë kohës së mbajtjes së garave ose aktiviteteve sportive”. Duhet të shkruhet “ me ndëshkim me gjobë prej 2000 deri në 3000 euro, dënohet organizatori i garave dhe aktiviteteve sportive, i cili nuk e siguron personelin mjekësor për ndihmën e parë gjatë kohës së mbajtjes së garave dhe aktiviteteve sportive”.

Meqenëse qëllimi i projektligjit ka qenë që të rregullojë organizimin, mënyrën e zhvillimit të veprimtarive sportive, të drejtat, detyrat dhe bartësit e përgjegjësive të bartësve të tyre, garat sportive, financimin, mbikëqyrja, si dhe shumë çështje të tjera me rëndësi të veçantë për këto veprimtari, konsiderojmë se deri diku një gjë është arritur, si objektiv, ndonëse mbetet akoma për t'u dëshiruar.

Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për sport 2003/24 duhet patjetër të përmbushë plotësimin e infrastrukturës së nevojshme ligjore në përputhje me praktikën e vendeve në rajon dhe atyre evropiane, sipas standardeve ndërkombëtarisht të pranuara. Pas elaborimit të këtij Projektligji për sportin, të paraqitur nga ministria, sipas vlerësimit tonë vërehet se në përgjithësi kemi të bëjmë me një legjislacion që veç tjerash do të prodhojë kosto shtesë buxhetore, e cila realisht është shumë e vështirë për t'u përballuar, sidomos nëse i referohemi buxhetit aktual, Ligjit të buxhetit për vitin 2011 dhe Kornizës afatmesme të shpenzimeve 2012–2014.

Barrë shtesë për buxhetin, edhe ashtu të varfër, në këtë drejtim paraqet edhe planifikimi i ministrisë për rritjen e 20 zyrtarëve të rinj. Një shqetësim i tillë është paraqitur edhe në raportin dhe vlerësimet e Departamentit të Buxhetit, pra në Ministri të Financave. Natyrisht, këto parashikime në projektligj do të ishin të mirëseardhura, mirëpo mundësitë buxhetore mendojmë se e ndikojnë të kundërtën, për faktin se shifrat janë të papërballueshme.

Megjithëkëtë, nëse kemi parasysh që buxheti për Ministrinë e Kulturës, përkatësisht Departamentin e Sportit është vetëm 4.772. 883 euro dhe i njëjti parashikohet të jetë edhe për vitin që vjen, atëherë shqetësimi ynë është, mendoj, i bazuar. Megjithatë, Aleanca do t'i japë dritën e gjelbër dhe do të mundohemi që të japim kontributin tonë në komision. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputeti Gëzim Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Ju faleminderit, i nderuari kryetar!

I nderuar ministër,

Kolegë dhe kolege deputetë të nderuar,

Situatën aktuale në të cilën ndodhet sot sporti i Kosovës, padyshim që në sferën e organizimit dhe në izolimin ndërkombëtar, ardhja e këtij projektligji shpresojmë të jetë sado pak një shpresë, e cila paraqet një organizim më të mirëfilltë të sportit, qoftë brenda vetë federatave, qoftë themelimin e federatave të reja të sportit të Kosovës.

Njëherësh shpresojmë, gjithashtu, që do të bëhet edhe më shumë sa i përket përfaqësimit të sportit kosovar në nivelin ndërkombëtar. Ne, si grup parlamentar, e mbështesim këtë projektligj dhe vërejtjet tona do t'ia paraqesim komisionit gjegjës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, deputeti Milivoje Stojanović e ka fjalën.

MILIVOJE STOJANOVIĆ: Gospodine predsedavajući, Parlamentarna grupa SLS podržaje ovaj zakon, odnosno dopunu i promenu Zakona o sportu, sagledali smo sve aspekte ovog zakona i mišljenja smo da će ove izmene i dopune omogućiti bolje funkcionisanje i bolju organizaciju u sportu, a samim tim podičiće se i kvalitet sporta u našem društvu. Podržaćemo ovaj Nacrt zakona. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “6+” deputetja Duda Balje e ka fjalën.

DUDA BALJE: Zahvaljujem, predsedavajući!

Ovaj Nacrt zakona se odnosi na uslove i načine održavanja sportskih delatnosti, prava, obaveza i odgovornosti njihovih nosilaca, sportskih takmičenja, kao i registrovanje i upravljanje sportskim organizacijama. Cilj Nacrt zakona je da se adresiraju sva pitanja koja su hitna u oblasti sporta i stvaranje novog zakonskog okvira za datu oblast. Parlamentarna grupa „6+“ podržava Nacrt zakona i glasaće za njega. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Tani e kanë radhën deputetët. Fjalën e ka deputeti Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Unë vërtet lidhur me këtë Projektligj do të ndalem në vetëm tri çështje dhe ato të tri çështje kanë të bëjnë me tri nene konkrete. Kështu, do të ndalem në nenin 18 të këtij projektligji, sipas të cilit neni 56 i ligjit të mëparshëm, Ligjit mbi sportin, duhet të riformulohet kështu: “Përkatësia e objekteve dhe mjedisve sportive përcaktohet me vendim të veçantë të Ministrisë për Sport dhe të komunave”. Fillimisht, mendoj se fjala “përkatësi” nuk është fjalë e përshtatshme, që besoj se është menduar në fjalën “pronësi”, respektivisht në pronë, që nënkupton pushtetin faktik dhe juridik mbi një objekt, e që në rastin konkret është fjala për objektet sportive, të cilat pasur parasysh sipërfaqet e mëdha që disponojnë, sigurisht vlejnë me miliona euro.

Së dyti, është e pakuptimtë që Ministria e Sportit të vendos për pronësinë e këtyre objekteve, siç thashë, me vlera milionëshe, me një vendim të veçantë. Nuk e di se çfarë kapacitetesh profesionale nga sfera pronësore-juridike mund të ketë një ministri për sport që të vendosë për objekte të tilla kapitale. Andaj, jam i mendimit që kjo dispozitë të anulohet në tërësi, kurse pronësia mbi objektet sportive të përcaktohet me dispozita të ligjeve të tjera, në të cilat parashihet apo mund të parashihet që gjykatat të vendosin mbi pronësinë e tyre në rast të kontesteve eventuale, respektivisht duhet të përcaktohet që këto objekte të jenë pronë e Republikës së Kosovës apo të njësive lokale qeverisëse, konkretisht të komunave, të cilat në mënyrë permanente do të shërbejnë për nevojat publike të sportit kosovarë.

Më tutje, do të ndalesha te neni 22 i këtij projektligji, sipas të cilit kërkohet që të ndryshohet neni 67.2. të Ligjit mbi sportin, në atë mënyrë që lehtësisht tatimore të mund të gëzojnë personat fizikë dhe juridikë që sponzorojnë veprimtarinë e organizatave

sportive konform Ligjit mbi sponzorimin dhe donacionin në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

Unë, si një ish-punëtor sportiv shumëvjeçar i Federatës së Futbollit të Kosovës dhe njohës i mirë i rrethanave dhe gjendjes së rëndë financiare të gjitha sporteve kosovare, jo vetëm që e përkrah këtë dispozitë, por në të njëjtën kohë kërkoj prej Qeverisë që sa më parë të sjellë në Kuvend një draft ligj, me të cilin do të rregullohej çështja e lehtësirave tatimore për sponsorët dhe donatorët e veprimtarisë sportive sepse, nëse vërtet kjo Qeveri dhe ky Kuvend ia donë të mirën rinisë kosovare, nëse vërtet dëshirojmë ta ruajmë dhe zhvillojmë sportin kosovar, me të cilin janë të lidhur me qindra mijëra të rinj sportistë dhe punëtorë sportivë, atëherë vërtet duhet draftuar dhe aprovuar një ligj të tillë, i cili do të paraqitej si shpëtimtar i sportit të lënduar kosovar.

Një fjalë e urtë popullore thotë: “Shpirti i shëndoshë, në trup të shëndoshë”, e unë do të shtoja, “Rinia e shëndoshë krijon shtetin e shëndoshë të Kosovës”, andaj obligim njerëzor kemi të japim kontributin tonë në këtë drejtim.

Çështja e tretë, ka të bëjë me neni 28, sipas të cilit kërkohet që të ndryshohet neni 79, pika 1 e Ligji mbi sportin, duke e rritur lartësinë e dënimit me gjobë, që ishte në Ligjin mbi sportin prej 1000 deri 2500 euro, e tani të rritet prej 2500 – 5000 euro, ndaj organizatorit të garave që nuk siguron personelin mjekësor për ndihmë të parë gjatë kohës së mbajtjes së garave ose të shfaqjeve sportive.

Duke pasur parasysh gjendjen e rëndë financiare të klubeve sportive dhe të federatave sportive të Kosovës, mendoj se dënimi ekzistues ka qenë i mjaftueshëm, e ndoshta është mirë që edhe të shqyrtohet heqja në tërësi e një dispozite të tillë ndëshkimore.

Dhe, krejtësisht në fund, një vërejtje lidhur me përdorimin e shprehjes: “Ministria përkatëse për sport” në pjesë të ndryshme të tekstit të këtij draft ligji, kështu siç është shprehur na bënë të mendojmë se kemi disa ministri për sport, e në raste konkrete bëhet fjalë për Ministrinë përkatëse, andaj propozoj që të fshihet fjala “përkatëse” dhe në tërë tekstin të mbetet “Ministria për Sport”. Ju faleminderit, për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit! Deputet, më duket që e barazove fjalën “pronë” dhe “pronësi”, që jo gjithëherë shkojnë bashkë dhe janë të barabarta. Fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë të nderuar deputetë,

Duke u bazuar nga hulumtimet në terren, kam vërejtur që me padurim pritet miratimi i këtij ligji nga mbarë shoqëria kosovare, e në veçanti nga komuniteti i sportit, duke e ditur që rregullon pikërisht shumë çështje esenciale për zhvillimin dhe funksionimin e veprimtarive të tyre sportive.

Në mes tjerash, unë dëshiroj që të flas me theks të veçantë për disa kërkesa të kahershme të komunitetit sportiv, e të cilat gjejnë zgjidhje pikërisht nëpërmjet këtij projektligji, e që realisht janë kërkesat e kahershme të tyre.

Besoj, të gjithë jemi të vetëdijshëm për rëndësinë e miratimit të këtij projektligji, i cili përmbledh në vete shumë elemente të rëndësishme, por që do të veçoja disa, siç janë: formimi i Agjencisë anti-doping, kontrollim sistematik të sportistëve, në mënyrë që të mos veprojnë kundërligjshëm, por gjithnjë në suazat fer play. Pastaj, kemi: fuqizimi i personave me aftësi të kufizuara në kuadër të komuniteteve dhe federatave përkatëse të tyre, përmirësimi esencial i statusit të sportistit dhe akterëve të tjerë në sport, si dhe mbështetja e përhershme financiare për sportistët e kategorizuar, si sportist të dalluar të nivelit vendor dhe veçanërisht për ata me të arritura ndërkombëtare, janë çështje të cilat sigurisht do të gëzojnë sportistët dhe ish sportistë të cilët për shumë vite kanë derdhur djersë dhe kanë arritur suksese të mëdha.

Dhe, në fund, padashur të përmend të gjitha, por që më duhet patjetër ta përmend, është dhënia e bursave olimpike për shpresat olimpike. Siç e dini, Majlinda Kelmendi është njëra prej atyre që duhet përgëzuar me këtë rast ministrin Krasniqi, që arriti ta ndal në Kosovë, duke i dhënë një mbështetje maksimale dhe padyshim me miratimin e këtij projektligji, edhe Majlinda, por edhe shpresat tjera olimpike dhe sportistë të dalluar të kenë mbështetje edhe më të madhe institucionale.

Duke përgëzuar Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për punën e bërë drejt rregullimit të infrastrukturës ligjore për komunitetin sportiv, unë sot ju ftoj, të nderuar deputetë, që së bashku ta mbështesim këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit deputete! Fjalën e ka deputetja Nazane Breca.

NAZANE BRECA: Faleminderit, kryetar!

Më lejoni që t'i paraqes disa sugjerime dhe vërejtje lidhur me këtë projektligj që do ta plotësonin atë. Vërejtjet e mia kanë të bëjnë me nenin 23, me të cilin neni 70 i shtohen 3 paragrafë dhe atë paragrafi 70.1. dhe 70.2 dhe 70.3.

70.1 Sjellja e dhunshme huligane në terrene sportive.

70.3 Dëmtimi apo prishja e qëllimshme e objekteve sportive dhe neni 24 me, të cilin ndryshohet dhe plotësohet neni 71, të mbajtja dhe përdorimi i fishekzjarrëve.

Në të tri këto tri paragrafë, në fund ceket se do të ndëshkohen në bazë të dispozitave të legjislacionit në fuqi. Në periudhën pas 1999 këto dukuri kanë qenë të shprehura në masë të madhe nëpër terrene sportive në Kosovë dhe se kohëve të fundit marrin përmasa për shqetësim.

Konsideroj se termi “legjislacioni në fuqi” vetëm në mënyrë të përgjithshme e rregullon këtë lëmi, d.m.th. nuk ekziston legjislacioni, i cili në mënyrë specifike e rregullon këtë lëmi. Andaj, do të konsultohet edhe legjislacioni përkatës i Bashkësisë Evropiane, Konventa apo rekomandime, si Konventa Evropiane për violencën, për dhunën në sport,

rekomandimi për përdorimin e mjeteve piroteknike në terrene sportive 2008/3 dhe të ngjashme.

Njëra prej mënyrave është edhe nënshkrimi i konventave multilaterale të shteteve të Bashkësisë Evropiane dhe jashtë BE-së, që i përkasin kësaj lëmie. Andaj, konsideroj se në fund të paragrafit 70.1, 70.3 dhe 71 duhet të shtohet edhe fjalia “ose legjislacionit të specifikuar për këtë lëmi”, duke u bazuar në konventat e BE-së dhe rekomandimet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: I nderuar kryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sinqerisht, po e ndiej veten mirë që erdhi radha që me çështjen e sportit të merret Parlamenti i Kosovës dhe besoj se me angazhimin e gjithëve, ne do të bëjmë ndryshimet e duhura në Ligjin për sport dhe të ngremë nivelin e sportit, kështu që me anë të sportit të prezantohet shteti ynë dhe emri i Kosovës dhe të sportistëve tanë të depërtojë në çdo cep të botës.

Personalisht duke qenë pjesë e sportit me vite, këtë segment e njoh mirë, si funksionon sporti dhe defektet të cilat janë në të. Andaj, mbështes punën që është bërë në ndryshimin e Ligjit për sport, e vlerësoj lartë angazhimin në këtë vit, si në kulturë, ashtu edhe në sport dhe për herë të parë ka ndryshime dhe angazhim aktiv të ministrisë për avancimin e sportit. Andaj, duke e vlerësuar punën që është bërë, do të paraqes disa propozime, të cilat mendoj se duhet të inkorporohen në ndryshimin e Ligjit për sport.

Me këtë ligj nuk është paraparë ndryshimi i regjistrimit të klubeve sportive, të cilat shumica janë regjistruar si organizata joqeveritare dhe ndryshimi i statusit të tyre nga OJQ në shoqëri aksionare apo private, pa ndonjë kriter të caktuar. Mendoj që do duhej të saktësohet mënyra e regjistrimit klubeve publike, përgjegjësitë e atyre që i regjistrojnë ... dhe mënyrën e ndryshimit të statusit të tyre apo edhe shuarjen e tyre, që mos të lejohet mundësia e individëve të papërgjegjshëm të luajnë me emrin e klubeve, siç është rasti i fundit i klubit të basketbollit “Prishtina”.

Pastaj, propozoj këto plotësime: në nenin 19.4, thuhet: “ Ministria për Sport, në bashkëpunim me Komitetin Olimpik të Kosovës dhe institucioneve sportive”, aty të shtohet “me federatat sportive dhe institucionet tjera”.

Në nenin 70 pika 1, thuhet: “sjelljet e huliganëve në terrenet sportive ndëshkohen në bazë të legjislacionit në fuqi”. Të nderuar, ne kemi parë efektet e legjislacionit në fuqi, shih vrasjen e futbollistit Kushtrim Nebiu, i cili humbi syrin si pasojë e hedhjes së gjësendeve në fushë. Sa raste, rrahje, therje, dhune shfaqen në terrenet sportive, për dënimin e këtyre akterëve legjislacioni në fuqi është tepër i ngadalshëm dhe qasja e gjyqtarëve ndaj dhunës në sport është shpërfillëse.

Andaj, propozoj që në nenin 70 pika 1, që për luftimin e dukurive huligane në këtë legjislacion për sport, do të duhej të parashihen dënime mandatare. Dënime mandatare, propozoj të rregullohen me një akt nënligjor, ku do të parashihen dënime për ata që bëjnë kundërvajtje, si në hedhje të gjësendeve në terrene sportive, ata që përfshihen në rrahje, qoftë të vogla apo të mëdha, dhe ndërprerjen e aktiviteteve sportive.

Në nenin 70 pika 3, parashihet dënimi i atyre që dëmtojnë objektet sportive dhe kjo është krejt në rregull, mirëpo nuk duhet të anashkalohen ata që 12 vjet pas luftës, me mjete të veta ngritën objektet sportive, i ruajtën, i mirëmbajtën dhe investuan në to, a do të kenë ndonjë përparësi nesër, në rast të privatizimit të këtyre objekteve sportive apo të dhënies në pronësi për shfrytëzim.

Këtu do të duhej të shtohet, se ata të cilët investuan në ruajtjen e objekteve sportive dhe ngritën vlerat e tyre, kanë përparësi në menaxhim në rast të privatizimit të objekteve sportive. Unë kam propozuar në amendament në Ligjin për partneritetin publiko-privat, ku shihet zgjidhja e pronësisë dhe menaxhimit të stadiumeve të futbollit, andaj unë konsideroj që ai amendament të kihet parasysh.

Në nenin 71, përdorimi i fishekzjarrëve ndëshkohet në të gjitha vendet dhe nuk duhet të lejohet fare futja e tyre në stadiumet apo objektet sportive dhe për të evituar këtë gjë, do të duhej që në të gjitha evenimentet sportive të jetë obligim kontrollimi në hyrje të stadiumeve dhe kjo çështje do të duhej të rregullohet me Policinë e Kosovës, të cilën klubet e paguajnë si punë sekondare, policisë.

Është absurd i llojit që sponsorët dhe donatorët e klubeve të paguajnë tatimet dhe nga ai tatim të paguhet Policia e Kosovës dhe për sigurimin në një garë sportive, ndaj mendimin se policia duhet të paguhet për punë shtesë, por jo nga ata të cilët paguajnë tatimin, por nga buxheti i Kosovës. Pastaj, konsideroj se policët që janë në punë primare, janë shumë më të përgjegjshëm, nëse ka nevojë për të marrë policë shtesë, ata do të duhej të angazhohen dhe të paguhen nga buxheti i Kosovës, e jo nga donatorët e klubeve, të cilët veç kanë paguar tatimet për të paguar policinë.

Në nenin 77, dënimi i paraparë me gjobë, duhet të hiqet dhe të parashihet me burgim prej 6 deri në 3 vjet.

Në nenin 78.1, dënimi për shitje të mjeteve stimuluese, duhet të hiqet dënimi me të holla dhe për përdorimin dhe shitjen e mjeteve stimuluese duhet të parashihet dënimi me burgim të gjatë, për shkak se shumica e mjeteve stimuluese janë droga.

Në nenin 79.1, në fund duhej të shtohet që federatat sportive duhet të përshtatin e Rregulloren e garave në bazë të ligjit, edhe Rregulloren disiplinore. Ky ligj rregullon tani shumë çështje, të cilat nuk janë rregulluar më parë, por kanë lënë anash çështjen e rregullimit ligjor të infrastrukturës sportive. Nëse nuk ka mundur të investohet deri më tani në ngritjen e objekteve kulminante sportive, hiq këtë vit angazhimet e veçanta të ministrisë, këtu aktualet kanë mbetur në mëshirën e donatorëve të klubeve, të cilët me vite derdhin para koti dhe këto objekte kanë mbetur peng i rregullimit ligjor i pronësisë

apo të shfrytëzimit të tyre. Mos të harrojmë se sportistët ishin shtyllë e shoqërisë edhe para lufte, sporti ishte segmenti i vetëm që ka funksionuar bashkë me arsimin. Andaj, ata njerëz që mbajtën gjallë këtë segment të shoqërisë, që është shkrinë kapitalin e tyre për të funksionuar ky segment i shoqërisë, duhet të kihet parasysh kur kemi të bëjmë me sportin.

Sporti deri më sot ka funksionuar falë donatorëve entuziastë. Andaj, sot besoj shumë që ky Kuvend do të japë dritën e gjelbër për zhvillimin e sportit, duke miratuar ndryshimin në Ligjin për sport dhe besoj që në afat sa më të shkurtër, ky Parlament ta aprovojë edhe Ligjin për sponzorim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Vjollcë Krasniqi e ka fjalën.

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Me të vërtetë, ky projektligj rregullon shumë çështje të organizimit të sportit kosovar, por ajo që do të rregullonte këto veprimtari më mirë, do të ishte shtimi i buxhetit për sport sepse, me gjithë këto ndryshime që janë bërë në këtë projektligj, buxheti do të mbetet prapë i njëjtë, përafërsisht sikur në këtë vit edhe në vitin e ardhshëm në bazë të kornizës afatmesme buxhetore. Për të mos i përsëritur fjalët e parafolësve, unë do të doja të ndalem vetëm në nenin 17, ku kam përshtypjen se ky nen bie në kundërshtim me praktikën e organizatave më të mëdha botërore mbi përgatitjen e kuadrove të trajnerëve, gjyqtarëve, vëzhguesve e të tjerë, sepse të drejtën për përgatitjen dhe licencimin e trajnerëve, gjyqtarëve e kanë vetëm organizatat sportive siç janë federatat e ndryshme. Për shembull, një person mund të jetë doktor i shkencave sportive, por nuk mund të udhëheqë asnjë klub që zhvillon gara në nivelin më të ultë të ndonjë lige, pa marrë licencë nga federata përkatëse, gjegjësisht federatat ndërkombëtare nëse është i pranuar ndërkombëtarisht. Andaj do t'i propozoja Komisionit, që gjatë procedurës së amendamentimit të organizojë takime pune me grupet sportive, në mënyrë që këto kompetenca të qartësohen dhe ta kemi një ligj të jetësueshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Deputeti, ish- ministri i Kulturës, Lutfi Haziri e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, kryetar!

Ministër,

Faleminderit që është sjellë ky ligj në Parlament më në fund, e meriton që të trajtohet seriozisht. Ligji i adreson problemet kryesore që sporti i ka identifikuar gjatë këtyre viteve të fundit si më problematike dhe natyrisht problem edhe më tutje i hapur mbetet qëndrueshmëria financiare e organizimit, e strukturës dhe e institucioneve që merren me sport.

Duhet të gjendet një mënyrë që të sigurohet financiarisht funksionimi i sportit. Ardhja e ligjit tjetër për donatorët dhe sponzorimin, natyrisht se do të na ndihmonte shumë dhe do ta rregullonte këtë fushë. Unë di që Ministria e Financave të Kosovës, frikësohet nga rregullimi i kësaj fushe duke besuar që afekton shumë buxhetin e Kosovës, por në fakt do ta rregullonte shumë më mirë, sepse donatorët do të kenë mundësi që përmes

sponzorimeve, një pjesë të vogël të kontributeve të tyre, t'u njihet me ligj dhe t'u rregullohet me ligj njëherë e përgjithmonë.

Zoti ministër, e fundit që mbetet në sport është disiplina dhe masat që janë paraparë, sigurisht që duken rigorozë, por janë të detyrueshme për t'i zbatuar.

Burim i problemeve në sport, i huliganizmit dhe i krejt të këqijave që vijnë këtu, janë kurdisjet e rezultateve. Kurdisjet e rezultateve edhe në shtetet e konsoliduar kanë dal problem, por kanë marr përgjigje jashtëzakonisht të mëdha edhe në Itali, në Greqi edhe së fundi në Turqi, por Kosova edhe më tutje mbetet si vend ku mund të rregullohen shumë lehtë këto çështje dhe ndikimet janë shumë negative, mandej reagimi i simpatizuesve është jashtëzakonisht agresiv dhe me pasoja.

Ne e dimë që me ligjet në fuqi është vepër penale, por duhet të gjendet një mekanizëm i cili i kontrollon, i monitoron dhe vërtet merret me këtë problem në mënyrë që të fillojnë për t'u disiplinuar dhe të vendoset ligjshmëria, rregulli dhe disiplina në këtë segment. Ligji si i tillë është i mirë, unë kisha dashur t' i falënderoj, është 20- vjetori i pavarësisht të sportit në Kosovë, është shënuar para disa ditëve, të gjithë ata të rinj, sportistë, sportiste, donatorë dhe njerëz që kanë kontribuar të mbahet gjallë ky sport, por besojmë që në të ardhmen ta përmirësojmë dhe t'ua njohim këtë meritë të gjithë atyre që vërtet e meritojnë për t'ua njohur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Dhe, kemi ardhur do të thotë në fund. Ministri, nëse ka diçka, po më duket nuk pat nevojë.

Atëherë, shkojmë në procedurën e votimit. Në sallë kemi 69 deputetë, hyjmë në procedurën e votimit. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash.

Konstatohet se me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2003/24 për sportin.

Kërkohet nga Komisioni funksional dhe komisionet e përhershëm, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportin me amendamente.

Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Policinë

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime, për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Bajram Rexhepi, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, të prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: I nderuar kryetar i Parlamentit,
Ministra,
Të nderuar deputetë,
Më lejoni të prezantoj para jush Projektligjin e ri për Policinë, i sponzoruar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Arsyet për hartimin e projektligjit të ri për Policinë, konsistojnë si në vijim: harmonizimin e tij me ligjin e ri për Inspektoratin Policor të Kosovës, konkretisht bartja e përgjegjësisë disiplinore, policore në Policinë e Kosovës, forcimin e kompetencave të drejtorit të përgjithshëm të policisë në procesin e emërimit të zëvendësrektorëve të përgjithshëm të policisë, garantimi i mandatit për menaxhmentin e policisë në rastet e kryerjes së detyrës me përgjegjësi dhe performancë të dalluar, rregullimi i pensionit familjar për zyrtarët policorë të rënë në detyrë, do të thotë garantimi i lartësisë së shumës së pensionit familjar 80% të pagës, organizimi i strukturës së projektligjit sipas dispozitave të Udhëzimit Administrativ numër 14/2008, për hartimin e projektligjeve dhe akteve nënligjore.

Në procesin e përgatitjes dhe hartimit të draftit përfundimtar të këtij projektligji kanë marrë pjesë njohës të mirë të çështjeve që kanë të bëjnë me ekspertimet forenzike si ekspertët nga NDP-ja, ICO, EULEX-it, CITAPI dhe OSBE-ja.

Hartimi i këtij projektligji është bërë në pajtim me procedurat e parapara me Rregulloren e punës së Qeverisë, andaj zonja dhe zotërinj deputetë, duke e parë nevojën e avancimit të kuadrit ligjor në këtë fushë, si dhe reformën policore në përputhje me standardet demokratike, kërkoj nga ju miratimin në parim të këtij projektligji. Faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Sipas renditjes, e ka fjalën kryetari i Komisionit funksional për Punë të Brendshme dhe Siguri.

Atëherë, në emër të Komisionit, flet Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Unë po i kryej të dyja për një herë edhe në emër të Komisionit, edhe në emër të Grupit Parlamentar.

Në fakt, në cilësinë e kryesuesit të Grupit punues për Ligjin në Policinë e Kosovës, unë do të përpiqem që shumicën e kohës dhe punës sime t'ia lë punës në Komision, por gjithsesi nuk mund t'i kapërcej këtë radhë para se t'i shpreh mendimet tona, si Grup Parlamentar dhe, po ashtu edhe të miat si deputet dhe anëtar i këtij komisioni, lidhur me vërejtjet tona çfarë i kemi në këtë ligj.

Pa dashur që të thellohem shumë dhe po ashtu siç thashë duke i lënë vetës kohën më të madhe të punës në Komision, unë dua të përmend nenin 43 të këtij ligji, nen me të cilin kemi shumë problem. Në fakt neni 43, që bën fjalë për përzgjedhjen e veçantë të komandantëve të stacioneve, pika 1 e këtij neni thotë: “Në komunat ku komuniteti serb

është komuniteti më i madh etnik, komandantët e stacioneve policore dhe komandantët e nënstacioneve i emëron Ministria e Punëve të Brendshme, me pjesëmarrjen e kuvendit komunal dhe drejtorit të përgjithshëm, në pajtim me dispozitat e këtij ligji”, por më poshtë thuhet: “ kur pozita e komandantit të stacionit ose komandantit të nënstacionit, lirohet, drejtori i përgjithshëm do t’ia dërgojë një kërkesë me shkrim kuvendit komunal, në të cilin gjendet stacioni ose nënstacioni policor në fjalë”.

Pra edhe sikur unë do të pajtohesha, gjë që nuk do të ndodhë, do të kisha shumë të vështirë t’ua shpjegoj deputetëve në leximin se pse ne e kemi pranuar që në një komunë të zgjidhet komandanti nga kuvendi komunal dhe për komunën tjetër të zgjidhet komandanti nga drejtori i përgjithshëm i policisë, përkatësisht nga struktura komanduese e policisë dhe e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Sipas paragrafit 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij ligji, Ministria e Punëve të Brendshme, asnjëherë nuk mund t’i zgjedhë komandantët e stacioneve policore në komunat serbe, pa pëlqimin e kuvendit komunal përkatës dhe kjo nuk ndodhë me komunat tjera, ndodh vetëm në komunat serbe. Pse ky diskriminim i tillë ndaj të gjitha nacionaliteteve tjera në Kosovë dhe pse ky trajtim vetëm i një komuniteti, siç është komuniteti serb si komunitet hyjnor?

Dhe, në anën tjetër mendoj se zgjedhja në këtë formë, jo vetëm që është alogjike, por është edhe jopraktike për shkak se automatikisht vetë përzgjedhësi i këtij drejtori, në këtë rast, ose pajtuesi i këtij drejtori për t’u përzgjedhur në këtë formë, do të bënte njëllë atentati ndaj zinxhirit komandues mbi Policinë e Kosovës, ngase çdo komandant i zgjedhur, do t’i jepte llogari atij që e ka zgjedhur, në këtë rast komandanti i zgjedhur nga pushteti komunal i ndonjë komune serbe, do t’i raportonte ashtu edhe siç po ndodhë vetëm atij kuvendi komunal dhe nuk do të funksionojë zinxhiri komandues ashtu siç do të duhej të ndodhte. Pra, këta komandantë do të jenë nën urdhrat e pushtetit lokal, gjë që nuk ndodhë me stacionet apo nënstacionet e policisë të komunave tjera.

Prandaj, ne mendojmë me vendosmëri që ky nen, pra neni 43 duhet të hiqet fare nga ky ligj dhe si i tillë nuk do të duhej të lejonin që të ishte hendikep i këtij ligji dhe njëkohësisht po ashtu të ishte hendikep i zinxhirit komandues të Policisë së Kosovës. Po ashtu, ne kemi shumë vërejtje tjera teknike dhe vërejtje tjera, por sidoqoftë do të japim kontributin tonë në komisionin përkatës dhe, nëse këto vërejtjet tona nuk do të përfshihen edhe nga gjithë komisioni edhe nga të gjithë, nuk do të votohen në Parlament, atëherë ne do ta diskutojmë votimin tonë “pro” apo “kundër”, pra në leximin e parë ne parimisht i japim vizën që ky t’i shkojë për trajtim Komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Radhën e kanë përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, deputeti Fatmir Xhelili.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryesues!

Përsëndetje, ministër!

Te nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, e ka shqyrtuar me kujdes këtë projektligj dhe e ka vlerësuar që ligji në parim i adreson të gjitha problemet, autorizimet dhe detyrat e Policisë së Kosovës, duke i përcaktuar qartë relacionet me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe relacionet brenda policisë, andaj edhe ndryshimet që janë propozuar në këtë ligj, faktikisht ligj i ri, i dal prej ndryshimit të Ligjit për Inspektoratin Policor, është ligj që duhet të përkrahet në parim dhe i plotëson kriteret që të jetë një ligj funksional dhe i zbatueshëm në drejtim të rritjes së cilësisë dhe efikasitetit të Policisë së Kosovës.

Ne si Grup Parlamentar kemi edhe vërejtjet dhe sugjerimet tona, por ato do t'i prezantojmë në Grupin punues në kuadër të Komisionit dhe besoj që me participimin tonë do ta arrijmë që ky ligj me të vërtetë të jetë ligj i zbatueshëm dhe funksional.

Andaj i lus deputetët që ta aprovojnë në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Anton Quni.

ANTON QUNI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Edhe ne si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, kemi studiuar dhe analizuar këtë projektligj dhe të gjithë jemi njëzëri që ta votojmë në parim. Të gjitha ato çështje që janë për diskutim, vërejtje të tjera, do t'i shfaqim në kuadër të Komisionit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Grupi Parlamentar "Vetëvendosje", e kreu përmes Rexhep Selimit.

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për Policinë e Kosovës, i jep mbështetje në parim, duke konsideruar se të gjitha angazhimet tona do t'i bëjmë që të dalë një ligj i përpunuar mirë, me amendamentimet që do të bëhen në Komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, Gëzim Kelmendi.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë dhe deputete të nderuara,

Projektligji, të cilin e kemi para veti, padyshim që është një projektligj i një rëndësie të veçantë, duke pasur parasysh rolin që ka Policia e Kosovës në rendin dhe sigurinë e qytetarëve të Kosovës si një faktor edhe i mirëqenies në përgjithësi. Padyshim që vërejtjet tona do t'i adresojmë në Komisionin përkatës, por janë disa gjëra të cilat

ndoshta nuk bën të tejkalohen, siç është fakti, këtu shumë mirë është cekur në ligj se familja e policit të vrarë në detyrë, do të ketë kompensime të cilat janë të definuar këtu me ligj. Por, unë mendoj se polici në detyrë edhe nëse nuk është i vrarë edhe të gjithë zyrtarët policorë duhet të kenë benificione në krahasim me shtresat e tjera të segmentit të Kosovës. Në radhë të parë, nëse një polic është i lënduar apo është i plagosur në e detyrë, ai duhet të ketë kompensim gjithashtu jo vetëm nëse është i vrarë, por edhe nëse është i lënduar apo i plagosur.

Në anën tjetër, nuk bën pjesëtari Policisë së Kosovës të barazohet me pjesëtarë apo sektorë të tjerë të administratës në Kosovës, duke pasur parasysh rolin dhe detyrën që e ka dhe gjithmonë jeta e tij është ekspozuar rrezikut. Ajo çka desha të potencoj këtu- një vërejtje me rëndësi është se kemi një diskrepancë apo mospërputhje të neneve 32 dhe 36. Në nenin 32 shihet, tregon se stacionet policore kufitare duhet të jenë nën juridiksionin e Drejtorisë së përgjithshme, ndërsa neni 36 thotë se stacionet policore kufitare duhet të jenë nën juridiksionin e Policisë rajonale. Do të thotë kemi një mospërputhje në mes të këtyre dy neneve, çka ndoshta ketë anëtarët e Komisionit janë më së miri në gjendje ta korrigjojnë, për arsye se është një mospërputhje mjaft e dukshme. Ndërsa, sa i përket ndryshimeve tjera, ne si Grup Parlamentar do të japim kontributin tonë në komisionin përkatës dhe në parim e përkrahim këtë projektligj.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Millosavleviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Poštovani ministre,

Poštovane kolege,

I Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke pažljivo je razmotrila Nacrt zakona o policiji i smatramo da sam nacrt zakona je detaljan i reguliše većinu pitanja. Međutim, motiv i garancija za integraciju Srpske zajednice u kosovske institucije je bio Ahtisarijev plan i mi se dosledno pridržavamo sprovođenju Ahtisarijevog plana, i zato smatramo da je član 43. tačka 4. Nacrta zakona o policiji u suprotnosti sa aneksom 8. člana 2. tačka 6. Ahtisarijevog plana, koji kaže: “Skupština opštine dostaviće drugu listu sa najmanje 2 druga predložena kandidata, pripadnika KPS koja ispunjavaju minimalne potrebne uslove za razmatranje Ministarstvu, kako je predviđeno zakonom Kosova. Ministarstvo ima obavezu da imenuje jednog od predloženih kandidata sa druge liste u roku od 15 dana, od dana prijema liste kandidata“. A u član 43. tačka 4. ovog Nacrta zakona se kaže: „U toku 15 dana, nakon prijema pismenog zahteva generalnog direktora, skupština opštine ne dostavlja zahtev preporuke“. Prema ovom članu, generalni direktor je ovlašćen da izabere i imenuje komandira stanice ili komandira podstanice bez preporuke skupštine opštine. Tokom izbora, generalni direktor treba imati u obzir potrebe i zabrinutosti lokalne zajednice u vezi sa policijskim uslugama. U roku od 15 dana, nakon izbora, generalni direktor obavestiće skupštinu opštine u vezi sa imenovanjem. Znači, sasvim suprotno od Aneksa 8. člana 2. tačka 6. Ahtisarijevog plana.

Mi samo tražimo da se svi zakoni, pa i ovaj, baziraju na Ahtisarijevom planu i dosledno se sprovede. Samostalna liberalna stranka će podržati ovaj zakon u načelu, s tim što ćemo uložiti amandmane između dva čitanja. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, deputetja Duda Balje.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Zbog neusaglašenosti Zakona o policiji, koji je na snazi, sa novim Zakonom o Policijskom inspektoratu Kosova, kao i drugim uticajnim zakonodavcima, ispred nas imamo novi Nacrt zakona o policiji koji uređuje ovlašćenje i obaveze Policije Republike Kosova, njenu organizacionu strukturu i druge aktivnosti delovanja.

Parlamentarna grupa „6+“ podržava Nacrt zakona, smatra ga značajnim i svoj dalji doprinos daće kroz rad u komisiji. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit!

Radha është e deputetëve.

E ka fjalën deputeti Behar Selimi .

BEHAR SELIMI: Ju faleminderit, kryesues!

Ministra të nderuar,

Deputetë,

Projektligji, edhe ky duket se është punuar me të vërtet mirë nga njerëzit kompetent të Ministrisë së Brendshme dhe kushdo tjetër që ka kontribuar, si sa i përket gjuhës, si sa i përket qartësisë. I kam së paku nja 20 çështje të cilat kisha mund t’i lavdëroja, që janë përfshirë apo integruar në këtë ligj, por unë do të kufizohem në tri prej tyre. Ligji e forcon pavarësinë operationale të policisë edhe më tepër ngaqë është aktualisht dhe kjo ka rëndësi. E dyta e forcon po ashtu menaxherin kryesor që të marrë pjesë në procesin e përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve, gjë që nuk ka qenë më parë. Po ashtu edhe vetë përzgjedhja e drejtorit kësaj radhe kalon nëpër Qeveri, që nuk ka qenë më parë, domethënë diskutohet apriori në Qeveri, pastaj kryeministri është ai që emëron dhe këtu juridikisht forcohet dhe profesionalisht, sigurisht i kontribuon forcimit të drejtuesit të policisë.

Gjithashtu është për t’u lavdëruar edhe pagesa që i është siguruar familjes së policit që e ka humbur jetën në krye të detyrës. Ato që i tha deputeti Gëzimi, më erdh mirë, unë do të shkoj pak më tutje dhe do të them, janë disa çështje që megjithatë nuk janë rregulluar dhe do të duhej të rregulloheshin me këtë ligj, jo me Ligjin për punën, jo me Ligjin për shërbyesit civilë, sepse është kategori specifike, kategoria e policit.

Cila është çështja që do të duhet ne gjatë amendamentimit ta përfshijmë? Është çështja çka t’i bëjmë policit i cili e humb aftësinë në krye të detyrës? Ne sot e kemi një polic që ka mbetur në karrocë në krye të detyrës dhe unë e di në atë kohë se si me solidaritet jemi munduar t’i gjendemi pranë. Prandaj detyra e policit supozon, lëndimi është shumë afër dhe pa aftësimi është po ashtu afër, prandaj duhet juridikisht të rregullohet

edhe pozita e atyre që humbin aftësinë në krye të detyrës, mos t'i mbetet rregullave aktuale të Ligjit për punën. Dhe çështja e dytë, mendoj është çështja e pensionit. Edhe këtë çështje nuk do të duhej, sepse në fund të fundit në shumicën e shteteve këto çështje rregullohen me Ligjin për polici. Pra, në marrëdhënien e punës në polici, çështja e pensionit rregullohet me Ligjin për policinë.

Nëse ne nuk ia njohim policit beneficinin plotësues, atëherë do të na ndodhë, siç jemi aktualisht, që të kemi moshën mesatare në polici, 41 vjeç. Aktualisht kjo moshë është në polici dhe i bie që diku rreth 1500 policë janë mbi moshën 55 vjeçare dhe jam shumë i sigurt si profesionalisht, si qytetar që polici i moshës 60 vjeçare, nuk ka mundësi ama bash asnjë punë në polici, punë operative ta kryej. Prandaj, unë e di që ligjet zakonisht e përfshijnë një raport ekzistues në shoqëri, po ka edhe ligje të cilat synojnë ndryshimin përmes normës e ndoshta në këtë rast kemi mundësi që rregullojmë edhe pensionimin përmes stazhit të benificuar, pra jo që të ketë 12 muaj, por t'i shtohet së plaku nga 4 muaj stazh benificion. Nuk është kjo relik i kohës së kaluar, këtu prej stazhit të benificuar, siç është quajtur më parë, është edhe i shteteve tjera demokratike. Pra kjo çështje do të duhej në kuadër të marrëdhënies së punës të rregullohej, në mënyrë që t'i jepej mundësia policit që të pensionohej përmes stazhit të benificuar. Pra këto janë disa çështje që mendoj gjatë amendamentimit, do të japin kontributin edhe deputetët tjerë dhe të forcohet pozita juridike e policit përmes këtyre ndryshimeve që futen në kapitullin për marrëdhëniet e punës. Përndryshe janë për t'u lavdëruar edhe shtesat.

Po, edhe çështja në praktikën e shteteve, kemi polici të veçantë kufitare. Kjo çështje është diskutuar kohë të gjatë sa kam qenë në polici. Unë natyrisht që kam qenë këmbëngulës se kam qenë në krye të policisë, kam qenë këmbëngulës që të kemi polici më vete sa i përket sigurimit të kufirit, duke pasur parasysh faktin që ne nuk kemi pasur ... operacionale dhe faktin se kufijtë si siguron policia në shoqëritë demokratike. Mirëpo kjo ka rënë ndesh me Kushtetutën, kjo ka rënë ndesh edhe me mundësitë tona financiare dhe është konsideruar e panevojshme që të kemi një polici tjetër të veçantë për sigurimin e vijës kufitare dhe të pikave të kontrollit dhe ka ngelur që funksionin e ruajtjes së kontrollit të mbikëqyrjes të kufirit, ta kryejnë Policia e Kosovës, përkatësisht një departament i veçantë në kuadër të Policisë së Kosovës. Po ky departament i cili ekziston aktualisht, duhet të ketë mëvetësi sa më shumë operacionale në menaxhimin edhe të burimeve e trajnimeve, sepse është funksion shumë i specializuar dhe kjo çështje mund të përgjithësohet në ligj, kurse ministri i Brendshëm mund ta specifikojë me Rregullore, për të pasur ata mëvetësi mbi bazën e praktikave më të mira evropiane. Domethënë kjo është çështje tjetër që mund ta përcaktojmë në ligj, nuk është e domosdoshme se në praktikë është duke funksionuar mirë, por mirë është ta garantojmë me ligj dhe është mirë se shkon Raporti i Progresit të Evropës dhe shkon në pajtim me manualin e Chengenit, i cili kërkon një, bile ai quan rojet e kufirit, kështu shprehimisht si terminologji. Po, kjo nuk është esenciale, kjo mund të vazhdojë edhe kështu si është, mund të debatohet, por këto janë ato sugjerime që mbase do t'i shndërrojmë në amendamente gjatë periudhës të amendamentimit.

Përndryshe është për t'u lavdëruar, u përmend këtu, nuk më kujtohet nga cili deputetë, po ekzistojnë të gjitha shtesat e mundshme për policin me këtë ligj, garantohen të gjitha shtesat për rrezikshmëri, për orar të zgjatur apo punë jashtë orarit. Prandaj, ligji garanton, çështja është pastaj edhe e mundësive financiare, por sigurisht që kostoja është menduar me kohë dhe ka edhe autoritet edhe drejtori, bashkë me ministrin që mbi bazën e këtij ligji, t'ua përcaktojë shtesat nga një fond i veçantë që e ka drejtori i policisë për shtesa. Prandaj edhe sa i përket shtesave mendoj se ligji i ka mbuluar të gjitha llojet e shtesave për policin. Këtu ligji meriton lëvdatë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Deputeti Agim Kuleta e ka fjalën.

AGIM KULETA: Ju faleminderit, zoti kryesues!
Të nderuar deputetë, Lëvizja për Bashkim konsideron se në parim ky projektligj është i mirë dhe se me disa ndryshime e plotësime të nevojshme, bëhet edhe me i kompletuar. Vërejtjet tona do t'i japim në vazhdim.

Neni 25- Vëzhgimi parandalues i vendit publik. Vërejtja këtu konsiston në çështje terminologjike. Në tërë nenin në vend të termit “incizime video akustike”, duhet të jetë “incizime video dhe audio”.

Neni 26- Përdorimi i forcës. Ky nen përmban 5 paragrafë. Në paragrafin e 5-të elaborohet termi “përdorim i forcës” me ç'rast theksohet, ndër mjetet që nënkuptohen sipas këtij termi, janë: armët e zjarrit, topat e ujit, automjetet dhe llojet e veçanta të armëve dhe mjeteve të zjarrit. Pra, në bazë të kësaj shihet se kemi të bëjmë me përdorim të forcës jo vetëm në raste individuale, por edhe ndaj masës më të madhe të njerëzve. Në këtë rast, këtu vërehet një e metë e këtij neni. Askund nuk definohet saktësisht se kush është përgjegjës për të dhënë urdhër për rastet e tilla, pra në rast reagimi ndaj masës së njerëzve.

Termi “zyrtar policor”, është shumë i përgjithshëm për këto raste. Në funksion të eliminimit të kësaj mungese, ne mendojmë se do të duhej të shtohet edhe një paragraf si paragrafi 6, i cili do të dukej kështu: “Urdhrin për përdorimin e forcës sipas paragrafit 5 të këtij neni e jep përgjegjësi i Njesisë në terren në bazë të kritereve të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ.

Neni 29 - Burimet e besueshme të informatave. Në paragrafin 3, fjalia e fundit thotë: “Zyrtari policor do ta mbajë sekret identitetin dhe rrethanat e tjera të burimit të besueshëm, përveç nëse me kërkesën e ligjshme të lëshuar nga prokurori publik kompetent ose gjyqtari, kërkohet zbulimi i identitetit.

Sipas ekspertëve të kësaj çështjeje, ky rregullim është problematik në praktikë, sepse i bën policët të hezitojnë të gjejnë bashkëpunëtorë përderisa ata mund të zbulohen në një proces gjyqësor. Ne propozojmë që kjo të hiqet, sepse polici informatën që e merr nga bashkëpunëtori, nuk e përdor asnjëherë si provë, por ajo është hap i parë i një hetimi.

Kjo informatë nuk mund të jetë provë në nj proces gjyqësor, andaj nuk ka nevojë të zbulohet identiteti i bashkëpunëtorit.

Neni 34- Drejtoritë rajonale të policisë. Në paragrafin e dytë të nenit 34, kemi të bëjmë me një formulim jo shumë të qartë. Fjalja e dytë thotë: “në përcaktimin e juridiksionit territorial të drejtorive rajonale , konsideratë do t’u jepet faktorëve ashtu siç janë, mirëpo jo të kufizuar në madhësinë e rajonit, numrin e banorëve e tjerë. Dhe mendojmë se duhet të jetë, “ në përcaktimin e juridiksionit territorial të drejtorive rajonale, konsideratë do t’ju jepet faktorëve që përfshihen, por që nuk janë të kufizuar në madhësinë e rajonit, numrin e banorëve e të tjerë”

Neni 35- Stacionet policore lokale. Ky nen përmban 5 paragrafë dhe ne mendojmë se dado të duhej të shtohet edhe një paragraf, që do të duhej të radhitej si paragrafi i tretë e në të cilin do të thuhet: “Stacioni policor lokal vepron nën juridiksionin territorial të Drejtorisë rajonale”.

Neni 38, Komisioni për përzgjedhjen e drejtorit të përgjithshëm dhe zëvendës drejtorëve të përgjithshëm të Policisë. Paragrafi i 3 i këtij neni thotë: “Nëse drejtorit të përgjithshëm dhe zëvendës drejtorëve të përgjithshëm të policisë u përfundon mandati në vitin kalendarik të zgjedhjeve të përgjithshme, atëherë qëndrimi i tyre në detyrë do të zgjatet në mënyrë automatike për 2 vjet”. Ne mendojmë se ky paragraf duhet të fshihet krejt ose së paku të shkurtohet në mënyrë drastike koha e zgjatjes së qëndrimit të tyre në detyrë.

Neni 42- Komandantët e stacioneve policore. Ky nen thotë se komandantët e stacioneve të policisë caktohen nga drejtori i përgjithshëm, bazuar në standardin e gradave, pozitave dhe përshkrimit të vendeve të punës në polici. Ne propozojmë që ky nen të ndryshohet dhe të formulohet si vijon: “Komandantët e stacionit të policisë, caktohen nga drejtori i përgjithshëm pas propozimeve të drejtorit rajonal, e bazuar në standardin e gradave, pozitave dhe përshkrimit të vendeve të punës në polici”. Ky propozim bazohet edhe në praktikat a e deritanishme të brendshme të vetë policisë.

Neni 43, Përzgjedhja e veçantë e komandantëve të stacionit. Këtë nen e kam veçuar vetëm për të nxjerrë në pah edhe një herë si dëshmi se sa jofunksional e bën Kosovën pakoja e Ahtisarit dhe përpjekja për ta zbatuar atë në mënyrë ortodokse. Ky është një diskriminim i hapur i të gjithë qytetarëve të tjerë të Kosovës dhe një rregullim që dëmton shumë rënd funksionalitetin dhe efikasitetin e policisë.

Për përmbajtjen, pat edhe parafolës që e theksuan.

Neni 46- Gradat dhe funksionet e zyrtarëve policorë. Paragrafi 1 thotë: “Sistemi i gradimit për zyrtarë policorë është në përputhje me gradat vijuese dhe i numëron: polici i ri – polic; polici i vjetër – rreshter-toger; kapiten – major, nënkolonel - kolonel, gjeneralmajor – gjeneralnënkolonel dhe gjeneral kolonel.

Ndërsa, paragrafi i dytë thotë: “gradat sipas paragrafit 1.10; 1.11 dhe 1.12 që janë gjeneralmajor, gjeneralnënkolonel dhe gjeneralkolonel, janë grada funksionale”. Këto grada merren nga punonjësi në momentin e emërimit dhe detyrat e drejtorit të përgjithshëm, zëvendësdrejtorëve të përgjithshëm dhe drejtorit të Departamentit dhe lihen me largim nga këto detyra. Pas periudhës së emërimit, i punësuarit rimerr gradën e kolonelit. Ne mendojmë se ky nen duhet të pësojë një ndryshim thelbësor, sepse në baza të praktikave ndërkombëtare, gradat nuk merren sipas funksionit. Ne propozojmë që nga paragrafi i parë të hiqen tërësisht gradat: gjeneralmajor, gjeneralnënkolonel dhe gjeneralkolonel.

Ndërsa paragrafi 2, të formulohet si vijon: “Grada më e lartë në Policinë e Kosovës është ajo e kolonelit. Funksionet e drejtorit të përgjithshëm, zëvendësdrejtorëve të përgjithshëm dhe të drejtorit të Departamentit, janë pozita në të cilat zyrtarët policorë emërohen. Me rastin e emërimit në këto poste, shenjat e tyre dallojnë në varësi të pozitës që kanë”.

Neni 50- Konflikti i interesave. Në paragrafin 4 thuhet: “pjesëmarrja aktive në cilëndo parti politike, ndjekja e udhëzimeve nga cilado parti politike e tjera,” vazhdon. Ne konsiderojmë se anëtarësimi i thjeshtë i një partie politike nuk, do të thotë që e përmend, është çështja për konflikt interesi këtu dhe ne konsiderojmë se anëtarësimi thjesht në një parti politike nuk përbën konflikt të interesit.

Me këtë nen nuk është sqaruar në të cilin rast zyrtari policor mund të jetë pjesë e një subjekti politik. Ky nen ose duhet të ndalojë tërësisht zyrtarin politik nga të qenit anëtar, sepse edhe në momentin që është anëtar prej tij pritet që të jetë edhe aktiv ose duhet ta rregullojë këtë çështje në këtë mënyrë.

Pjesa e fjalisë, si vijon: “ pjesëmarrja aktive në cilëndo parti politike të zëvendësohet me pjesëmarrje në organet ekzekutive të cilëndo parti”. Gjithashtu kemi identifikuar dy çështje që nuk janë përfshirë në ligj e mendojmë se do të duhej të përfshiheshin. Ekspertët policorë që kemi konsultuar, kanë theksuar se këtij ligji, si dhe tërë infrastrukturë ligjore që ka të bëjë me policinë, i mungon përcaktimi i mbrojtjes institucionale kur në një proces gjyqësor polici është palë që përfaqëson institucionin.

Në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, ekziston Departamenti i Përfaqësimit Ligjor që mbron institucionet kur ato janë palë, por jo individin kur ai ka vepruar në emër të institucionit.

Çështja e dytë që nuk është përfshirë në këtë ligj e mendojmë se do të duhej të ishte, ka të bëjë me mbrojtjen e identitetit të policit që merr pjesë në aksionet e ndjeshme të luftës kundër krimit të organizuar. Problemi është se në shumë raste ata thirren si dëshmitarë në këto raste, të krimit të organizuar, gjë që bën që ata dhe familjet e tyre, automatikisht të rrezikohen nga rrjetet kriminale. Të prirë për ta zbuluar identitetin e këtyre policëve janë sidomos gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it, të cilët i thërrasin këta policë si dëshmitarë, pa marrë parasysh rrethanat e vendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,
Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Lidhur me këtë projektligj unë do të paraqes këtu dy lloj të vërejtjeve dhe atë vërejtjet e karakterit të përgjithshëm dhe disa vërejtje konkrete. Sa i përket vërejtjeve të përgjithshme lidhur me këtë ligj ato kanë të bëjnë me strukturën e tij dhe me mënyrën e rregullimit të çështjeve tejet të rëndësishme nga sfera e policisë.

Kështu, në kreun II projektligji rregullon një varg çështjesh të ndryshme në mënyrë tejet të përgjithësuar dhe të pasistemuar.

Fillohet me autorizimet e përgjithshme të policisë, pastaj trajtohen disa masa që mund t'i zbatoj policia, e përfundon me mbledhjen e të dhënave.

Por, kjo pjesë e ligjit ka mundur të sistemohej me nënkapituj të veçantë, si: nënkapituj mbi autorizimet e policisë dhe mënyrën e përmbushjes së tyre, nënkapitulli mbi evidencat policore, pastaj mbi vërejtjet dhe dhënien e urdhëresave, mbi ndalimin policor, mbi përdorimin e mjeteve të dhunës nga policia, përdorimin e pasurisë së huaj, mbrojtjen e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve, si dhe një kapitull i posaçëm ka qenë dashur të jetë mbi masat dhe veprimet operativo - taktike që i ndërmerr policia.

Po ashtu, një vërejtje tjetër e karakterit të përgjithshëm të këtij ligji mund t'i bëhet lidhur me mënyrën e trajtimit të përdorimit të forcës, respektivisht të mjeteve të dhunës nga policia. Sepse në nenet 26 dhe 27 rregullohet përdorimi i forcës dhe i armëve të zjarrit nga policia, mirëpo nuk specifikohet se mjetet e tjera të dhunës, si për shembull, forca fizike, mjetet kimike, mjetet eksplozive, në cilat situata dhe në çfarë rrethanash mund të përdoren apo eventualisht në cilat situata ndalohet përdorimi i tyre.

Kurse sa i përket vërejtjeve konkrete, unë do të isha nisur nga neni 10 të këtij projektligji, në të cilin numërohen detyrat dhe autorizimet e përgjithshme të policisë.

Mendoj se përveç autorizimeve të theksuara, duhet shtuar edhe këto autorizime dhe detyra të policisë.

- a) Kontrolli, respektivisht mbikëqyrja e lëvizjes dhe qëndrimet të të huajve në Kosovë,
- b) Sigurimi i kushteve për punë të papenguar të gjykatave dhe të prokurorive,
- c) Sigurimi i personave të caktuar dhe të objekteve me rëndësi shtetërore, dhe
- d) Sigurimi i tubimeve publike dhe të tubimeve të tjera të qytetarëve.

Më tutje, do të ndalesha në neni 11 i titulluar - Autorizimet policore.

Përmbajtja e vetë këtij neni është jo në përputhje me titullin e tij dhe njëherësh ka formulime jo të arsyeshme, sepse thuhet, citoj: “Zyrtarët policorë mund të hyjnë në pronën private në zonën kufitare, përjashtimisht ata nuk mund të hyjnë në banesa private”, por të imagjinojmë situatën. Nëse një kriminel i rrezikshëm futet në banesën private të ndonjë qytetari, ndërsa ne me ligj ia ndalojmë zyrtarit policor kosovar që të hyjë në banesa private, sa të sigurt do të ndihen qytetarët dhe prona e tyre, respektivisht në çfarë niveli do të mund t’i përmbush detyrat dhe autorizimet e saj policia kosovare.

Më tutje, në nenin 16.2, theksohet: “Kur personi nuk bashkëpunon dhe masa të tjera dështojnë për të përcaktuar identitetin e tij, zyrtari policor mund të marrë personin në mbajtje”. Po e përsëris, thotë: “Mund të marrë personin në mbajtje”.

Thënë të drejtën, për mua shprehja “marrja e personit në mbajtje” është e pakuptimtë, sepse sot ndoshta është lehtë të përkthehet ligji, por për t’u zbatuar me sukses në praktikë, ligji duhet të ketë shprehje dhe formulime të kuptueshme dhe të qarta. Shprehje e përshtatshme për situatën e lartë theksuar është “ndalimi policor” apo “ndalimi nga zyrtari policor”.

Në nenin 17, rregullohet çështja e thirrjes së personit për të dhënë informacione, respektivisht thirrjen për intervistë. Në paragrafin 2, trajton thirrjen e bërë gojarisht, kurse në paragrafin 4, thirrjen me shkrim.

Por, për habi, sipas dispozitave të këtij projektligji, sikurse për thirrjet gojarisht, ashtu edhe për atë me shkrim, parashihen kushtet e njëjta. Andaj, jam i mendimit që dispozitat me të cilat rregullohet thirrja gojarisht duhet të fshihen në tërësi.

Në nenin 18, rregullohet kufizimi i përkohshëm i lirisë së lëvizjes së personave. Pas analizimit të dispozitave të këtij neni, mund të vërehet se në përgjithësi policia mund t’ia kufizojë lirinë e lëvizjes personit në rastet e fatkeqësive, të epidemive dhe në raste të tjera të rrezikut të pashmangshëm.

Unë mendoj se me këtë ligj duhet dhënë e drejta policisë që personit t’ia kufizojë lirinë e lëvizjes edhe në rastet kur policia është duke kryer masa operativo - taktike dhe veprime hetimore konkrete. Për shembull, gjatë organizimit dhe zbatimit të pritës, gjatë zbatimit të racisë, gjatë kryerjes së kontrollimit. Policia, me qëllim që të kryej me sukses masat e këtilla, duhet të ketë të drejtë t’ua kufizojë personave lirinë e lëvizjes përkohësisht.

Ndërsa, në nenin 21, përdoret shprehja: “konfiskimi i përkohshëm i sendit”. Jam i mendimit që duhet përdorur shprehjen: “sequestrimi i përkohshëm i sendit” sepse “konfiskimi” nënkupton masën e tillë e cila konsiston me marrjen e sendit, i cili nuk do t’i kthehet më personit.

Kurse në nenin 24, apo sipas nenit 24, “zyrtari policor është i autorizuar ta sigurojë dhe ta shikoj vendin e ngjarjes së veprës penale”. Kjo dispozitë në masë të konsiderueshme është në kolizion me nenin 254 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, sepse sipas

nenit 254 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, prokurori publik ose gjykata mund të urdhërojë këqyrjen e vendit të ngjarjes për të shqyrtuar provat e mbledhura.

Edhe pse në paragrafin 2 të këtij neni i njihet e drejta policisë që të bëjë këqyrjen e vendit të ngjarjes, me dispozitën e cila thotë: “Këqyrja e vendit të ngjarjes kryhet nga gjykata, prokuroria publike dhe policia”. Unë jam i mendimit që neni 24 i këtij draft-ligji duhet analizuar dhe njëherësh duhet harmonizuar me nenin 254 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Më tutje, pas nenit 32, mendoj se duhet shtuar një nen të ri, i cili rregullon mbajtjen e evidencave gjegjëse policore. Konkretisht duhet përcaktuar që policia mbanë këto lloje të evidencave: evidencat mbi personat e privuar nga liria, evidencat mbi veprat e kryera penale dhe kundërvajtjet, evidencat mbi personat dhe sendet që gjurmohen, evidencat mbi personat që iu është ndaluar hyrja në Kosovë, evidencat mbi personat ndaj të cilëve është zhvilluar procedura e identifikimit, pastaj personat të daktiloskopuar, fotografuar dhe ekzaminuar me metodën e ADN-së, pastaj evidenca mbi mjetet e përdorura të dhunës, evidencat mbi personat e zhdukur, evidencat mbi gjësendet e zhdukura, evidencat mbi kufomat e paidentifikuara dhe evidencat mbi parashtresat e qytetarëve.

Dhe, krejtësisht në fund, do të theksoja se në nenin 20 të këtij projektligji rregullohet ndalimi i përkohshëm i personit nga policia.

Mendoj se këtij neni duhet shtuar një paragraf, me të cilin rregullohet vendimi mbi ndalimin e përkohshëm, përmbajtjen e këtij vendimi, si dhe procedurat, afatet lidhur me dorëzimin e këtij vendimi. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja, Suzan Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryesues!

Edhe unë e kam shqyrtuar Projektligj për policinë dhe i kam disa vërejtje.

Fillimisht, meqë pritet plotësimi dhe ndryshimi i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, mendoj se është dashur të pritet ky plotësim dhe ndryshim ngase në të përfshihen detyrat dhe autorizimet policore të policisë gjyqësore, derisa në këtë projektligj nuk përmenden.

Tek neni 39, te kriteret për emërim të drejtorit të përgjithshëm dhe zëvendës drejtorëve të përgjithshëm, do të thotë kërkohet në pikën 1.3 të ketë edhe gradën policore - kolonel.

Mendoj se nuk është e domosdoshme që të kërkohet një gradë e tillë, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca vetëm në një gradë. Pika 1.3 duhet të ndryshojë dhe kishte qenë mirë të jetë: “të ketë ushtruar punën dhe detyrat e menaxherit të lartë”.

Tek neni 46, te gradat dhe funksionet e zyrtarëve policorë, numërohen gradat vijuese. Mirëpo, tek pika 1.10 thuhet: “gjeneralmajor”, 1.11 “gjeneralnënkolonel” dhe 1.12 “gjeneralkolonel”. Gradat sipas paragrafit 1.10, 1.11 dhe 1.12 të cilat i numërova të këtij neni, janë funksionale dhe janë të lidhura me mandat. Këto grada merren në momentin e emërimit në detyrat e drejtorit të përgjithshëm, zëvendës drejtorëve të përgjithshëm të

policisë dhe drejtorit të departamentit dhe lidhen me largim nga këto detyra. Pas përfundimit të periudhës së emërimit, i punësuar rimerr gradën e kolonelit. Do të thotë, këto janë gradat të cilat lidhen me mandat. Prandaj, unë kisha propozuar që pika 1.10, 1.11 dhe 1.12 të mos jenë grada ushtarake, por ato duhen të jenë me shenja të pozitive funksionale. Për shembull, tek pika 1.10, në vend të “gradës gjeneralmajor” të jetë “ndihmësdrejtor”. 1.11 “gjeneral nënkolonel” të jetë “zëvendësdrejtor” dhe 1.12 “gjeneralkolonel” “drejtor i përgjithshëm”.

Sipas strukturës organizative të policisë, tash dhe sipas këtij opsioni do të duhej të kemi 5 gjeneralmajorë, 2 gjeneral nënkolonelë dhe një gjeneralkolonelë. Çka do të bëhet me gradat e këtyre dhe pozitat në Policinë e Kosovës kur ata e kryejnë mandatin ose shkarkohen në këto tri pozita? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Po e filloj me një analogjikë kështu që, ashtu sikur neni 143 për Kushtetutën e Republikës së Kosovës, që e rrënon në fakt Kushtetutën, pasi që paketën e Ahtisarit e vendos mbi Kushtetutën, edhe te ky projektligj, neni 43 i këtij projektligji e rrënon çdo gjë të mirë që mund të ketë ky projektligj. Pra, pavarësisht elementeve të mira të këtij projektligji, neni 43 e godet atë pasi e fut elementin racist brenda tij dhe i fut standardet e dyfishta.

Sipas këtij ligji, nxitet dhe kultivohet edhe më tutje ideja që për qytetarin serb, polic i mirë është vetëm polici serb, pra ideja e uniformës, ideja e të qenit zyrtar, ideja e sundimit të ligjit mbetet nën hijen e elementit etnik.

Ky nen i këtij projektligji, së pari, përveç që e godet këtë projektligj, në fakt e godet edhe policinë e atyre komunave në të cilat kanë të drejta të veçanta komunitetet dhe komuna që ta zgjedhin drejtorin, pasi që e bën të privilegjuar mbi të tjerët dhe e bën të ndjehet disi mbi ligjin.

Dhe, tjetra, është fakti që e godet në përgjithësi policinë, pasi që në polici e fut logjikën e standardit të dyfishtë. Pra, e bën që përkatësia etnike të bëhet më e vlefshme në fakt se sundimi i ligjit.

Kjo dukuri është prezente qysh tash në polici. Pra, deri tash në polici kemi pasur rastin të shohim shumë qartë që ekzistojnë standarde të dyfishta. Kemi pasur raste kur protestojnë shqiptarët dhe ka dhunë të paparë ndaj tyre nga Policia e Kosovës dhe kemi raste sikur që kanë qenë ato para dy vjetësh në Ranillug dhe në Mutivodë, në kufi, kur ka pasur protesta dhe policia ka qenë totalisht e butë dhe e qetë ndaj tyre, edhe pse ka qenë e goditur dhe e sulmuar fizikisht.

Pra, ky element e bën atë që brenda policisë të ekzistojë në logjikën, në mendësinë e policit ideja se kur ke të bësh me qytetarin serb, duhet të jesh ndryshe dhe të sillesh ndryshe në raport me qytetarin shqiptar.

Ky ligj, në vend se ta eliminonte këtë dukuri, pra, të standardit të dyfishtë, në këtë nen vetëm sa do ta forcojë këtë dhe në përgjithësi ky element i këtij ligj po e shpërfaqë edhe për një gradë më tutje, po e demaskon paketën e Ahttisarit dhe aspektin kriminal të saj në raport me lirinë e qytetarëve të Kosovës dhe në raport me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit!

Nuk ka diskutues të tjerë. Përfaqësuesi i Qeverisë a dëshiron ta marrë fjalën më? Jo!

Atëherë, kërkohet deklarimi i deputetëve për miratim në parim të Ligjit për policinë.

Në mbledhje janë prezentë 73 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani! Faleminderit!

Konstatohet se me 60 vota “për”, një abstenim dhe 11 “kundër”, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për policinë.

Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’i paraqesin raportet me rekomandime.

Po, zoti nënkryetar Hamiti e ka kërkuar fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryesues i seancës!

Meqë e mora fjalën, meqë jemi në fundin e pjesës së trajtimit legjislativ në këtë seancë, me qenë se kemi 6 raporte, me qenë se është punuar disa orë rresht dhe me qenë se është e pamundur që ky rend dite të kalojë sot, Grupi Parlamentar i LDK-së propozon që të votohet eventualisht edhe shqyrtimi i dytë i Projektligjit për nisma legislative dhe të gjitha raportet të fillojnë të trajtohen nesër nga ora 10:00. Kjo ka qenë edhe si diskutim në Kryesi, sepse është ditur që 19 pikë nuk mund të kalohen brenda ditës. Unë mendoj që është momenti që të kryhet kjo pjesë e seancës, në mënyrë që nesër të kemi shqyrtim raportesh. Kërkoj që ta qitësh propozimin në votim!

KRYESUESI: Faleminderit!

Unë mendoj që s’ka nevojë të votojmë fare, është vendim edhe i Kryesisë bashkë me kryetarët që të ndahet në dy pjesë. Edhe ashtu, kjo është pika e fundit për sot, pika njëmbëdhjetë e rendit të ditës dhe nesër vazhdojmë me pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës.

Pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës, është:

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për nismat legislative

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për nisma legislative dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratim e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Legjislacion, deputetin Arben Gashi, nuk është këtui, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime. A e ka autorizuar dikë? Atëherë, fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Po flas në emër të Grupit punuese që i ka hartuar këto amendamente në kuadër të Komisionit të ligjeve. Gjithsej janë hartuar 6 amendamente, shumica prej tyre janë plotësime terminologjike. Mirëpo, dëshiroj të tërheq vëmendjen te amendamenti 4, që është ndoshta përmbajtësor dhe ky amendament parasheh që nismat legjislative të qytetarëve, pasi t'i kenë plotësuar kushtet, t'i dorëzohen kryetarit të Kuvendit apo anëtarit të Kryesisë së Kuvendit në një ceremoni solemne. Thjesht, ne kemi menduar se dorëzimi i një nisme me 10.000 nënshkrime është një ngjarje për Kuvendin. Në ligjin e sponzoruar nga Qeveria ka qenë një procedurë rutinore, kur kjo dorëzohet thjesht para zyrtarit për parashtrësia. Kemi dashur që vërtetë të shkojmë me praktikën e vendeve tjera, kur në shenjë të respektit për nismën legjislative, Kuvendi i Kosovës organizon ceremoni të veçantë të pranimit të kësaj nisme. Do të thotë, këto janë 6 amendamente, të cilat në fakt e plotësojnë dhe e ndryshojnë këtë projektligj.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetja Lama është paraqitur.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë kam një vërejtje themelore në lidhje me këtë projektligj, sepse megjithëse nismën legjislative e ndërmerr Kuvendi, pra në momentin kur janë deputetët ata që ndërmarrin nismën legjislative, në këtë projektligj i është lënë qeverisë që të vendosë nëse një nismë legjislative duhet të kthehet në ligj apo jo, pra të merret miratimi i Qeverisë dhe mendoj që këtu ka një kontradiktë të thellë logjike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Tani ne po vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Ju patët një propozim, por ligji ka ardhur, kështu që e vetmja mundësi e juve është që të bëni një kërkesë te nënshkruesi i ligjit, ose të propozosh një amendament. Në qoftë se ke amendament të shkruar ose do të propozosh diçka, ne mund ta qesim në votim, pa problem. Urdhëro, Alma!

ALMA LAMA: Këtë vërejtje të cilën e thashë shkurtimisht në mënyrë shumë të zgjeruar, e kam paraqitur në komisionin përkatës, kur është diskutuar, sepse është shumë thelbësore. Një ligj i cili përgatitet nga Kuvendi, nuk ka pse të marrë për shembull miratimin për buxhetin nga ana e Qeverisë. Duke pasur parasysh që Kuvendi ka Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe do të duhej që deklaratën në lidhje me këtë projektligj të bënte ky komision. Mendoj që në këtë mënyrë sigurohet pavarësia e Kuvendit nga ana e Qeverisë, sepse po ndodhë e kundërta dhe ky projektligj që sot kemi para vetes, domethënë ia lenë kompetencat Qeverisë që për nisma legjislative të cilat i ndërmarrin deputetët, të vendosin në lidhje me çështjet buxhetore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Deputeti, Gjini është paraqitur.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Për shkak se jam në Komision të ligjeve po e marrë fjalën. ajo që ka bërë komisioni dhe grupi punues, në këtë rast është e domosdoshme për shkak se cilado nismë legislative është e mirëseardhur. Mirëpo, nuk ka kapacitet as komisioni, as Kuvendi që ta bëjë vlerësimin e ndikimit në buxhet dhe disa vlerësime tjera të cilat duhet të bëhen. Shembull konkret është nëse një nismë, një iniciative ligjore me 10.000 nënshkrime për ndërtimin e ndonjë objekti i cili mund të kushtojë 2 miliardë, vjen në Kuvend, ne jemi të obliguar ta marrim mendimin e Qeverisë. Kjo nuk e ndalon procedimin e ligjit më tutje. Mirëpo, është obligative që të merret mendimi i Qeverisë së Kosovës, cilësdo Qeveri, tash mos të keqkuptohemi ashtu. Po Qeveria i ka kapacitetet për të vlerësuar se një ligj a mund të mbështetet me buxhet a jo. Po, Kuvendi, prapë se prapë e ka fjalën e fundit, duhet të jemi të qartë këtu. Nuk i ndalohet Kuvendit ta procedojë ligjin më tutje, vetëm se kërkohet mendimi i Qeverisë për këtë çështje. Mendoj se mund të më plotësojë edhe profesor Bajrami, mirëpo kjo është ajo që e kemi bërë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Edhe një herë, zoti Bajrami e ka kërkuar fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Mendoj që kjo dilemë as që duhet të shtrohet, sepse Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka përcaktuar se kush mund të propozojë ligje. Ato janë subjektet e autorizuar. Ajo çfarë ky ligj ka përpunuar, ka afirmuar qytetarët si propozues të ligjeve dhe qytetarët plotësisht janë të barabartë.

Mirëpo, e tha edhe kolegu që ka qenë bashkë në Komision kur e kemi punua, qytetarët apo nisma qytetare nuk ka kapacitete për ta vlerësuar koston financiare dhe, siç dihet, në bazë të rregullave të Kuvendit, çdo ligj duhet të ketë koston financiare, duhet të ketë vlerësimin e koston financiare dhe është krejt e natyrshme që një ligj mund të ketë shpenzime edhe ato shpenzime duhet t'i planifikojë Qeveria, e cila edhe propozon buxhetin. Me asnjë gjë nuk diskriminon kjo dispozitë qytetarët që të bëjnë nisma legislative.

KRYESUESI: Faleminderit!
Alma edhe një herë e ka kërkuar fjalën. Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit!

Të gjitha këto arsyetime që u thanë më sipër, natyrisht që qëndrojnë, por çështja është çfarë nëse për një nismë legislative të nisur nga qytetarët ose nga deputetët, Qeveria thotë se s'ka buxhet, sepse nuk i intereson që të miratohet ai ligj. Kjo është çështja, kjo është dilema të cilën unë po e trajtoj. Mendoj që do të ishte shumë më demokratike që për nisma të cilat vinë nga Kuvendi, të vendos Komisioni për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Unë mendoj që arsyetimi i përfaqësuesit dhe të dy anëtarëve të komisionit është më bindës dhe konform Kushtetutës. Megjithatë, unë s'mund të qes në votim diçka që nuk është e shkruar dhe nuk është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës, me qenë se ashtu e parasheh edhe Kushtetuta.

Pra, po vazhdojmë me votimin e amendamenteve veç e veç.

Amendamenti 1.
Kush është “për”?
“Kundër”, nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamente të Komisionit funksional të gjitha janë, nuk ka asnjë dyshim.

Amendamenti 2.
“Kundër”, nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 3.
“Kundër”, nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 4.
“Kundër”, nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 5.
“Kundër”, nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 6.
“Kundër”, nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Në sallë janë 67 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani:

Konstatohet se me 61 vota “për”, 3 abstenime dhe asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për nisma legjislative.

Faleminderit! Mirupafshim nesër në orën 10:00.

* * *

E premte, 7.10.2011, Vazhdimi i seancës

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 6 tetor 2011, për pikat e mbetura.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 61 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë.

Vazhdojmë me pikën dymbëdhjetë të rendit të ditës.

12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me përcaktimin e përgjegjësive dhe të procedurave të zbarkimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit

Komisioni funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës e ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj ministrin e Forcës së Sigurisë, zotin Agim Çeku, si propozues i çështjes ta prezantojë këtë vendim.

MINISTRI AGIM ÇEKU: I nderuar zoti kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, I nderuar ministër dhe shumë të nderuar e të respektuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Siç e dini, neni 126.1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës e definojnë Forcën e Sigurisë së Kosovës si forcë kombëtare të sigurisë së Republikës së Kosovës dhe që mund të dërgojë pjesëtarët e saj në operacione jashtë vendit në përputhje me përgjegjësitë dhe obligimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës.

Po ashtu, neni 2.1 i Ligjit për FSK-në, numër 03/L-46 e autorizon Forcën e Sigurisë së Kosovës që mund të dërgojë njësi apo pjesëtarët e vet në operacione në rast krizash dhe në operacione të mbështetjes së paqes.

Po i njëjti ligj, në nenin 4 thotë se Kuvendi i Republikës së Kosovës miraton dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës për përballimin e situatave të jashtëzakonshme apo për operacionin në mbështetje të paqes.

Po ashtu, neni 5 i këtij ligji autorizon Presidentin apo Presidenten e Republikës së Kosovës të urdhërojë FSK-në që të dërgojë forcat jashtë vendit në operacione të ndryshme, pas miratimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Pra, Ligji për FSK-në parasheh dërgim të njësiteve të Forcës së Sigurisë në dy lloj operacionesh. Në operacione për menaxhimin e situatave emergjente apo të emergjencave civile dhe në operacione në mbështetje të paqes apo në operacione paqeruajtëse.

Procedurat e dërgimit të forcave jashtë vendit për operacione në mbështetje të paqes gjithmonë duhet të jenë dhe do të jenë në përputhje me ligjin dhe do të ndodhin gjithmonë pas një debati në Kuvendin e Kosovës dhe pas miratimit të Kuvendit të Kosovës, sepse situatat kur kërkohet dërgimi i forcave në operacione në mbështetje të paqes janë situata të parashikueshme, ka kohë të mjaftueshme për planifikim, për vendimmarrje, për miratim dhe përgatitje të njësiteve të FSK-së për të shkuar në operacione paqeruajtëse. Por, nëse aplikohet kjo procedurë në raste kur kërkohet reagim i shpejtë i Forcave të FSK-së në një vend që kërkon ndihmën tonë, nëse aplikohet kjo procedurë, mund të pamundësohet apo mund të vonohet dërgimi i Forcave të Sigurisë së Kosovës, kështu që nëse kërkohet një debat apo seancë e parlamentit, thashë, mund të vonohet, sepse dihet - duhet të thirret një seancë e jashtëzakonshme, sepse këto janë situata e paparashikueshme, janë situata ku në çdo moment mund të ndodhin dhe në çdo moment një vend tjetër mund të na ftojë për ndihmë. Kështu që thirrja e një seance të jashtëzakonshme merr kohë, Parlamenti mund të jetë i shpërbërë në atë kohë kur ndodhë fatkeqësia, Parlamenti mund të jetë në pushim në kohën kur ndodhë fatkeqësia dhe ne e kemi vërejtur për këtë arsye se këtu është një boshllëk ligjor dhe mu për këtë arsye ne e kemi paraparë që në vitin e ardhshëm në Strategjinë apo Planin legjislativ të Qeverisë të nxirret një ligj i cili definon të gjitha detalet lidhur me zbarkim apo dërgim të forcave të FSK-së jashtë vendit në këto dy lloj operacionesh.

Për këtë arsye, Qeveria propozon që si masë e përkohshme që ta tejkalojmë këtë boshllëk ligjor, ta nxjerrim një vendim dhe t'i definojmë procedurat e zbarkimit të FSK-së jashtë vendit vetëm dhe vetëm në situata emergjente, kur kërkohet reagim i menjëhershëm. Ne kemi propozuar që kjo procedurë të shkojë në këtë mënyrë, e keni propozim-vendimin, që pas marrjes së kërkesës nga shteti pritës, nga shteti pritës apo Qeveria e shtetit pritës, kryeministri kërkon nga ministri i Forcës së FSK-së që sa më shpejtë ta hartojë një plan operacional me të gjitha detajet e zbarkimit për nga numri, kapacitetet e nevojshme, koha e nisjes, detyrat, sistemi i komandimit, komunikimit e tjerë e tjerë dhe këtë plan t'ia prezantojë kryeministrit. Posa kryeministri ta miratojë këtë plan, e njofton Presidentin apo Presidenten me planin operacional të dërgimit të forcave të FSK-së. Presidentja e miraton, e njofton Kuvendin e Republikës së Kosovës për vendimin e saj për dërgimin e forcave të sigurisë dhe njëkohësisht e urdhëron komandantin e FSK-së për dërgim të forcave të FSK-së në përputhje me Planin operacional, të aprovuar nga Kryeministri dhe Presidenti.

Andaj, ne kërkojmë nga ju që ta miratoni këtë propozim, që në rast se ndodhë një gjë e tillë, ta kemi dhe të jemi të autorizuar që ta ndjekim këtë procedurë të dërgimit të forcave të FSK-së jashtë vendit.

Kemi pasur dy rast të intervenimit në situata të tilla në Republikën e Shqipërisë, ku është kërkuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë që të dërgojmë forca të FSK-së për ndihmë në përballimin e emergjencave civile me rastin e përmbajtjeve në rajonin e Shkodrës. Atë kohë Kuvendi ka qenë i shpërbërë për shkak të zgjedhjeve që kanë qenë, ka qenë koha e zgjedhjeve dhe është tejkaluar kjo procedura ligjore dhe një farë forme edhe nuk është respektuar në tërësi Ligji për FSK-në. Që mos të ndodhë edhe raste të tilla, deri në nxjerrjen e ligjit kërkojmë që të aprovohet nga Kuvendi kjo procedurë e dërgimit të forcave të FSK-së jashtë vendit nëse kërkohet nga ne. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjala është për kryetarin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë, deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ne në Komision e kemi shqyrtuar dhe analizuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me përcaktimin e përgjegjësisë dhe të procedurave të zbarkimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit dhe me rekomandimet që i kemi ofruar seancës plenare, mendojmë se duhet të aprovohet për arsyet që i përmendi edhe ministri.

Konsiderojmë se Forca e Sigurisë së Kosovës sot ka kapacitete mirë të përgatitura, të cilat kanë dhënë shembullin më të mirë të funksionimit të një institucioni të shtetit dhe janë bërë imazh i mirë për vendin, gjë që ka mundur edhe daljen jashtë vendit edhe më herë në misione të ndryshme të cilat u përmendën.

Duke konsideruar kapacitetet e Forcës së Sigurisë së Kosovës, e cila duke qenë edhe në bashkëpunim të ngushtë me KFOR-in, me mekanizma ndërkombëtarë të Sigurisë në Kosovë dhe të veprimtarisë së saj, ka treguar zhvillimin e gjithmbarshëm të një force, e cila pretendon të jetë nesër edhe strukturë e NATO-së, një ushtri e cila garanton edhe sigurinë e vendit, bashkëpunimin në rajon dhe në integritet që po ndodhin. Prandaj, konsiderojmë se me rekomandimet që i ka ofruar Komisioni, mund të aprovohet ky vendim i Qeverisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputeti Fatmir Xhelili.

FATMIR XHELILI: Faleminderit kryetar, përshëndetje!

Përshëndetje për ministrat!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë për zbarkimin e forcave të sigurisë në vendet tjera dhe duke u bazuar në analizën dhe

vlerësimin e kapacitetit momental të forcave të sigurisë, që është një forcë e cila i ka arritur parametrat thuaja se evropian për veprim në situata emergjente dhe në gjendje të jashtëzakonshme, i ka arritur kapacitetet për t'u përballur, t'i menaxhojë situatat e jashtëzakonshme dhe gjendjet e jashtëzakonshme, falë absorbimit të plan - programeve dhe trajnimeve prej ushtrive më eminente strategjike, të cilat kanë kooperua dhe janë partner me forcën e sigurisë dhe duke u bazuar në rezultatet e forcës së sigurisë që i ka dëshmuar disa herë me ushtrimet fushore, posaçërisht me ushtrimin e fundit fushor, ne pajtohemi që t'ju krijohet hapësirë juridike forcave të sigurisë për t'i dëshmuar aftësitë e veta edhe për t'ju ofruar ndihmë shteteve të cilat kanë nevojë për t'i zgjedhur situatat emergjente dhe pasojat prej fatkeqësive natyrore apo të fatkeqësive tjera, kështu që pajtohem me Propozim - vendimin e ministrit për t'i zbarkuar forcat e sigurisë në vendet tjera.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka kërkuar deputetja Vjollca Krasniqi.

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar këtë Propozim-vendim të Qeverisë për zbarkimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit dhe besojmë plotësisht që FSK-ja ka kapacitete dhe do të mund të realizojë suksesshëm ndërhyrjen e saj në nevoja të vendeve të tjera.

Andaj, si Grup Parlamentar e mbështesim këtë propozim-vendim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, deputeti Rexhep Selimi e ka kërkuar fjalën.

REXHEP SELIMI: faleminderit, zoti kryetar!

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” mbështet këtë Projekt-vendim, duke dhënë kontributin tonë edhe në komisionin përkatës dhe edhe në këtë mbledhje pas shqyrtimeve ne e kemi mbështetur dhe i kemi rekomanduar Kuvendit që ta miratojë këtë Projekt-vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me përcaktimin e përgjegjësive dhe të procedurave të zbarkimit të Forcës së Sigurisë jashtë vendit, duke qenë shumë të vetëdijshëm që ky vendim do ta plotësojë një vakum ligjor i cili ekziston tani në lidhje me zbarkimin e Forcës së Sigurisë jashtë vendit dhe gjithsesi do të jemi shumë të gatshëm të japim kontributin tonë në momentin kur procedohet Ligji për zbarkimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe deri në ardhjen e këtij ligji, ky vendim apo në këtë rast ky propozim-vendim i Qeverisë do të jetë jo vetëm i mirë se ardhur, po do të jetë i domosdoshëm që FSK-ja të ketë infrastrukturën e mjaftueshme ligjore që të zbarkojë jashtë vendit në misionet e saj emergjente, paqeruajtëse apo në forcimin e partneritetit me shtetet anëtare të NATO-s. Pra, ne i rekomandojmë Kuvendit që ta miratojë këtë Propozim-vendim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të AAK-së, deputeti Ardian Gjini, e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Sikur edhe dje, ne mendojmë se përkundër faktit se qëllimi i sjelljes së këtij dokumenti në Kuvend është pozitiv, ka ndodhur gabim në sistemin e vendimmarrjes për shkak se dje e kemi aprovuar një ligj për këshilldhënien në bujqësi, gjë të cilën ka mund ta bëjë ministri ose Qeveria me një vendim të vetin, pa pasur nevojë të sjellë ligj në Kuvend, ndërsa sot një vendim për procedurat e zbarkimit të Forcës së Sigurisë jashtë vendit, e kemi vendim e jo ligj. Sidoqoftë, duhet të them se qëllimi është ai që Aleanca e mbështet, qëllimin e këtij vendimi. Shpresojmë seriozisht që Qeveria sa më shpejtë që të jetë e mundshme do ta sjell ligjin, për shkak se kjo është çështje që duhet të rregullohet me ligj e jo me vendim të Qeverisë.

Po ashtu, mendojmë se ligji duhet të jetë urgjent për shkak se ky dokument mund të kontestohet edhe në aspektin kushtetues për shkak se në një demokraci parlamentare Kushtetuta ose fryma kushtetuese nuk lejon që as Qeveria as Kuvendi me vendim ta detyrojë Presidentin që të sillet në mënyrë ose një mënyrë tjetër, përpos se me ligj.

Do të thotë, ne kemi të drejtë ta bëjmë një ligj dhe Presidenti obligohet që ta respektojë ligjin, por nuk mund të nxjerrim vendime të cilat mund ta përcaktojnë mënyrën se si vepron ose çka, më saktë të themi, vepron Presidenti. Këtë po e them, për shembull, e keni pikën 3.3 të Vendimit, i cili thotë: “Presidenti e njofton Kuvendin e Kosovës dhe autorizon komandantin...” e tjera e tjera, thotë ne po marrim vendim dhe tregojmë se cilat duhet të jenë veprimet e Presidentit dhe prapë se prapë nuk është gabim, kështu duhet të jetë, mirëpo është vendim në vend se të jetë ligj.

Edhe një herë, Grupi Parlamentar i Aleancës e mbështet qëllimin e këtij propozimi, do ta votojë këtë Propozim-vendim, duke kërkuar edhe një herë që Qeveria edhe ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës sa më shpejtë që të jetë e mundshme ta sjellë një ligj i cili do ta mbulojë atëherë këtë vendim të cilin e marrim sot. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Myzejene Selmani, e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Përsëritet për dy ministrat dhe të gjithë deputetët në seancë!

Koalicioni për Kosovë të Re ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me përcaktimin e përgjegjësisë dhe të procedurave të zbarkimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit.

Duke marrë parasysh se Ministria e FSK-së ka për momentin vetëm Ligjin e FSK-së, të cilin edhe ministri e prezantoi mjaftë mirë çka e ngarkon Ligji për daljen e forcës së sigurisë jashtë vendit në operacione krize dhe paqe. U pa mjaftë mirë që ligji potencon

qartë që një propozim-vendim duhet të miratohet edhe në Kuvend të Kosovës dhe njëkohësisht edhe obligimet që i dedikohen Presidentit apo Presidentes në rast të autorizimit të Forcës së Sigurisë jashtë vendit.

Me shpresë që ministri në një të ardhme shumë të shpejtë mund të na sjell Ligjin për zbarkim të Forcës së Sigurisë, në Kuvend të Kosovës, Koalicioni për Kosovë të Re, për arsye se kemi një forcë kombëtare e cila dita - ditës është kah ecë mjaftë mirë, jep mendimin e vet që kjo të kalojë sot në seancë plenare, që ministri në të ardhmen të jetë në përgatitje të projektligjit që të miratohet në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të SLS-së, a e do fjalën dikush? Jo.

Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, deputetja Duda Balje e ka fjalën.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Posle razmatranja predloga Vlade i uzimanje u obzir svih činjenica, Parlamentarna grupa „6+“ je donela odluku da podrži predlog Vlade Republike Kosova za iskrcavanje bezbednosnih snaga van zemlje i svoj dalji doprinos daće kroz rad u nadležnoj komisiji. Zahvaljujem!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Faleminderit!

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Sigurisht që është mirë që Forca e Sigurisë së Kosovës të ketë të drejtë, gatishmëri dhe interes të zbarkojë edhe në vatrat e ndryshme të krizës për ndihmë vendeve dhe popujve të tjerë dhe kjo është një gjë e mirë. Mirëpo, do të ishte shumë më e mirë nëse do ta kishim së pari FSK-në ushtri në Kosovë, e më pastaj ushtri që shkon në misione të tjera.

Mendoj që Kosova sot urgjentisht ka nevojë për FSK-në që të shpall dhe të bëhet ushtri, para se ajo të shkojë në misione, ku sërisht nuk do të pranohet si ushtri. Në një farë mënyre, ka më shumë kuptim në politikën e jashtme, se sa të brendshme, FSK-ja siç po konceptohet këtu. Pra, vetëm për misione jashtë vendi të veprojë, e jo brenda vendit, po duket diçka që i përket më shumë politikës së jashtme, se sa të brendshme, gjë që nuk është në rregull.

Në anën tjetër, në përgjithësi në Kosovë ka një lloj përzierje të politikës së brendshme me të jashtme. Ne e dimë që politika e jashtme është bërë politikë e brendshme, e tash politika e brendshme po bëhet politikë e jashtme, sepse ... zyrtarët të cilët punojnë në mekanizmat shtetërorë tek politika e jashtme bëjnë gara për njohje, të cilët janë pjesë të politikës së brendshme në Kosovë dhe, në anën tjetër, ajo që do të duhej të ishte politikë e brendshme, në fakt bëhet gjithmonë për jashtë. Mendoj që edhe FSK-ja tash po futet përbrenda kësaj kornize, e cila nuk është me interes prioritar në Kosovë.

Mendoj që është e padrejtë qysh Qeveria e Kosovës nuk e lejoj një seancë të Kuvendit për gjendjen e sigurisë në veri dhe për çështjen e sovranitetit dhe integritetit territorial, pikërisht në kohën kur ajo vazhdimisht fliste për këtë gjë, siç tha Visari dje, me gazetarët e dëgjueshëm, në vend se të flas këtu ku ka edhe deputetë të padëgjueshëm.

Njëkohësisht, ne të gjithë e dimë që demokracia është kulmi i shtëpisë, themelet janë ekonomia dhe ushtria, dhe është evidente që në Kosovë po e ndërtojmë një shtëpi, ku i gjithë përqendrimi është tek kulmi, ndërkohë që themelet në fakt nuk janë aty.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë superfuqia kryesore botërore sot, jo pse mbase e kanë demokracinë më të mirë në botë, se ka demokraci edhe më të mira, siç janë ta zëmë vendet skandinave, mirëpo ata e kanë ushtrinë edhe ekonominë më të fuqishme në botë dhe kjo përbën fuqinë e tyre dhe dominimin e tyre. Domethënë, shtetndërtimi si fuqi, si sovranitet, si përparim bazohet mbi ekonominë dhe ushtrinë para se demokracinë, e ne kur jemi tek themelet, ato i projektojmë jashtë, pra nuk i ndërtojmë brenda, nuk e kuptojmë shtetndërtimin si shtet ndërtim tash edhe këtu po e kuptojmë si ndihmë jashtë, prej nga edhe presim ndihmë andej.

Gjithashtu, mendoj se demokracia pa ekonomi edhe pa ushtri prodhon të drejta formale të cilat në rastin më të mirë janë të papërdorshme, ndërkajzë zakonisht aktualizohen si shkelje të tyre. Pra, po prodhohen disa të drejta në Kosovë, të cilat ose janë të papërdorshme, ose po i marrim vesh sepse po na i shkelin, sepse e këtillë është demokracia pa ekonomi edhe pa ushtri.

Dhe, së fundit, desha të them që është mirë që ne sa më shumë të integrohemi në botë, t'ju ndihmojmë popujve të tjerë, shteteve të tjera, të krijojmë partneritete, aleanca, mirëpo besoni kur s'jemi për vete, s'jemi as për dikë tjetër. Dhe mbase nuk do të na thonë, mirëpo buzëqeshjet me të cilat do të përballemi, do të jenë sarkastike karshi nesh dhe nëse ne nuk jemi një herë si shtet i pavarur dhe sovran në shërbim të qytetarëve të Kosovës, është vështirë e besueshme që do të mund të jemi në shërbim të qytetarëve të tjerë.

Mendoj që FSK-ja do të duhej që të shpallet dhe të bëhet ushtri dhe më pastaj gjithsesi t'i ndihmojmë edhe të tjerët. Mendoj se ka një lloj gabimi në hapa, ndonëse si veprim politik është i nevojshëm që ne të kemi misione të FSK-së edhe jashtë vendit, por duhet ta kuptojmë, në momentin aktual në Kosovë kjo ngjanë shumë si një lloj gjesti jashtëkohor. Faleminderit!

KRYTARI: Faleminderit!

Deputeti Hydajet Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Si edhe bashkëfolësit, bashkë kolegët më parë, unë s'mund ta vë në pyetje nevojën për ta miratuar një ligj të tillë, si edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike dhe grupet e tjera.

Madje edhe kështu siç jemi, mendoj që është shumë mirë për Kosovën që më në fund kemi bërë kapacitete edhe për t'u angazhuar në misione ndërkombëtare dhe kjo është vërtet e arritur kolosale, që s'mund të mos e bëjë secili të ndihet mirë.

E mbështesë prandaj në parim, por ajo që është shqetësim i imi, si dhe që u tha më parë, është një praktikë që me vendim të rregullohet një praktikë e rregulluar me ligj. Është një precedent, që po të vazhdohet, mund të shkaktojë shumë probleme.

Ka mundësi që ligji të amendamentohet në procedurë të përshpejtuar dhe, nëse është e nevojshme, të mos humbet kohë. Por, megjithatë, praktikat e rregullta të ligjvënies duhet t'i respektojmë, aq më shumë nëse me ligj preken edhe kompetencat e institucioneve kryesore të shtetit, edhe me Kushtetutë dhe del i vështirë rregullimi i këtyre raporteve, pa lëre më tash edhe me vendime.

Dhe, e treta dhe kryesorja, për mendimin tim dhe që më bëri të marrë fjalën, është prirja për të zhveshur Kuvendin nga kompetencat që ka. Kjo vërehet gjithkund, gjithandej dhe e konsideroj shumë të rrezikshme për shëndetin e demokracisë në të ardhmen. Gjithkund parlamentet janë pak më indolente, se janë trupa kolektive me qindra anëtarë. Por, askund nuk vërehet kjo prirje për ta anashkaluar Kuvendin.

Për më tepër, Kuvendi asnjëherë nuk është dëshmuar pengesë edhe kur ka qenë nevoja për miratimin me urgjencë të vendimeve ose të zgjidhjeve ligjore. Edhe kur ka qenë Kuvendi në pushim, megjithatë Kuvendi është mbledhur në kohë kur zakonisht nuk mbledhen kuvendet. Prandaj, i konsideroj të pa baza justifikimet që meqë Kuvendi mund të jetë në pushim, atëherë duhet të gjejmë zgjidhje tjera. Me këtë bazë, ne çdo gjë mund ta heqim prej Kuvendit. I konsideroj madje të pa baza edhe disa aludime, aluzione që bëhen sikur Kuvendi qenka pengesë e do vonesave në proceset tona. Nuk është e vërtetë dhe nuk është mirë që të cenohet funksionimi i organit më të lartë të pushtetit qendror dhe tempullit të demokracisë edhe në Kosovën e re. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: I nderuar kryetar,
I nderuar ministër,
Të nderuar deputetë,

Qëndrimi im personal për këtë pikë të rendit të ditës, për zbarkimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, është përkrahës pozitiv dhe nëse shihet në disa drejtime, janë mesazhe të cilat Kosova është duke përgatitur institucionet e veta të sigurisë të jenë pjesë e sigurisë rajonale dhe globale në nevojat që mund të paraqiten gjatë ndonjë katastrofe të mundshme ose qoftë edhe si pjesë stabilizuese dhe kontribuuese për vendet ku do të jenë në të ardhmen e afërt pjesë edhe e NATO-s, si forcë e sigurisë.

Ne i kuptojmë shqetësimet e të gjithë atyre të cilët thonë se Forca e Sigurisë duhet të jetë më e fortë brenda Kosovës. Mirëpo, Forca e Sigurisë dhe organizimi i ri ushtarak nënkupton reagimin e brendshëm në situata emergjente të vendit nga ushtritë të cilat krijohen dhe pjesa tjetër është pjesa e solidarizimit për stabilizimin e situatave në shtetet tjera.

Disa parafolës këtu folën për admirim për Amerikën dhe unë u befasova sepse hera e parë që dëgjoj fjalë të mira nga parafolësit e “Vetëvendosjes” për Amerikën. Deri pa ca kohësh janë vlerësuar si okupator ose kolonialistë të politikës së Kosovës dhe tani shihet që zhvillimi ekonomik i Amerikës dhe forca ushtarake është pjesë dominante edhe nëpër tërë botën.

Ne aspirojmë të jemi pjesë e zhvillimit ekonomik dhe pjesë përbërëse e Forcave Ushtarake të Amerikës dhe të NATO-s dhe prandaj pa shqyrtuar procedurën në çfarë mënyre juridike ne nesër do t’i zbarkojmë forcat në rast se na kërkohen, është një çështje shumë pozitive sepse Kosova është duke ofruar mesazh të paqes, mesazh të solidarizimit, mesazh të shtetit i cili nuk ka asnjë aspiratë për shtetet tjera, siç kanë shtetet tjera karshi neve, dhe në këtë mënyrë do të kontribuojë pozitivisht për qetësinë dhe për kontributin e zhvillimeve të rajonit.

E përkrahim në këtë pikë dhe besoj që Forca e Sigurisë në të ardhmen duhet të shihet edhe në kuadër të GDP-së tonë për rritjen e vlerës ekonomike që t’i ngritet edhe financimi dhe të plotësohet numri më i lartë i ushtarëve brenda Forcës së Sigurisë, duke shtuar numrin sipas standardeve që i ka edhe NATO dhe edukimi i tanishëm që ne i kemi përcjellë është konform standardeve të NATO-s, edhe në TMK sa ka qenë, TMK-ja ka qenë një bazament i kësaj force, i cili sot dhe nesër do të jetë pjesë përbërëse e NATO-s. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Deputeti Halit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!
Përshëndetje për ministrat dhe për kolegët deputetë!

Është një moment shumë emocional për mua, besoj që edhe për ju të tjerët këtu, besoj edhe për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Përkrah jashtëzakonisht me emocione, prapë po shprehem, Propozim- vendimin e Qeverisë për zbarkimin e Forcës së Sigurisë në vende të tjera në rast nevojë, në raste emergjente, me besim dhe me mendimin që edhe radha e ligjit do të vijë së shpejti me propozimin e ministrit e të Qeverisë.

Ministria e Forcës së Sigurisë ka shënuar rezultate brenda edhe jashtë në ato pak raste dhe është shikuar me simpati nga qytetarët dhe nga analistët. Po, në mënyrë të veçantë,

dalja e Forcës së Sigurisë jashtë vendit është përcjellë me interesim dhe me admirim të jashtëzakonshëm.

Dihet që Forca e Sigurisë në bashkëpunim me NATO-n ka filluar dhe është duke u konsoliduar jashtëzakonisht mirë, e vlerësuar jo vetëm nga ne vendorët, por edhe nga ndërkombëtarët dhe sidomos ngritja e saj ka ardhur në mënyrë të natyrshme dhe të gjithë analistët kanë bërë vlerësime të jashtëzakonshme për rritjen e Forcës së Sigurisë.

Unë për veten time dhe gjithë ata që e kanë në perceptim konsolidimin e Forcës së Sigurisë nisen nga një koncept. NATO-ja nuk bashkëpunon me shoqatat e gjuetarëve, as me të peshkatarëve, as me shoqata kulturore, po as nuk ngrit shoqata të tilla. Armët nuk i bekon NATO-ja këtu për shoqata të tilla dhe shoqatat jo ushtarake nuk armatosen as me uniforma dhe as me armë.

Natyrisht, neve kemi dëshirë që të shohim edhe tanke edhe helikopterë, edhe aeroplanë të kësaj force të sigurisë, me siguri që do të kemi rastin t'i shohim së shpejti edhe ato pajisje. Por, për momentin, edhe ky konfiguracion dhe ky imazh që vërehet në perceptim tonin në Ministrinë e Forcës së Sigurisë dhe në Forcën e Sigurisë, na bën që të ndihemi mirë dhe çdo propozim që të vijë nga Ministria e Forcës së Sigurisë, nga Qeveria për Forcën e Sigurisë, të përkrahet dhe të admirohet.

Unë, edhe një herë e përkrah Propozim-vendimin e Qeverisë, me shpresë se së shpejti edhe ligji do të kalojë në këtë parlament.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Ky vendim, domethënë Projekt-propozim për vendim të Qeverisë së Kosovës për zbarkimin e Forcave të Sigurisë së Kosovës jashtë vendit, është shumë me rëndësi për Kosovës. Mirëpo, është vërtet e çuditshme se si një propozim-vendim i tillë vjen në një kohë kur Qeveria e Kosovës në fakt nuk ka as kompetenca për ta zbarkuar Forcën e Sigurisë në rajonet e vatrave të krizës së brendshme që e ka Kosova, sidomos në veriu të Kosovës dhe në këtë kohë ne po miratojmë vendime për dërgimin e Forcave të Sigurisë jashtë vendit, ku ndërkohë kemi aq shumë probleme brenda vendit, ku Forca e Sigurisë është e nevojshme sa që ky vendim duket shumë i shpërputhshëm me nevojat që i ka shteti i Kosovës brenda territorit të vet.

Sidoqoftë, desha po ashtu të shtoj se ma merr mendja që në këtë Kuvend të Kosovës do të kishte qenë mirë që të ndërmarrim edhe disa hapa për rregulla të brendshme këtu, sidomos që të ndalohet ndoshta me Rregullore të Kuvendit apo me ndonjë ligj të veçantë shpifja në Kuvend të Kosovës, siç e bëri për shembull deputeti Shaip Muja, për lëvizjen “Vetëvendosje”, sepse ne kurrë nuk kemi thënë që Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë okupatorë, ne kemi thënë që Administrata e UNMIK-ut nga Kombet e Bashkuara është një administratë kundër shtetësisë së Kosovës dhe në kohën kur ne që prej vitit 2005 e

kemi thënë këtë gjë, njerëzve të tillë të cilët po kritikojnë tash, ju ka rënë në mend tek në vitin 2009 apo 2010 që UNMIK-u duhet të ikë nga Kosova.

Desha vetëm të them që me këtë mentalitet dhe me këtë logjikë të vonuar për vite të tëra, kështu do të ndodhë edhe me konceptin e tyre për EULEX-in, domethënë pas vitesh të tëra kur të bëhet e qartë se EULEX-i nuk është tjetër veçse një UNMIK i radhës, atëherë do t'ju bie në mend që është po e njëjta gjë sikur UNMIK-u, por pasojat do t'i vuaj Kosova për shkak të vonesave të mëdha.

Edhe një gjë për Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Natyrisht, unë mendoj që dikush më së miri i shfrytëzon lëvdatat për Shtetet e Bashkuara të Amerikës për t'i fshehur krimet e veta. Faleminderit!

KRYETARI: Ju lutem, është mirë që vërtet kur të bisedohet një çështje, t'i përmbahemi rendit të ditës. Dhe sa herë dilet nga rendi i ditës, pastaj na dalin fjalë që vërtet nuk do të duhej të ishin pjesë e fjalorit në debatet në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Replikë, Shqip Muja, por vërtet nuk është mirë t'i nxisim replikat në diskutimet tona.

SHAIPI MUJA: Kur thashë në fillim, zoti kryetar, që kjo pikë tregon që Kosova është duke u radhitur karshi forcave më progresive, që në këtë kuadër hyjnë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, unë u befasova me zotin Albin Kurti, kur thotë që merr shembull pozitivisht për herë të parë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe, për sqarim, që zoti Konjufca duhet ta shoh në një gazetë gjermane, më 8 gusht, ku zoti Albin Kurti thotë që - ne e kemi shndërruar Kosovën në koloni të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. E shprehin qartë anti-amerikanizmin e tyre dhe sot mundohen të konvertohen, sepse i dinë gabimet të cilat janë bërë.

KRYETARI: Po, nuk e kemi këtë çështje në rend të ditës sot.

SHAIPI MUJA: Unë desha ta kursej me emër dhe për këtë çështje ne më gjerësisht do të bisedojmë edhe në takimet tjera. Prandaj, nuk kam shpifur asgjë, ndërsa sa i përket fshehjes së krimeve, zoti Konjufca, nëse fillojnë të merren me shpifjet, siç janë marrë edhe më parë dhe siç i kanë dalë për krahu edhe Dik Martit, atëherë mund të vazhdojnë, sepse është një parti e cila është duke humbur identitetin dhe e cila nuk po di të akomodohet në institucionet e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Kundër replikë, Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Ne i themi deputetit Muja që të mos shërbehet me informata të gazetave pro-serbe, do të ishte mirë që ta ndalonte këtë punë. Dhe, e dyta, është që vetë zoti Muja është e çuditshme se si flet për demokracinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kur vetë po hetohet që në mënyrë indirekte ia ka vjedhur paratë publike buxhetit të Kosovës, sepse po hetohet për rastin e RTK-së. Ky është vetë në gjyq për RTK-në, se si në mënyrë artificiale ka krijuar emisionet për t'ia vjedhur paratë publike buxhetit të Kosovës, e po të ndodhte kjo në shtetet e Bashkuara të Amerikës, zoti Muja, ju nuk do të mund të ishit në një shtet të tillë përfaqësues i popullit ose deputet.

KRYETARI: Një minutë, kundër replikë, po realisht kur lypni punë, gjithë dalin replikat, atë duhet ditur.

SHAIPI MUJA: Zoti kryetar,

Më vjen keq që s'është niveli im në asnjë drejtim me zotin Konjufca të barazohem. Këto janë shpifje të cilat janë të njohura që nga fillimi i këtij parlamenti dhe nuk barazohem në asnjë drejtim me krimin ose me gjyqin, kjo është shpifje e cila do ta glorifikojë zoti Konjufca dhe e cila lirisht mund ta them që është një rrenë ose një gënjeshtër e kulluar. Prandaj, le të merret me partinë e cila është duke ju shpërbërë dhe nuk po e krijojnë identitetin, a janë lëvizje, a janë në rrugë, a janë institucione? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Nuk kemi më të lajmëruar për diskutim.

Unë, megjithatë i kam nja 2 – 3 vërejtje dhe pastaj fjalën do ta merrm nëse ka çka të thotëm ministri i Forcës dhe i Sigurisë.

Unë kërkoj nga Administrata e Qeverisë që vendim mos të bjerë në Kuvend, po të bjerë propozim-vendim. Kjo do të ishte ajo që do të duhej të ishte, propozim-vendim, e ne pastaj pas nëse duhet të miratohen në Kuvend, pasi miratohen në Kuvend, propozim-vendimi bëhet vendim.

Në pikën 1 të këtij propozim-vendimi, unë mendoj që fjala “zbarkim”, do të duhej më mirë të tingëllonte, të ishte “dërgim”.

Dhe, vërejtja ime tjetër është në pikën e fundit të këtij propozim-vendimi, ku thuhet: “Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit” të jetë “Vendimi hyn në fuqi në ditën e miratimit në Kuvendin e Kosovës.” dhe pjesa tjetër vazhduese të jetë “Vendimi është i plotfuqishëm deri në nxjerrjen e një akti ligjor i cili rregullon këtë çështje”.

Nëse jeni dakord për këto çështje, unë mendoj që këto çështje duhet të ndryshohen në këtë propozim-vendim të Qeverisë. A jeni dakord? Po.

Fjalën, nëse ke ministër diçka, mund ta marrësh fjalën!

MINISTRI AGIM ÇEKU: Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit të nderuar deputetë,

Ju falënderoj për mbështetje të këtij propozim-vendimit, që unë megjithatë mendoj se është propozim-vendim, se ashtu e kam para veti, jo vendim por që nga dita e parë ka qenë dhe i referohem si propozim - vendim të Qeverisë.

Sa i përket fjalës “zbarkim”, mendoj që kryetari i Kuvendit ka plotësisht të drejtë, fjala “zbarkim” thjeshtë është përkthyer nga fjala “diplozment” që fjalorët zyrtar e përkthejnë si “zbarkim” apo “vendosje”, por fjala “dërgim” edhe unë në paraqitjen time gjithmonë i kam referuar fjalës “dërgim” dhe pajtohem lidhur me këtë.

Atë çka dua të them, është që disa komente që bënë, mund të përgjigjem. Absolutisht nuk është bërë fjalë për përpjekje për të zhveshur Kuvendin nga kompetencat e tyre.

Ne menjëherë me të vërejtur këtë boshllëk ligjor, ka pasur iniciativa që menjëherë të plotësohet Strategjia legislative e Qeverisë për vitin 2011, dhe të nxirret një ligj. Por, ka pasur mendime që mos ta ndryshojmë për këtë vit strategjinë legislative, që mund edhe ministritë të tjera të kenë ligje, atëherë kemi edhe ashtu ligje të mjaftueshme për të aprovuar këtë vit dhe jemi pajtuar që të marrim një vendim, ta rregullojmë procedurën e zbarkimit jashtë vendit vetëm, prapë po e përsërisë, vetëm në rastet emergjente, por ky vendim të jetë subjekt i miratimit nga Kuvendi dhe pikërisht këtu është respektimi dhe përfillja e Kuvendit të Kosovës që e kemi prurë një vendim të Qeverisë që këtë ta miratojë edhe Kuvendi.

Desha disa komente ti bëjë. Forca e Sigurisë së Kosovës është sot institucion i sigurisë nën mbikëqyrje civile demokratike të institucioneve të Kosovës. Duke filluar nga Komisioni parlamentar për Mbikëqyrje, kryeministri, presidenti, Kuvendi e tjerë e tjerë, kështu që ne e kemi një ligj, e kemi Kushtetutën, e cila është miratuar, të dyja janë miratuar nga ky vend dhe jemi shumë të përkushtuar për të kryer detyrat tona të përshkruara, të përcaktuara me ligj dhe me Kushtetutë.

Prandaj, ligji dhe Kushtetua na ka caktuar një mision, por ne edhe si ministri, si Qeveri, si FSK e kemi edhe një vizion për FSK-në apo për Forcën e Kosovës, qysh do që ta quajmë në të ardhmen, dhe ky vizion është që të ndërtojmë forca Kosovës që do të jenë të mjaftueshme për ta mbrojtur Kosovën, për ta mbrojtur integritetin territorial, sovranitetin e Kosovës, për t'i mbrojtur qytetarët, jetën dhe pasurinë e tyre dhe për t'i mbrojtur interesat kombëtare të vendit. Dhe interesat kombëtare të vendit shpeshherë mbrohen edhe me dërgimin e forcave jashtë vendit, kështu që edhe pse Kushtetuta, ligjet e përcaktojnë FSK-së si forcë vendore, FSK e ka edhe një dimension ndërkombëtar dhe është në një farë mënyrë, çdo forcë ushtarake apo sigurisht është në një farë mënyrë çdo forcë ushtarake apo është në njëfarë mënyrë edhe instrument i politikës së jashtme, sepse me forcat e veta shteti i përmbush obligimet e veta ndërkombëtare, krijon, siç u tha, edhe aleanca, partneritete, krijon domethënë imazh, sjell miq, partner, kurajo vendit dhe është një farë forme, thashë, edhe instrument i politikës së jashtme. Kështu që në asnjë mënyrë Forca e Sigurisë apo Forcat e Sigurisë, Forcat e Mbrojtjes kurrë nuk do të jenë politike apo instrument i politikës të brendshme, por do të jenë gjithmonë në shërbim të vendit, interesa të vendit, interesa të qytetarëve, e tash, një ndër interesat e vendit është edhe dërgimi jashtë vendit, një ndër interesat kombëtare që duhet t'i mbrojë FSK-ja, është që Kosova gradualisht të shndërrohet nga konsumuesi i sigurisë, në kontribuues të sigurisë. Ky është vizioni ynë dhe jam i sigurt që do t'ia dalim dhe shumë shpejtë edhe ky Kuvend do të merret dhe do t'i aprovojë ndryshimet që duhet të bëhen sot edhe në ligj, edhe në strukturë, edhe në Kushtetutë sa i përket aktualitetit të FSK-së

Edhe një herë faleminderit që e aprovat, do ta aprovoni apo e mbështetët deri tash këtë vendim. Shpresoj që me votën e juaj edhe do ta aprovoni.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Pra, debati edhe diskutimet janë harxhuar.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Ne votojmë propozim-vendimin, me ndryshimet e propozuara.

Prezentë kemi 77 deputetë, votojmë tash!

Konstatohet se me 66 vota “për”, 2 “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me përcaktimin e përgjegjësisë dhe të procedurave të zbarkimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Votimi kur votojmë me elektronikë, bëhet vetëm me elektronikë dhe ju e dini pse. Faleminderit!

Në rend dite kemi pikën e trembëdhjetë:

**13. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Mbikëqyrjen e
Financave Publike për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për
themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës
së Auditimit të Kosovës**

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka mbikëqyrur zbatimin e Ligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së Auditimit të Kosovës dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Radha e diskutimeve. Fjalën e ka raportuesi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, deputetja Valbona Dibra, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka mbikëqyrur zbatimin e Ligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së Auditimit të Kosovës, numër 03/L-075.

Për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji, Komisioni ka formuar grupin punues, i cili i ka zhvilluar aktivitetet e nevojshme me qëllim të mbledhjes së informatave dhe të dhënave mbi nivelin e zbatimit të ligjit.

Qëllimi kryesor i mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit numër 03/L-075 për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së Auditimit në Kosovë, nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ishte të vlerësohet niveli i zbatueshmërisë në praktikë i këtij ligji dhe nevoja eventuale për ndryshimin e tij.

Fillimisht është bërë analiza e hollësishme e Ligjit numër 03/L-075 për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së Auditimit në Kosovë.

Për të vlerësuar zbatimin e këtij ligji, janë vizituar Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, Departamenti i Thesarit, do të thotë Ministria e Financave, për të parë nga afër se sa është

i zbatueshëm ky ligj, si dhe janë zhvilluar intervistat e detajuara me përfaqësues të këtyre dy institucioneve.

Përveç takimeve të rregullta të grupit punues, takimet e veçanta janë mbajtur edhe me auditorin e përgjithshëm, ministrin e Financave dhe drejtorin e Thesarit.

Gjatë këtyre takimeve punuese janë mbledhur informata të sakta dhe të detajizuara sa i përket sfidave dhe problemeve të menaxhimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Po ashtu, nga këto takime janë nxjerrë pikëpamjet nga këndvështrimi i Zyrës së Auditorit dhe i Ministrisë së Financave.

Gjatë vizitave në terren dhe shqyrtimit të të dhënave janë identifikuar mangësi të zbatimit të Ligjit numër 03/L-075 për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së Auditimit në Kosovë, si në vijim: Forma, struktura, përkufizimet, terminologjia e përdorur, roli dhe mandati i auditorit të përgjithshëm paraqesin paqartësi të cilat duhet të harmonizohen me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Duke marrë për bazë mangësitë e identifikuara, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike konkludon se Ligji nr. 03/L-075 për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së Auditimit të Kosovës është i zbatueshëm. Mirëpo, me qëllim të funksionalizimit të mëtejshëm të Zyrës së Auditorit duhet të bëhet plotësim - ndryshimi i ligjit në fjalë.

Bazuar në vlerësimet e lartcekura, Komisioni ka rekomanduar Kuvendit miratimin e këtij raporti me rekomandim.

Rekomandimi është:

Qeveria e Republikës së Kosovës të përfshijë në agjendën legjislative plotësim - ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-075 për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së Auditimit në Kosovë.

Njëkohësisht dua që edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës të përkrahë raportin me rekomandim të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Nejse, rekomandimet janë pak të paqarta, por fjalën e ka në emër të Lidhjes Demokratike, deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin e komisionit funksional në aspektin e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për themelimin e

Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së Auditimit të Kosovës sipas Ligjit në fjalë, numër 03/L-075.

Pasi që edhe anëtarët tanë kanë qenë pjesë e grupit punues, i cili në bazë të dinamikës dhe afateve të përcaktuara nga Komisioni për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligjim ne e përkrahim raportin në fjalë, edhe pse më duhet të them që gjatë mbikëqyrjes për zbatimin e këtij ligji ne kemi hasur me disa paqartësi të cilat janë vetë në formulimet brenda ligjit në fjalë dhe jo në punën e auditorit gjeneral, sepse si kategori kushtetuese është institucion i pavarur dhe dihen të cilat janë kompetencat e tij. Por, duke plotësuar edhe kërkesën që ka qenë nga Raporti i progresit rreth fuqizimit apo rolit mbikëqyrës, të cilin e ka Zyra e Auditorit Gjeneral edhe në raport me Kuvendin, por edhe në raport me organizatat buxhetore dhe konkretisht me Ministrinë për Ekonomi apo Ministrinë e Financave.

Rekomandimi, zotëri kryetar, është shumë i qartë. Qeveria e Republikës së Kosovës e përfshinë në agjendën legjislative plotësim - ndryshimin e Ligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së Auditimit të Kosovës. Pse kemi dalë me këtë rekomandim? Sigurisht arsyetimin e dha edhe kolegja ime Valbona, por më lejoni që të them se gjatë hartimit të këtij ligji, sigurisht edhe në përkthimet që janë bërë, sepse dihet koha kur është miratuar ky ligj, nëse flasim edhe për formën, strukturën edhe përkufizimet, por edhe terminologjia e përdorur, nuk po dëshiroj të hyjë edhe te roli i mandatit të auditorit të përgjithshëm, paraqesin disa paqartësi. Dhe për shkak të eliminimit të këtyre paqartësive, edhe një herë po e them, pa dashtë të ndërhyjë në punën dhe kompetencat e auditorit gjeneral, ne i kemi rekomanduar Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe dëshiroj që edhe deputetët të tjerë të japin përkrahje këtij rekomandimi, që në agjendën legjislative të përfshihet plotësim - ndryshimi i këtij ligji.

Atëherë, bashkërisht me të gjitha institucionet që janë relevante, por edhe me vetë auditorin gjeneral, do t'i shohim të gjitha ato mangësi të cilat janë të paraqitura në ligj, kërkesat edhe në raport me ndarjet buxhetore, efikasitetin e punës, por edhe në raport me Komisionin e ri i cili është për Mbikëqyrjen e Financave Publike, që puna e auditorit gjeneral të jetë shumë e qartë, me kompetenca shumë të qarta edhe në raport me Qeverinë e Republikës së Kosovës, por edhe me Kuvendin.

Ne, si grup parlamentar, i japim mbështetje këtij raporti dhe i ftojme edhe deputetët të tjerë që ta votojnë rekomandimin në fjalë. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Unë, megjithatë, dua të them që rekomandimet që i kanë ardhur Kuvendit, në faqen e parë është i paqartë. Megjithatë, ju në diskutimet e juaja e bëtë më të qartë. Lexoni rekomandimet, çka i rekomandohet Kuvendit, do të thotë nuk është thënë të miratohet dhe bashkë me këtë, do të thotë, të miratohet edhe rekomandimi për ndryshimin e ligjit. Fjalën e ka në emër të "Vetëvendosjes", deputeti Afrim Hoti.

AFRIM HOTI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi ynë Parlamentar ka shqyrtuar raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së Auditimit të Kosovës, zbulon shumë mangësi të caktuara në lidhje me zbatimin e këtyre dy ligjeve të cekura në raport.

Në lidhje me këtë, grupi punues identifikoi këto mangësi: Pas vizitave që bëri në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm, si rrjedhojë e kësaj, Auditori i Përgjithshëm Orson shprehu shqetësimin e tij me nivelin e ulët të sigurisë së pavarësisë së Zyrës së Auditorit në aspektin financiar, organizativ dhe atë funksional. Si pasojë e kornizës ligjore, ai gjithashtu thekson se është shqetësues fakti që stafi i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm është kategori e shërbyesve civilë. Sipas Ligjit për shërbimin civilë, pastaj organizimi i zyrës duhet të bëhet gjithmonë duke iu drejtuar Ministrisë së Administratës Publike, kjo bie ndeshë me pavarësinë e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, sepse si mund të kërkohej organizimi i zyrës të bëhet me leje të një etniteti të auditorit vetë Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Për më tepër, Orson thekson se duhet të hartohet një ligj i ri, sepse propozimet e bashkangjitura në raport janë më shumë se ndryshime. Gjithashtu, ai shprehu shqetësimin e tij në pavarësinë e ekzekutimit të akteve nënligjore që kanë të bëjnë me auditorin e përgjithshëm, duke cituar se pavarësia nuk është problem derisa unë të jem auditor i përgjithshëm. Ky i fundit vendos të bëhet gardiani i ekzekutimit të pavarur të akteve juridike, gjë që është e pamundur si rrjedhojë e mungesës së kornizës ligjore. Nga gjithë kjo konsiderojmë se Zyra e Auditorit të Përgjithshëm gjendet në një pozitë jo të lakmueshme për shkak të mungesës dhe paqartësisë së legjislacionit dhe presionit të vazhdueshëm nga institucionet e audituara.

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do të votojë raportin dhe do të kujdeset që të gjitha propozimet e paraqitura në raport të inkorporohen në plotësim dhe ndryshim të Ligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së Auditimit të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të AAK-së, deputeti Xhevdet Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

I nderuari zoti kryetar, ministra, kolegë deputetë,

Edhe Grupi Kuvendor i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës përkrah rekomandimet që i ka bërë komisioni dhe shpresoj që edhe kolegu ynë, zoti Bali Muharremi, ka dhënë kontributin e vet në këto rekomandime dhe i ka përkrahur këto rekomandime. Po, do të kisha cekur se përveç ndryshimit të këtij ligji, është mirë që ndryshimi i ligjit ka të bëjë edhe me rekomandimet të cilat është duke i dhënë auditivi, për arsye se të gjitha rekomandimet nga agjencionet buxhetore shpeshherë po mbesin në sirtarë të agjencioneve dhe po mbesin tek deputetët, dhe unë do të kisha për ta përkrahur mendimin e profesor Hamiti, që para dy - tri seancave pati thënë - çka do të bëjmë me këto rekomandime? Është mirë që rekomandimet të jenë obligative për agjencionet buxhetore për arsye se do të bëhet që agjencionet buxhetore të menaxhojnë më mirë, më sigurt dhe në bazë të Ligjit të menaxhimit publik të financave do ta harxhojnë buxhetin e Kosovës.

Unë shpresoj se e meta më e madhe në këtë ligj është që rekomandimet të jenë obligative për agjencionet buxhetore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Muzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Koalicioni për Kosovën e Re e ka shqyrtuar raportin me rekomandime të Komisionit për Mbikëqyrjen Financiare të zbatimit të Ligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së Auditimit të Kosovës dhe njëkohësisht përkrahë rekomandimin në faqe nr. 7 të Komisionit Parlamentar ku dedikohet që Qeveria e Republikës së Kosovës të përfshijë në agjendën legjislative plotësim - ndryshimin e Ligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së Auditimit të Kosovës. Domethënë, gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit, që është edhe një ndër kushtet e çdo komisioni parlamentar, në bazë të Rregullores së punës është parë që ky ligj ka mangësitë e veta dhe Komisioni në mënyrë shumë të qartë t'i japë rekomandim Qeverisë që të ndryshojë projektligjin në tërësi.

Koalicioni për Kosovë të Re edhe një herë i jep mbështetje komisionit parlamentar për punën që e ka bërë në monitorimin e këtij ligji. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Regjia, i ftoni deputetët të vinë në sallë!

Në emër të SLS-së, nuk ka.

Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, deputeti Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERTI KINOLLI: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

I nderuar nënkryetar, ministra,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Grupi Parlamentar “6+” e ka bërë shqyrtimin e Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së Auditimit të Kosovës, numër 03/L-075, ligj i cili ka për qëllim rregullimin e themelimit, funksionimin si dhe kompetencat e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së Auditimit në Kosovë.

Në raport shihet se grupi punues ka bërë disa vizita zyrtare dhe atë të Auditorit të Përgjithshëm dhe Departamentit të Thesarit, ku gjatë vizitës në terren ka identifikuar mangësi në zbatimin e Ligjit nr. 03/L-075 për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së Auditimit të Kosovës dhe ka propozuar që të ndërmerren masa konkrete që kanë për qëllim funksionalizimin sa më të mirë të këtyre institucioneve.

Prandaj, Grupi Parlamentar “6+”, bazuar në arsyet e lartcekura, e përkrah dhe e mbështet plotësisht këtë raport me rekomandimet e dhëna, të cilat po ashtu janë pjesë e këtij raporti dhe dalin nga ky raport. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Të lajmëruar për diskutim nuk ka.

Edhe një herë ftoj deputetët që të kthehen në sallë.

Si duket, përfaqësimin po e kuptojnë deputetët për të pirë kafe në Kuvend, sidomos deputetët e pozitës.

Vërtet, nuk mundemi për çdo pikë të rendit të ditës t'i ftojmë deputetët. Le ta dinë përfaqësimin pse jemi këtu, nuk kemi ardhur për të pirë kafe!

Në seancë janë 63 deputetë, shkojmë në procedurën e votimit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash!

Konstatohet se me 54 vota "për", 2 "kundër", asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Raportin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me zbatimin e Ligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së Auditimit të Kosovës.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

14. Shqyrtimi i Projekt-planit hapësinor 2010-2020 - Zona me interes të veçantë ekonomik "Fusha e Mihjes së Re"

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim hapësinor ka shqyrtuar projekt-planin hapësinorë 2010-2020 - Zona me interes të veçantë ekonomik "Fusha e Mihjes së Re" dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Kryetari i Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor, deputeti Nait Hasani, për arsyetimin e raportit me rekomandime. Nuk është. Atëherë, fjalën e ka deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim, Rural, Planifikim Hapësinor dhe Mjedis, e ka trajtuar planin hapësinor 2010-2020, zona me interes të veçantë ekonomike, Fusha e Mihjes së Re dhe ka dhënë rekomandimet, japin rekomandim pra që të votohet, do të thotë, të kalojë tutje.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Deputeti Niazi Idrizi.

(Reagim nga salla)

Ky nuk e ka parë të arsyeshme ta marrë fjalën, ministër! Jo, nëse e do fjalën, urdhëro! Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI DARDAN GASHI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Me anë të këtij dokumenti, synohet që të vendoset bazat e zhvillimit të qëndrueshëm hapësinor për një zonë shumë të rëndësishme ekonomike të Kosovës.

Siç e dini, në mars të vitit 2009, Qeveria e Republikës së Kosovës, shpalli zonën në fjalë si zonë e interesit të veçantë ekonomik dhe obligoi Ministrinë me hartimin e këtij dokumenti. Në qershor të këtij viti, dokumenti që sot është para jush, është miratuar në Qeveri nga ku është dërguar në Kuvend për miratimin tuaj.

Plani hapësinor për zonën e interesit të veçantë ekonomik, Fusha e Mihjes së Re, si një ndër dokumentet e rëndësishme të Qeverisë, ka për bazë planin hapësinor të Republikës së Kosovës, të aprovuar kohë më parë nga Kuvendi, raportin e vlerësimit strategjik mjedisor dhe social për zonën dhe strategjinë e Kosovës për energji 2009-2018. Fjala është për një dokument që merret me zhvillimin hapësinor të zonës që mbulon një sipërfaqe prej përafërsisht 150 kilometrash katrorë në të cilën pjesërisht përfshihen 4 komuna: Obiliqi; Fushë Kosova, Vushtrria dhe Drenasi.

Tema kryesore e dokumentit është zhvillimi hapësinor i zonës me fokus të veçantë, zhvillimin e mihjeve dhe impianteve të reja energjetike dhe ndikimin e tyre në zonën përreth saj. Ky dokument është hartuar nga Instituti i Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim të ngushtë me sektorin e energjetik, duke përfshirë edhe të gjithë sektorët e rëndësishëm të Qeverisë së Kosovës, që në një formë apo tjetër janë të ndërlidhura me projektin.

Ndihmë të veçantë në këtë drejtim, ka dhënë projekti Patell të dhënat dhe ekspertizat e të cilëve kanë qenë të pazëvendësueshme në gjithë procesin. Vlen të theksohet se pjesë e rëndësishme e procesit ka qenë edhe debatet publike të cilat janë reflektuar në këtë dokument. Plani hapësinor për zonën e interesit të veçantë ekonomik, fusha e mihjes së re, është dokument që garanton respektimin e të drejtave dhe lirive të gjithë qytetarëve që jetojnë në të. Ju siguroj që janë respektuar të gjitha parimet që dëshmojnë se dokumenti është në përputhje me standardet kryesore që dalin nga ligjet e vendit dhe rregulloret evropiane.

Me këtë dokument, Qeveria e Kosovës në mënyrë të qëndrueshme orientojnë kahen e zhvillimit hapësinor energjetik duke respektuar në maksimum mbrojtjen e mjedisit dhe shfrytëzimi racional të resurseve natyrore. Duke qenë të vetëdijshëm për situatën e vështirë ekonomike dhe problemet e shumta që po ballafaqohet vendi, jemi të sigurt që dokumenti i ofruar i zhvillimit të ardhshëm hapësinor të zonës është kontribut i rëndësishëm në konsolidimin e situatës së energjisë në vend. Ju faleminderit për mbështetjen tuaj!

Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Tani radhën e kanë përfaqësuesit e grupeve parlamentare

Në emër të Grupit parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Niazi Idrizi.

NIAZI IDRIZI: I nderuar kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Në bazë të Ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003/14, Ministria është përgjegjëse për të përgatitur projektet e planeve për zonat e veçanta. Planet e zonave të veçanta, duhet të jenë në përputhje me parimet dhe qëllimet afatgjata të planit hapësinor për zonat e veçanta për periudhë të paktën 10 vjeçare.

Posa të jenë të finalizuar draftet, Ministria ia dorëzon Qeverisë ato për miratim paraprak dhe Qeveria i procedon Kuvendit për aprovim përfundimtar. Kjo është rruga ligjore e ndjekur.

Në kuadër të strategjisë së mjedisit dhe planifikimit hapësinor të Kosovës, për periudhën 2010-2020, është përfshirë edhe zona me interes të veçantë ekonomik, fusha e minierës së re të qymyrit në Sibovc. Ka dokument i ka identifikuar potencialet energjetike në përgjithësi dhe sektorin e prodhimit të energjisë nga qymyri në veçanti. Vendi ynë Kosova është shumë e pasur me resurse minerale energjetike, me kushte të volitshme për shfrytëzim, për shfrytëzimin e këtyre resurseve është hartuar strategjia energjetike dhe minerare e Kosovës.

Qymyri është resursi më i rëndësishëm energjetik i Kosovës nga i cili prodhohet afërsisht 97% të energjisë nga termocentralet. Nga hulumtimet e bëra vlerësohet se sasia e rezervave të linjtit në Kosovë arrin në 12 miliardë tonë. Nga këto hulumtime është vlerësuar se fusha e Sibovit është potencial i rëndësishëm për shfrytëzimin e qymyrit, prandaj kjo fushë është shpallur nga qeveria si zonë e veçantë e interesit ekonomik. Si e tillë, kjo fushë është caktuar si fusha e radhës që duhet të shfrytëzohet pas përfundimit të shfrytëzimit të qymyrit në Mirash dhe Bardh.

Rezervat gjeologjike të qymyrit në këtë fushë janë rreth 700 milionë tonë me kualitet mesatar. Shtresa e qymyrit ka trashësi mesatare 56 metra. Raporti mesatar argjil-qymyr është një e gjysmë me një, që është një raport i volitshëm. Objekti primar i kësaj miniere është sigurimi i garantuar për furnizim me qymyr për termocentralet ekzistuese dhe ato të reja, d.m.th. kjo është objektivi.

Shfrytëzimi i kësaj miniere do të ketë ndikim negativ në mjedis, siç dihet degradimi i madh i tokave, humbje e bimësisë, ndryshimi hidro-gjeologjike, ndotjet të tokave të ujit, të ajrit, të pluhurit të cilat duhet t'i ketë Qeveria në të ardhmen parasysh. Po ashtu duhet të përmendet fakti se kjo zonë është e banuar dhe zhvendosja e fshatrave dhe shpronësimi i familjeve paraqet pengesë të madhe për eksploatim. Përndryshe, kufizime tjera për shfrytëzimin të qymyrit nuk ka. Fusha e Sibovcit, në krahasim me fushat tjera klasifikohet si fushë teknikisht dhe ekonomikisht më e favorshme dhe më e përshtatshme e cila më së miri i përgjigjet strategjisë për sa i përket kërkesës për energji në të ardhmen. Kjo punishte do të punësojë një numër të madh të punëtorëve, numri i të cilëve mund të rritet varësisht prej sasisë së shfrytëzimit të qymyrit. Bazuar në parametrat gjeologo-minerale fusha minerare Sibovc, përmban të gjitha faktet e domosdoshme, llogaritjet dhe elementet e nevojshme për të garantuar prodhim të mjaftueshëm të qymyrit për kërkesat energjetike në Kosovë.

Jeta e kësaj miniere, sipas parametrave llogaritet të jetë 40 vjeçare. Po ashtu analizat ekonomike të kryera, rezultojnë se zhvillimi i minierës në të ardhmen do të jetë në përgjithësi profitabil. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Salih Morina.

SALIH MORINA: Ju faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke marrë për bazë gjendjen aktuale që ka të bëjë me mjedisin në përgjithësi dhe në veçanti me zonën me interes të veçantë ekonomik, Fusha e Mihjes së Re, siç janë mbeturinat e shumta brenda zonës industriale, tek Termocentrali “Kosova A” dhe të hirit te Termocentrali “Kosova B”, i cili është ndotësi më i madh në territorin e Republikës së Kosovës dhe shumë i dëmshëm përcaktorin njeri që sipas strategjisë së prezantuar mbi 7000 banorë janë të rrezikuar brenda dhe përreth kësaj zone, dhe po të shikohet krejt strategjia e paraqitur, gjithçka na prezantohet një gjendje reale dhe negative.

Gjendja mjedisore është prekur thellë dhe do të thotë është e degraduar. Cilësia e ajrit është e dobët për shkak të termocentraleve ekzistuese, cilësia e tokës dhe e ujërave nëntokësore është e degraduar, menaxhimi i dobët i deponisë rajonale të mbeturinave është jashtë standardeve mjedisore si dhe mungesa dhe reduktime të shumta të energjisë elektrike që po ballafaqohen qytetarët e Kosovës, e obligojnë Qeverinë e Republikës së Kosovës që premtimet e dhëna gjatë fushatave elektorale t’i realizojnë e jo t’i afatizojnë me periudha kohore afatgjate siç janë të prezantuar në këtë strategji ku thuhet se projekti Mihja e Re- Termocentrali Kosova e Re, planifikohet të ndërtohet në vitin 2015 ose 2016, ndërsa faza e dytë, në vitin 2020, kurse faza e tretë, pas vitit 2025 dhe shtrohet pyetja çka me gjendjen aktuale, cila do të jetë strategjia aktuale e Qeverisë për përmirësimin e energjisë elektrike që po e prek drejtpërdrejt qytetarin e Republikës së Kosovës, bizneset në Kosovës, investitorët e huaj dhe që po ndikon direkt në uljen e zhvillimit të ekonomisë në Kosovë?

Një çështje shumë serioze dhe problematike ka qenë dhe vazhdon të jenë vendbanimet në zonën Fusha e Mihjes së Re, që banorët e kësaj zone, obligohen t’i nënshtrohen procesit të zhvendosjes. Të gjithë qytetarët e kësaj zone, duhet të gëzojnë trajtim dhe përkujdesje të veçantë nga institucionet qendrore dhe ato lokale. Dhe atë që e shoh si problematike është buxheti për të cilin do të jetë i papërbalueshëm për qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët janë taksapagues dhe i papërbalueshëm për vetë Qeverinë.

Qytetari i Republikës së Kosovës sot paguan energjinë elektrike dy herë, e para si obligator për shpenzimin e rrymës, për nevojat e veta dhe e dyta si taksapagues për subvencionet që i ndan Qeveria KEK-ut nga buxheti i Republikës së Kosovës. Nga kjo Ministri, të aprovuar në Qeveri, në Parlament kanë ardhur dy strategji. E para është

plani hapësinor i Kosovës, strategjia e zhvillimit hapësinor 2010-2020, dhe tash, sot kemi prapë planin hapësinor 2010-2020, zona me interes të veçantë ekonomik fusha e Mihjes së Re. Ne inkurajojmë Ministrinë për këto dy strategji, por do të jetë e vështirë që të implementohen, pa një buxhet të mirëfilltë, kur dihet që Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, në kornizën afatmesme 2012-2014 e ka buxhetin në rënie në krahasim me vitet e mëparshme.

Po të merret buxheti i vitit 2009 dhe 2010, kjo Ministri ka pasur mbi 10 milionë dhe po të shikohet buxheti i vitit 2011, i cili do të vazhdojë deri në vitin 2014, ka një buxhet në shumë prej mbi 8 milionë. Andaj, duke u bazuar në të dhënat e deritanishme mbi gjendjen ekzistuese të zhvillimeve hapësinor sipas sektorëve të ndryshëm në kuadër të kësaj zone, si degradimi mjedisit, mungesa e krijimit të zonës mbrojtëse rreth minierave, prezenca e deponimeve të hapura të hirit, humbja e tokës bujqësore, zhvendosja e vendbanimeve nga Fusha e Re e Mihjes, reduktime të shumta të energjisë elektrike, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, do të miratojë strategjinë - zona me interes të veçantë ekonomik, Fusha e Mihjes së Re, me shpresë se kjo strategji të jetë e implementueshme dhe që për çdo mos implementim të kësaj strategjie, përgjegjëse do të jetë vetë Ministria dhe Qeveria e Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Është e qartë pra se njëri nga resurset kryesore natyrale të Kosovës është se linjiti dhe është e domosdoshme që të trajtohet kjo çështje, çështja pra e shfrytëzimit të tij të trajtohen dhe të hartohen edhe strategji për mënyrën se si do të duhet shfrytëzuar ai.

Planin hapësinor 2010-2020, si grup parlamentar e kemi trajtuar, po ashtu edhe çështjen e zonës së veçantë, Fusha e Mihjes së Re. Si Grup Parlamentar i lëvizjes “Vetëvendosje” jemi dakord që kjo pasuri të shfrytëzohet, por gjithmonë duke u respektuar në maksimum parimet mbi mbrojtjen e mjedisit në përgjithësi. Nëse e shikojmë aktualisht gjendjen e mjedisit në Kosovë dhe pasojat e mihjeve aktuale të deritanishme për termocentralet “Kosova A” dhe “Kosova B”, ne mund të vijnë shumë lehtë në konkludim që mjedisi në këto rrethina është degraduar plotësisht. Prandaj edhe gjatë trajtimit të kësaj, të këtij plani faktet që janë marrë parasysh këto elemente, bënë që si plan hapësinor ta pranojmë dhe ta votojmë tutje. Natyrisht, na bënë pak skeptik ideja e rehabilitimit të tokës e cila do të shkatërrohet pas shfrytëzimit të thëngjillit dhe plani aktual mund të jetë edhe i realizueshëm, por një fakt një grimë na bënë pak më skeptik, është ideja e trajtimit të hirit.

Hiri që mendoj se do të duhej shumë më tepër të trajtohej në idenë e rehabilitimit të tokës se sa idenë e përdorimit të tij për çështje industriale, meqenëse ajo për çështje industriale do të mund të përdoret kurdoherë që do të mund të kishim mundësi të tilla. Dhe këtë po e them nga përvoja që si shoqëri kemi me hirin, i cili është stivuar aty dhe pret gjithmonë me dekada idenë e shfrytëzimit të tij në industri.

Natyrish, për sa i përket shfrytëzimit të thëngjillit, gjithmonë ka zgjidhje, gjithmonë ka ide dhe mënyra se si ai mund të shfrytëzohet duke mos u degraduar rëndë ambienti dhe sidomos duke u rehabilituar edhe toka edhe ambienti pas shfrytëzimit të tij. Problemi kryesor që ka lëvizja “Vetëvendosje” nuk është me zonën me interes të veçantë ekonomik të fushës Mihja e Re, as me idenë e shfrytëzimit të këtyre resurseve ekonomike, pasi është e vetëdijshme mbi rolin dhe ndikimin që do ta kenë në ekonominë e Kosovës, ideja është të menaxhimi në të ardhmen, përgjithësisht i prodhimit të energjisë i cili në njëfarë mënyre sot për Kosovën është bërë një sfidë kryesore. Pra, për sa i përket kësaj çështjeje, ne jemi dakord dhe do ta votojmë dhe do ta procedojmë tutje.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Ajo që vlen të thuhet është se i kemi parë katër vjet stagnim në zhvillimin energjetik të Kosovës, kemi parë 4 vjet ndoshta edhe kthim prapa përkundër premtimeve të cilat i kemi pasur në fushatën e vitit 2007. Në vitin 2007, planet kanë qenë të gatshme, procedurat kanë qenë të hapura për të shkuar më tutje. Po ashtu kemi katër vjet stagnim, për të mos thënë kthim prapa në situatën mjedisore në Kosovë. Asgjë nuk ka ndodhur. Për katër vjet Kosova nuk ka arritur në asnjë mënyrë ose me asnjë parametër të matshëm ta përmirësojë situatën mjedisore në Kosovë, e posaçërisht në Kosovën Qendrore, në pjesën për të cilën po flasim që kryesisht janë në komunat: Obiliq, Fushë Kosovë.

Mund të thuhet se është paradoksale që vitin 2004 deri në vitin 2007, Kosova, jo vetëm qeveria e atëherëshme por Kosova e ka kuptuar që pasuria më e madhe të cilën e ka, është thëngjilli dhe thëngjilli për Kosovën është sikur nafta për vendet të cilat kanë naftë. Është një pasuri e cila duhet të shfrytëzohet sa më shpejtë që të jetë e mundshme për shkak se është energji fosile tepër e qartë dhe se do të vijë një ditë që do të jetë gati e pamundur për t’u shfrytëzuar e aq më tepër për një vend të varfër, për një vend që e ka GDP-në për kokë banori më të vogël jo vetëm në Evropë por goxha më gjerë se Evropa.

Për katër vjet Qeveria e Kosovës nuk ka arritur ta kuptoj që nuk mund të rregullohet mjedisi kur vendi është i varfër, kur spitalet janë më të ndyta se burgjet, kur njerëzit nuk kanë barëra. Por, pa u zhvillua ekonomikisht nuk mund të rregullohet mjedisi që do të thotë Kosova nuk po mbërrin për të kuptuar ende saktë që pa u ngutur domethënë me zhvillimin e potencialit energjetik, nuk mund të zhvillohet as mjedisi, as nuk mund të rregullohen spitalet, as nuk mund të rregullohet asgjë për shkak se ne nuk e kemi ama bash as edhe një pasuri që mund të krahasohet me këtë që e kemi. Gjysma e botës ka vrapuar për ta marrë këtë pasuri prej nesh, për derisa ne për 4 vjetët e fundit e kemi stopuar, e kemi kthyer në zero edhe tash edhe interesi është shumë më i vogël për shkak të krizës globale në të cilën jemi.

Plani të cilin e kemi para vetes, është një plan i mirë në letër, duhet të themi një plan i cili ka mund të sillet i tillë pa asnjë ndryshim as më të voglin edhe në vitin 2008 nga paraardhësi i ministrit që e kemi këtu në sallë edhe në vitin 2009, edhe në vitin 2010, por nuk ka ardhur. Ish ministri e di pse nuk e ka sjellë edhe kryeministri i tashëm edhe ish kryeministri i njëjti, e di pse Kosova edhe 4 vjet pas ardhjes të tij në pushtet, është në pikën zero energjetike, ashtu qysh e ka gjetur bile, bile mund të themi edhe më keq se ka qenë për shkak se e thashë më përpara interesimi për investimin e energjisë sot është shumë më i vogël se që ka qenë në vitin 2007 dhe në vitin 2008. Pse po flas për këtë temë, tepër e qartë, nuk mund njëra pa tjetrën, nuk mund të ketë plan hapësinor për zonat të cilat janë të pasura me thëngjill nëse nuk e kemi ndërmend investimin në energji elektrike. Nëse nuk e kemi ndërmend shfrytëzimin e pasurisë më të madhe që e ka Kosova, pasuri e cila mund ta levojë Kosovën, mund ta ngritë prej pikës zero dhe ta shndërroj në një vend i cili e fillon zhvillimin ekonomik, i cili ende as që ka filluar. Përralla janë krejt çka thuhet se kemi filluar, përralla janë ato që kemi rritje ekonomike, janë përralla të cilat mendoj se tani më nuk po i ha as nuk po i pranon askush.

Po flasim prej 12 deri në 24 miliardë ton thëngjill të shfrytëzueshëm me një mbishtresë dhe të hollë, me kushtet më të mira jo vetëm në Evropë, por ndoshta edhe më gjerë. Tash 12 deri 14 miliardë, dikur e kemi pasur 14 miliardë, tani e kemi 12 miliardë. Dallimi prej 2 miliardë ton është goxha i madh edhe me siguri se gjeologët edhe ekspertët e tjerë duhet të punojnë edhe pak aty, mirëpo të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, dhënia e çfarëdo çmimi që do një toni të thëngjillit edhe mendoni se për çfarë pasurie po flasim vetëm për fushën e Sibovcit, pa e llogaritur fushën D, pa i llogaritur rezervat të cilat janë në Dukagjin dhe çka mendon Kosova, a kemi ne luginë të silikonit që e ka përmendur kryeministri për të shpikur diçka që ka shpikur i njderi Steve Jobs, apo çka kemi ne në Kosovë që të arrijmë të akumulojmë mjete të mjaftueshme që të kemi universitete në rregull dhe të kemi spitale në rregull, kurrgjë tjetër nuk po përmend. Mund të them se fakti që ky dokument, çfarëdo qoftë, i mirë e i keq, ka ardhur sot në Kuvendin e Kosovës e tregon dështimin fatal të Qeverisë të Kosovës të udhëhequr nga zoti Hashim Thaçi, në 4 vjetet e fundit, dy qeveritë. Është dështim fatal, dështim i cili e ka lënë Kosovën në varfëri të skajshme dhe i cili rrezikon me zgjatë edhe të paktën për një dekadë për shkak të kushteve në të cilat ka hyrë ekonomia globale. Ky është dështimi më i madh, ky është varfërimi më i madh që kjo Qeveri ka arritur t'ia shkaktojë Kosovës, duke mos e përmendur korrupsionin e tjera.

Sinqerisht po ju them, kam qenë luftëtar i madh dhe kundër korrupsionit, por kjo që ka ndodhur me fushën energjetike në Kosovë, është shkatërrim total i ekonomisë së Kosovës, është shkatërrim i të ardhmes së Kosovës dhe është dështimi më i madh ndoshta që do ta përjetojë Kosova për një kohë shumë të gjatë.

Ne do ta votojmë këtë plan me shpresën se ndoshta do të jetë një ndihmesë në këtë drejtim, mirëpo po them edhe një herë, mendoni katër vjet në pikën zero, mendoni katër vjet kthim prapa, mendoni 4 vjet fukarallëk, mendoni katër vjet mbytje e ekonomisë së Kosovës dhe blerje e energjisë nga Serbia në vazhdimësi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, Sevdije Lama e ka fjalën.

SEVDIJE LAMA: Ju faleminderit, i nderuar zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re, e ka shqyrtuar Projekt-planin hapësinor 2010-2020, zona me interes të veçantë ekonomik, fusha e Mihjes së Re, dhe të njëjtin e përkrahë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të SLS-së, nuk ka të paraqitur, “6+” deputetja Duda Bale

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Posle analize i razmatranja Nacrta prostornog plana 2010-2020. godine, zone od posebnog ekonomskog interesa, Parlamentarna grupa „6+“ je donela odluku da podrži preporuku Komisije. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të grupeve nuk ka tjetër të paraqitur.

Fjalën e ka deputetja Justina Pula.

JUSTINA PULA: Ju faleminderit, kryesues!

Unë nuk desha të hyj as që do të hyjë në analizën e kësaj strategjie dhe strategjisë e cila do të vijë, vetëm desha t'i them ministrit gjatë punimit të strategjisë duhet të keni kujdes të dhënat dhe sa janë ato të argumentuara dhe nga cili burim janë marr, se ka të bëjë me një strategji, ku të gjithë investitorët apo punimet shkencore tjera, do të bëhen duke u thirr në këtë strategji dhe unë e pash që në të dy strategjitë, ka të dhëna të cilat nuk janë të argumentuara. Strategjia duhet të ketë edhe të ardhura, edhe të dhëna të argumentuara bazike prej cilit institucion si dhe duhet të jenë profesionale dhe shkencore.

Prandaj, duhet të keni kujdes, se sa i përket popullsisë, sipërfaqes, resurseve kemi të dhëna shkencore prej institucioneve të ndryshme, prej punimeve të ndryshme, prandaj unë mendoj që duhet të bazoheni në ato të dhëna e jo nga grupet punuese të cilat i kanë marrë dhe bëhet pyetje prej nga i ka marrë. Kjo ishte sa i përket një kërkesë të cilën desha ta bëj, në ndërkohë dëshiroj t'i përgjigjem edhe Ardian Gjinit. Është e vërtetë që Qeveria aktuale edhe ajo e kaluara, ka premtuar se do të ketë energji dhe kjo energji ka të bëjë me projektet madhore strategjike, ekonomike për Kosovën, mirëpo mund të them që ndonjëherë është më mirë ndonjë projekt të mos finalizohet, të mos kryhet se të kryhet dhe të ketë pasoja shumë të mëdha me vite të tëra Kosovën, për të ardhmen e Kosovës.

Është e vërtetë që në Qeverinë të cilën e kanë menaxhuar apo në të cilën kanë qenë AAK-ja dhe LDK-ja, ka qenë projekti strategjik 2000 megavat dhe unë mendoj që kemi bërë shumë mirë që nuk kemi shkuar me 2000 megavat, për shkak se nuk e ndërtojmë

na, por e ndërton investitori dhe tërë fitimi do të jetë i investitorit, jo e Kosovës kjo është nën dy.

E dyta, në Qeverinë Thaçi 1 është bërë një ndryshim dhe janë zvogëluar kapacitetet gjeneruese të energjisë nga 2000 në 1000 plus 1000, mirëpo ekziston një gabim tjetër që është bërë se është futur Termocentrali “Kosova B”, i cili me të vërtetë është një gabim apo më mirë të themi është një projekt i cili gjithashtu mund të ketë pasoja dhe ajo çka unë dëshiroj të them pasi që kemi të bëjmë me shfrytëzimin e Sibovicit, edhe një herë po e ceku, të nderuar deputetë dhe tërë qytetarët e Kosovës, duhet të analizojmë ndonjëherë është më mirë projekti të stagnojë apo të mos realizohet sipas kërkesave të ndërkombëtarëve apo kërkesa tjera me të cilat nuk do të fitojë Kosova për shkak se në këtë periudhë të kishte shkuar realizimi Termocentralit “Kosova e Re”, me ato kërkesa të cilat kanë qenë, tërë fusha e Sibovcit nuk kishte qenë më e Kosovës, por kishte qenë e një investitorit të huaj dhe vazhdimisht i dëgjojmë këto komente, nuk kemi rrymë, marrim rrymë prej investitorit apo importojmë. Një gjë duhet t’ua them, nëse investitori do të vijë në Kosovë për të ndërtuar, ajo më nuk është kapacitet i Kosovës, është i investitorit të huaj. Prandaj Kosova do të importojë rrymë ose prej Bullgarisë, Serbisë apo prej Greqisë ose do të importojë rrymë prej investitorit i cili ka ardhur në Kosovë. Prandaj fitimin do ta merr investitori. Prandaj mos të japim paushall deklarata të ndryshme që qe çka bëre, nuk u kryer projekti.

Unë po them, që deri më tani është shumë mirë që nuk është kryer projekti, se të ishte kryer në ato kushte të cilat është paraparë prej 2006-2007. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Replikë, deputeti Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!
Zonja ish ministre, unë kam ditur për ta përmendur emrin nëse kisha menduar që ti i ke pasur fajet, por nuk e di pse po e merr fajin e huaj përmbi veti. Këta thonë që duhet pasur investimin e vet Kosova në energji e donë ta shesin Postën, në të njëjtën kohë, tash ja bëni njërën, ja bëni tjetrën. Ju nuk munde të thoni që ndërmarrja publike shumë profitabile që është PTK-ja, nuk duhet të jetë e Kosovës, duhet dhënë investitorit të huaj e në energji duhet pasur investitorin e vendit.

Sikur Kosova t’i kishte pasur diku 2 miliardë euro kesh e kish nderuar vetë. Por, problemi është që Kosova është në terr, nuk ka energji, nuk po mund ta ndërtoj vetë dhe e ka bërë një plan që me shuarjen e A-së dhe të B-së dhe me fillimin e zhvillimit ekonomik kur industria fillon të marrë energji, Kosovës i duhen 2000 megavat energji efektive, po flas edhe, nëse nuk i kemi duhet importuar. Kjo ka qenë logjika dhe kurrkush nuk po thotë që Kosova kish pasur me ia falur fushën D ose Sibovcin, çfarëdo investitori. Investitori kur të vjen në Kosovë, vjen me kushte edhe e blen thëngjillin, paguan Rojellti bile, bile Kosova ka pasur mundësi të jetë edhe aksionar shumë i madh duke garantuar se e fut fushën D- Sibovcin. Mirëpo të themi tash që e kemi ndërprerë projektin për shkak se kemi dashur të jetë i Kosovës, pse nuk e bëtë atëherë qe 4 vjet? Llogaritni humbjet e Kosovës për 4 vjet pa energji, llogaritni që 500 milionë euro keni

blerë energji jashtë. A i llogaritni këto? Keni dashur t'i mbani për veti. Hajt ndërtoni tash nëse mund t'i ndërtoni.

KRYESUESI: Kundër replikë, 1 minutë, Justina Pula.

JUSTINA PULA: Unë nuk desha që t'i as të më lëvdosh as të më kritikosh se atë çka në periudhën time çka është mirë apo është bërë keq, ekzistojnë argumente dhe kurdoherë do të shihet në një periudhë çka është bërë dhe pse është stagnuar apo pse është realizuar

Vetëm desha t'ju them, ka pasur të shkojë i tërë Sibovci, prandaj ne kemi luftuar që Sibovci të mbetet dhe të hyjë në përqindje të aksionarëve të shtetit të Kosovës: Nënë një, nëse shitet qymyri vetëm ta dini, një ton qymyr tani është 0,25 dhe investitorit të ri po insistohet t'ia japim 0,75, që do të thotë na japim një ton qymyr për një makiato. Edhe, ju lutem prandaj mos bëni replika dhe mos kritikoni që nuk po shkon projekti.

Unë edhe një herë po luftoj edhe po ju them, në qoftë se duhet, unë do të dal me argumente dhe do t'ju tregoj çdo gjë...

KRYETARI: Ju faleminderit!

Nuk ka deputetë tjerë të paraqitur.

Ministri e ka kërkuar fjalën, kërkon diçka shtesë të na thotë.

DARDAN GASHI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Vetëm desha t'ju përkujtoj se plani hapësinor nuk e paragjykon as mënyrën e investimit, as metodologjinë e investimit, vetëm trasimin e rrugës për përdorimin e logjikshëm të këtij resursi, andaj ju kisha lutur debatet që ndodhen të mos përzihen se çka ka prezantuar Qeveria sot. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Vazhdojmë me votimin e Projekt-planit hapësinor 2010-2020, zona me interes të veçantë ekonomik, Fusha e Mihjes së Re.

Konstatohet se në sallë janë 73 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët le të përgatiten për votim. Votojmë tani.

Ju faleminderit!

Konstatohet se me 66 vota "për" 4 abstenime, asnjë "kundër", Kuvendi miratoi Planin hapësinor 2010-2020 zona me interes të veçantë ekonomik, Fusha e Mihjes së Re.

Vazhdojmë me pikën e 15 të rendit të ditës:

15. Shqyrtimi i Propozim - strategjisë dhe Planit të veprimit për biodiversitetin 2011-2020

Komisioni për Pylltari, Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, ka shqyrtuar propozim strategjinë dhe Planin e veprimit për biodiversitetin 2011-2020 dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj, kryetari nuk është, a ka dikush të flas, përfaqësuesin e Komisionit, deputetin Liburn Aliu ta marrë fjalën për arsyetimin e raportit me rekomandime.

LIBURN ALIU: Komisioni për Bujqësi Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, e ka trajtuar strategjinë dhe planin e veprimit për biodiversitetin 2010-2020 dhe për këtë plan ne kemi pasur edhe përfaqësues nga Ministria me të cilët kemi diskutuar dhe e rekomandojmë që të votohet. Jemi pajtuar tërësisht me këtë plan.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, nëse e do fjalën. Nuk ka.

Përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, deputeti Niazi Idrizi.

NIAZI IDRIZI: I nderuar kryesues,

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Strategjia dhe plani i veprimit për biodiversitetin, i përgatitur nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, është një dokument bazë për mbrojtjen e natyrës që del si obligim nga neni 140 i Ligjit për mbrojtjen e natyrës, i cili është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2010. Kosova ka një diversitet të pasur biologjik dhe pejsazhor, falë pozitës gjeografike, faktorëve gjeologjikë, pedologjikë, hidrologjikë, relievit dhe klimës.

Zonat më të rëndësishme për biodiversitetin e Kosovës janë: Malet e Sharrit, Bjeshkët e Nemuna, Pashtriku; Koretniku e tjerë. Bota bimore dhe shtazore është shumë e pasur dhe deri me tani janë inventarizuar rreth 1800 lloje të florës vaskulare, ndërsa supozohet se ky numër mund të arrijë deri në rreth 2500 lloje dhe në mbi 500 lloje të faunës. Për fat të keq këto vlera të jashtëzakonshme janë duke u shfrytëzuar pa kritere të qëndrueshme dhe në masë të konsiderueshme janë dëmtuar ekosistemet dhe diversiteti biologjik.

Dëmet më të mëdha i ka pësuar parku i vetëm kombëtar “Malet e Sharrit” ia cili përfshin 84% të tërë sipërfaqes së përgjithshme të zonave të mbrojtura, ndërsa nuk janë kursyer as Bjeshkët e Nemuna, Parku “Gërmia”, Mirusha, e shumë zona të tjera. Ky dokument i ka nxjerrë në pah shumë probleme, siç janë: mungesa e inventarit të plotë për florën, faunën dhe habitatet si dhe mungesën e listës së kuqe. Mungesa e indikatorëve kombëtar të biodiversitetit, mungesa e organeve menaxhuese, buxhetin e pa mjaftueshëm për mbrojtjen e natyrës e tjera.

Strategjia dhe plani i veprimit për biodiversitetin, i përcakton dy synimet afatgjata të hulumtimit, të ruajtjes dhe subdiferzitetit, vlerave të mbrojtura të natyrës të cilat do t'i realizojë përmes veprimeve konkrete. Hulumtimi dhe inventarizimi i llojeve të habitateve dhe pejsazheve, zvogëlimi i shkallës, humbjes së biodiversitetit përmes shtimit të sipërfaqeve të zonave të mbrojtura, shpallja e zonave të mbrojtura me rëndësi ndërkombëtare, si zonat nga Natyra 2000, që dalin nga direktivat evropiane për mbrojtjen e natyrës, hartimi i planeve hapësinore edhe menaxhuese për zonat e mbrojtura e tjerë. Strategjia e ka edhe planin e veprimit i cili e ka identifikuar listën e veprimeve dhe projekteve kryesore të cilat do të ndërmerren për periudhën ardhshme 5 vjeçare. Projektet e rekomanduara në këtë strategji dhe plani i veprimit përmbajnë politikat legjislaconin, planet dhe programet që janë të nevojshme për përmirësim të në sektor të ndryshëm të vendit.

Të nderuar vendimmarrës,

Me miratimin e kësaj strategjie dhe me Ligjin e natyrës që është miratuar më parë, ne i shtojmë edhe një mbrojtje natyrës dhe biodiversitetit, e me këtë ne e përmbushim edhe një obligim kushtetues i cili del nga neni 52, ku në mes tjerash thuhet se natyra dhe biodiversiteti janë përgjegjësi për secilin. Për më mirë, me këtë rast ne do të përmbushim edhe një obligim nga sfera e integriteteve evropiane dhe bashkëpunimit ndërkombëtar nga fusha e mbrojtjes së natyrës si Konventën për biodiversitetin dhe konventat tjera të cilat Kosova ende nuk i ka firmosur, por që në të ardhmen synon t'i nënshkruajë.

Strategjia synon edhe përmbushjen e disa kritereve nga fusha e integritetit të Bashkimit Evropian, duke synuar harmonizimin e Ligjit për mbrojtjen e natyrës me Direktivën e habitateve dhe direktivat tjera. Kjo strategji edhe plani i veprimit për biodiversitetin nuk mund të themi se është dokument i përsosur, por me miratimin e tij, ne do të japim shansin që ai të fillojë të zbatohet në praktikë dhe të fillohet me zgjidhjen e problemeve të grumbulluara për ruajtjen e natyrës dhe biodiversitetit. Ne do ta miratojmë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputetja Afërdita Berisha.

AFËRDITA BERISHA: I nderuar kryesues,

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar dokumentin e strategjisë dhe planin e veprimit për biodiversitetin 2011-2020 dhe mendojmë se është një dokument bazë për vlerat natyrore dhe krijon kornizën e aktiviteteve për shfrytëzimin e resurseve natyrore, si dhe kujdeset për ruajtjen e botës bimore dhe shtazore. Prandaj, mendojmë se ky dokument duhet të kalojë për qëllimin qartë që ka ruajtjen e biodiversitetit, shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore, sepse ato nuk janë pasuri të pashtershme, prandaj, një plan i shfrytëzimit racional të tyre, është i mirëseardhur.

Edhe pse Kosova si shtet ende nuk është palë nënshkruese e ndonjë konvente a marrëveshjeje në fushën e mbrojtjes së natyrës, që do ta detyronte përmbushjen e kërkesave, mirëpo, në të ardhmen presim që të jemi aty, prandaj me këtë strategji synohet të përmbushen detyrimet ndaj konventave të tjera, si Konventa për tregti ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të florës dhe faunës e të tjera.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, e mbështet duke rikujtuar implikimet buxhetore që sjell kjo strategji. Realisht, ky dokument ka ardhur me vërejtje nga Qeveria rreth implikimeve buxhetore, mirëpo shpresojmë që do të gjinden rrugë duke bërë harmonizimin për gjetjen e mjeteve buxhetore, qoftë përmes donacioneve apo mënyrave të tjera për implementimin e kësaj strategjie, sepse mjedisi sot është duke u shkatërruar në mënyrën më të egër të mundshme. Prandaj, një plan apo strategji e mbrojtjes së tij, duhet mbështetur. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Strategjinë dhe planin e veprimit për biodiversitetin e kemi trajtuar si grup parlamentar dhe me këtë strategji pajtohemi plotësisht.

Vërejtjet për këtë strategji janë tejet të vogla në raport me misionin e pamundshëm të kësaj strategjie. Si strategji do të duhej të.....sidomos kur bëhet fjalë për statistikën dhe për rezultatet edhe këto të fundit të regjistrimit dhe të thellohej pak më tepër në hapat konkret të eliminimit të dukurive shkatërrueses të biodiversitetit. Po flas për hapat konkret që aty i përmend, të cilat mendoj se nuk janë thelluar mjaftueshëm.

Vërejtja kryesore në lidhje me këtë strategji është në aspektin që problemin që ajo do ta ketë me politikën aktuale të Qeverisë, pasi që konsideroj që politika aktuale e Qeverisë, është totalisht në kundërshtim me logjikën e kësaj strategjie shumë të drejtë për biodiversitetin që na është dhënë në Kuvend. Pra, kur flasim për këtë strategji, ajo i merr parasysh të gjithë shkaktarët të cilët e shkatërrojnë biodiversitetin dhe për secilin veç e veç përgjegjësinë dhe fajin kryesor gjithmonë duhet kërkuar te politika, sepse nuk ka gjë tjetër përpos se si do ta arsyetojmë edhe më tutje tash. Pra, cilët janë faktorët kryesor të cilët po e shkatërrojnë biodiversitetin sot? Është nën një shkatërrim i pejsazhit, është shkatërrimi i shtretërve të lumenjve, është ndotja e lumenjve, është shkatërrimi i pyjeve, është ndotja e ajrit e të gjitha kështu me radhë.

Të gjitha këto ndodhin si pasojë e eksploatimit më brutal të mundshëm të mirave materiale natyrore që ne i kemi. Këto ndodhin nga ndërmarrjet profitabile edhe ilegale, por të cilat natyrisht tolerohen. Problemi është që te të gjitha këto ndërmarrje interesi material për shfrytëzim, është jashtëzakonisht i madh. Pra, kur bëhet fjalë për shkatërrimin e pejsazhit, i kemi parasysh guroret dhe milionat që dalin nga shfrytëzimi dhe shkatërrimi i këtij peizazhi, i kemi parasysh ndërmarrjet ilegale të cilat e bëjnë eksploatimin e zhavorrit dhe e shkatërrojnë totalisht ta zëmë shtratin e Drinit të Bardhë, i cili është e paimagjinueshme se çka ka ndodhur atje dhe kjo dukuri është toleruar nga politika, aktualisht nga Qeveria sot. Pastaj, e kemi shkatërrimin e biodiversitetit të

lumenjve nga pasoja e ndotjes, e kemi shkatërrimin e pyjeve ku natyrisht që edhe shfrytëzimi i pyjeve dhe i drurit, është tejet profitabil në Kosovë dhe kjo ndodhë prapë nga ndërmarrjet ilegale, gjysmë ilegale, me tenderë të cilët tejkalohen e kështu me radhë që është një problem jashtëzakonisht i madh dhe sot për pasojë në zonën complete të Bjeshkëve të Nemuna, pjesa që është në Kosovës, pyjet janë shkatërruar si asnjëherë në histori deri tash. Pra, për të gjitha këto probleme, rrënjët janë te eksploatimi brutal i pasurive natyrore, rrënjët janë te logjika e mbrapshtë e politikës aktuale të Kosovës, e cila në fakt është një politikë e shkatërron ambientin dhe prioritet i jep zhvillimit të ndërmarrjeve të cilat eksploatojnë pa pasur ndonjë strategji apo ide apo ndjesi të themi mbi biodiversitetin dhe natyrën në përgjithësi.

Duhet ta kemi parasysh që komplet zonat të cilat ky shfrytëzim ndodh pra si kur bëhet fjalë për zhavorrin, si kur bëhet fjalë për zhavorrin e lumenjve, si kur bëhet fjalë për masën drusore, ndodh shkatërrim dhe degradim i paparë i natyrës. Ta zëmë, vetëm mund ta merrni komunën e Deçanit dhe shpyllëzimin total të tërë atyre sipërfaqeve me pyje që kanë qenë, që në fund të fundit janë edhe mushkëritë e Kosovës. Pra, ajo që është më kryesore këtu të thuhet, është që kjo strategji për biodiversitetin e ka një problem kryesor i cili nuk është trajtuar këtu, pra nuk është problemi drejtpërdrejt pylli apo, problemi është te politika e Qeverisë dhe te pasioni i madh për shkatërrim dhe po të themi edhe të pasioni dhe epshi i madh për shpërbërje.

Kjo politikë e Qeverisë, po e shohë sot që ideja e shkatërrimit dhe e shpërbërjes edhe si terme, janë reflektuar edhe tek deputeti Muja, i cili e dëshiron ta themi edhe shpërbërjen të Lëvizjes “Vetëvendosje”, natyrisht kjo ndodhë tani, në këto momente kur priten edhe marrëveshje të reja me Serbinë dhe natyrisht kundërshtari kryesor në këtë pikë lëvizja “Vetëvendosje”, duhet të shpërbëhet disi dhe për këtë punë, natyrisht që punoni, por fatkeqësisht po ju themi që ne jemi duke u forcuar vazhdimisht. Atë po e shohim në terren, po e shohim që po na rritet përkrahja dhe lëvizja “Vetëvendosje” po i shton strukturat e saj kudo.

KRYESUESI: Shqip Muja, replikë.

SHAIPI MUJA: Zoti kryesues, është krijuar njëfarë lloj opsioni, nëse kritikohet “Vetëvendosja” merret, ne nuk kemi qëllim që ta kritikojmë dhe të kemi ide vrastare për ta, por këta duhet të jenë jo lëvizje anarkiste, por të jenë lëvizje konstruktive dhe lideri i saj, Albin Kurti, duhet të deklarohet kundër Der Spiegelit për qëndrimet e tij anti-amerikaniste dhe, prandaj unë nuk kisha asgjë tjetër më shumë. Nëse ju dhemb kjo, këto janë fakte nuk kemi nevojë më shumë.

E problemi i rritjes është në lëvizje anarkike, ato çka bën lëvizja “Vetëvendosje” në rrugë, janë lëvizje anarkiste të cilat janë të dënueshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Unë ju kisha lutur që të mos i fusni këto pyka tani në kohën kur po shqyrtojmë raporte krejt tjera. Kur doni e bëjmë një debat rreth kësaj edhe nuk komentohen gazetatat se gazetatat janë gazeta, ka njerëz këtu për të cilët kanë shkruar gazetatat me dekada edhe s’i ka gjetur kurrëgjë.

Kundër replikë Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Problemi aktual, tashmë meqë e qite, ti nise të flasësh për biodiversitetin, a po më kupton dhe në kuadër të biodiversitetit edhe fjala ime nënkuptohet aty. Por meqenëse e qite tash te politika, problemi kryesor aktualisht është marrëveshja me Serbinë. Atë e keni ju problemin kryesor. Ju mund tash të përdorni elemente tjera jo Der Spiegel, apo elementet tjera që na shumë qartë e kemi definuar raportin tonë me faktorin ndërkombëtar, ndërsa për sa i përket lëvizjeve tona, apo akteve tona të përmbysejeve të maunave që ju i lejoni të vijnë, ato natyrisht që nuk janë anarkike, pasi që janë rezultat i strukturave të organizuara që ne i kemi.

Lëvizjet anarkike nuk kanë struktura të organizuara, ju i keni ato problem, përpiqeni të etiketoni, ne keni vu lloj-lloj etiketa, nuk e kemi problem punën e etiketave, na keni quajtur fashistë, lloj-lloj, gjithçka edhe anarkistë, nuk është problem, shikon strukturën në terren, puna jonë në terren po e bën të veten.

KRYESUESI: Time Kadrijaj e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së.

TIME KADRIJAJ: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Natyra e Kosovës edhe para lufte edhe pas lufte e shkatërruar pamëshirshëm e atë nga faktori njeri. Qeveritë nuk janë marrë me mbrojtjen e natyrës, as nuk kanë kontribuar në këtë drejtim, duke rrezikuar florën dhe faunën e vendit tonë. Qeveria, megjithatë ka kontribuar, por në aspektin e shkatërrimit të natyrës duke dhënë tenderë, duke shkatërruar pyjet dhe lumenjtë e Kosovës.

Ne e mirë presim këtë strategji dhe plan të veprimit për biodiversitetin 2010-2020. Pra, është krijuar dokumenti bazë për mbrojtjen e natyrës i cili dokument përcakton synimet afatgjata të ruajtjes së biodiversitetit dhe larmisë pejsazhore. Të dhënat për biodiversitetin në Kosovë, janë të pamjaftueshme, atëherë si do të fillojë procesi i ruajtjes së biodiversitetit? Në strategji është bërë identifikimi i problemeve, prioritet dhe veprimet strategjike, por nuk kuptohet si do të realizon këto veprime strategjike ku problem është buxheti? Përmendet se përgjegjëse për ruajtjen e natyrës janë ministritë, komunat, popullata lokale, por rolin udhëheqës e ka Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e cila është përgjegjëse për harmonizim të veprimeve, me qëllim të arritjes të ndonjë rezultati.

Grupi Parlamentar i Aleancës e ka shqyrtuar planin dhe strategjinë për biodiversitetin dhe do ta përkrahë në parim, me shpresë se strategjia dhe plani i veprimit, do të realizohen ashtu siç janë paraparë në këtë strategji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Koalicionit Kosova e Re, deputetja Sevdije Lama.

SEVDIJE LAMA: Ju faleminderit, i nderuar kryesues!

Edhe Kosova si dhe shumica e vendeve të botës po përballet me problemin e humbjes së biodiversitetit. Padyshim që faktori njeri e shkakton këtë dukuri si me shpyllëzimet

masive, ndotjen e ajrit dhe ujit, gjuetinë e pakontrolluar, shfrytëzimin intensiv të tokës e tjerë.

Nga të gjitha këto, humbja e sipërfaqeve pyjore që ka përfshirë me të madhe ekosistemin natyror, është një nga problemet më emergjent për natyrën e Kosovës. Redukimi i sipërfaqeve pyjore dhe degradimi i vazhdueshëm i tyre, ka ardhur kryesisht si pasojë e shfrytëzimit pa kriter të zonave pyjore. Si pasojë e këtyre ndikimeve, rrjedh edhe kërcënimi për zhdukjen e shumë llojeve bimore dhe shtazore.,

Ruajtja e biodiversitetit, është e rëndësishme dhe e domosdoshshme për shumë arsye. Është detyrim i yni moral që t'u lëmë pasardhësve një mjedis po aq të pasur sa kemi trashëguar. Çdo qenie e gjallë ka të drejtë të jetojë ashtu si edhe vet njeriu. Shumica e llojeve bimore, kanë vlerat e jashtëzakonshme shëndetësore që zhdukja e tyre do të thotë zhdukje e kësaj vlere.

Proceset natyrore biologjike, janë rregullatorët më të mirë të ruajtjes së mjedisit të pastër dhe jetës në planetin ton. Biodiversiteti dhe shumëllojshmëria biologjike e natyrës, paraqet një potencial të lartë për zhvillimin e turizmit dhe rekreacionit të një vendi. Zhvillimi ekonomik i një vendi mund të sigurohet përmes ruajtjes dhe përdorimit të qëndrueshëm të pasurive natyrore biologjike dhe mbi të gjitha, vetë jeta e njerëzimit në tokë është e varur nga biodiversiteti, shfrytëzimit të bimëve dhe të kafshëve.

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosova e Re, duke marr parasysh rëndësinë e kësaj strategjie, e përkrah. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Grupi Parlamentar SLS, deputeti Sasha Millosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

I naša parlamentarna grupa je razmatrala Predlog strategije i Plan delovanja o biodiverzitetu za 2011-2020. godinu. Smatramo da je ovaj strateški plan veoma bitan i podržaćemo ga.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Grupi Parlamentar “6+”, deputeti Albert Kinolli

ALBERT KINOLLI: Ju faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë,

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar këtë rekomandim rreth strategjisë dhe planit të veprimit për biodiversitetin për vitin 2011-2020 dhe do ta miratojë këtë strategji me rekomandimin e Departamentit të Buxhetit të Ministrisë për Financa, e që ka të bëjë me implikimet buxhetore për realizimin e këtij projekti apo kësaj strategjie dhe planit të veprimit për biodiversitetin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të grupeve parlamentare diskutimet janë kryer.

Vazhdojë me deputetë të paraqitur.
Deputeti Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Ju faleminderit!

I nderuar kryesues,

I nderuar ministër,

Një strategji dhe plan i veprimit për biodiversitetin në Kosovë, ka qenë e nevojshëm dhe e përkrah Qeverinë, në këtë rast Ministrinë e Ambientit për hartimin e kësaj strategjie dhe planin e veprimit. Konsideroj se është një strategji e hartuar mirë dhe në mënyrë profesionale nga ekspertët në bashkëpunim edhe me organizatat joqeveritare. Ajo çka unë doja të propozoja në këtë strategji është t'i kushtohet edhe më tepër rëndësi edukimit në ruajtjen e ambientit, dhe të natyrës dhe me këtë në vetë biodiversitetin.

Pra, fëmijët qysh në bankat shkollore, të mësohen për efektet që mund faktori njeri të ndikojë negativisht në dëmtimin e natyrës dhe me këtë edhe në prishjen e biodiversitetit, por edhe për veprimet pozitive që mund t'i bëjmë për ruajtjen e natyrës.

Sot biodiversiteti në Kosovë dëmtohet nga individët dhe organizatat e ndryshe për përfitime personale, e nganjëherë veprimet që dëmtojnë natyrën dhe ndikojnë negativisht në biodiversitete, bëhen për arsye krejt banale, siç është djegia e arave dhe shkurreve, të cilat pastaj e marrin përmasa më të gjëra në djegie të pyjeve të cilat vërtet rënd dëmtojnë natyrën dhe biodiversitetin.

Pastaj, ndotja e lumenjve e cila ndikon në zhdukjen e llojeve të ndryshme të peshqve dhe të botës tjetër ujore. Kjo ndotje e lumenjve vjen në masë të madhe nga ujërat e zeza të vendbanimeve, e në veçanti këtu duhet kushtuar rëndësi menaxhimit të ujërave të zeza që ato të mos të ndikojnë në dëmtimin e lumenjve. Masat ndëshkuese duhet të jenë më të rrepta për të gjithë ata të cilët dëmtojnë natyrën, e në veçanti kur ky dëmtim i natyrës bëhet për përfitime individuale dhe kohëve të fundit edhe për përfitime politike, siç është rasti i rrokullisjes të qëllimshme të kamionëve në Lupç, nga rruga në natyrë. Andaj, masat ndëshkuese për ata të cilët dëmtojnë qëllimshëm natyrën, duhet të ashpërsohen, në veçanti kur një grumbull i vogël njerëzish grumbullohet si milingona dhe dëmtojnë milingonat e vërteta dhe botën tjetër shtazore dhe bimore. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ministër,

Deputetë të nderuar,

Fatkeqësisht, është bërë praktikë që në mungesë të zbatimit të ligjeve, ne apo Qeveria thënë më mirë, tenton të hartojë strategji vetëm e vetëm që të shtyjë afatin e zbatimit të ligjeve, sepse sa i përket kësaj fushe, vetëm në legjislaturën e kaluar janë nxjerrë një mori ligjesh, të cilat merren me ruajtjen e natyrës dhe të mjedisit. Prandaj, kjo paraqet vetëm një neglizhencë në këtë drejtim, këtë më mirë e dinë ata që banojnë apo jetojnë në

zonat të cilat janë të atakuar, sepse nuk ka shembull më konkret se sa rruga Prishtinë-Pejë, se sa ruhet natyra, biodiversiteti dhe qeniet edhe tjera edhe shtazore edhe to pyjore.

E dyta, ata të cilët e dinë se cila është ruajtja e Bjeshkëve të Nemuna, nga kush atakohen, kush janë përfituesit dhe sa zbatohet ligji në atë pjesë të vendit, sepse deri në vitin 2020, nëse pritet miratimi i kësaj strategjie shumë efektive siç është e paraqitur në letra edhe pse i mungojnë shumë elemente siç është për shembull gështenja që rritet dhe kultivohet në pjesën e Deçanit dhe pjesën tjetër edhe pse këtu nuk është e përfshirë, nuk do të mbetet asnjë dru, asnjë shtazë e vetme nga keqpërdoruesit dhe ata të cilët përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejt jo pa mbështetje politike. Këtë e them me përgjegjësi të plotë sepse ato shihen, shihen anash rrugëve, në rrugën nacionale, jo në lokale se si shkatërrohen bjeshkët-natyrë bjeshkët, por edhe pjesët e tjera që janë shumë afër vendbanimeve dhe fshatrave që gravitojnë apo janë të mbipopulluara me qytetarë.

Prandaj, unë e shoh këtë më shumë si ikje nga përgjegjësia e moszbatimit të ligjeve në fjalë se sa një qëllim efikas edhe pse me shumë të drejtë, Ministria për Financa e ka paraqitur që kjo nuk mund të zbatohet edhe ashtu, sepse kërkon kosto shtesë buxhetore, del jashtë kompetencave të ligjeve në fjalë për këtë drejtim, dhe paramendoni vetë në këtë strategji i kanë identifikuar problemet. Thotë shumë kompani ushtrojnë bizneset pa pëlqime dhe lejen mjedisore. Tash na duhet neve ta miratojmë sot strategjinë për t'i ndalë veprimet ilegale, ashtu siç ishte edhe për gurëthyesit që me shumë të drejtë kanë paraqitur edhe Komisionin në fjalë në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve. Prandaj nuk kërkohet ndonjë moszbatim i kësaj strategjie se janë për, sepse me të drejtë janë shumë mirë të paraqitura, por kërkohet veprim konkret zotëri ministër dhe Qeveri e respektuar dhe të gjithë ata që ia dëshirojnë të mirën vendit, kërkohen masa dhe veprime konkrete, sepse ligji në ato pjesë ku unë personalisht i shohë me sy, aspak nuk zbatohet në këtë drejtim dhe arsyetimet eventuale të atyre të cilët janë të thirrur për të respektuar ligjin, janë sepse thotë ne nuk mund ta zbatojmë, kemi kërcënime, kemi mosbashkëpunim me policinë, kemi joefikasitet të Prokurorisë dhe sot ne duhet ta miratojmë një strategji të tillë. Unë jam për, me shumë të drejtë, kjo strategji ka nevojë të kompletohet edhe me njerëz të fushave shumë përkatëse edhe prej vendeve që i njohin territoret mirë të caktuara, por veprimet duhet të jenë konkrete dhe të menjëhershme. Ju faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputetja Flora Brovina e ka fjalën.

FLORA BROVINA: Ju faleminderit!

Së pari përshëndes ministrin për strategjinë që e solli në Kuvend. Kaherë ka qenë e nevojshme një plan strategjik për ruajtjen e ambientit ose ruajtjen e diversitetit. Vetë kjo është një shprehje e kulturës së një vendi dhe të një populli sa e ruan dhe di ta çmojë këtë diversitet dhe të kujdeset për te. Ndoshta ka qenë e nevojshme që edhe në Parlament të bisedojmë gjerësisht për këtë çështje, por mendoj se në strategji vërehen edhe disa mangësi ose një plan pak i ngutshëm, megjithatë mendoj që është i nevojshëm.

E them i ngutshëm sepse kur është fjala për ruajtjen e diversitetit, kur përmenden shumë komuna dhe shumë lokalitete, disa mungojnë, dhe konkretisht e kam fjalën për një brengë time të kahershme për mbrojtjen e bozhureve që ndodhen në fshatin Gllarevë, rreth Gllarevës aty ku është edhe varri i Azem Galicës, e bozhure shumë të rralla që janë simbol i Kosovës dhe këto ndodhen në territor mjaft të gjerë. Një grup parlamentarësh, domethënë i pata nxitur që ta shohin këtë vend, që është shumë i rrezikuar nga gurëthyesit e shumë rreth e rrotull dhe nga ajri i ndotur.

Ministër, në pranverë vizitoni këtë vend dhe sigurisht në listën, shtojcën e juaj numër 8, në zonat e propozuara për mbrojtje do të futet edhe kjo zonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputeti Glauk Konjufca e ka fjalën, nënkryetar i Parlamentit.

GLAUK KONJOFCA: Ju faleminderit, kryesues!

Unë vetëm desha ta bëj një ndërhyrje për hir të cilësisë së diskutimeve këtu dhe të them që, megjithëse për deputetët e Qeverisë së Kosovës këtu, çështja më e rëndësishme mbetet mbrojtja e milingonave në fshatin Lupç. Unë do të thosha që me siguri që kjo do të ishte për prioritet për Kosovën pasi të rregullohet integriteti territorial, sovraniteti, zhvillimi ekonomik i Kosovës, pastaj një Qeveri e cila do t'i ndalonte mallrat e Serbisë dhe do ta subvenciononte ekonominë vendore, pastaj ndoshta do të mund të vinte deri te mbrojtja e milingonave në fshatin Lupç. Mirëpo sa i përket biodiversitetit dhe ndotjes që ndodh dhe shkatërrimit të biodiversitetit, është me rëndësi se është rasti i Ferronikelit, një ndotje e tmerrshme dhe aje ne kemi marrë edhe shqetësimet e qytetarëve të cilët tashmë edhe nëpërmjet bashkimeve në shoqatat dhe organizata të ndryshme kanë krijuar një këshill protestues atje në komunën e Drenasit, me qëllim që të kundërshtohet ndotja e madhe që ia shkakton Ferronikeli kësaj ane. Me siguri se me rëndësi është për këtë Qeveri po ashtu që në vend që të merret me milingona, do të ishte mirë që të vendoste edhe filtra në termocentralet të cilat shkaktojnë ndotje shumë të madhe në Kosovë.

Dihet që ka fshatra në Obiliq, popullata e të cilave mund të ndodhë që deri në 30 apo 40% e njerëzve vdesin nga kanceri për shkak të këtyre ndotjeve dhe ju kisha këshilluar Qeverinë se shumë më mirë të merren me këto gjera se me milingona. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Replikë, Bekim Haxhiu ka kërkuar.

BEKIM HAXHIU: I nderuar kryesues, ju faleminderit!

Mendoj që në kornizën ligjore të veprimit, në faza të ligjit duhet të jemi të gjithë, prandaj edhe ajo arsyeja domethënë që dëmtimet dhe veprimet politike nganjëherë ndikojnë negativisht edhe në natyrën e veprimeve të secilit.

Sa i përket strategjive tjera kombëtare, në veçanti veprimet e Qeverisë në veri, unë e di që Glauku as më shumë, as sa unë si anëtarët e tjerë të Qeverisë nuk e do Kosovën edhe pse sot vonë i ka dal gjumi të paraqitët si patriot, mirëpo kohën për të treguar

patriotizmin edhe Glauku edhe të gjithë të tjerët e kanë pasur, prandaj duhet të mbështesim Qeverinë se ky Kuvend i ka dhënë mbështetje Qeverisë për të gjitha këto veprime edhe nuk ka nevojë të bëhet edhe me biodiversitetin politik, për shkak se edhe çështjet të cilat u cekën ma lartë në diskutimin tim, kishin të bëjnë kryesisht me ruajtjen e biodiversitetit, prandaj duhet pasur parasysh veprimet e disa milingonave të vogla për dëmtimin e milingonave të vërteta.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Unë ua dhashë për replikë, Shaip, për faktin se ju iu referuat diskutimit të atij e jo diskutimit tënd.

Kundër replikë, zoti Konjufca.

GALAUK KONJUFCA: Unë mendoj se me shprehje të tilla në Kuvendin e Kosovës, sikur cilësimi milingonë për deputetët dhe të zgjedhurit e popullit, mendoj që është praktikë të cilën bota e ka kaluar që nga 60 vjet në kohën e nazizmit, janë bërë kualifikime të tilla për kundërshtarë politikë, duke i krahasuar d.m.th. me kafshë apo me insekte, në mënyrë që nëpërmjet të këtij diskualifikimi, të kalohet edhe në masa më të ashpra. Këtë fjalor bota e ka kaluar që 60 vjet, por fatkeqësisht ka mbetur të tejkalohet edhe në Kosovë ende, kurse sa i përket patriotizmit të vonuar, mua më bën përshtypje koncepti i Kamishit për patriotizmin. Diqysh e ka sikur konceptin për ta kapërcyer fruthin, domethënë e ke kapërcyer fruthin, edhe ky e ka kaluar patriotizmin, i ka kapërcyer fakultetet e patriotizmit edhe këtë punë e ka bërë në vitin 1999, që 12 vjet tash e ka lënë patriotizmin, është biznesmen.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Po mundohem t'i them disa fjalë në të mirë të aprovimit të kësaj strategjie. S'do mëndë që shoqëria jonë pas disa vitesh, projekte të rëndësishme të infrastrukturës së rrugëve, në përgjegjësi të zhvillimit ekonomik, ka pasur edhe sjellje të pakontrolluara të njerëzve në disfavor të natyrës.

Në anën tjetër, e dimë të gjithë sa është e rëndësishme natyra, të gjitha llojet e bimëve dhe shtazëve në të mirë të jetës normale të njeriut. Është koha e fundit pra që të kemi një strategji e cila është në favor ose është pas aprovimit të disa ligjeve që kanë të bëjnë me natyrën në përgjithësi dhe kjo strategji, zoti ministër, i hap rrugën Ministrisë suaj edhe juve personalisht që t'i koordinoni të gjitha këto kapacitete institucionale në të mirë të mbrojtjes së natyrës në përgjithësi. E dimë që ka devijime aty-këtu, por fjala është vetëm për një koordinim më të mirë të institucioneve përkatëse dhe shfrytëzimi i kapaciteteve ekzistuese në të mirë të ruajtjes së natyrës në përgjithësi. Ia vlen për ta përshëndetur dhe për ta falënderuar Komisionin Evropian dhe projektet e saj që ju kanë ndihmuar për ta bërë këtë strategji dhe për të angazhuar ekspertë në këtë drejtim. Asgjë tjetër nuk na mbetet, vetëm edhe ne deputetët edhe institucionet në terren, dhe sidomos një bashkëpunim më i mirë i komunave me ministrinë përkatëse dhe agjencitë

përkatëse, në të mirë të implementimit të kësaj strategjie implementimi i të cilës do t'i gëzoheshin qytetarët e Kosovës.

Zonja Flora i përmendi edhe listën e ambienteve dhe territoreve. Unë mendoj që kjo strategji po besoj se nuk është e mbyllur. Në rrugë e sipër ju do të mund të evidenconi edhe ndonjë bimë ose ndonjë vend –territor ku do të mund të ishte në listën e mbrojtur. Ju faleminderit!

KRYESUESI: A e deshe fjalën ministër?
Ministri e ka kërkuar fjalën.

MINISTRI DARDAN GASHI: Ju faleminderit, zoti kryesues!
Po e nisim me ma të lehtë. Sa i përket listës, lista nuk është përfundimtare në esencën nuk është e mbyllur. Ne jemi edhe ashtu në diskutim me Akademinë e Shkencave të Republikës së Kosovës, që në mënyrë të përbashkët të bëjmë një inventar të përgjithshëm të biodiversitetit, do të thotë të Republikës së Kosovës.

Sa i përket deputetit Konjufca, i cili u referua në problemin në Ferronikel dhe në disa lokacione tjera, me sa e di unë sot ka filluar gjykimi ndaj Ferronikelit si pasojë e padisë që e ka bërë Qeveria ose Ministria e Mjedisit. Po ashtu sa i përket termocentralit, në marrëveshje me menaxhmentin e Korporatës Energjetike të Kosovës, është arritur që deri në mars të vitit të ardhshëm Termocentrali “Kosova A” të pajiset me të gjithë filtrat e nevojshëm ose të ndërpritet puna, do të thotë, ata janë zotuar dhe kanë nënshkruar në ndërkohë një kontratë me një kompani të huaj e cila do ta pajisë këtë termocentral deri në mars të vitit të ardhshëm, pra me filtrat e nevojshëm. Do të thotë politika e Qeverisë nuk është ashtu siç u tha, që të lejojë shkatërrim dhe të promovojë shkatërrimin, mirëpo që të tentojë të balancoj mes zhvillimit ekonomik dhe ruajtjes së ambientit dhe jo, do të thotë që sponsorizimi i shkatërrimit në asnjë rast. Do të shihni edhe masa tjera sidomos ndaj operatorëve të gurëthyesve dhe të eksploatorëve të lumenjve. Në të ardhmen sigurisht masat besoj, se do t’ju pëlqejnë.

Sa i përket buxhetit për strategjinë e biodiversitetit, është e vërtetë se Qeveria e Kosovës nuk ka buxhet të mjaftueshëm për implementimin e përgjithshëm të kësaj strategjie, mirëpo një prej arsyeve që ne e kemi dërguar sot në Kuvend këtë strategji, është edhe premtimi që i kemi nga donatorët të cilët kanë kërkuar që kjo strategji t’i kalojë të gjitha fazat për miratimin në Qeveri, miratimit në Kuvend, në mënyrë që të jemi në situatë në pozicion që të kërkojmë asistencë financiare nga bashkësia ndërkombëtare. Ju faleminderit!

KRESUSEI: Ju faleminderit!
Deputeti Shaip Muja e ka kërkuar fjalën.

SHAIP MUJA: I nderuar kryesues,
I nderuar ministër,
Të nderuar deputetë,

Kjo temë është jashtëzakonisht e rëndësishme për t'u trajtuar dhe kërkon aprovim, mirëpo në mënyrë permanente kërkon edhe monitorim të implementimit të politikave dhe strategjive, të cilat janë sfida për Republikën e Kosovës që të jetë pjesë e Bashkimit Evropian, por mbi të gjitha është nevojë për zhvillimin ekonomik dhe shëndetin e popullatës.

Ne kemi ngritur disa herë shqetësimet lidhur me Ferronikelin, i cili është një dëmtues i ekosistemit në përgjithësi dhe dënimet juridike që do bëhen në Ferronikel mendoj që do të jenë minimale, nëse nuk organizohen grupe, të cilat i kam ngritur si shqetësime edhe më parë, edhe para të gjitha grupeve politike, të cilat janë këtu në Parlament, edhe në prezencë të menaxhmentit të Ferronikelit që ne nuk jemi për ta ndaluar prodhimin e Ferronikelit, por jemi që ai t'i respektojë rregullat e mbrojtjes së ambientit, tokës, ujit dhe ajrit. Ato që të tri elementet nuk janë dhe në atë tokë, ujë dhe ajër jeton një popullatë.

Mandej, problemi tjetër, i cili është dëmtimi i lumenjve. Dje, edhe zoti Xhavit Haliti e ngriti problemin e burimit të Drinit. Ne, nëse e analizoni, nuk ka nevojë studim të madh. Deri tek hidrocentrali uji vjen shumë mirë, pas hidrocentralit që është aktivizuar për interesa ekonomike, që ne nuk jemi prapë kundër atij investimi, është shkaktuar një shkretëtirë, e cila nuk mbahet mend nga ajo pjesë e popullatës.

Prandaj, përfitimet individuale ekonomike, ne popullatës edhe kolektivit, i cili është pjesë e atij diversitetit, e asaj ekonomisë së zhvillimit dhe qëndrueshmërisë në atë mes, është sot për t'u tërhequr. Janë elemente tjerë të shfrytëzimit, pa kriterë të gurëthyesve, edhe të mihjes sipërfaqësore, cila është që u bisedua pak më parë, e cila duhet të jetë në planin strategjik se sa do të sjell edhe dëmtime nga lëvizjet tektonike të tokës.

Sot, Kosova edhe qendrën sizmike nuk e ka në atë nivel, i cili mund t'i parasheh edhe nivelet e shpërthimeve, le që dëmtimet që i bëjnë ambientit. Ka shumë fshatra, të cilat ju i keni ankesat nga gurëthyesit, duke filluar në tërë Kosovën, ku janë dëmtimet jashtëzakonisht të vështira.

Ndërrimi i shtretërve të lumenjve, të cilat janë duke u bërë, kanë asgjësuar komplet gjallesat në ata lumenj dhe përveç se nuk lejojnë një qëndrim normal tash të rrjedhjes së ujit, ata rrezikojnë edhe vendbanimet përreth, duke krijuar laguna dhe duke krijuar rrezikshmëri të rrëshqitjeve të dheut.

Prandaj, ne i kuptojmë vështirësitë e Ministrisë së Ambientit dhe mendoj që Ministria e Ambientit të ngritë kapacitete, të kërkojë kapacitete plotësuese, fillimisht në kuadër të Kosovës, sepse në Kosovë nuk janë duke u shfrytëzuar gjitha kapacitetet, jo të dilet, është një vërejtje shoqërore, të dilet vetëm nga jashtë të thirren, sepse ata që do vijnë nga jashtë, mund të jenë të specializuar, por nganjëherë vijnë edhe me lajthitje për interesa të ndryshme.

Vendorëve duhet t'u jepen mundësitë të hulumtimeve, të analizave, të konkludimeve dhe të përgjegjësi. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Nënkryetari Hamiti e ka kërkuar fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë dua shkurt të theksoj që Shtojca 7, Llojet bimore, që konsiderohen të rralla dhe të kërcënuara nga aktivitetet e njeriut në Kosovë, duhet të kihet veçanërisht parasysh.

Këtu e kujtoj dhe e përkrah kolegen e moçme, Flora Brovinën, e cila e ritheksoi problemin e bozhurit, është një lule e veçantë që e karakterizon Kosovën edhe në kuptimin e biodiversitetit dhe ta quaj unë kulturor-mitologjik, e cila është e rrezikuar dhe duhet të mbrohet. Natyrisht që Flora që e ka emrin “florë”, që i bie “lule”, kujtohet më mirë se të gjithë për këtë problematikë dhe unë e plotësoj edhe njëherë me problemin e Bathrës “Narcissus poetikus”, që i bie “lulja e xhenetit” që i themi ne këtu. Nuk e di, pse Bathra, se nuk e ka emrin bash bathër.

Pra, edhe “Sanza e Verdhë” që lidhet me “Gentiana lutea”, që është edhe si origjinë dhe si emër karakteristik i vendit. Çfarë dua të them? Dua të them që dhe bimët kanë një kulturë dhe një histori dhe është mirë që edhe në këtë kuptim të trajtohen problemet e vendit, sepse kultura lidhet me përbërje të tokës, me bimësitë, që gjitha janë të lidhura dhe në këtë rast, këto tri elemente që unë i përmenda, një emër bashkë me Florën, janë të rëndësishme dhe duhet të kihet parasysh. Dhe unë po përfundoj. Ju e dini, që një hotel këtu, kryesori në Prishtinë e ka pas emrin “Bozhur”. Duke mos e pas ditur njerëzit çka është “Bozhur”, duke pas menduar që është e marrë prej dikujt, edhe emrin ia kanë ndërruar. Jo! “Bozhur” është në kuptimin e bimëve, identitet i Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Faleminderit! Tani nuk do mend, mendoj t’i jap të drejtë dhe vetes të flas, që nuk është vështirë të dimë se çfarë duhet të bëjmë për mbrojtjen e lumenjve, çfarë duhet të bëjmë për mbrojtjen e zonave turistike të Kosovës, të cilat po shkatërrohen, siç u përmend, pyjet me zonat më të bukura të Bjeshkëve të Nemuna. Dhe, për këtë nuk është e vështirë në qoftë se pushteti dhe ligji respektohet dhe zbatohet në të gjitha nivelet.

Çka dua të them?! Në qoftë, se duam t’i mbrojmë lumenjtë, ne duhet që buzë lumenjve, ku ata qarkullojnë përmes fshatrave, duhet të ndërtojmë kanalizimet që ujërat e zeza mos të derdhen në lumenj. Mbetjet helmuese nga pastrimet tani që po përdoren, edhe ato duhet të kanalizohen dhe të derdhen jashtë lumenjve, për t’i ruajtur peshqit, bimët, etj.

Duhet të ndalohet ndërtimi i lokaleve në zonat turistike, të cilat ndikojnë në prishjen e biosistemit, në prishjen e shtretërve të lumenjve dhe në prishjen e ekosistemit në përgjithësi dhe të rregullohet, të paktën në këtë aspekt, në këtë fushë mund t’i përafrohemi standardeve dhe mund të ndërtohen impiantet të cilat e pastrojnë ujin. Në qoftë se ndërtimet private sot po kanë mundësi që të pastrojnë ujërat e zeza për interesa ekonomike të përfuturit edhe personal, atëherë edhe këto hotele, edhe këto lokale që po ndërtohen buzë lumenjve, kanë mundësi që ta bëjnë këtë, bile do ta kursenin edhe ujin dhe do ta përdornin për pastrim.

Në qoftë se zonat turistike mbrohen me ligj dhe jo të shkatërrohen, siç ka ndodhur, e përmenda edhe dje, burimi i Drinit dhe, fatkeqësisht, me donacion të USAID-it, të cilin e

ka keqpërdorë kuvendi komunal i Pejës, do të ishte mirë të shohim se çfarë mund të bëjmë.

Pyjet nuk është vështirë që të ruhen, sepse janë ruajtur historikisht dhe të gjithë ata që i kanë ruajtur dhe kanë organizuar ruajtjen e pyjeve, e dinë si ruhen pyjet. Por, problemi është që ata që paguhën t'i ruajnë pyjet, janë shkatërruesit më të mëdhenj, sepse bashkëpunojnë me ata që i presin pyjet dhe s'japin llogari askund. Pra, këtu duhet për të gjitha këto çështje të veprojë fuqia e ligjit ose në demokraci që i thonë "diktatura e ligjit" për t'i mbrojtur të gjitha këto dhe, në fund, për ta mbrojtur njeriun, se përmes mbrojtjes së bimësisë, lumenjve dhe pyjeve të Kosovës, ne e mbrojmë jetën e njerëzve tonë, e mbrojmë shëndetin e njerëzve tonë dhe i mbrojmë të drejtat e qytetarëve ose domosdoshmërinë që t'ju bëjmë një jetë më të mirë dhe më të shëndetshme. Kjo është detyrë e jona, e të gjithëve që jemi këtu dhe atyre që paguhën për ta bërë këtë. Faleminderit!

Nuk ka tjerë të paraqitur. Në sallë janë 61 deputetë. Ministri e ka kërkuar edhe njëherë fjalën, si përfundim.

DARDAN GASHI: Faleminderit kryesues! Desha vetëm, si të them, t'ju falënderoj shumë, se nuk kam pritur që debati rreth strategjisë të biodiversitetit të zgjatë afër 1 orë. Kam menduar se do të jetë një akt formal që do të kalojë në Kuvend pa u vërejtur, kështu që jam shumë i lumtur që një temë e tillë është debatuar kaq gjatë.

Shpresoj, po ashtu, që interesi juaj të reflektohet edhe në buxhetin që do t'i jepni ministrisë, vitin e ardhshëm, që të gjitha këto aktivitete të mund t'i mbulojmë disa prej tyre. Ju falënderoj, edhe njëherë për interesin!

KRYESUESI: Zoti ministër, ju kisha ftuar edhe juve që t'i vizitoni qendrat që duhet ndërhyrë me buxhet, t'i bëni projektet dhe ne, besoj, jemi të gatshëm që të votojmë buxhetin e propozuar. Deputeti Sadriu, ka kërkuar fjalën.

ALI SADRIU: E di që psiqikisht deputetët këtu presin që kjo pikë të kalojë, se edhe ministri tha është e gjatë. Unë mendoj se koha ka qenë e shkurtër për një temë të tillë dhe ka shumëçka që të bisedohet. Po e marr dy elemente në regjionin e Shtimes dhe të Lipjanit. Sitnica është lumi, nuk është më i gjati në Kosovë, por përafërsisht është lumi kryesor që e përshkon Kosovën.

Ai i është nënshtruar një mbyetjeje shumë të ashpër. Me buxhetin e Kosovës komuna e Shtimes krejt implementin e ka të derdhur në lum, pa asnjë piement, pa asnjë kurrgjë. Dhe ajo është në zanafillë, do të thotë, në burim, atje. Krejt Sitnica përbën dhe sot ne e kemi një gjendje vërtet të mjerueshme në atë pjesë.

Për më keq, në ndalje të Lipjanit, shtrati i lumit Sitnica ndërtohet prej mbeturinave dhe jo pak, po shumë i gjatë. Paramendojeni, pasojat që do të ketë Sitnica nga ai shtrat që është ndërtuar. Sepse, ato mbeturina do të prodhojnë acide dhe elemente tjera që janë shumë të dëmshme për njeriun.

Do të thotë, sa qeveritë në të kaluarën kanë menduar në këtë drejtim, mendoj se ju si ministër duhet t'i hulumtoni këto dhe t'i keni parasysh. Koha ka qenë e shkurtër, është dashur më shumë të bisedohet për këtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Në sallë janë 61 deputetë. Pra, po futemi në votim për të votuar Propozim-strategjinë dhe Planin e veprimit për biodiversitetin 2011- 2020.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Konstatohet, se me 58 vota “për”, 1 abstenim, asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi Strategjinë dhe Planin e veprimit për biodiversitetin 2011-2020, me vërejtjet e Qeverisë, përkatësisht të Ministrisë për Financa.

Vazhdojmë me pikën e 16-të të rendit të ditës, që është:

16. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Avokatit të Popullit, për vitin 2010

Komisioni Funkcional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione ka shqyrtuar Raportin vjetor të Avokatit të Popullit, për vitin 2010, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Raportin vjetor financiar të Avokatit të Popullit, për vitin 2010, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Ftoj, sipas rregullit, Avokatin e Popullit, në qoftë se është këtu, që ta marrë fjalën, ta prezantojë Raportin e Avokatit të Popullit, zoti Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: I nderuari kryesues,
Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,
Bazuar në nenin 135, paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 27, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, ju paraqes Raportin e 10 – të vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës, që përfshinë periudhën 1 janar-31 dhjetor 2010.

Njëkohësisht, ju falënderoj për mundësinë e ofruar, për paraqitjen e Raportit vjetor, i cili është obligim kushtetues reciprok i Avokatit të Popullit dhe i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në Republikën e Kosovës paraqesin bazën e rendit juridik të saj. Mishërimi normativ i të drejtave dhe i lirive themelore të njeriut dhe ngritja e tyre në kategori kushtetuese, si dhe funksionalizimi ligjor dhe teknik i institucioneve garantuese dhe mbrojtëse të drejtave të njeriut, e dëshmojnë këtë katërçipërisht.

Republika e Kosovës vazhdon të ballafaqohet me dy kundërshti që përbëjnë realitetin që e shohim dhe e prekim të gjithë ne - kërkesat e mëdha dhe mundësitë e vogla. Gjetja e baraspeshës politike, gjegjësisht e baraspeshës midis kërkesave dhe mundësive shoqërore është pikërisht qëllimi i organizimit dhe i veprimit të shtetit.

Sfidat kryesore më të mëdha që vazhdojnë të lëkundin themelet e baraspeshës politike në Republikën e Kosovës, janë: shteti ligjor, ai social dhe siguria fizike. Ndonëse Republika e Kosovës tashmë ka krijuar një traditë modeste në angazhimin e mekanizmave ligjor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut nga çfarëdo aspekti dhe segmenti shkelës, qytetarët e saj të cilët në të kaluarën janë ballafaquar me masat më të egra shtypëse, individualisht dhe kolektivisht, ndonëse në forma të tjera dhe jo me po atë brutalitet të dhunës fizike, edhe sot e kësaj dite përballen me shkeljet nga më të ndryshme të lirive dhe të drejtave të tyre.

Fokusi i misionit të Avokatit të Popullit është mbrojtja e të drejtave të njeriut, pikërisht kur këto shkelje janë pasojë e veprimeve aktive të paligjshme apo të pamjaftueshmërisë së angazhimit të institucioneve publike në zbatimin e ligjeve. Pasqyrimi i mbrojtjes, mbikëqyrjes dhe promovimit të drejtave dhe lirive të qytetarëve të Republikës së Kosovës nëpërmjet mekanizmave veprues-ligjor, i sublimuar në veprimtarinë e përcaktuar kushtetuese dhe ligjore, është Raporti vjetor tash i 10-ti me radhë, të cilin Avokati i Popullit po e paraqet para jush.

Rastet e shkeljeve të drejtave dhe lirive të njeriut nga institucionet publike në Republikën e Kosovës, as gjatë kësaj periudhe raportuese nuk kanë rezultuar me ndonjë zvogëlim të numrit që do të duhej theksuar, ashtu siç ka mbetur e njëjtë natyra e shkeljeve. Ndërkaq, zgjidhja e tyre vazhdon të jetë e koklavitur, shpeshherë e pamundshme, qoftë për shkak të shpërfilljes së kërkesave dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit, qoftë për shkak të zvarritjes për zgjidhjen e problemeve.

Raporti i 10-të vjetor i Avokatit të Popullit, sikurse edhe raportet e mëparshme, duke qenë dokument zyrtar, paraqet në mënyrën më të përafërt gjendjen reale të të drejtave dhe lirive të njeriut, përkatësisht anën e pakëndshme të realizimit të tyre. Njëkohësisht, ky raport shpërfaq edhe përpjekjet dhe angazhimet e Avokatit të Popullit për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe për promovimin e tyre, në anën tjetër.

Në Institucionin e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2010 janë paraqitur 1233 raste që janë proceduar. Numri më i madh prej tyre janë ankesa kundër gjyqësorit, në të gjitha nivelet. Ankesat kanë të bëjnë me zvarritjen e proceseve gjyqësore ose vonimin e drejtësisë, moszbatimin e vendimeve të plotfuqishme të gjykatave të rregullta ose pafuqishmërinë e shtetit për të vënë drejtësinë në vend apo edhe vendimet e padrejta me elementet e korrupsionit dhe falsifikimeve, që nënkupton padrejtësi nga ata që pritet të vënë drejtësinë në vend. Të gjitha këto emërohen shkurt e qartë - mohim i drejtësisë.

Kurse, në pjesën veriore të Mitrovicës, si dhe në komunat Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan as nuk ka, e as nuk ndahet drejtësia ligjore. Republika e Kosovës nuk ushtron pushtetin në këtë pjesë të territorit të vet, prandaj edhe nuk mund të mbahet përgjegjëse

për këtë pjesë. Megjithëse, Avokatit të Popullit me ankesa i drejtohen edhe qytetarët e këtyre komunave përmes zyrës së institucionit në këtë pjesë.

Një pjesë tjetër e madhe e ankesave të qytetarëve kanë të bëjnë me moszbatimin e vendimeve të plotfuqishme të institucioneve të pavarura shtetërore nga vetë institucionet shtetërore apo edhe vendimet e paligjshme të institucioneve shtetërore.

Gjithashtu, nga analiza e vendimeve dhe akteve të tjera gjyqësore, si dhe të institucioneve të tjera shtetërore, të cilat i ofrohen si dëshmi Avokatit të Popullit, vërehen lëshime e mangësi, shkelje e padrejtësi të natyrës materiale dhe procedurale. Ndërkaq, Avokati i Popullit nuk ndërhyr në punën e gjyqësorit në asnjë fazë të zhvillimit të procedurës, as në marrjen e vendimeve dhe as në interpretimin apo ndryshimin e vendimeve gjyqësore.

Një dukuri negative e cila vazhdon të lëshojë rrënjë në Republikën e Kosovës, është humbja e besimit në zbatimin e ligjit. Në këtë dritë, humbja e besimit në zbatimin e ligjit vë Avokatin e Popullit në pozicionin drejt të cilit, po e theksoj, gabimisht shtrohen kërkesa për t'u angazhuar më tepër në vënien e drejtësisë në vend. Rrjedhimisht, edhe presioni mbi Avokatin e Popullit është në rritje dhe vjen nga të gjitha anët, nga individët, nga politika, nga grupet e ndryshme të interesit, nga shoqëria civile dhe nga mediat. Disa e kanë nga halli i madh, të tjerët kanë synime politike, disa e bëjnë të shtyrë nga interesi material, disa duan të shtyjnë përpara agjendën e tyre, kurse të tjerët duan thjeshtë të kenë ndikimin e tyre mbi Institucionin e Avokatit të Popullit. Pothuajse, të gjithë harrojnë qëllimshëm ose jo, se Avokati i Popullit është institucion i pavarur Kushtetues, me mision dhe kompetenca të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj. Agjenda, veprimet dhe vendimet e Avokatit të Popullit janë të pavarura dhe të tilla do të mbeten, përderisa Kushtetuta dhe ligji e përcaktojnë kështu.

Avokati i Popullit nuk ndan drejtësi, por do të vazhdojë të evidentojë dhe të nxjerrë në pah veprimet apo mosveprimet e parregullta e të paligjshme të autoriteteve publike, pikërisht për të luajtur rolin që ka në ndërtimin e një shoqërie të bazuar në parimin se askush nuk është mbi ligjin.

Nëse shteti shkel mbi parimet e drejtësisë ligjore, ka prekur në besimin e domosdoshëm për funksionimin e një shoqërie demokratike. Prandaj, humbja e besimit në shtetin prish shtyllat mbajtëse të funksionimit të baraspeshuar e të bazuar në drejtësi për të gjithë. Kjo nuk duhet të ndodh. Barazim para ligjit duhet ta sigurojnë dhe ta garantojnë në radhë të parë mekanizmat shtetëror.

Të nderuar deputetë,

Pavarësisht përballjeve të shumta dhe të ndryshme, pavarësisht ngecjeve dhe vështirësive, pavarësisht situatave nganjëherë të pakëndshme, në të cilat janë gjendur për shkak të ndjeshmërisë së rasteve dhe krijimit të raporteve ndërmjet qytetarit që ka konsideruar se i është shkelur akëcila e drejtë ligjore dhe institucionit që është supozuar që ka bërë shkeljen, Avokati i Popullit dhe bashkëpunëtorët e tij kanë arritur të përmbushin misionin e tyre themelor, të mbrojnë edhe më me sukses të drejtat e njeriut duke shtuar efikasitetin e punës së tyre.

Në këtë dritë, gjatë kësaj periudhe raportuese, në krahasim me periudhën e kaluar raportuese, ka pasur një ngritje prej mbi 10% të numrit të rasteve të zgjidhura, sipas kërkesave të ankuesëve d.m.th pozitivisht.

Kjo ngritje pos si rezultat i efikasitetit, është edhe rezultat i cilësisë së dëshmuar në punë. Parimet, kriteret dhe aspektet kryesore për hartimin e ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ia vazhdoni edhe 2 minuta!

SAMI KURTESHI: Parimet, kriteret dhe aspektet kryesore për hartimin e këtij raporti, qëndrojnë në shpërfaqjen e punës 1 vjeçare të Avokatit të Popullit, përfshirë: të gjitha hallkat vepruese të tij dhe të paraqitura sipas një radhitje logjike, të bazuar në misionin kushtetues të Avokatit të Popullit.

Mbrojtja, mbikëqyrja dhe promovimi i të drejtave dhe lirive të njeriut. Avokati i Popullit duke qenë një mbikëqyrës i zbatimit kushtetues dhe ligjor i të drejtave dhe lirive të qytetarëve të Republikës së Kosovës, njëkohësisht është edhe një ndriçues i rasteve, kur qytetarët privohen nga ndonjë e drejtë e tyre, si dhe qortues i institucioneve publike, kur ato shprehen mospërfillëse në zbatimin kushtetues dhe ligjor të drejtave dhe lirive të tyre.

Ky është njëri prej postulateve kryesore që shpërfaq ky raport me një synim sublim - paraqitjen reale të gjendjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë dhe kahet e zhvillimeve të kësaj gjendjeje.

Zoti kryesues,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Duke mbetur në dispozicionin tuaj për sqarimet e domosdoshme, në qoftë se më jepet fjala, ju falënderoj për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kurteshi! Sipas, Rregullores, fjalën e ka kryetarja e komisionit funksional deputetja Suzan Novobërdaliu, për arsyetimin e raportit me rekomandime. Zoti Ali Sadriu, e kërkuar fjalën, por pak mbas deklaramentit të saj, nuk e dita për çka e keni fjalën! Jam plotësisht dakord me vërejtjen që e keni. Vazhdoni!

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryesues!

Komisioni për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, në takimin e mbajtur më datën 13 shtator, e ka shqyrtuar Raportin e Avokatit të Popullit.

Në këtë takim ka qenë i ftuar dhe ka prezantuar edhe Avokati i Popullit, zoti Sami Kurteshi. Pas shqyrtimit të raportit, komisioni ka konkluduar se i njëjti voluminoz, gjithëpërfshirës, pasqyron shumë çështje dhe probleme të cilat kanë ngelur të pazgjidhura. Të njëjtin e ka përkrahur, propozojmë që i njëjti të përkrahet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sadriu, e keni fjalën!

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë, realisht, desha ta ndihmoj procedurën e mënyrës së kalimit të kësaj pike. Ju, siç e dini, kemi pasur në shqyrtim një raport të Avokatit të Popullit. Një raport, të cilin e ka audituar një grup i profesionistëve, nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm dhe atje janë gjetur shumë të gjetura, të cilat janë konstatuar edhe në Komision për Mbikëqyrje të Financave Publike, por janë konstatuar edhe këtu në Kuvend dhe Kuvendi ka marrë vendim që të kërkojë nga Zyra e Avokatit të Popullit, gjegjësisht menaxhmentit të atij institucioni që të reflektojë në ato të gjetura dhe brenda periudhës të caktuar ta njoftojë Kuvendin përmes këtij komisioni për mënyrën dhe sqarimet që kemi nevojë t'i dimë pse kanë ndodhur ato të gjetura.

Unë mendoj se Institucioni i Avokatit të Popullit është një institucion jashtë çdo rregulli, në kuptimin që duhet ta përkrahim të gjithë dhe në atë kontest është shumë keq kur vërehen aty parregullsi, më shumë se kudo tjetër. Për më tepër, aty është një parregullsi që komisionin e ka bërë të mendojë shumë, sepse ankesat kryesisht vijnë nga menaxhmenti për mungesën e përvojës edhe profesionalizmit të njerëzve që ka aty për t'u rrekur me problemet dhe ballafaqimet e shumta dhe nevojave të shumta të qytetarëve të Kosovës.

Në anën tjetër, Zyra e Auditorit Gjeneral ka pasur një donacion qysh në vitin 2005 dhe atë donacion nuk e ka shfrytëzuar. Donacioni ka qenë i dedikuar për trajnim dhe aftësim profesional të kuadrove, mos të flas edhe për tjera.

Nuk dua t'i zbeh këto që janë arritur. Më vjen mirë nëse qëndrojnë ato çfarë i prezantoi Avokati, por unë mendoj se kjo zyrë ka një përgjegjësi dhe ka një obligim në veçanti në momentin ku gjinden të drejtat e njeriut dhe të drejtat e qytetarëve sot në Kosovë, që shkelen në mungesë të stabilitetit të institucioneve, meqë kanë qenë në fillim etj., etj., dhe ligjeve përkatëse që e përcjellin atë. Mendoj se kjo fushë është shumë e gjerë dhe nevojat janë tepër të mëdha, nuk kam nevojë kurrkujt t'i sqaroj, sepse çdo njëri i gjen në vetvete, në të afërm apo në qytetarë me të cilët kanë kontakt. Pra, kjo zyrë për mu ka një mal punë që është dashur të bëjë dhe, realisht, sipas prizmit buxhetor vërehet se nuk është bërë aq sa duhet.

Në veçanti është tepër prekëse mënyra se si është menaxhuar edhe pjesa tjetër e buxhetit, edhe me prokurim, edhe me format tjera, e kemi parë atë, një individ deri në 5 telefona celularë. 5 telefona celularë i blen prej buxhetit të Kosovës, çka është ndërmarrë aty? Ai personi i dytë ka qenë. Ka shumë e shumëçka që në këtë zyrë mendoj se nuk është dhënë dhe nuk po jepet ajo që kanë nevojë dhe nevojat janë të shumta, thashë, të qytetarëve të Kosovës. Faleminderit! Kjo ishte, pra, Edhe më herët unë kam thënë dhe kam bërë apel tek të gjithë tjerët, raportet vjetore duhet të vijnë pasi të shqyrtohen raportet e audituara, sepse ajo është... Asnjë institucion, asnjë individ për çdo vepër që e bën, nuk e ka mungesën e një arsytimi.

Ajo është e natyrshme, natyra e njeriut edhe për mua, edhe për çdonjërin është. Por, është shumë më reale ajo kur e bën vlerësimin një i dytë, i tretë, i paanshëm profesional për një sferë. Dhe po t'i bashkëngjitet ajo pjesë këtij raporti, raporti del edhe më komplet. Ta marrim kështu, na duhet të... Ta marrim atë formën tjetër, do të vërejmë se ka shumë lëshime.

Unë mendoj se edhe në emër të grupit parlamentar, menjëherë po e shprehi, raporti është dashur të shtyhet dhe ta shqyrtojmë mbasi t'i marrim përgjigjet për të cilën e kemi ngarkuar dhe kemi nxjerrë një vendim, si Kuvend. Ne jemi në pritje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit zoti kryesues!

Unë e dëgjova me kujdes kryetarin e Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike. Është mirë që para se të fillohet me debate i dha disa sqarime në lidhje me Raportin e auditorit.

Disa herë është ngritur nga kryetari i Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike që krahas raporteve të shqyrtohen edhe Raporti i auditimit. Do të ishte mirë që të kemi edhe Raportin e auditimit, të bashkëngjitur çdo raporti që na vjen për t'u shqyrtuar në komision, mirëpo raportimi i institucioneve në përgjithësi në Kosovë, është rregulluar me ligjet përkatëse të atyre institucioneve dhe këto institucione i sjellin raportet, dikush në muajin mars, dikush në prill, dikush në qershor, e ku ta di unë si e kanë të paraparë me ligjet e tyre. Për të pasur mundësinë për t'i shqyrtuar ne raportet bashkërisht me Raportin e auditorit, atëherë auditori duhet t'i përshtatet agjendës së raportimit të këtyre institucioneve. Kur raporti të vijë në Kuvend, ne të kemi njëkohësisht edhe Raportin e auditimit. Nëse auditori nuk i përshtatet e agjendës së auditimit në agjendën e raportimit, atëherë është e pamundur të shqyrtohen raporte të tilla. Sepse, nëse një raport na vjen të shqyrtohet në muajin prill dhe Raporti i auditimit mbërrin diku në muajin shtator, atëherë është shumë e pakuptimtë që të mbetet raporti deri atëherë i pashqyrtuar. Secili raport e ka natyrën e raportimit të vet. P.sh. Raporti financiar, që e paraqesin agjencionet e caktuara apo institucionet e caktuara, e paraqet rrjedhën e shpenzimit të mjeteve. d.m.th. sa është planifikuar, sa është shpenzuar, sa është përqindja e atij shpenzimi dhe a ka bërë ndonjë shpenzim ndryshe nga ajo që është planifikuar? Kurse, Raporti i auditimit e paraqet efektshmërinë e shpenzimit të mjeteve d.m.th. sa mjete janë shpenzuar me efikasitet dhe me efektivitet. Prandaj, këto raporte ndryshojnë njëra me tjetrën, fundi i fundit, deputetët e Kuvendit duhet të vlerësojnë vetë. Atëherë, po përqendrohemi në Raportin vjetor financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Siç, e tha edhe Avokati i Popullit, me nenin 135, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe nenit 27 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 03/L195 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i paraqet Raport vjetor të punës Kuvendit, ku pjesë e këtij raporti duhet të jetë edhe Raporti financiar.

Avokati i Popullit i ka dorëzuar Kuvendit Raportin vjetor dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Raportin financiar në mbledhjen e mbajtur më 6 shtator 2010, dhe ka kërkuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit dorëzimin e raportit shtesë të shpenzimeve dhe të buxhetit për vitin 2010, i cili i është bashkangjitur këtij rekomandimi të komisionit.

Institucionit të Avokatit të Popullit në fillim të vitit i është ndarë një buxhet me vlerë prej 523.735 euro, kurse janë shpenzuar 474.417 euro. 38.213 euro kanë mbetur të pashfrytëzuara, kurse 10.105 euro, sipas Ligjit të buxhetit, neni 4, paragrafi 3, janë tërhequr nga Ministria e Financave për shkak të mos shfrytëzimit të mjeteve nga Institucioni i Avokatit të Popullit, në fund të vitit.

Të dhënat e faqes së parë të raportit shtesë, ku jepet sqarimi për buxhetin e ndarë në fillim të vitit dhe buxhetit final, bie në kundërshtim me të dhënat në pjesën 7, - Harmonizimi i ndarjeve fillestare dhe finale, ku jepet sqarim se pse ka ndodhur dallimi në mes të ndarjeve fillestare dhe ndarjeve finale dhe pse janë tërhequr mjetet nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave?

Në raportet financiare flasin shifrat dhe nuk është mirë të jepen vlerësime të pabazuara. Po ashtu, sqarimet që janë dhënë në faqen 4 të raportit, kur flitet për financimin e Institucionit të Avokatit të Popullit nga donatorët, në vitin 2010 nuk janë të sqaruara si duhet dhe bien në kontradiktë me të dhënat nga Raporti financiar në pjesën 5, shënimi 3, - Grandet e përcaktuara të donatorëve.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka qenë i interesuar dhe i ka bërë një varg pyetjesh Avokatit të Popullit në lidhje me çështje të caktuara, të cilat kanë qenë shqetësim i anëtarëve të komisionit dhe nga Avokati i Popullit janë dhënë sqarime të cilat kanë qenë në fokus të interesimit të anëtarëve të komisionit, kështu që komisioni njëzëri e ka miratuar Raportin vjetor për vitin 2010 të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Po ashtu, Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon Institucionit të Avokatit të Popullit që të jetë më aktiv dhe të bëjë më shumë në forcimin e kapaciteteve njerëzore që merren me planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit. Një rekomandim i tillë po përforcohet edhe më shumë nga të gjeturat të cilat kanë ndodhur në Raportin e auditimit të auditorit të përgjithshëm, të cilat i theksoi pak më parë kryetari i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas Rregullores, fjalën e kanë kryetarët e grupeve parlamentare ose përfaqësuesit. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, fjalën e ka deputetja Justina Pula Shiroka.

JUSTINA PULA SHIROKA: I nderuari kryesues,
Deputetë,
Grupi Parlamentarë i PDK-së ka shqyrtuar dhe analizuar Raportin vjetor të punës së Avokatit të Popullit, për vitin 2010.

Raporti vjetor i Avokatit të Popullit është pasqyrim i gjendjes, por edhe i ndryshimeve në fushën e të drejtave të njeriut, në mbrojtjen dhe promovimin e tyre brenda periudhës, pra është rezultat i punës së vazhdueshme gjatë një periudhe.

Ky raport dallon nga ata të mëparshmit për nga çështjet e trajtuara, nismat e ndërmarra etj. Ndryshimet që karakterizojnë këtë raport janë të natyrës konceptuale dhe përfshijnë tema më të mëdha, si gjyqësori, diskriminimi etj.

Pra, thjeshtë mund të thuhet se ky raport është një analizë kritike e të gjitha çështjeve të drejtave të njeriut etj. Avokati i Popullit në raportin e tij shpreh pakënaqësinë për ligjvënësit kosovarë dhe autoritetet e tjera shtetërore të Kosovës. Sfida më e madhe mbetet nxjerrja dhe miratimi i ligjeve themelore që drejtpërsëdrejti prekin të drejtat e njeriut, të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, përfshirë këtu Ligjin për sigurimin invalidor dhe Ligjin për sigurimin shëndetësor.

Vështirësi e veçantë është nxjerrja me vonesë e akteve nënligjore që shpeshherë e kanë penguar zbatimin përkatës të ligjeve. Në këtë kontekst, Avokati paraqet edhe çështjen e mungesës së themelimit të Gjykatës Administrative, që do të përmirësonte situatën, pasi që ligji në fuqi është çështje e konflikteve administrative, është në kompetencë të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Raporti i 10-të me radhë përfshin periudhën 1 vjeçare dhe përkundër të metave, paraqet vazhdimësi të punës së Institutit të Avokatit të Popullit. Raporti ka disa mangësi sa i përket punës dhe aktiviteteve të Avokatit të Popullit, i cili vepron në shumë sfera, duke mos qenë kompetencë dhe përgjegjësi e tij. Ai për shumë raste që paraqiten ose gjatë hetimit prek apo hynë në kompetencat e gjyqësisë, që nuk është nën kompetencat e tij.

Kundër të gjeturave të tij, ankesat, kërkesat mbasin të pazgjidhura, sepse vendimet nuk ekzekutohen dhe nuk përcillen te autoritetet përkatëse. Gjithashtu, ai ka kritika ndaj institucioneve, autoriteteve tjera shtetërore të Kosovës, duke mos pasur argumente bazë për deklaratën e tij. Ky raport është në pajtim me nenin 27 të Ligjit për Avokatin e Popullit dhe ofron mjaftë të dhëna. Mirëpo, gjithashtu është konstatuar se raporti ka mangësi dhe shpresoj që gjatë diskutimeve do të identifikohen të metat, nga të cilat mund të nxjerrim rekomandime me qëllim të përmirësimit të punës në të ardhmen.

Grupi Parlamentar i PDK-së fton deputetët të miratojnë këtë raport. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratik të Kosovës, deputeti Ismet Beqiri. S’është! E tha Aliu, atëherë, në rregull.

Vazhdojmë me Grupin Parlamentar “Vetëvendosje”, deputetja Albana Gashi e ka fjalën.

ALBANA GASHI: Faleminderit, kryesues!

Lëvizja “Vetëvendosje” do të votojë për Raportin e Avokatit të Popullit dhe rekomandimet që kanë dal nga ky raport, mirëpo ne kemi disa vërejtje.

Tek liria e lëvizjes të komuniteteve pakicë, në pjesën ku pretendohet që pakica serbe dhe rome ndihen të rrezikuara për të lëvizë lirshëm në shumë pjesë të territorit të Kosovës, kjo nuk qëndron, meqë nuk ka argumente se pakica nuk është e lirë të lëvizë ose të paktën në raport nuk janë përmendur se ka pas raste të tilla.

Mënyra se si ndjehen pjesëtarët e një komuniteti dhe gjendja faktike duhet të trajtohen ndaras. Për më tepër, termi në “shumë pjesë të territorit të Kosovës” është shumë i përgjithshëm dhe nuk ofron informata konkrete. Pra, konsiderojmë që kjo vërejtje është e pabazuar dhe si e tillë duhet të eliminohet nga raporti.

Tek e drejta e punës dhe e ushtrimit të profesionit, te kjo pjesë nuk është cekur shkelja kryesore që po i bëhet Ligjit të punës, e që është mospërshtatja e orarit të punës sipas këtij ligji. Punëdhënësit, kryesisht bizneset private nuk përfillin Ligjin e punës, duke e shkelur të njëjtin në mënyrë flagrante, e i detyrojnë punëtorët që të punojnë më shumë orë se sa e parasheh ligji, e që janë gjithsej 40 orë në javë.

Tek aktivitetet e njësisë për barazi gjinore, përveç trajnimeve dhe seminareve e takimeve të ndryshme, nuk është cekur ndonjë masë konkrete që është marrë në këtë drejtim, ndonjë monitorim, kontroll apo edhe ndonjë hap tjetër për të ndërhyrë në rastet e shkeljeve apo të diskriminimit.

Bashkëpunimi me institucionet vendore. Në këtë pjesë përmenden takimet me institucione të ndryshme, por megjithatë nuk është cekur ndonjë rezultat konkret që ka realizuar si rrjedhojë e këtij bashkëpunimi, duke pas parasysh që në pjesët tjera të raportit ceket që shumë institucione nuk kanë implementuar rekomandimet e Institucionit të Avokatit të Popullit.

Bashkëpunimi do të duhej të rezultonte me ndonjë hap konkret për implementimin e rekomandimeve dhe diçka e tillë nuk haset në këtë raport. Dhe, në fund, janë vërejtjet e Avokatit të Popullit drejtuar institucioneve që edhe më tej mbesin shumë shqetësuese, e që janë: shpërfillja e kërkesave dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga institucionet shtetërore të nivelit qendror dhe atij lokal, moszbatimi i vendimeve të plotfuqishme të gjykatave të rregullta, mosfunksionimi i institucioneve në pjesën veriore të Kosovës, mohimi i drejtësisë ligjore në komunat e pjesës veriore të Kosovës, moszbatimi i vendimeve të institucioneve të pavarura shtetërore e sidomos Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës nga vetë institucionet shtetërore dhe komplikimi ndërinstitutional i zgjedhjes së problemeve, e që bën kështu të iket nga përgjegjësia. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja Kymete Bajraktari.

KYMETE BAJRAKTARI: Faleminderit, zoti kryesues!

Raporti vjetor i Avokatit të Popullit për vitin 2010 përfshin një pasqyrë të gjerë të gjendjes së lirive dhe të drejtave të qytetarëve në tërë territorin e Republikës së Kosovës që burojnë nga aktet më të larta juridike, si: Kushtetua e Republikës së Kosovës, ligjet e aplikueshme dhe konventat ndërkombëtare. Pastaj, tregon punën apo veprimet e Avokatit

të Popullit lidhur me kompetencën kushtetuese që i është dhënë këtij institucioni dhe rekomandimet e tij për autoritetet shtetërore lidhur me përmirësimin e sundimit të ligjit dhe të drejtës. Marrë nga përmbajtja, radhitja e çështjeve të ngritura në këtë raport përkon plotësisht me përmbajtjen e kapitullit II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Në raport mund të kuptohet se përkundër pothuaj kompletimit të legjislationit dhe një baze të avancuar të mirë normative, juridike, pozitive dhe ndërkombëtare, si mekanizëm mbrojtës të të drejtave dhe lirive të njeriut, autoritetet publike të Kosovës vazhdojnë të jenë neglizhente dhe mospërfillëse në zbatimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve që janë pasojë e moszbatimit jo përkatës të ligjeve.

Po ashtu, raporti vë në pah mosgatishmërinë dhe kurajën e institucioneve publike që të respektojnë të drejtat e garantuara, duke filluar prej të drejtave më themelore, si e drejta e barazisë para ligjit, liria e lëvizjes, e drejta për përdorimin e mjeteve juridike, për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, lirinë e shprehjes, e drejta në qasje në dokumente publike, pastaj lirinë e mediave, e drejta e pronës etj.

Avokati i Popullit konstaton se sistemi gjyqësor dhe i prokurorisë vazhdojnë të jenë sfida kryesore me të cilën po përballët shoqëria kosovare, si pushtet i tretë i pushtetit, ku mbrohet ligjshmëria dhe kushtetutshmëria. Në kuadër të këtij raporti janë identifikuar tri mangësi, të cilat rëndë e cenojnë bazën e shtetit dhe të së drejtës, si mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore, zvarritja e procedurave gjyqësore dhe korrupsioni, i cili mjerisht ka hyrë në këtë sistem. Mandej, përmendet rasti i Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës, ku i obligon qytetarët që dokumentacionin, gjegjësisht kërkesat, paditë t'i paraqesin në gjuhën angleze, duke e ditur se cila gjuhë zyrtare përdoret në Kosovë, me çka është cenuar Ligji për përdorimin e gjuhëve.

Raporti gjithashtu i identifikon se sfidat më të mëdha mbeten në mos nxjerrjen e disa ligjeve, të cilat e kompletojnë Kornizën ligjore, sa i përket mirëqenies sociale, ekonomike dhe shëndetësore, e të cilat prekin liritë dhe të drejtat e qytetarëve të Republikës së Kosovës, siç janë: Ligji për sigurimin invalidor dhe pensional, si dhe Ligji për sigurinë shëndetësore.

Po ashtu, sfida të veçantë për institucionet e Kosovës mbesin vonesat në nxjerrjen e akteve nënligjore dhe ky mosveprim i institucioneve është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare. Pastaj, propozimi i Avokatit të Popullit, se mungesa e një gjykate administrative funksionale në zgjedhjen e konflikteve administrative do të përmirësonte standardet për mjete juridike, meqë deri më tani nuk ka marrë ndonjë nismë për themelimin e një gjykate të këtillë, pasi që çështja e konflikteve administrative është në kompetencë të gjykatave supreme të Kosovës dhe nuk ka dhënë rezultatet e duhura.

Sa i përket barazisë para ligjit, edhe pse thuhet se është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe është e sanksionuar me Ligjin kundër diskriminimit, sipas saj nuk shihet përparim në zbatimin e tij dhe ka paqartësi në disa nene të këtij ligji. Por, mjerisht, deri më tani nga ana e autoriteteve nuk është marrë ndonjë veprim.

Gjithashtu, edhe në Ligjin për liritë fetare në Kosovë, që e anashkalon rregullimin e pozitës juridike të bashkësive fetare dhe mungesën e një infrastrukture ligjore, krijojnë probleme ndërfetare, që me një fjalë të disa bashkësi fetare kemi diskriminim pozitiv. Në tërë raportin shihet se respektimi i parimeve kushtetuese sa i përket të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Kosovë, është larg plotësimit të standardeve të kërkuara me ligje pozitive dhe ato ndërkombëtare.

Raporti e ka bërë shumë të qartë këtë dhe inkurajon institucionet vendore për përkushtimin e avancimit në zbatimin e të drejtave në jetën reale të njerëzve e jo vetëm në letër. Kjo do të ishte edhe pasqyrë e vërtetë e këtij raporti dhe anë pozitive e tij, në mënyrë që qytetarët të krijojnë besimin në institucionet publike, në respektimin e të drejtave të njeriut, në mënyrë që në të kundërtën të mos aplikojnë veç gjyqësinë si një mjet jo ligjor në zbatimin e ligjit.

Përveç kësaj, këtij Raporti mund t'i bëjmë edhe disa vërejtje, si p.sh. e ka bërë përsëritjen e panevojshme të të njëjtave gjëra, duke i përsëritur 2 deri 3 herë. Ditët e hapura, të cilat organizohen nëpër qytetet e Kosovës, janë praktikë e mirë, por sa janë të informuar qytetarët dhe sa respektohet nga zyrtarët orari për këto takime, si dhe Raporti i Buxhetit nuk është i përpiluar sipas Ligjit të menaxhimit publik të financave.

Grupi Parlamentar i AAK-së e mbështet këtë raport. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Biserka Kosqit.

BISERKA KOSTIĆ: Zahvaljujem, gospodine predsjedavajući! Parlamentarna grupa Samostalne Libelarne stranke je pažljivo razmotrila godišnji Izveštaj Narodnog advokata, za 2010 godinu, i aktivnim učešćem u istoimenoj komisiji, gde Narodni avokat, Institucija Narodnog advokata polaže godišnji izveštaj, dali smo određene kritike, to su zapravo pozitivne kritike i u nadi da će Narodni avokat u sledećem svom izveštaju podneti malo bolji izveštaj što se tiče manjinske zajednice, to su zapravo one kritike koju su njemu ukazane na komisij, ali u nameri i nadi da će Narodni avokat ispraviti te greške, mi ćemo podržati Izveštaj za 2010. godinu. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! “6+” Albert Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar me vëmendje Raportin vjetor të Avokatit të Popullit dhe do ta miratojë këtë raport të punës të Avokatit të Popullit me një vërejtje, se komuniteti rom e gëzon të drejtën e lëvizjes së lirë, po ashtu edhe shprehjes së lirë dhe kjo nuk përkon me këtë raport apo me përmbajtjen e Raportit të Avokatit të Popullit, për vitin 2010.

Po ashtu, kam edhe një vërejtje për kolegen nga “Vetëvendosje”, duke respektuar Kushtetutën e vendit, Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kushtetuta jonë nuk njeh pakicë rome, por komunitetin romë. Po ashtu, Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar edhe Raportin financiar vjetor të Avokatit të Popullit. Është “pro” këtij raporti financiar

vjetor, duke pas parasysh se është plotësuar me një raport plotësues. Po, me një vërejtje, të cilën e ceku edhe kryetari i Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike që nuk është respektuar afati kohor që ka pasur të bëjë me rekomandimin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, gjegjësisht që ta njoftojë lidhur me mangësitë dhe parregullsitë që janë gjetur në këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti kryesues!

U fol mjaftë për aspektet tjera të këtij raporti, sidomos për aspektet financiare. Unë do të ndalem pak në aspekte kushtetuese dhe në atë që quhet prevenetim i shkeljes së të drejtave të qytetarëve. Përgjithësisht, unë jam i kënaqur me Raportin, është mjaftë analitik, mjaftë zbërthyes. Raporti është bazuar kryesisht në një metodologji të mirë të raportimit, duke përfshirë përshkrimin e plotë të gjendjes në realizimin e të drejtave kushtetuese qytetarëve. Ka respektuar plotësisht konceptin kushtetues të këtyre lirive që nga liritë individuale, liritë politike e deri te liritë sociale e ekonomike.

Janë tri segmente që dëshiroj t'i cek, do të thotë, në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës, Avokati duhet jo vetëm të mbrojë të drejtat e njeriut të garantuara me Kushtetutë, por të ndikojë edhe në politikat legjislative që të eliminohen dispozitat ligjore që mund të jenë burim. Ne të gjithë e dimë që Avokati nuk e ka cilësinë e një propozuesi të ligjeve, nuk e ka atë autoritet, por do të mundet në rekomandimet vjetore që i jep Kuvendit të Kosovës të vërejë eventualisht nevojën e rishikimit të legjislacionit sa i përket shkeljes së lirive dhe të drejtave të njeriut.

Në mënyrë të veçantë Avokati duhet të angazhohet që legjislacioni i Kosovës, por edhe veprimet e organeve shtetërore, plotësisht e respektojnë standardet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ai të bëjë analizimin edhe të legjislacionit, por edhe të praktikave të zbatimit të ligjeve qoftë në nivelin lokal apo në nivelin qendror, në mënyrë që të jetë edhe një mekanizëm shtesë i verifikimit se Kosova po i plotëson standardet e Konventës Evropiane sa i përket lirive dhe të drejtave të qytetarëve.

Një dimension tjetër që dëshiroj ta ngrejë, edhe pse është thënë në raport, është aktiviteti i Avokatit të Popullit në drejtim të referimit të çështjeve te Gjykata Kushtetuese. Siç dihet, Avokati i Popullit është subjekt i autorizuar që ka të drejtë të referojë çështjen te Gjykata Kushtetuese. Ne po shohim në raport disa çështje që janë referuar, është jashtëzakonisht mirë. Por, do të doja që në Raportin e vitit të ardhshëm të shoh më shumë çështje të referuara te Gjykata Kushtetuese, në mënyrë që ky institucion të bëhet një mbrojtës institucional i qytetarëve në rastet kur ata ndeshen me shkeljet e natyrave të ndryshme. Të afirmohet jo vetëm kur mbron, kur atakon vendimet konkrete të institucioneve publike, por edhe kur vihet në mbrojtje të drejtpërdrejtë të lirive dhe të drejtave qytetarëve të shkelura me akte individuale të organeve të natyrave të ndryshme publike.

Marrë në tërësi, unë shoh një progres te ky raportim, shoh një progres në raport me raportet e viteve paraprake. E di që Avokati i Popullit ka edhe probleme tjera, filluar nga problemet hapësinore, e di që vepron në një objekt privat, e di që ka edhe probleme të

stafit edhe po shpresoj që sa më shpejt ky institucion kushtetues t'i zgjidh problemet, të kompletohet me staf, t'i zgjidh edhe problemet tjera në mënyrë që të jetë në funksion të plotë kushtetues. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Bekim, je lajmëruar me vonesë, se janë kryer diskutimet. Diskutimi po e nxjerr diskutimin. Mundësh nja 1 minutë, por po më doket që ne në emër të grupit e kemi thënë. Vazhdo, vazhdo, thuaje!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit kryesues!

Derisa s'është paraqitur d.m.th. në fund të raportit edhe prezantuesi i raportit, mendoj që kam të drejtën për fjalë dhe këtu pat dikush që u lajmërua edhe mbas fjalës përfundimtare të ministrit, e s'ju mor ajo e drejtë. Nëse ti mendon ashtu, atëherë unë e tërheq diskutimin, nuk është problem.

KRYESUESI: O, Ramiz ti ki të drejtë të flasësh sa herë të duash! Fol, o burrë, fol! Ramiz Lladrovci!

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në kuadër të shqyrtimit të Raportit vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin 2010, desha edhe unë të paraqitem me një fjalë të shkurtër, për hir të sëvërtetës.

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike, në kuadër të shqyrtimit të Raportit të Auditimit të Financave Publike të organizatave buxhetore ka shqyrtuar Raportin financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit. Opinioni i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm ka dhënë një opinion të pakualifikuar, me theksim të çështjes, që do të thotë nuk është i shkëlqyeshëm, por është shumë i mirë.

Prandaj, ajo çka tha kryetari i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, zoti Ali Sadriu, është e pavërtetë kur tha se "aty ekziston një mal me të pagjetura". Nuk ekziston një mal, nuk ka të pagjetura, por Avokati i Popullit i ka trashëguar nga avokati i kaluar, d.m.th. nga përgjegjësi i kaluar. Prandaj, për hir të vërtetës duhet thënë se nuk është e vërtetë që ekziston një mal i të pagjeturave, sepse edhe opinioni i Zyrës së Auditorit nuk e ka dhënë ashtu, por e ka dhënë një opinion shumë mirë, jo të shkëlqyeshëm, por shumë mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, Ali Sadriu. Kam hyrë në gjynah me Bekimin më parë dhe...

ALI SADRIU: E para, nuk kam pasur nevojë ë ceki "malin" për të pagjeturat, sepse të pagjeturat kanë ardhur në Kuvend edhe në Kuvend janë shqyrtuar, pos komisionit, dhe i janë dërguar Avokatit të Popullit.

Një mal parregullsish, kam thënë që janë në jetën e Kosovës dhe të qytetarëve të saj, ku Avokati i Popullit e ka hapësirën që duhet të afektojë, ajo është shumë e vërtetë, është një lajthitje.

E dyta, nuk duhet të luajmë me terminologjinë e parregullsisë, theksim çështjeje, a e kuptoni ju çka është ajo?! Pasqyrat që i ka paraqitur, a janë në harmoni me Ligjin mbi raportimin. Ajo është vlerësimi i parregullsisë – theksim i çështjes. Ne kemi pasur edhe një ministri para disa dite, që të gjeturat janë vërtetë shumë të mëdha dhe ka punë edhe gjyqësia, edhe prokuroria dhe ka hy në atë ministri dhe është duke hulumtuar etj.

Opinionin e ka të pakualifikuar, sepse e ka paraqitur si të tilla të pagjeturat. Do të thotë, e rregullt, e parregullt është, a e ka paraqit në harmoni qysh janë, por aty çka ka brenda, kur e analizon, ato dalin. Prandaj, nuk është mirë të keqpërdoret foltorja dhe kjo është keqpërdorim i foltores. Unë isha vetëm për atë që Raporti financiar duhet bashkarisht me Raportin vjetor në harmoni të trajtohen para Kuvendit, e jo ndaras. Sepse, vërtetë aty ka parregullsi. Ne i kemi trajtuar dhe ne i presim, pavarësisht që dikush mendon që është kaluar.

Ata janë të obliguar në bazë të vendimit të Kuvendit, të përgjigjen dhe ne do t'i diskutojmë, cilat janë ato dhe çka kanë reflektuar?

KRYESUESI: Faleminderit! Unë publikisht dua t'i kërkoj falje Bekimit! Edhe pse paska dalë. Kundër replikë, Ramiz Lladrovci. Ia ndala fjalën, për të hyrë në votim, edhe Bekimit, edhe Lutfisë!

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, nënkryetar!

Ndoshta më mirë kishte për të qenë, se të pagjeturat duhet t'i atribuohen ish-Avokatit të Popullit ose ish-zëvendësve të Avokatit të Popullit dhe jo këtij që është sot. Prandaj, këtë desha ta sqaroj.

KRYESUESI: Në rregull. Kundër replikë nuk ka më!

Atëherë, vazhdojmë me votimin e Raportit vjetor të Avokatit të Popullit, për vitin 2010. Në sallë janë 63 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim. Votojmë, tash!

Faleminderit! Konstatohet që me 49 vota “për”, 11 “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Raportin vjetor të Avokatit të Popullit, për vitin 2010.

Faleminderit! Mendoj, që duhet të shkojmë në pushim të drekës deri në orën 15:00.

Vazhdimi i seancës pas pauzës

KRYETARI: Të nderuar deputetë!

Vazhdojmë seancën. Pika 17 e rendit të ditës:

17. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, për vitin 2010

Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Raportin vjetor të punës së Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, për vitin 2010, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka shqyrtuar Raportin vjetor dhe pasqyrat e audituara financiare të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, për vitin 2010, dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandimin për miratim.

Fjalën e ka kryetari i komisionit funksional, deputetja Safete Hadërgjonaj, për arsyetimin Raportit me rekomandime.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur me datën 6.7.2011, shqyrtoi Raportin vjetor të Bankës Qendrore të Kosovës, për vitin 2010, dhe vlerësoi se Raporti i përmbush kushtet ligjore të parapara me nenin 28 dhe 29 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Komisioni vlerësoi se Raporti i Bankës Qendrore është i përgatitur mirë në aspektin teknik dhe profesional, si dhe pasqyron punët që ka bërë Banka Qendrore gjatë vitit financiar: objektivat dhe politikat e saj, gjendjen në sektorët e ndryshëm të ekonomisë, me përqendrim në sistemin financiar dhe ngjarjet e rëndësishme që kanë ndikuar në ekonominë e Kosovës.

Nga raporti shihet se në vitin 2010 ekonomia e Kosovës ka pasur rritje të produktit të brendshëm bruto për 4%, ndërsa vlera nominale e produktit të brendshëm bruto është 4.2 miliard euro. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i rritjes së konsumit dhe investimeve në sektorin privat. Sektori financiar ka pasur rritje gjatë vitit 2010 me një normë prej 13.7% krahasuar me vitin 2009.

Depozitat dhe kreditë, si komponentë kryesore të bilancit të gjendjes së sistemit bankar, kanë shënuar rritje, depozitat për 11%, kurse kreditë e sistemit për 13.2%. Pjesëmarrja e kredive jo performuese në gjithsej kreditë e sistemit bankar, shënoi rritje duke arritur në 5.9%.

Nga raporti shihet se ka rritje të eksportit dhe importit, por ende është i lartë deficitin në llogarinë rrjedhëse. Pra, bilanci i pagesave ende mbetet i lartë, mbulueshmëria e importit me eksport është vetëm 13.7%.

Komisioni, gjatë shqyrtimit të raportit kërkoi sqarime sa iu përket masave që ka ndërmarrë Banka Qendrore për rregullimin e statusit dhe mbikëqyrjen e institucioneve mikro-financiare, të cilat kanë qenë shqetësim edhe në të kaluarën për menaxhimin e mjeteve të privatizimit dhe të trustit. Po ashtu, brengosëse ishin edhe kushtet e kredisë dhe shpërndarja sektoriale e tyre.

Me interes për anëtarët e komisionit ishte edhe përgatitja që po i bën Banka Qendrore në bashkëpunim me Ministrinë e Financave për emetimin e letrave me vlerë.

Guvernatori sqaroi se Banka Qendrore e Kosovës është duke punuar për rregullimin ligjor të statusit të institucioneve mikrofinanciare. Sipas guvernatorit, është duke u

hartuar Ligji për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e bankave komerciale, institucioneve mikro - financiare dhe institucioneve tjera financiare, jo bankare, dhe pritet që këtë vit të procedohet për miratim në Kuvend.

Po ashtu, janë dhënë sqarime rreth menaxhimit të mjeteve të privatizimit dhe të Trustit. Sa i përket emetimit të letrave me vlerë, sipas guvernatorit janë bërë të gjitha përgatitjet dhe parashikimet që emetimi i tyre të ndodhë në tremujorin e parë të vitit 2012. Kjo do të krijonte mundësinë e investimit të mjeteve të Trustit dhe mjeteve tjera të akumuluar në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Pas sqarimeve për çështjet që janë ngritur nga anëtarët e komisionit, nga ana e Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, komisioni njëzëri e ka miratuar Raportin e Bankës Qendrore, për vitin 2010, dhe i rekomandon Kuvendit miratimin e tij. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, deputeti Ali Sadriu e ka fjalën.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje për ju dhe të gjithë të pranishmit tjerë!

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike po ashtu e ka shqyrtuar këtë raport në prezencën e guvernatorit dhe vjen deri te konkludimi se raporti është teknikisht mirë i pasqyruar dhe si i tillë rekomandohet që të marrë notën kaluese, siç po e quajnë disa, por nëse e shikojmë performancën e kësaj banke, do të konstatojmë diçka krejt tjetër.

Në Kosovë kemi normë të kamatave më të larta se kushdo tjetër, jo veç në regjion, por edhe më larg. Nëse merret kriter bazë për normën e kamatës, shkalla e rrezikshmërisë së kapitalit të investuar, e shoh unë një pasqyrë tjetër, sepse në Kosovë kreditë e këqija janë vetëm me 4%, ndërsa në regjion shkojnë 14%, 16% e 17%. Do të thotë, arsye për një normë të tillë të kamatave nuk ka dhe kjo ndikon drejtpërdrejt në mos zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Buxheti si buxhet nuk siguron, nuk gjeneron vende pune, pra nuk zbret papunësinë. Elementë kyç apo faktor kyç i një procesi të tillë është menaxhimi i tregut financiar ose organizimi i tregut financiar, me të cilin banka... ligji po e quan dhe të tjerët po e quajnë Bankë Qendrore, por unë nuk do ta quaj, sepse ky agjencion bankar, realisht kryen dy funksione. Kryen: 1. Funksionin e licencimit të organizatave financiare dhe

2. Bën mbikëqyrjen e tyre.

Do të thotë, nuk merret me elemente qenësore, siç është pra tregu financiar, organizimi i tij, nuk merret me emetimin e parasë, çka nënkupton se Kosova nuk e gëzon vlerën e rikrijuar të vetën, nuk e gëzon, ajo mbetet në Bankën Qendrore, në Frankfurt.

Gjitha shtetet që janë në kuadër të zonës, bëjnë emetimin e parasë dhe marrin vlerën e rikrijuar. Te ne nuk është kjo. Ato janë mjete më kualitative për çdo qeveri, për investim në sektorë ku ai pretendon se duhet të kenë përparësi. Këto nuk janë në Kosovë dhe unë

mendoj se duhet të fillojë procedura e ndryshimit të ligjit, sepse edhe me ligj bankën që është krijuar, realisht nuk i janë dhënë këto kompetente.

Po t'ia shikoni stafin, stafi i Bankës, hajde ta quajmë Qendrore, se kështu e emërton ligji, te ne mban stafin 1/3 e stafeve që kanë bankat qendrore në regjion. Kjo vetvetiu tregon se është larg funksioneve të veta. Po të hyjmë në procesin e kompanive siguruese, sa është kryer kjo në të kaluarën, drejtë?

Kemi një seri çështjesh që mendoj se Kuvendi duhet t'i dijë dhe duhet t'i diskutojë, sepse këtu ka pasur banka që janë licencuar realisht, që nuk ka ekzistuar bankë. Unë tash kur të them, e di që shumëkush do të habitet dhe do të thotë, si është e mundur kjo?!

ProCrediti nuk ka qenë bankë dhe sot nuk ka Bankë Qendrore, nuk ka seli të bankës së vet. Ka qenë një fondacion, këtu e krijuar një bankë dhe sot është bërë një bankë shumë e madhe. Tregu i Kosovës për sistemin bankar të huaj është një oazë jo e shkëlqyeshme, por super e shkëlqyeshme. Sepse, ata mendojnë vetëm për dividendë të vet dhe kurrëgjë tjetër nuk u intereson.

Pra, sistemi bankar në Kosovë është pak në funksion të ekonomisë së Kosovës dhe të qytetarit të Kosovës. Dhe kjo është brenga jonë që duhet të krijojmë mekanizma që ai funksion të jetë në funksion që realisht i kërkohet një vendi, siç është Kosova në këtë rast.

Këto janë komentet që realisht është dashur të kihen parasysh në momentin kur është nxjerrë ligji, kur janë determinuar përgjegjësitë. Pra, këtij autoriteti te ne, këtë desha t'ju bëj me dije deputetëve, i mungojnë një seri përgjegjësisë që realisht ta gëzojë titullarin e Bankës Qendrore dhe ta operojë funksionin e Bankës Qendrore.

Problemet janë edhe këtu, pra ne duhet ta ndihmojmë, sepse përgjigja e guvernatorit ka qenë shumë e qartë. Unë jam i gatshëm dhe kam dëshirë, por ligji më kufizon në atë drejtim. Do të thotë, duhet shumëçka të ndërmarrim që format që i ka paraqitur, se nganjëherë po na përzihen termet rregullsi, parregullsi, mirë, jo bash mirë. Ajo është formë që është paraqitur, por çfarë është ajo formë, çka përmban ajo formë, është krejt diçka tjetër. Do të thotë, për të thënë "mirë" ose "keq", duhet të marrësh mjetet që i ke investuar për një shërbim. Sa tu kanë kthyer ato, çka ke marrë prej mallrave, shërbimeve, a janë në harmoni me atë që ti ke investuar. Dhe, nëse e shohim kështu, ky sistem është larg kryerjes së funksionit të vet. Faleminderit!

KRYETARI : Faleminderit! Tani është radha e kryetarëve të grupeve parlamentare ose përfaqësuesve. Në emër të Partisë Demokratike, kush e donë fjalën për këtë çështje?

Fjalën e ka deputetja Valbonë Dibra.

VALBONË DIBRA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar Raportin vjetor të Bankës Qendrore, për vitin 2010, dhe ka vlerësuar se raporti është i përgatitur në mënyrë profesionale.

Raporti prezanton aktivitetet njëvjeçare të Bankës Qendrore. Viti 2010 konsiderohet si vit i përmirësimit të ekonomisë globale. Vlerësimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar tregojnë për një rritje të ekonomisë botërore, prej 5% gjatë vitit 2010. Ky përmirësim i ekonomisë globale u reflektua edhe në ekonominë e Kosovës, ku bartës kryesor i rritjes ekonomike gjatë vitit 2010 konsiderohet të jetë sektori privat, për dallim nga viti 2009, ku gjenerator kryesor i rritjes ekonomike ishte sektori publik.

Vlerësimet tregojnë për rritje reale të bruto produktit të brendshëm prej 4.6%, ku në këtë rritje përpos sektorit publik kanë ndikuar edhe dërgesat e emigrantëve. Norma mesatare e inflacionit, në vitin 2010, gjithëherë duke iu bazuar raportit në fjalë, ishte 3.5%. Inflacioni ishte si rezultat i ngritjes së çmimeve të produkteve ushqimore në nivel global.

BQK-ja gjatë vitit 2010 ka ngritur cilësinë e shërbimeve të saja, si në cilësinë e furnizimit me kartëmonedha dhe monedhave euro, ka rritur vëllimin dhe vlerën e pagesave ndër bankare, si dhe ka funksionalizuar Këshillin Kombëtar të Pagesave.

Pavarësisht krizës globale, sektori financiar i Kosovës vazhdoi në stabilitet dhe rritje gjatë vitit 2010. Vlera e aseteve të këtij sektori në vitin 2010 arriti në 3.2 miliard euro, që paraqet një normë të rritjes për 13.7% krahasuar me vitin 2009. Sistemi Bankar i Kosovës vazhdon të ketë shkallë të lartë të koncentrimit të tregut, ku 3 bankat më të mëdha, menaxhojnë 77.4% të gjithsej aseteve të sistemit bankar.

Në këtë kontekst, norma mesatare e interesit në kredi edhe gjatë vitit 2010 ka qenë shumë e lartë, gjë që vazhdon edhe në këtë vit të jetë shumë e lartë. Kjo është shqetësuese, si për ne, si grup parlamentar, ashtu edhe për qytetarin e Kosovës, ku dihet që shumica e bizneseve në Kosovë operojnë me kredi. Andaj, në këtë aspekt kërkojmë nga Banka Qendrore që në pakon e ligjeve që pret të aprovohet në nëntor, të ndërmarrë masa në lidhje me normën e interesit.

Në vitin 2010, ekonomia e Kosovës shënoi rritje të eksporteve prej 77.8% përderisa importet u rritën në 10.8%.

Po ashtu, sistemi elektronik i Kliringut ndërkombëtar, gjatë vitit 2010 ka shënuar rritje të konsiderueshme, ku rreth 3.9 milion të transaksioneve në vlerë prej 4.6 miliard euro u kanalizuan përmes Sistemit Elektronik të Kliringut ndërkombëtar. Dua të theksoj edhe çështjen se bashkangjitur në Raportin vjetor të Bankës Qendrore, për vitin 2010, është edhe Raporti i Auditorit të Pavarur, ku Banka Qendrore vazhdimisht ka auditime dhe Raporti i Auditorit të Pavarur jep opinionin e pakualifikuar, që do të thotë që pasqyrat financiare paraqesin një gjendje të drejtë dhe reale të Bankës Qendrore, për vitin 2010.

Dhe, në fund, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike përkrah Raportin vjetor të Bankës Qendrore dhe njëherësh fton edhe grupet tjera parlamentare ta mbështesin këtë raport. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Përshëndetje për Qeverinë, e cila asnjëherë nuk është këtua.

Spektori bankar në Kosovë është një sektor i ri, i krijuar në Kosovë (Qetësi, ju lutem)!

Spektori bankar në Kosovë është një sektor i ri i krijuar në Kosovën e pasluftës, i krijuar në një treg ku konkurrenca nuk ka ekzistuar fare. Situata ekonomike e pasluftës ka ndikuar që kërkesa për kapital, për rindërtimin e vendit totalisht të shkatërruar të jetë shumë e madhe, më e madhe se sa oferta. Kjo ndikoi që normat e interesit fillimisht të ishin tepër të mëdha.

Por, çka është shumë për t'u çuditur, është se këto norma dhe sot pas 12 vjetëve kanë mbetur të larta. Unë e kam thënë edhe më herët në këtë Kuvend, kur ne shqyrtojmë raportet e institucioneve të tilla, ne duhet t'i lejojmë vetës që të dalim edhe përtej raporteve. Të shikojmë punën e këtyre institucioneve, dobite që këto institucione ju sjellin qytetarëve të Kosovës dhe kontributin e tyre të përgjithshëm.

Spektori bankar sot në Kosovë është sektori më profitabil. Bankat komerciale sot në Kosovë garojnë se cila po ia kalon tjetrës për nga niveli i fitimit. Bravo! Por, ne dhe Banka Qendrore e Kosovës, sektorin bankar nuk duhet ta shikojmë sikur të ishim aksionarët kryesorë të këtyre bankave, por duhet ta shikojmë nga pozicioni i qytetarëve të varfër që paguajnë norma shumë të larta të interesit për kreditë që me mezi i marrin.

Nga pozicioni i bizneseve, ku ky sektor kaq i suksesshëm bankar paraqet barrierën kryesore të financimit që po e pengon drejtpërdrejt rritjen dhe zhvillimin e këtyre bizneseve. Duhet gjithashtu të theksojmë se sektori bankar në Kosovë po gjendet shumë mirë, pikërisht në sajë të besimit dhe respektit që qytetarët e Kosovës e kanë për këtë sektor.

Depozitat këtë vit janë rritur për mbi 15% apo afër 2.000.000.000 euro. Normat e interesit për ata që depozitojnë paratë në bankat e Kosovës janë 4%, e për ata që marrin kredi nga bankat e Kosovës janë 14.4%.

Arsyetimi se në Kosovë rreziku është shumë i madh, nuk qëndron fare. Sepse kreditë e këqija në Kosovë janë rreth 4.5%, derisa kreditë e këqija në Shqipëri, Maqedoni, Bosnje dhe Serbi janë dyshifrore. Por normat e interesit në krahasim me këto vende janë më të lartat, në Kosovë.

Edhe një fakt tjetër. Në Kosovë bankat japin kredi vetëm sa 1/3 e bruto produktit vendor, derisa Mali i Zi, një vend aq i vogël, jep kredi sa dy herë bruto produkti vendor i vendit të tij. Si rezultat i gjithë kësaj, ne kemi një status quo, papunësi shumë të madhe, import shumë herë më të madh se eksporti dhe rritje të varfërisë.

Tash i kthehem Bankës Qendrore të Kosovës, e cila është kujdestari ose ombrella e bankave tjera në Kosovë. Çfarë pune po bën ky institucion, cila është vlera e shtuar që i

jep këtij sektori? Për të gjitha këto, Banka Qendrore do të më përgjigjej: Zonja deputete, jemi në ekonominë e tregut dhe në ekonominë e tregut institucionet nuk ndërhyjnë në përcaktimin e çmimeve dhe normave të interesit. Por, kur flitet për sektorin bankar në Kosovë, nuk kemi fare të bëjmë me ekonominë e tregut. Kemi të bëjmë me një treg obligo-politik të tipit klasik, sepse në tregun e parasë asnjëherë nuk është arritur ekuilibri ofertë-kërkesë.

Kërkesës gjithnjë në rritje për kapital nga ana e qytetarëve, bankat nuk u janë përgjigj me rritje të ofertës së parave për kredi dhënie, por me rritje të normave të interesit, për të mos folur këtu për institucionet mikro-financiare, të cilat operojnë me paratë e donatorëve dhe u japin ato qytetarëve tonë me norma të interesit, mbi 20%.

Banka Qendrore e Kosovës para se gjithash duhet të jetë në shërbim të qytetarëve dhe të zhvillimit ekonomik të vendit. Dhe unë kërkoj që Banka Qendrore të punojë më shumë rreth funksionimit në rregullimin e mosfunksionimit të tregut të parasë në Kosovë.

Ne jemi të zgjedhurit e popullit, ne e kemi zgjedhur këtu guvernatorin e Bankës Qendrore, andaj të vihem në shërbim të popullit të Kosovës, e jo në mbrojtje të institucioneve dhe individëve të caktuar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të “Vetëvendosjes”, Visar Ymeri, por mendoj që është tema mjaftë interesante dhe është mirë të dëgjojmë pak më me vëmendje!

VISAR YMERI: Ju faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Konsideroj që këto kritika që ju bënë sikur Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, por veçanërisht sistemit bankar të Kosovës, shumica prej tyre, më duhet të them, janë kritika që qëndrojnë dhe natyrisht që edhe ky prezantim i imi në këtë pikë të rendit të ditës do të jetë i kësaj natyre, në pjesën më të madhe, për shkak se është e pamundur që ta shmangim një problem, të cilin e ka Kosova, e që unë mendoj që është sistemi bankar apo mënyra se si funksionon ky sistem bankar edhe mënyra se si sillet ai, të them ashtu, ndaj nevojave ekonomike të Kosovës.

Një sistem bankar mund të quhet i shëndoshë dhe i suksesshëm për dy arsye kryesore, pra këtu është edhe një lloj, të them, ashtu globalisht një lloj ndarje ideologjike në atë se si shihen sistemet bankare. Pra, njëra anë është ta shikojmë mënyrën, se si funksionojnë bankat dhe sa janë ato profitabile për veten e tyre.

Dhe, në këtë drejtim konsideroj që sistemi bankar i Kosovës është mjaftë i suksesshëm, pra në aspektin e profiteve që bankat gjenerojnë nga depozitat dhe kreditë që u japin qytetarëve të Kosovës. Sipas Raportit të BQK-së, vetëm gjatë vitit të kaluar, siç u përmend këtu, më duket nga parafolësja, bankat kanë fituar në shumë agregate, neto përfitime për vitin 32.900.000 euro, pra gati 33.000.000 euro, më falni, që nënkupton një profit goxha i lartë, veçanërisht kur merret parasysh sasia apo niveli i investimeve që këto banka e kanë si kapital fillestar.

Dhe, mënyra e dytë është, si mund të vlerësohet një sistem bankar i suksesshëm dhe i dobishëm, është mënyra apo niveli deri në të cilin sistemi bankar e financon dhe e krediton një ekonomi të një vendi. Në këtë aspekt konsideroj që sistemi bankar i Kosovës është shumë larg të suksesshmit.

Natyrisht që në një vend si Kosova, me zhvillimin ekonomik të cilin e kemi, kur e kemi po ashtu parasysh se një prej çështjeve apo problemeve gati kryesore të këtij mos zhvillimi ekonomik është qasja në kapital, një sistem bankar i cili nuk e financon dhe nuk e krediton këtë ekonomi, nuk mund të vlerësohet i suksesshëm, mirëpo është një sistem bankar i cili do të duhej doemos që të jetë ai sistem i cili e kryen këtë punë.

Pra, ne nuk mund dhe nuk duhet të biem në grackën e vlerësimit të sistemit tonë bankar vetëm duke u bazuar në profitet, të cilat i gjeneron banka apo bankat komerciale, të gjitha së bashku. Dhe, fatkeqësisht, më duhet të them që deri tash e nga pak po shihet edhe me këtë Raportin e BQK-së, që BQK-ja si institucion publik pikërisht po bie në këtë grackë, duke e vlerësuar me nota shumë të larta funksionimin e sistemit bankar, ndërkohë duke e mos problematizuar problemin kryesor që ky sistem e ka.

Pra, këtu u përmendën disa herë dhe nuk ka qytetarë i Kosovës i cili nuk e di se kamatat me të cilat japin kredi bankat e Kosovës janë shumë të larta, e veçanërisht për disa sektorë, për të cilët Kosova ka shumë nevojë, sikur ta zëmë p.sh. sektorin e bujqësisë, ato janë jo vetëm të larta, por janë absolutisht të papërballueshme, p.sh. kamatat sa i përket sektorit të bujqësisë shkojnë prej 20% deri në 25% në vit, gjë që nënkupton që thjesht bujku i Kosovës nuk ka kurrfarë leverdie, madje do të humbte shumë po qe se orientohet për të marrë kamatë ose për të marrë kredi në njërën prej bankave komerciale të Kosovës.

E njëjta gjë ndodh faktikisht edhe me ndërmarrjet tjera dhe me bizneset tjera. Edhe ato e kanë nivelin shumë të lartë të kamatave dhe nëse shihet struktura ose zbërthimi i strukturës së kredive të sistemit bankar të Kosovës, kuptohet që faktikisht vetëm tregtarët kanë leverdi që të marrin kredi nëpër banka, për shkak se në Kosovë fatkeqësisht vetëm tregtarët janë biznesmen të cilët fitojnë shumë, duke e marrë parasysh se çfarë marrëdhënie tregtare kemi ne me botën jashtë e veçanërisht këtu hyjnë, natyrisht, ata që importojnë mallra nga Serbia.

Pra, pjesa dërmuese e kredi - marrjes nga ndërmarrjet në Kosovë janë: shërbimet tregtarë, pastaj janë shërbimet tjera, në fund vijnë prodhimi dhe bujqësia. Dhe, kjo d.m.th. tregon qartë se pse sot në Kosovë nuk kemi ekonomi të zhvilluar, pse rrjedhimisht sot në Kosovë nuk kemi mirëqenie të qytetarëve.

Dhe një gjë e tillë ndodh edhe për shkak dhe kryesisht për shkak të mos intervenimit të Bankës Qendrore të Kosovës. Pra, aty Banka Qendrore e Kosovës vetë në raportin e vetë, në faqen 31 e ka specifikuar se një prej problemeve kryesore këtu në Kosovë është koncentrimi i aktiviteteve bankare në disa banka. Pra, bankat e huaja ose bankat me pronësi të huaj e kontrollojnë diku 90.2% të tërës transaksioneve bankare, depozitave dhe kredive, ndërkohë që vetëm 3 bankat më të mëdha e kontrollojnë 77.4% të tërës transaksioneve bankare.

Dhe, kjo flet natyrisht jo për një ekonomi tregu, siç u fol më herët, po kjo flet për një koncentrim monopolistik edhe obligopolistik të tërë potencialit financiar të Kosovës në duar të disa bankave, të cilat, siç e thashë edhe më herët, nuk janë banka të Kosovës dhe rrjedhimisht e kanë edhe një dozë më të ulët të përgjegjësisë karshi interesave ekonomike të Kosovës. Dhe, ky është problem i madh në të cilin duhet të intervenojë doemos BQK-ja, për shkak se Banka Qendrore e Kosovës, nëse vërtet dëshiron që të jetë e tillë, duhet të jetë aktive veçanërisht në sektorin bankar, në mënyrë që ta sigurojë një likuiditet më të mirë dhe një qasje më të lehtë dhe më të mirë ndaj kapitalit për qytetarët e Kosovës dhe për ndërmarrësit e Kosovës, në mënyrë që t'u mundësojë këtyre një zhvillim ekonomik.

Ne e dimë këtu, kushdo që ka pasur ndonjëherë ndonjë kontakt me biznesmenë të Kosovës, veçanërisht prodhuesit e Kosovës, njëri prej problemeve kryesore që ata e kanë për kesh, përveç mungesës së tregut e kanë edhe qasjen në kapital, mungesën e likuiditetit që ua pamundëson atyre investimet dhe që ua pamundëson atyre zgjerimin e biznesit, zgjerimin e prodhimtarisë, që do të nënkuptonte rritjen e vendeve të punës. Pra, këto janë probleme të cilat natyrisht rrjedhin nga një politikë e gabuar, e natyrisht që këtu BQK-ja është pjesë e kësaj politike edhe është nën këtë politikë, gjë që e shtynë këtë të veprojnë në këtë drejtim.

Një fakt tjetër që dua të përmend këtu, që lidhet me kamatat e larta, pra është ajo që bankat e Kosovës disa herë e kanë dhënë arsytimin jo në rrezikshmërinë e kredive përbrenda Kosovës, për shkak se ky është një argument i cili fare nuk qëndron, siç u përmend edhe këtu, se përqindja e kredive të pakthyeshme në njëfarë mënyre është shumë e vogël në Kosovë, mirëpo e kanë ndërlidhur këtë kamatat e larta me një lloj rrezikshmërie, sipas së cilës vlerësohet gjendja e përgjithshme ekonomike dhe politike në Kosovë, pra kjo nënkupton për ta zbërthyer në gjuhë të thjeshtë që, po qe se një bankë e Kosovës dëshiron që të marrë kredi nga një bankë jashtë Kosovës, atëherë ajo kredi i vjen me një kamatë shumë të lartë për shkak të kësaj rrezikshmërie të cilën e vlerësojnë ato banka. Mirëpo, edhe ky argument sipas raportit të Bankës Qendrore të Kosovës nuk qëndron fare për shkak se shihet që megjithatë në sistemin bankar të Kosovës, pjesëmarrja e depozitave karshi detyrimeve, është mjaft e madhe, domethënë është pjesa më e madhe e aseteve me të cilën menaxhojnë bankat.

Bankat Kosovës nuk varen edhe aq nga kreditë nga jashtë, vetëm 2.3% të aseteve nën menaxhim të bankës, gjatë vitit 2010 kanë qenë kredi nga jashtë, ndërsa 78.9% kanë qenë depozita të qytetarëve të Kosovës. Pra këto janë ato depozita të cilat qytetarët e Kosovës ia japin bankës, para që ia japin bankës për të marrë diku 3.5 ose në rastin më të mirë 4% kamatë, ndërkohë që të njëjtat para pastaj banka ua jep ndërmarrëseve të Kosovës me kamatë 11, 15, 20 e 25%. Pra, ky argument i bankave nuk qëndron fare dhe këtu shihet që në njëfarë mënyre sistemi bankar i Kosovës, fatkeqësisht, funksionon si një lloj sistemi i legalizuar i fajdeve, ku ata me paratë tona na dënojnë neve pastaj. Dhje, rrjedhimisht, kjo shifër e madhe e profitit neto të bankave, nuk është fare e çuditshme për shkak se në këto kushte, natyrisht që këto banka kanë hapësirë shumë të madhe për të fituar, dhe natyrisht që kapitali privat, do ta shfrytëzojë secilën hapësirë për të përfituar. Dhe në këtë drejtim konsideroj që nevojitet ose është e domosdoshme që të intervenojë

Banka Qendrore e Kosovës, por edhe Qeveria e Kosovës përmes planeve dhe përmes mekanizmave të mirëfilltë financiar që do ta bënin këtë sistem bankar ose të mirë dhe të dobishëm për ekonominë e Kosovës ose do ta bënin të parëndësishëm për ekonominë e Kosovës, duke e organizuar ose duke e bazuar financimin e ekonomisë së Kosovës nga bankat të cilat nuk punojnë për profit edhe nga fondet të cilat e kanë atë qëllim. Pra, është e domosdoshme që Kosova të lëvizë kah intervenimi më i shpeshtë edhe më i vendosur i politikës në ekonomi, përndryshe natyrisht që do ta vazhdojmë këtë gjendje, që ta kemi këtë gjendje të vazhduar edhe për një kohë të gjatë.

Vetëm edhe një gjë desha ta përmend për këtë raport ose për çka mungon në këtë raport. Aty te mbikëqyrja e kompanive të sigurimeve, po ashtu edhe aty Banka Qendrore në disa raste ka dështuar që të ndërhyjë dhe ta rregullojë tregun e kompanisë të sigurimeve. Tastin më të mirë e kemi me bashkatdhetarët kosovarë të cilët jetojnë jashtë dhe të cilët vijnë në Kosovë dhe paguajnë nga 50 euro. Në asnjë moment Banka Qendrore nuk ka bërë asgjë kundër kësaj premie shumë të lartë për këta bashkëqytetarë dhe kundër kësaj forme shumë perfide të dënimit, të cilën Kosova ua bën bashkëqytetarëve që jetojnë jashtë vendit. Pra, Banka Qendrore e Kosovës përfundimisht ose duhet të jetë më aktive dhe ta marrë këtë çështje në duar të veta, meqenëse i takon, e nëse ka natyrisht pengesa ligjore, ato duhet të zgjidhen ose vërtet shumë lehtë ne mund të themi që nuk jemi Bankë Qendrore. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të AAK-së, Xhevdet Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Ju faleminderit, i nderuari zoti kryetar!

Kolegë deputetë,

Unë nuk do t'i përsëris ato çka përsëritën kolegët, por e kam pasur më lehtë të lexoj raportin për arsye se e kam pasur raportin e vitit 2009, kur e kam lexuar vjet dhe për kureshtje, kryetari i Bordit thotë që në vitin 2010, ka shumë risi, ndërsa raporti i përmbajtur thuaja se e ka të njëjtë, përveç në vitin 2009, ky raport e ka ngjyrën kaltër të çelët, ndërsa ky e ka të mbyllët. Dhe kuptohet që rritjen ekonomike dhe disa shifra, ka bërë disa ndryshime. Unë do të ndalem tek institucionet financiare, kur kjo bankë qendrore edhe i licencon. Do të isha ndalur te institucionet mikro - financiare, institucione këto të cilat kapitalin e vet e krijojnë në bazë të donacioneve dhe në bazë të atyre donacioneve duhet ta financojnë ndërmarrjet e vogla, të mesme dhe ekonominë familjare. Unë kisha për të thënë që ndërmarrjet e vogla dhe të mesme kanë dështuar, se nuk i financojnë për arsye se kamatat janë shumë të larta deri në 20% e ndoshta ekonominë familjare e financojnë, se këtu pajtohem për arsye se një numër shumë i madh i qytetarëve të Kosovës marrin kredi në këto institucione mikro-financiare, por këto kredi i marrin ja për konsum, ja për organizim të ndonjë kanagjeqi, do të thotë në këtë aspekt ka përparim se bëhen bashkime familjare. Do të thotë, është një problem se kamatat në këto institucione mikro-financiare janë mjaftë të larta edhe pse kryesisht këto institucione, kapitali i tyre është me donacione të cilat do të kishin ndikuar në rritjen ekonomike.

Një diçka tjetër që do të kishte për ta krye Banka Qendrore dhe që e ka për qëllim, është që bashkërisht me Qeverinë, me Ministrinë për Ekonomi dhe Financa të përgatitë Ligjin mbi letrat me vlerë. Në mungesë të këtij legjislacioni të letrave me vlerë, edhe Trusti Pensional letrat me vlerë i ka jashtë Kosovës, i ka në ndërmarrjet jashtë Kosovës, të cilat ne i japim me 1%, ndërsa ata i japin me 10 ose 11%. Do të thotë, në këtë drejtim Banka Qendrore, pasi që nuk merret me emetimin e parave dhe nuk e ka me ligj, sepse paratë tona euro i marrim si duket nga Banka e Frankfurtit, ata e bëjnë emetimin e parave dhe euros edhe për Kosovën, atëherë le t'i kryejnë këto detyra të pakta që i kanë me ligj.

Një çështje tjetër që është dhe mungon dhe që duhet të jetë në raportin tjetër, e që me të vërtetë ka risi, Bordi duhet të shkruaj më tepër për veten, duhet të shkruaj më tepër për punën që është duke e bërë në Bankë Qendrore të Kosovës dhe faktikisht mos t'i përsëritë raportet vit më vit të njëjtat përveç rritjes ekonomike ose të eksportit dhe importit ose ndonjë shifër tjetër. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputeti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Ju faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne e kemi para vetës një raport i cili domethënë e përshkruan pak a shumë ngjashëm me shumë raporte që kemi lexuar, më tepër situatën ekonomike të Kosovës në sektorë të ndryshëm, me përqendrim në sektorin financiar dhe si i tillë ai i ka paketuar informatat të cilat kanë qenë në disponim, në disa pjesë shkon më tutje në analiza, mirëpo ajo që i mungon këtij raporti, është se disa probleme me të cilat ballafaqohemi, të cilat janë prezente dhe me të cilat ballafaqohemi në sektorin financiar, janë adresuar në mënyrë tepër teknike, në mënyrë të zakonshme, jo në mënyrë shumë analitike dhe me propozimin e rrugë zgjidhjeve. Në këtë drejtim, e unë mendoj se kolegu im Xhevdeti pati të drejtë, sepse në këtë raport ne nuk shohim se si Bordi i Bankës Qendrore të Kosovës iu ka qasur këtyre problemeve dhe çka ka ndërmarrë Bordi? Nuk kemi përgjigje çfarë ka ndërmarrë ky Bord i Bankës Qendrore për rritjen e konkurrencës në sektorin e kredisë, në mënyrë që të ulen normat e interesit.

Nuk kemi shumë informatat tjera, cilat janë aktivitetet, të cilat janë masat, cili është bashkë tentimi i këtij Bordi që bashkë me institucionet tjera të përmirësojnë situatën në këtë sektor edhe më tutje. Përndryshe, roli i sistemit bankar është që të mobilizojë mjetet e lira financiare dhe këto mjete në mënyrë të volitshme t'i plasojë tek ata të cilët kanë nevojë. Natyrisht, ky Bord e ka krijuar, ky sektor financiar dhe brenda tij edhe Banka Qendrore e Kosovës, kanë krijuar një status quo në këtë sektor, i cili rezulton të jetë jo efektiv në rritjen e sektorit të prodhimit dhe në rritjen e punësimit dhe në rritjen e investimeve.

Kjo status quo karakterizohet me faktin se, domethënë, kemi një rritje të depozitave, tash kohëve të fundit ma ngadalshëm se përpara, kemi një përcjellje të ngadalshme të rritjes së kredisë, por kemi një vendnumrin në normat e interesit dhe shtrohet pyetja pse? Shkaku

kryesor qëndron pse domethënë, rritja e ofertës së kredisë është shumë më e ngadalshme se rritja e kërkesës. Dhe, rritja e ngadalshme e ofertës, vazhdimisht më e ngadalshme se sa e kërkesës për kredi, i mundëson sektorit financiar që të qëndrojë mirë, të ketë fitime të larta dhe rrezik të vogël dhe mua për këtë nuk është çudi që bankat në Kosovë kanë performancën më të mirë sa i përket profitit.

Dhe tash roli i Bankës Qendrore natyrisht se është që ta ruajë stabilitetin e këtij sektori financiar dhe kjo deri më tani është realizuar me sukses. Por, BQK-ja ka edhe një rol tjetër shumë me rëndësi, është që ta rregullojë këtë sistem, që këtu të jetë konkurrenca e cila do të shpie në uljen e normave të interesit dhe në furnizimin e bizneseve me kredi më të volitshme. Në këtë drejtim kemi dështime, për këtë problem diskutojmë shumë gjatë, por nuk ka zgjidhje, nuk ka rezultate. Nuk ka rezultate sepse, as Banka Qendrore, por mund të them as Qeveria, nuk po arrin që ta rritin ofertën e parasë në Kosovë.

Në një, nuk arrin që t'i kthejnë domethënë mbi një miliardë mjete për të cilat u fol, nuk dëshiroj t'i përsëris, që t'i kthejnë dhe t'i fusin këtu në aktivitete ekonomike, në financimin e bizneseve.

Dhe nën dy, nuk arrin që të fusin aktorë të rinj në sistemin e kredive dhe financave. Në tri vjetët e fundit ne nuk kemi aktorë të rinj në këtë sektor. Dhe konkurrenca mund të rritet vetëm në dy mënyra, duke rritur ofertën e parasë dhe duke futur aktorë të rinj e ky është pikërisht roli i Bankës Qendrore, por duhet të jemi të sigurtë se nuk është vetëm i Bankës Qendrore, është edhe i Qeverisë. Ajo që është problematike është se nuk ka përpjekje të koordinuara, nuk ka politika dhe nuk ka angazhim që kjo të ndodhë.

Ne kënaqemi me përgjigjet negative se nuk mund të kthehet Fondi i Pensioneve, nuk mund të përdoren paratë e privatizimit edhe këtu përfundon gjithçka, nuk kemi angazhim që situata të ndryshojë. Unë jam i bindur që mund të ndryshojë dhe për këtë shpeshherë edhe janë dhënë propozime.

Prandaj, unë do të doja që Banka Qendrore, bordi i saj edhe institucione tjera të preokupohen me këtë problem dhe ta zgjedhin një herë e përgjithmonë.

Përndryshe, janë disa sinjale nga ky raport që nuk janë të mira. Shikoni pjesëmarrjen e ndërmarrjeve private në kredi, në 2007 ka qenë 77%, tash ndërmarrjet marrin pjesë 70%, domethënë, ato që krijojnë vende të punës marrin më pak kredi se sa që kanë marrë para katër vjetëve. Kjo tregon se nuk mund t'i përballojnë ato kredi, jo që s'kanë nevojë ato, po i përdorin këto mjete që i ofron sistemi bankar mund të përdoren vetëm për periudha afatshkurtra, jo për investime kapitale, ajo që i duhet Kosovës.

Mandej, shikoni strukturën e kredive brenda, sektori i prodhimit ngel konstant në të njëjtën gjë, është pjesa e asaj status quoje ose zvogëlohet.

Dhe të gjitha këto çështje pra duhet të analizohen dhe gjenden politikat që të tejkalohet situata. Përndryshe, raportet të tilla që teknikisht janë në rregull dhe profesionalisht janë në rregull, nuk do të na zgjidhin problemin. Problemin do të na zgjidhin vetëm politikat

të cilat e çrregullojnë domethënë e trandin status quon e cila vazhdon të jetë në dëm të bizneseve e në dobi të bankave të sistemit të bankave që aktualisht janë prezent, të cilat domethënë qëndrojnë mirë për shkak të konkurrencës jo të ashpër në këtë sektor. Për ndryshe vetëm të them edhe në fund që ne, domethënë e përkrahim Raportin e Komisionit. Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah Raportin e Komisionit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS-së, nuk ka.

Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar Raportin vjetor të punës për vitin 2010 të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës si dhe raportin vjetor me pasqyrat financiare dhe si të tillë do ta votojë për miratim. Faleminderit!

KRYETARI: Shaip, a e ke kërkuar fjalën? Hajt çka do të na thuash?

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Lidhur me raportin edhe unë do ta votoj, mirëpo kam disa propozime praktike të cilat janë duke rënduar jetën e qytetarëve në funksionimin e tanishëm të sistemit bankar në Republikën e Kosovës.

Ne mund t’i kishim arsyetuar veprimet siç i bëjnë bankat momentale sot nga ato kamata të larta që fundosin zhvillimin ekonomik, qoftë nga ajo pjesa familjare deri tek ajo e biznesit të lartë.

Mirëpo, shtrohet pyetja pse ekziston kjo formë? Faktorët e rrezikut të cilët unë mendoj edhe ata që na këshillojnë neve, nuk janë valid të mjaftueshëm, mirëpo nuk ekzistojnë mekanizma që janë konkurrues të këtyre bankave.

Në disa seanca paraprake kur kemi folur për sistemin bankar se si t’i menaxhojmë edhe mjetet të cilat gjenden jashtë Republikës së Kosovës, unë mendoj që Kuvendi dhe Komisioni përgjegjës të jetë pak më azhur të thirret një herë në 3 muaj, jo një herë në vit të raportohet nga banka, mirëpo të thirret dhe të analizohen mundësitë se si të menaxhohet para e cila gjendet jashtë Republikës së Kosovës.

Njëra ndër propozimet kanë qenë edhe letrat me vlerë të cilat do të jenë njëra ndër forcat stimuluese që nga biznesi i ulët familjar deri tek bizneset tjera më të larta dhe të cilat do të ishin të kontrollueshme me kamatë më të ulët dhe do të ishin konkurrues për bankat që janë ekzistuese momentale këtu.

Një bankë për shembull që është iks bankë në Kosovë edhe nëse merr kredi për vete ajo merr me 2.5% në grejs periodë, ndërsa qytetarëve të Republikës së Kosovës duke i rënduar me fakte, duke marr faktorë të krizës dhe të gjitha i ngrit mbi 15%, është

fundosëse edhe kushtet e tërheqjes së kredisë janë fundoseshe, pa asnjë garancion të menjëhershëm, do të thotë.

Kështu që unë e përkrah raportin, mirëpo megjithatë Komisioni për Ekonomi, të cilët janë më të thirrur, të marrin edhe ekspertë tjerë t'i ndihmojnë edhe Qeverisë edhe Ministrisë së Financave, që të ngritët një Komision për aktivizimin sa më të shpejt të letrave me vlerë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Valbonë, e ke kryer fjalën, më duket.

Nuk ka të lajmëruar tjerë për diskutim.

Unë pajtohem me disa diskutime që u thanë këtu, por realisht ndoshta do të ishte mirë që dy komisionet, Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, ta analizojnë situatën mbi bazën e këtyre raporteve dhe raportit të Trustit të Kursimeve dhe të raportit të Agjencisë së Privatizimit të Kosovës dhe realisht ne ta zhvillojmë një debat, t'i bëjmë disa rekomandime se është një fjalë thuhet: "i varfëri i mbanë dy shtëpi" po më duket edhe Kosova e varfër po i mban dy shtëpi, po jo shtëpinë e vet.

Po shkojmë në votim.

Prezentë janë 67 deputetë.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash.

Konstatohet se me 60 vota "për", 2 "kundër" dhe 4 abstenime, Kuvendi miratoi Raportin vjetor të punës së Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2010.

Dhe vazhdojmë me pikën e radhës:

18. Shqyrtimi i Propozimit të Avokatit të Popullit për zgjedhjen e zëvendësve të tij

Avokati i Popullit në bazë të nenit 8, paragrafëve 2, 11 dhe 13 të Ligjit për Avokatin e Popullit dhe nenit 11, paragrafi 4 të Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të Avokatit të Popullit i ka propozuar Kuvendit listën me emrat e 5 kandidatëve për zëvendës të Avokatit të Popullit.

Komisioni funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, ka shqyrtuar propozimin e Avokatit të Popullit lidhur me emërimin e zëvendësve të Avokatit të Popullit dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ftoj kryetaren e Komisionit Funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, deputeten Suzan Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, në mbledhjen e mbajtur më 25 gusht 2011, duke u bazuar në Ligjin për avokatin e Popullit

dhe Rregulloren për përzgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij, ka formuar panelin rekrutues në përbërje:

- Rita Hajzeraj, kryesuese,
- Kurtan Kajtazi,
- Albana Gashi,
- Bisekra Kostiq,
- Kimete Bajraktari,
- Duda Balje, të gjithë anëtarë.

Paneli ka shqyrtuar dokumentacionin e kandidatëve, të cilët kanë konkurruar për postin zëvendës të Avokatit të Popullit.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit për kandidatët që kanë plotësuar kushtet sipas konkursit, dokumentacioni i 27 kandidatëve që i kanë përmbushur kërkesat formale sipas konkursit i është dorëzuar institucionit të Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit ka bërë përzgjedhjen e 5 kandidatëve për zëvendës të Avokatit të Popullit dhe Komisionit ia ka proceduar listën me emra të përzgjedhur për procedim të mëtutjeshëm.

Komisioni, i përfaqësuar nga të gjitha grupet parlamentare, në mbledhjen e mbajtur më 15 shtator 2011, shqyrtoi listën dhe mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve nga Avokati i Popullit.

Unanimisht konstatoi se veprimet e Avokatit të Popullit lidhur me përzgjedhjen e kandidatëve janë në mospajtim me nenin 8.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nenit 11.3 të Rregullores për përzgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij dhe nenit 2.12 dhe neni 3 të Ligjit për barazinë gjinore.

Avokati i Popullit me panelin intervistues ka kryer intervistim dyditor të kandidatëve me çka ka shkaktuar diskriminim të kandidatëve të ditës së parë në raport me kandidatët e ditës së dytë, dhe ka shkaktuar konkurrencë jo fer, jo objektive dhe favorizuese.

Duke u bazuar në këto shkelje Komisioni unanimisht vendosi që Kuvendit t’ia paraqes këtë:

REKOMANDIM

Propozojmë të mos miratohet lista e kandidatëve të propozuar për zëvendës të Avokatit të Popullit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave ligjore. Procedura e mëtutjeshme lidhur me zgjedhjen e zëvendësve të Avokatit të Popullit të zhvillohet në pajtim me dispozitat e Ligjit për Avokatin e Popullit dhe Rregulloren për përzgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit si dhe zëvendësve të tij dhe Ligjit për barazi gjinore dhe ligjeve tjera.

A RSYETIM

Avokati i Popullit ka bërë përzgjedhjen e 5 kandidatëve për zëvendës të Avokatit të Popullit dhe Komisionit ia ka proceduar listën me emra të përzgjedhur për procedim të mëtutjeshëm.

Komisioni në takimin e mbajtur më 15 shtator 2011, shqyrtoi listën e kandidatëve të përzgjedhur nga Avokati i Popullit, unanimisht vlerësoi se veprimet e Avokatit të Popullit lidhur me përzgjedhjen e kandidatëve janë në mospajtim me nenin 8.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nenit 11.3 të Rregullores për përzgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij, dhe nenit 2.2.12, nenit 3 të Ligjit për barazi gjinore.

Avokati i Popullit, me panelin e zgjedhur intervistues ka intervistuar, domethënë me intervistë gojore kandidatët në dy ditë të njëpasnjëshme, çka kandidatët e ditës së parë janë diskriminuar në raport me kandidatët e ditës së dytë, sepse kandidatët e intervistuar në ditën e dytë kanë pasur mundësi shumë më të madhe të marrin pyetjet e intervistimit dhe duke i ditur pyetjet në intervistim të jenë më të përgatitur.

Me këtë është shkaktuar konkurrencë jo fer, jo objektive dhe favorizuese.

Nenet e ligjeve të cilat nuk janë respektuar nga Avokati i Popullit janë cekur më lart, është bërë shkelje e barazisë gjinore, diskriminim gjinor, me përzgjedhje të 4 zëvendësve të Avokatit të Popullit meshkuj dhe një femre.

Në krye të IAP-së me këtë përzgjedhje së bashku me Avokatin e Popullit do të ishin 5 meshkuj dhe një femër. Në këtë përzgjedhje së paku është dashur të zgjidhen 2 femra dhe 3 meshkuj.

Për fund me që nuk i keni në rekomandim më duhet të shtoj se është bërë shkelje e Kushtetutës së Kosovës, nenit 7.2 ku thotë, citoj: “Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabartë për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat tjera të jetës shoqërore.” Gjithashtu më duhet të theksoj se nuk është respektuar pika... e Raportit të Progresit, ku thotë: “Pjesëmarrja e femrës në tregun e punës mbetet jashtëzakonisht e ulët dhe përfaqësimi i femrave në vendimmarrje mbetet një sfidë”. Prandaj, duke i vlerësuar shkeljet e kryera nga një institucion shumë i rëndësishëm, Komisioni unanimisht mori vendim si në rekomandim. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Unë kisha kërkuar nga deputetët edhe në komisione që vërtet të kenë kujdes sa herë se edhe deputetët bien në konflikt të interesit dhe ne jemi ata që duhet të kemi kujdes nga konflikti i interesit.

Sigurisht që me ligj është e drejtë e Avokatit të Popullit ta bëjë përzgjedhjen dhe ai e ka bërë përzgjedhjen, sigurisht që nuk e ka pasur lehtë, se është dashur të këqyren nacionalitetet, është dashur ta ketë parasysh edhe gjininë, por është dashur ta shikojë

edhe anën e cilësisë së të përzgjedhurve. Dhe realisht unë e kam parë dokumentacionin dhe konsideroj që e ka kryer detyrën e vet mbi bazën e ligjit.

Por, tani ftoj kryetarët e grupeve parlamentare që ta thonë fjalën e tyre.
Në emër të Partisë Demokratike, kush e do fjalën?
Fjalën e ka deputetja Justina Shiroka- Pula.

JUSTINA SHIROKA- PULA: Faleminderit, kryetar!
Grupi Parlamentar i PDK-së e ka analizuar me vëmendje listën e propozuar nga Avokati i Popullit.

Gjithashtu e ka diskutuar me shumë vëmendje edhe raportin nga Komisioni funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore për Persona të Pagjetur dhe Peticione. Ndërkohë, ekspertë e grupit parlamentar e kanë konsultuar ligjin e Avokatit të Popullit dhe rregulloren për përzgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve dhe ka rekomanduar se procedurat për përzgjedhje janë konform të gjitha rregullave.

Prandaj, Grupi Parlamentar i PDK-së e miraton listën e propozuar nga Avokati i Popullit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Imri Ahmeti e ka fjalën.

IMRI AHMETI: Faleminderit, kryetar!
Të nderuar kolegë deputetë,
Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, duke shqyrtuar raportin e Komisionit funksional, do ta mbështetë këtë raport, pavarësisht që ka mund të ketë ndonjë konflikt interesi , megjithatë ky është një raport i kolegëve tanë deputetë dhe thuhet që është raport unanim i këtij grupi të deputetëve dhe ka deputetë edhe të koalicionit të partisë në pushtet, kështu që Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e mbështet rekomandimin e Komisionit funksional.

KRYETARI: Faleminderit!
Në emër të “Vetëvendosjes”, deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERY: Faleminderit, kryetar!
Vetëm desha një herë një qartësim ta bëj, përfaqësuesja jonë në këtë Komision, në mbledhjen për të cilën po flasim kur është marrë ky raport nuk ka qenë e pranishme, pra, nuk është se aty ka qenë përfaqësimi i të gjitha partive në atë mbledhje kur është marrë ky raport, jo në të gjitha, vetëm këtë qartësim desha ta bëj.

Në anën tjetër konsideroj që këto vërejtje të cilat janë dhënë nga Komisioni për përzgjedhjen nuk qëndrojnë. Pra, në njërin anë nëse shikohet ligji, por edhe ..të cilës te ky Komision i referohen, ato duket se intervistimi edhe përzgjedhja e këtyre kandidatëve është bërë konform këtyre rregullave. Tash ne mund të mos pajtohemi me rregullat, mirëpo nuk mund të themi që ka pasur shkelje aty. Unë konsideroj që natyrisht që për sa i

përket përzgjedhjes së zëvendësve të Avokatit të Popullit, pajtohem me ty që sigurisht se e kanë pasur të vështirë t'i përzgjedhin dhe këtu veçanërisht jo vetëm në këtë rast, por në të gjitha rastet kjo kuota veçanërisht etnike po më duket se po shkon në dëm të profesionalizmit të agjencive edhe institucioneve të pavarura, për shkak se personat po zgjidhen aty bash për përkatësinë e tyre etnike, jo për shkak të ndonjë përgatitje profesionale që kanë për vendin dhe kjo natyrisht që është një lloj dëmi që po i shkaktohet institucioneve në Kosovë në përgjithësi. Dhe argumenti se e ka përdorur Komisioni për intervistimin e kandidatëve që janë intervistuar në dy ditë të ndara e jo në një ditë, unë po ju them shumë sinjerisht të nderuar kolegë deputetë, 27 kandidatë nuk mund të intervistohen për një ditë, është e pamundshme, përveç nëse krijohen dy panele intervistuese. Pra, kjo do të shkaktonte probleme tjera.

Dhe unë mendoj që ky si argument i cili është vendosur nga Komisioni .. është argument i paqëndrueshëm.

Pa hyr në listën e emrave për të cilët ne si grup parlamentar edhe unë personalisht nuk e njohim asnjërin pra rrjedhimisht nuk e dimë asnjërin se kush është as çka është, po flas vetëm për procedurat, për shkak se procedurat janë ato që janë problematizuar nga Komisioni dhe unë nuk po shoh kurrfarë parregullsie në këto intervista. Pra, është edhe një dokument i cili nuk i është dorëzuar deputetëve, nuk e di a ka pas nevojë të dorëzohet a jo, po me sa po e marr vesh nuk i është dorëzuar madje as anëtarëve të Komisionit, dokument të cilin e ka dorëzuar Avokati i Popullit, më 10 shtator në Komisionin në fjalë për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, ku përmes dokumenteve të ndryshme dhe përmes listave të gradimit dhe votimit të këtyre kandidatëve të gjithë kandidatëve, është dëshmuar qartë, një farë mënyre është dokumentuar se si ka vijuar i tërë procesi i përzgjedhjes, i thirrjes së kandidatëve në intervista, intervistimi i tyre, dhënies së pikëve për secilin dhe pastaj si kemi ardhur deri te kjo listë me 5 emra.

Dhe nga ky dokument për aq sa kam mund të vërej unë nuk shoh kurrfarë parregullsie dhe nuk shoh ndonjë gjë që ka ndodhur që na e arsyeton neve si Kuvend ose na jep bazën neve si Kuvend për ta kthyer këtë listë prapa.

Prandaj, Grupi Parlamentar i lëvizjes “Vetëvendosje” konsideron që arsyetimet të cilat janë përdorur nga Komisioni, nuk janë të qëndrueshme edhe nuk paraqesin ndonjë bazë që të mos votojmë këtë listë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të AAK-së, deputeti Ardian Gjini, e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ne mendojmë se Kuvendi e ka zgjedhur Avokatin e Popullit dhe për çka do që ndodhë ne mund ta mbajmë përgjegjës Avokatin e Popullit dhe duke pasur parasysh se të gjitha procedurat janë ndjekur në rregull, siç u tha edhe më përpara, mendojmë se nuk kemi tjetër arsye përpos nëse do të ishte

subjektive që të mos e votojmë listën që na ka ardhur, kështu që në bazë të kësaj logjike, Grupi Parlamentar i Aleancës do ta votojë këtë listë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të SLS-së, deputetja Biserka Kostiq e ka fjalën.

BISERKA KOSTIĆ: Zahvaljujem, gospodine predsedavajući!

Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke je u dotičnoj komisiji aktivno učestvovala preko svojih članova u toku čitavog procesa izbora zamenika Narodnog advokata.

S obzirom da, kako je već navedeno, da je institucija Narodnog advokata prekršila niz odredbi vezanih za odabir svojih zamenika, da ne nabrajam članove koje je već predsednica komisije iznela u svom govoru. S hodno tome, Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke neće podržati predlog Narodnog advokata o izboru svojih zamenika već predlog funkcionalne komisije, sa obrazloženjem smatramo da baš ta institucija Narodnog advokata ne bi smela da ima takve propuste. Hvala!

KRYETARI: Në emër të Grupit “6+”, deputetja Duda Balje e ka fjalën.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Na izbor Narodnog advokata za 5 kandidata kao zamenika Narodnog advokata imalo sledeće primedbe koje su generalno iste kao i primedbe funkcionalne komisije.

Postupak izbora zamenika Narodnog advokata je bio neregularan, jer su kandidati intervjuisani u dva dana jedan za drugim, bez promene pitanja, što automatski znači da su pitanja kandidatima u drugom ispitnom danu bila poznata.

Druga anomalija izbora se odnosi na nepoštovanje polne ravnopravnosti. U aktuelnom slučaju je trebalo da se izaberu dve pripadnice ženskog pola i tri kandidata muškog pola. Zbog svega navedenog, ne podržavamo predlog Narodnog advokata, već podržavamo predlog funkcionalne komisije. Zahvaljujem!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Blerta Deliu- Kodra.

BLERTA DELIU- KODRA: Faleminderit, kryetar!

Zgjidhja e zëvendësve të Avokatit të Popullit ka qenë edhe kërkesë e Raportit të Progresit për dy vjet me radhë.

Një kërkesë e tillë është përsëritur edhe nga përfaqësuesit e Komisionit Evropian, në Prishtinë, të cilët kanë kërkuar që sa më shpejtë që është e mundur të zgjidhen zëvendësit e Avokatit të Popullit. Edhe komisionari Stefan Fule ka rekomanduar që të merren në konsideratë kërkesat e këtij institucioni. andaj po besoj se sot është një ditë e mirë, pasi që kemi para vetes listën e propozuar me emrat për zëvendës të Avokatit të Popullit.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit besoj se Kuvendi i Kosovës duhet të votojë këtë listë dhe përfundimisht ky institucion të kompletohet me stafin e kërkuar edhe me Ligjin për Avokatin e Popullit. Në këtë mënyrë ne i dërgojmë edhe sinjale të qarta Brukselit se

institucionet po i përmbushin kriteret e kërkuara, por edhe në këtë mënyrë përmbushja e këtyre kriterëve konsideroj se do të sjellë edhe rezultate në funksionimin dhe realizimin e misionit të Avokatit të Popullit, të përcaktuar me Kushtetutë dhe me ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Ramiz Lladrovci e ka fjalën.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Shumicën e rasteve në këtë Parlament rekomandimet që vijnë nga komisionet merren si të sakta dhe procedohen më tutje duke i mbështetur ato, megjithatë, një vëmendje më e madhe se si bëhen rekomandimet dhe sa janë korrekte ato ndikon se si do të votojmë ne si deputetë.

Besoj se një vëmendje e veçantë meriton raporti i sotëm i Komisionit parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore për Persona të Pagjetur dhe Peticione, kjo për dy arsye.

E para, në Raportin e Progresit të vitit 2010, Kuvendi i Kosovës është përmendur se nuk e ka bërë përzgjedhjen e zëvendësve të Avokatit të Popullit, gjë që është obligim ligjor i Parlamentit, që të mos përsëriten e njëjta vërejtje në Raportin e ardhshëm të Progresit, një gjë e tillë duhet sa më shpejtë e siç e dini tashmë jemi me vonesë në këtë pikë.

Çështja e dytë ka të bëjë me listën e kandidatëve të cilët Komisioni parlamentar edhe pse këtë nuk ja lejon ligji, ia propozon Avokatit të Popullit. Është e çuditshme se si në këtë radhitje të kandidatëve që e bën ky Komision parlamentar shfaqet po i njëjti fenomen që Komisioni e gjen si shkelje të propozimet që i ka bërë Avokati i Popullit. Ndër 5 të parët e preferuar të Komisionit parlamentar ndodhet vetëm një femër. Për çudi kjo është motra e kryetares të këtij Komisioni. Po ashtu edhe pse Komisioni në arsyetimin e tij deklaron se radhitjen e ka bërë duke vlerësuar profesionalizmin dhe CV-të e kandidatëve, pas shikimit të kujdesshëm vërehet se të katërtin në radhë e vendos një praktikant në këtë Komision, i cili pa shqyrtuar fare CV-në e tij nuk ka moshë që të ketë përvojë për pozitën e zëvendësit të Avokatit të Popullit.

Në anën tjetër, Ligji për barazi gjinore parasheh kuotën gjinore brenda institucioneve në organet vendimmarrëse. Sa kam marrë informacion institucioni i Avokatit të Popullit, në aspektin gjinorë të punonjësve është përafërsisht 50 me 50, 50 femra, 50 meshkuj. Ndërkaq, sa i përket vendimmarrjes institucioni i Avokatit të Popullit është institucion monarkik, prandaj organ vendimmarrës në këtë institucion është vetëm Avokati i Popullit dhe jo zëvendësit e tij, gjë që nuk e kërkon domosdoshmërisht kuotën gjinore.

Lista e propozuar nga ana e Avokatit të Popullit, pasi kandidatët kanë kaluar procedurat e testimit me shkrim dhe me gojë, ka në përbërjen e saj një femër, ka një kandidat nga pakica turke dhe një kandidat nga minoriteti serb, gjë që nuk e kishte në radhitjen e vet propozimi i Komisionit parlamentar.

Dosja e dorëzuar prej institucionit të Avokatit të Popullit në lidhje me propozimin e listës së kandidatëve për zëvendës të Avokatit të Popullit është e përgatitur në mënyrë

profesionale dhe pasqyron në mënyrë të detajuar dhe transparente tërë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve të propozuar.

Ky është një shembull për përgatitjen dhe transparencën e një procesi të rekrutimit, prandaj përfundimisht lista e kandidatëve të propozuar nga Avokati i Popullit nuk është në kundërshtim me Ligjin për Avokatin e Popullit dhe as Rregulloren e këtij Parlamenti, as me procedurat sepse kjo nuk është përshkruar askund.

Prandaj, lista e propozuar nga Avokati i Popullit do të duhet të ketë mbështetjen e të gjithë deputetëve dhe ju ftoj ta votoni. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, Suzan Novobërdaliu e ka fjalën.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Për informatë, përfaqësuesit të lëvizjes

“Vetëvendosje” dëshiroj t’i tregoj që nuk kanë qenë në pyetje 27, po 22 kandidatë, i shikoni pak më mirë dhe nuk është e vërtetë që Albana Gashi, nuk ka marrë pjesë në komisione, ka marrë pjesë në panelin rekrutues.

E dyta, deputeti i fundit tha se ka konflikt, u përmend konflikti i interesit, nuk kam qenë pjesë e panelit rekrutues, çfarë liste ka shkuar nuk kam qenë pjesë e panelit rekrutues dhe ju kisha lutur të jeni më profesional në këtë çështje. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Replikë, Visar Ymeri.

VISAR YMERY: Unë nuk thashë që s’ka marrë Albana pjesë në mbledhje, po nuk ka marrë në mbledhjen kur e keni marrë këtë raport. Veç këtë, mendo të dëgjosh pak më mirë.

KRYETARI: Fjala është për deputetin Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit!

Dëshiroj veç të shtoj diçka që lidhet me Raportin e Progresit, që u përmend në dy raste këtu.

Na vjen mirë që standardi i dyfishtë po funksionon aty ku po dështon një grupim i partnerëve në koalicion, po plotësohet nga grupet e opozitës që s’është parimore, por është problem i tyre, e dinë ata që ne e dimë pse po bëhet kjo, po është krejt problem i tyre, kështu që i referohem dy çështjeve që lidhen me Raportin e Progresit.

E para është e vërtetë ajo që deputetja Novobërdaliu tha që Raporti i Progresit ..që dy vjet, që 4 vjet që e përmend kuotën e barazisë si problem në institucionet e Kosovës dhe në tregun e punës në Kosovë.

E dyta, pritjet që pasqyrimi i funksionimit të Avokatit të Popullit në Kosovë do të them janë penalizur veç nga ana e Komisionit, me vetë letrën që Avokati i Popullit ia ka dërgua Kuvendit. Avokati i Popullit, para 2 muajve na ka dërguar një letër që ka treguar për vështirësitë serioze që i ka.

Përveç zëvendësve që ka pasur problem, ai ka probleme shumë të tjera që lidhen me funksionimin e kësaj.

Sa i përket emërimeve, unë e kam mbështetur Avokatin e Popullit, unë besoj në vlerat e tij si njeri, si personalitet dhe si tash si përfaqësues i shtetit tonë, detyra kushtetuese e tij është që ta funksionalizojë këtë punë, por nuk i besoj përzgjedhjes së tij për zëvendës.

Kështu që nuk po flasim tash për Avokatin e Popullit, as s'po flasim për institucionin e tij, sepse Raporti i Progresit do të vijë edhe një javë në Kosovë e do ta lexojmë krejt, kjo që po e bëjmë sot është teknikisht e ndihmon, por pasqyrimi nuk e ndërron asgjë. Ndërsa në 5 kandidatura nuk ja ka qëlluar, se po flasim vetëm për një rast. Një përfaqësues që e përfaqëson etninë joshqiptare, jo serbe ai duhet të jetë mesë turqve dhe të tjerëve, nuk u zgjedh femër, por u zgjedh mashkull, këtu është ai dallimi shumë i vogël që është nxjerr në Kuvend, por përzgjedhja i takon atij, është fakt me ligj, por t' i pasur votat e krejt neve është dashur të mendohet më ndryshe, por unë i uroj sukses që zëvendësit t'i ndihmojnë në punën e vet.

KRYETARI: Faleminderit!

Realisht me ligj e ka krye detyrën e vet dhe unë kisha kërkuar nga deputetët që pasi është e drejtë ekskluzive e Avokatit të Popullit, ta kemi parasysh, dhe mos ta politizojmë është institucioni do të thosha prej të pavarur më kushtetues dhe duhet ta respektojmë edhe Kushtetutën edhe ligji mbi të cilën funksionon.

Kështu që kisha shkuar në procedurën e votimit.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Votojmë kandidatët e propozuar nga Avokati i Popullit. Votojmë tash:

Konstatohet se me 40 vota “për”, 25 “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi zëvendësit e Avokatit të Popullit me mandat 3 vjeçar sa vijon:

1. Basri Berisha,
2. Isa Hasani,
3. Bogoljub Steloviq
4. Shqipe Ibraj -Mala,
5. Ibrahim Asllani.

Pika e nëntëmbëdhjetë e rendit të ditës:

19. Njoftimi i deputetëve nga radha e komuniteteve ashkali, egjiptian dhe goran për ndarjen e mandateve për përfaqësimin e tyre në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve

Deputetët e komunitetit ashkali, egjiptian dhe goran të përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës, në bazë të marrëveshjes kanë propozuar ndarjen e mandateve në Komisionin për të Drejtat e Komuniteteve dhe për Kthim për një periudhë 12 mujore dhe si vijon:

1. Etem Arifi, mars 2011 – shkurt 2012,
2. Xhevdet Neziraj, mars 2012 – shkurt 2013, dhe
3. Mursel Halili, mars 2013 – shkurt 2014.

Të nderuar deputetë,

Kërkoj nga ju që përmes një votimi formal, me ngritje dore, të deklaroheni për propozimin e lartpërmendur.

Kush është “për”? Faleminderit!

A ka “kundër”? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Mirupafshim në seancën e radhës!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës